

*Botohet në kuadër të 550-vjetorit të vdekjes së heroit tonë
Kombëtar
Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*

Kryeredaktor:

Prof.asoc.dr.Sabit SYLA

Redaktor shkencor:

Prof.asoc.dr.Gjon BERISHA

Redaksia:

Prof.asoc.dr.Sabit SYLA

Akad. Marenglen VERLI

Prof. dr.Skënder ASANI

Akad. Beqir META

Prof.asoc.dr.Gjon BERISHA

Redaktore gjuhësore:

Ma.Shqipe DODA

Realizimi kompjuterik:

Prof.asoc.dr.Teuta SHALA-PELI

@2019 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë

Ueb: www.ih-rks.org

e-mail: institutihis@hotmail.com

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

**Gjergj Kastrioti-Skënderbeu
në 550-vjetorin e vdekjes**

*(Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Gjergj
Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes”, mbajtur në
Prishtinë, më 16 tetor 2018)*



Prishtinë, 2019

INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” – PRISHTINA

**George Castriota-Skanderbeg
on 550th anniversary of his death**

(Materials from International Conference dedicate: “*George
Castriota-Skanderbeg on 550th anniversary of his death*”,
Prishtina, 16 October 2018)



Prishtina, 2019

PËRMBAJTJA

Sabit SYLA- Fjala e hapjes

1. Gjon BERISHA

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe qëndrimi *modus vivendi* i Republikës së Raguzës.....13

2. Antal MOLNÁR

The Memory of Skanderbeg and the Beginning of the Albanian Catholic Nation Building.....41

3. Teuta SHALA-PELI

Përpjekjet për çlirimin e Drishtit nga sundimi venedikas, në kohën e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut.....53

4. Evalda PACI

Vepra e Marin Barletit në pikëpamje vëzhgimesh ndërdisiplinore. Interpretime e hollësi studimore rreth një ndërmarrjeje lapidare.....61

5. Csaplár-DEGOVICS KRISZTIÁN

The first appearance of the Hunyadi-Skanderbeg alliance in the Albanian historiography.....75

6. Eduart CAKA

Aspekte të situatës politiko-ekonomike të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV bazuar në regjistrat kadastralë osmanë të kësaj periudhe.....89

7. Qerim DALIPI & Besim MORINA

Rrethanat socio-etnike në nahijen e Tetovës, sipas regjistrimit të viteve 1467-1468.....101

8. Bedri MUHADRI

Beteja e Dytë e Kosovës, më 1448, sipas autorëve shqiptarë të kohës: Marin Barleti, Dhimitër Frangu.....123

9. Dominik QERIMI

Marrëdhënia e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Selinë Shenjtë, klerin dhe Kishën Katolike.....141

10. Adem BUNGURI

Të dhëna të reja mbi disa fortifikime të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës.....153

11. Muhamet BELA

A ishte Skënderbeu nga Hasi?! - Mendime rreth origjinës së Skënderbeut.....219

12. Enver REXHA

Historiografia serbe për Betejën e Dytë të Kosovës, 1448.....221

13. Petrika THËNGJILLI

Vështrim kritik mbi bazën dokumentare dhe bibliografike të Betejës së Dytë të Kosovës (1448).....237

14. Jakup KRASNIQI

Porosia e fundit e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe vlerat e saj për kohën tonë (Komentimi i fjalës së fundit të Skënderbeut)257

15. Iljaz REXHA

Skënderbeu nga këndvështrimi i kronikave klasike osmane dhe i historiografisë moderne turke.....261

16. Myrvete DRESHAJ-BALIU & Begzad BALIU

Portreti i Skënderbeut në letërsinë botërore.....281

17. Mirie RUSHANI

Gjeografia politike e Evropës në shek. XV dhe ideja për mbrojtje të përbashkët në luftën kundër invazionit turk.....301

**Prof. asoc. dr. Sabit SYLA - Drejtor i Institutit të Historisë
“Ali Hadri” - Prishtinë**

**FJALA E HAPJES NË KONFERENCËN SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE: “GJERGJ KASTRIOTI-
SKËNDERBEU NË 550-VJETORIN E VDEKJES”**

**I nderuari President i Republikës së Kosovës, z. Hashim
Thaçi,
I nderuari Kryeministër i Republikës Kosovës, z. Ramush
Haradinaj,
I nderuari Z. Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të R.
Kosovës,
Të nderuar ministra e deputetë, përfaqësues institucionalë,
dhe të korit diplomatik, zonja dhe zotërinj e gjithë ju të
pranishëm,**

Në kuadër të *Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*, jemi mbledhur sot, që përmes kësaj Konference shkencore ndërkombëtare të kujtojmë dhe nderojmë, atë që na dha emër si askush tjetër deri më sot - Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, në 550-vjetorin e kalimit të tij në amshim. Jemi sot, këtu, për ta kujtuar dhe respektuar atë që na bën të ndjehemi krenarë, duke personifikuar një epokë të tërë të historisë kombëtare të shqiptarëve.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu, hyri në skenën e historisë në një moment tepër kritik për Shqipërinë dhe për fatin e Evropës. Nën udhëheqjen e tij lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë të lartë e të organizuar, shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të vendit dhe në forcimin e vetëdijes kombëtare të tyre. Figura e tij paraqet një nga ato raste, jo të shpeshta në histori, kur shtresat e ndryshme shoqërore të një kombi takohen me një personalitet të shquar, në të cilën gjejnë shprehjen e vet aspiratat e vetitë e tyre më të mira dhe që për këtë arsye bëhet simbol i bashkimit kombëtar dhe i luftës së

tyre të përbashkët. Ai e kuptoi, më qartë se kushdo tjetër, detyrën që shtronte çasti historik, nevojën e bashkimit politik si kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e interesave të vendit.

Duke njohur këtë botëkuptim, se shqiptarët nuk mund të arrinin në fitore, pa kapërcyer copëtimin politik të vendit në një varg zotërimesh, pa një bazë organizative të qëndrueshme, pa bashkërendimin e mjeteve dhe të burimeve njerëzore, ekonomike, ushtarake e materiale e të gjitha veprimeve që zhvilloheshin në rrafsh të brendshëm me veprimet e ndërmarra në aspekt ndërkombëtar. Një nga hapat e parë në këtë drejtim që themelimi, me nismën e nën drejtimin e tij, i Besëlidhjes Shqiptare të Lezhës, që përbënte të parin bashkim të gjerë politik të shqiptarëve. Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me botën e jashtme. Përveç krijimit të marrëdhënieve me shtetet e sferës perëndimore, edhe me shtetin osman ka përfunduar dy marrëveshje.

Në vitin 1460 u arrit marrëveshja e bashkëpunimit trevjeçar, ndërsa marrëveshja e dytë është përfunduar në prill të vitit 1463 në Shkup. Ndërkohë, pas luftës, për qytetin e Dejës, më 4 tetor 1448, u nënshkrua Traktati i Paqes me Venedikun. Ky është dokumenti i parë që njohim deri tani, ku Lidhja Shqiptare del si subjekt i pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Zonja dhe zotërinj,

Me këtë rast, kur po përkujtojmë 550-vjetorin e heroit tonë kombëtar, është e rëndësishme të theksohet dashuria dhe respekti që gëzonte Skënderbeu nga të tjerët dhe roli i tij përbashkues. Kujtimi i Skënderbeut jetoi jo vetëm në zemrën e popullit që e lindi, por vepra dhe figura e tij mori përmasa me rendësi evropiane. Ai u lartësua nga personalitetet e shquara evropiane të kohës. Burri i shtetit anglez i shek. XVII, Uiliam Temple, e vë Skënderbeun në radhët e shtatë kapiteneve më të mëdhenj jo mbretër, pranë Belisarit e Huniadit, kurse filozofi frëng, Volter, ka shkruar: “Sikur perandorët bizantinë të qenë Skënderbe, Perandoria e Lindjes do të kishte shpëtuar”. Pra, jo

rastësisht është shkruar një literaturë e shumëllojtë, prej qindra vëllimesh, të botuara në shumë gjuhë dhe në katër anët e botës.

Skënderbeu i detyroi të gjitha kohërat të flisnin për të. Andaj, veprimtaria kombëtare e radhiti atë në grupin e figurave më emblematike, si shëmbëlltyrë e udhëheqjes luftarake, sakrificës e përpjekjeve për pavarësi politike dhe bashkim të të gjitha viseve shqiptare në një shtet kombëtar. Prandaj, vepra e tij patriotike ka inspiruar breza të tërë, u thurën këngë në popull, u emëruan sheshe, rrugë, shkolla, dhe u ngritën buste. Ai u bë frymëzim edhe në artin letrar, muzikor dhe në atë pamor.

Për fund, urojmë që kjo konferencë dhe i gjithë aktiviteti kushtuar *Vitit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*, të na shërbej si mundësi për të gjithë studiuesit për t'u njohur me gjetjet e reja shkencore, lidhur me epokën e Skënderbeut. Duke, ju dëshiruar punë të mbarë e të frytshme, i shpall të hapura punimet e Konferencës shkencore ndërkombëtare: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes”.

Ju falënderojmë për vëmendje!

Prishtinë, më 16 tetor 2018

Gjon BERISHA
(Prishtinë)

GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDËRBEU DHE QËNDRIMI MODUS VIVENDI I REPUBLIKËS SË RAGUZËS

Që nga fillimi i pushtimeve osmane në Ballkan, Raguzë shërbeu si qendër e informacioneve në Evropën e krishterë lidhur me rrethanat në Arbëri, ku zhvilloheshin luftime kundër pushtuesit osman dhe përmes Raguzës mbaheshin lidhje me mbretin hungarez Sigismundin.

Prandaj shumica e dokumente raguzane që trajtojnë periudhën pararendëse të Skënderbeut, janë lajme që Raguzë i ofronte Sigismundit për gjendjen në Arbëri dhe Bosnje. Vetë perandori dhe mbreti hungarez do t'u dërgonte zotit Andrea Topia dhe disa udhëheqësve tjera arbërorë letra dhe udhëzime, gjithnjë nëpërmjet Raguzë. Kjo formë e komunikimit përmes Raguzës, vërtetohet edhe nga vet Andrea Topia, i cili i shkruante perandorit se letrat e tua nuk i kemi por i marrim vesh tërthorazi nga Raguzë. Prandaj, Senati i Raguzës, i cili e njihte sovranitetin e perandorit mbi Raguzën, e informonte sistematikisht për depërtimin e ushtrive turke, luftën çlirimtare të arbërorëve dhe fitoret e tyre.

Në të vërtetë, këtë studim e kemi trajtuar duke marrë për bazë pozicionin dhe statusin e veçantë që kishte Republika e Raguzës në raport me Perandorinë Osmane. Andaj, nisur nga ky status, i kemi parë edhe qëndrimet e Raguzës në raport me luftën ashtiosmane të Skënderbeut.

Pikërisht, zhvillimi i marrëdhënieve tregtare me Arbërinë dhe qëndrimi i Republikës në raportet me Skënderbeun, ishin të përcaktuara edhe nga ky status i veçantë që kishte Raguzë me pushtuesin më të madh të kohës, Perandorinë Osmane. Të paktën, që nga viti 1460, Republika e Shën Vlashit u përball me dominimin e plotë osman në Ballkan. Në këtë kohë ushtria turke i ishte afruar kufijve të Raguzës. Në vitin 1463, osmanët mposhtën boshnjakët, madje vranë mbretin e fundit boshnjak. Dy vjet më vonë, pushtuesit osmanë, pushtuan pothuajse gjithë Hercegovinën - një territor që kishte qenë një njësi e veçantë politike brenda mbretërisë së Bosnjës, që nga gjysma e parë e shekullit XV – duke u bërë fqinj të drejtpërdrejtë të Republikës së Raguzës. Raguzanët, si tregtarë që ishin, kishin kuptuar shumë më herët se kjo do të ndodhte dhe kishin vendosur marrëdhënie diplomatike me osmanët. Kontaktet e para zyrtare politike filluan më 1392, kurse përpjekjet e raguzanëve për të negociuar garancinë për tregtinë e tyre në Ballkan, me *Sulltan Bajazidin I* (1389-1402), u kurorëzuan në vitin 1396. Pas kësaj, kontaktet vazhduan. Raguzanët intensifikuan kërkimet e tyre për një *modus vivendi*¹ me osmanët pas betejës së Varnës më 1444.²

Në vitin 1447, autoritetet raguzane kishin negociuar një traktat me turqit që i lejonte tregtinë e lirë në Ballkan, por më 1458 ndodhi një zhvillim i ri dhe shumë i rëndësishëm. Osmanët kishin këmbëngulur që raguzanët të paguanin një haraç vjetor, kurse Raguzë ishte përpjekur ta shmangte këtë me çdo kusht, sepse pagesa e këtij haraçi/tributi mund ta vendoste qytetin në pozitën e vasalitetit ndaj osmanëve. Megjithatë, pas rënies së Bizantit dhe pas vdekjes së despotit *Gjergj Brankoviqit* në vitin 1456, si dhe me këmbënguljen dhe aftësinë e sulltanit të ri, Raguzë u detyrua të fillojë në vitin 1458 pagesën e haraçit në favor të osmanëve. Në atë kohë, ky haraç,

¹ Shprehja latine “*modus vivendi*” ka kuptimin “*mënyrë jetese*”, por në këtë rast përdoret për të nënkuptuar një marrëveshje ose një mënyrë që lejon palët kundërshtare të bashkëjetojnë në paqe (një lloj kompromisi).

² Bariša Krekić, *Dubrovnik in the 14th and 15th centuries: A City Between East and West*, University of Oklahoma Press, Norman, Oklahoma 1972, p.58; Bogumil Hrabak, “Dubrovnikasit dhe Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, *Përparimi*, Vjeti XIII, nr.4 (Prishtinë, 1967), 58.

përbëhej nga një sasi relativisht e vogël parash, vetëm 1.500 dukatë dhe dhurata për dinjitarët turq, por gjatë dy dekadave të ardhshme shuma e haraçit u rrit në mënyrë graduale, derisa më në fund, në vitin 1481, arriti shumën e 12.500 dukatë në vit. Me një ndërprerje të shkurtër në vitin 1684 - kur Raguzat kishte shpresuar për mbrojtje nga austriakët - raguzanët mbetën besnikë ndaj detyrimeve të tyre kundrejt osmanëve deri në vitin 1808.³

Osmanët i lejonin raguzanët të vijonin aktivitetet e tyre në vendet e pushtuara të Ballkanit, dhe Raguzat përfitoi shumë nga këto lëshime. Në të njëjtën kohë, qyteti krijoi marrëdhënie të shkëlqyera me Mbretërinë e Aragonës në Italinë Jugore në gjysmën e dytë të shek. XV; me simpati i shikonte përpjekjet e *Papës Piu II* për të organizuar një kryqëzatë të re kundër turqve, si dhe luftën e guximshme të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në Arbëri dhe atë të mbretit hungarez dhe kroat, *Matia Korvini*, në veri, kundër osmanëve. Por, shikuar nga aspekti politik, të gjitha këto përpjekje, ata i konsideronin shumë të vogla për të bërë ndonjë ndryshim thelbësor në situatën në Ballkan. Ata ishin të bindur se, duke ruajtur pozicionin e tyre në Ballkan nëpërmjet marrëveshjeve të tyre me osmanët, ata po bënin gjënë e vetme të arsyeshme dhe pozitive që mund të bëhej në këto rrethana. Për më tepër, vetë Raguzat ishte në një pozicion gjeografik të përshtatshëm, nga i cili osmanët mund të mbanin një sy në botën e krishterë perëndimore.⁴

Ndonëse Raguzat shërbente si ndërmjetësuese për informimin e Evropës katolike mbi rrethanat në Arbëri, që më 1433, kur në disa vise të Arbërisë u zhvilluan luftëra kundër pushtuesve turq dhe kur kryengritësit nëpërmjet Raguzës krijonin lidhje me mbretin Sigismund, respektivisht, edhe pse raguzanët, në maj të vitit 1435, shoqëruan në Arbëri të dërguarin e perandorit për t'u informuar mbi rrethanat në viset arbërore,⁵ interesimi i tyre për Gjergj Kastriotin, në

³ Krekić, *Dubrovnik in the 14th and 15th centuries*, p.59.

⁴ Ibid., pp. 62; 167-168.

⁵ “*Que habentur ex Albanis cum Teucris nova reservavimus prefato domino Frussin, qui per litteras suas, quas deferunt harum latores, ad noticiam prefate Maiestatis ea deducit, que per nunc nostris exarare preterimus*”, Hrvatska-Državni Arhiv u Dubrovniku (më tej: HR-DADU), HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XI (1430-

periudhën e parë të luftës së tij kundër osmanëve, pasqyrohej vetëm si vrojtues të ngjarjeve në këtë vend fqinj. Nga ana tjetër, nëpërmjet Raguzës kalonin edhe komunikimet midis Skënderbeut dhe *Janosh Huniadit*, e më vonë edhe me mbretin *Matia Korvini*. Raguzë, po ashtu shërbente edhe si nxitje e ndërhyrjes së Skënderbeut në grindjet napolitane për fronin mbretëror në vitin 1461, meqë mbreti Ferrante favorizonte tregtarët raguzanë.⁶

Lidhjet e Kastriotëve me Raguzën të dokumentuar na dalin shumë herët. Që më 21 mars 1413 Gjoni ishte bërë qytetar i Raguzës, pas vendimit të Këshillit të Rogatëve.⁷ Këto u intensifikuan më 1420,⁸ me arritjen e një marrëveshje tregtare ndërmjet Gjon Kastriotit dhe Raguzës në bazë të së cilës tregtarët raguzan do të paguanin vetëm një doganë nëpër zotërimet e Gjonit, kurse ai u garantonte atyre sigurinë e kalimit nëpër gjithë atë zonë; për tu ngritur edhe më lartë në vitin 1439, kur Republika mori vendim për t'u dhënë djemve të Gjon Kastriotit qytetarinë.⁹

1437), fol.244v; Jovan Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku: istoriksa grada*, Beograd: Srpska Kraljevska Akademija (Spomenik XCV, Drugi razred 74), 1942, no.7.

⁶ HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*XVII (1461-1463), fol.7; 14r; Radonić, *Skenderbeg*, no.213

⁷ Që më 21 mars 1413, sipas vendimit të *Këshillit të Rogatëve*, Gjoni ishte bërë qytetar i Raguzës, “*mbi pranimin e zotit Gjon Kastrioti si qytetar dhe si fqinji ynë me të gjitha privilegjet e imunitetet, që u jepen qytetarëve të nderit*” (HR-DADU, *Reform.*, vol.XXXIV (1412-1414), fol.188r).

⁸ HR-DADU, no.793; Radonić, *Skenderbeg*, no.2; *Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka*. Peta knjiga / prikupio i uredio Stojan Novaković. Beograd : Štampano u Državnoj štampariji kraljevine Srbije, 1912, no.10; Ljubomir Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma. Knjiga I: Dubrovnik i susedi njegov, II deo* (Srpska Kraljevska Akademija. Zbornik za istoriju, jezik i knjizevnost srpskog naroda; I odeljenje. Spomenici na srpskom jeziku. Knj. XXIV), Beograd-Sr.Karlovc, 1934, no.157; Tefik Geci, “Mbi sfragjistiken e Kastrioteve”, *Sipoziumi për Skënderbeun – Simpozijum o Skenderbegu* (9-12 maj 1968), Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës 1969, p.241.

⁹ Me këtë rast, duhet përmendur një moment tjetër të rëndësishëm, përkatësisht një dokument raguzan të datës 10 korrik 1439, që ka të bëjë me vendimin e Senatit të Shën Vlashit për t'u dhënë djemve të Gjon Kastriotit qytetarinë e atij qyteti. (HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol.VII (1438-1441), fol.76; *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll.II, Tiranë 1989, p.352)

Që në vitin 1443, kur Skënderbeu u kthye në Arbëri, Komuna e Raguzës i dha të drejtën e qytetarisë raguzane, fisnikut arbëror Arianitit, i cili, në këtë kohë kishte ngritur arbërorët në kryengritje. Raguza i dërgoi Arianitit edhe flamurin, por refuzuan kërkesën e tij për t'i dërguar një bombardë për nevojat e kryengritjes.¹⁰ Për krijimin e marrëdhënieve të ngushta me Evropën e krishterë, Skënderbeu shfrytëzoi kanalim më të përshtatshëm, dhe të më hershëm - Raguzën. Kërkesat e tij drejtuar Papës dhe baronëve hungarezë, në prillin e vitit 1446, u dërguan nëpërmjet shërbimit diplomatik të Raguzës.¹¹ Një vit më vonë Raguza i dhuroi Heroit shqiptar 500 libra barut bombardash.¹² Duke iu përgjigjur thirrjes së Huniadit për të sulmuar turqit, në tetorin e vitit 1448, Skënderbeu kërkoi hua në Raguzë, mirëpo Senati i Raguzës deklaroi se nuk mund t'ia akordonte shumën e kërkuar, dhe në vend të saj, i dhuroi 200 dukatë ari.¹³

Përparimi i ushtrive osmane në Ballkan, afrimi i tyre në kufijtë e Hungarisë katolike, dalja e tyre në brigjet e Adriatikut, synimi i sulltanëve për të depërtuar në Evropën Qendrore dhe për të kaluar në Gadishullin Italik, e kishin shqetësuar seriozisht Romën. Shqetësimi i papës Eugjenit IV (1431-1447) u rrit më tepër pas Koncilit të Firences (1439), ku projekti i tij për një kryqëzatë të përbashkët me Kishën Lindore nuk doli të jetë i suksesshëm. Pikërisht në këto rrethana, rezistenca e Skënderbeut kundër ushtrive osmane, fitoi një rëndësi të veçantë strategjike, politike, ushtarake dhe kishtarë për Romën, si kishë dhe si shtet. Madje, së bashku me Hungarinë dhe Bosnjën, Arbëria u konsiderua, sikurse shkruan *Basilio Pandzic*, një

¹⁰ Nicolae Iorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XVe siècle*, vol.II, Paris: E. Leroux, 1899, pp.395-396; Ivan Božić, *Dubrovnik i Turka u XIV i XV veku*, Beograd: Naučna knjiga, 1452, p.100.

¹¹ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol.IX (1444-1446), fol. 238r; Radonić, *Skenderbeg*, no.13.

¹² HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. X (1446-1448), fol. 102r; Radonić, *Skenderbeg*, no.14

¹³ Senati i Raguzës i kërkonte ndjesë Skënderbeut që nuk kishte pasur mundësinë që t'i jepte atij hua për luftë kundër turqve. Ajo vendos që t'i dhurojë 200 dukatë ari – “*Prima pars est de donando dicto Scanderbech ducatos auri ducentos*”, HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol.XI (1448-1451), fol. 14r.

nga tri pikat nevralgjike të kryqëzatës, të cilën papa Eugjeni IV e kishte shpallur më 26 maj 1443.¹⁴

Ai që e vlerësoi Skënderbeun si faktor në projektet e Romës, ishte pasardhësi i *Eugjenit IV*, papa *Nikolla V* (1447-1455), i cili, sapo hipi në fronin e Shën Pjetrit (1447), filloi të mendonte për Arbërinë, e cila përbente një shpresë për Evropën e krishterë, të cilës i kanosej rreziku osman. Në të vërtetë, që më 20 qershor të vitit 1447, po ky papë dërgoi françeskanin *Antonio de Oliveton* si “*nunc të Selisë Apostolike në viset e Arbërisë dhe Dalmacisë*” (ad partes Albaniae et Sclavoniae), që mund të jetë edhe *nunci* i parë apostolik që vjen si i tillë zyrtarisht në Arbëri, me porosi që të bënte të pamundurën për të bindur besnikët e krishterë t’i jepnin mbështetje luftës kundër osmanëve të drejtuar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të cilin e përmendë shprehimisht “*t’i japim birit të dashur, burrit fisnik Gjergj Kastriotit zot në Arbëri përkrahje dhe ndihmë kundër turqve*”.¹⁵ Po ky *Antonio Olivento*, nuk ishte tjetër përpos At *Antonio de Napoli*, që papa *Eugjeni IV* e kishte emëruar *nunc* pontifikal në Raguzë gjatë viteve 1443-1447.¹⁶ Detyra kryesore e Antonit, sipas letrës papnore, ishte mbledhja e ndihmave nga besimtarët, në mbështetje të luftës kundër turqve, të udhëhequr nga Skënderbeu, të cilin e përmendë shprehimisht. Mbase At Antoni i mori në Raguzë letrat pontifikale. Faktikisht, në muajin

¹⁴ Basilio Panzić, “Françeskanët në shërbim të Shqipërisë gjatë epokës së Skënderbeut”, *Hylli i Dritës*, Vjeti XXVIII, 4 (Shkodër, 2009), p.42.

¹⁵ Në Breve ndër të tjera thuhej: “... *nostrum et Sedis apostolicae Nuncium, ad praesens mittimus, cupientes illas tibi iacere concessiones, in quarum vim christifidelibus carum partium tu possis gratiorem reddere ac utiliore...* Caeterum, *quia cupimus dilecto filio, nobili viro Georgio Castrioto, Domino in Albania, a fidelibus christianis favores et praesidia praestari adversus Turcas...*”, *Bullarium Franciscanum continens constitutiones, epistolas, diplomata Romanorum pontificum Eugenii IV et Nicolai V ad tres ordines S. P. N. Francisci spectantia*. Collegit et edidit Fr. Ulrichus Hüntemann O.F.M. lector iubilatus. Nova Series. Tomus I. (1431–1455). Ad Claras Aquas (Quaracchi), MCMXXIX, dok.1071, p.540; Panzić, “Françeskanët në shërbim të Shqipërisë”, pp.48-49.

¹⁶ Në dokumentet e Raguzës e gjejmë edhe me emrin At *Antonio de Giovinazzo (Juvenacii)*. Cfr.: B. Rode, “Documenti Francescani di Ragusa”, *Miscellanea Francescana: di storia, di lettere, di arti*, vol.XIV (Foligno : Feliciano Campitelli Editore 1912), no.49.

korrik 1447 gjendet në Raguzë,¹⁷ dhe me gjasë ia dërgoi menjëherë Skënderbeut. Në muajt pasues, përkatësisht, në dhjetor të vitit 1447 e gjejmë në mbretërinë e Napolit, si i dërguar i Skënderbeut që t'i kërkonte ndihmë Alfonsit V, kryesisht anije. Alfonsi V, në përgjigjeje të Skënderbeut, më 14 dhjetor 1447, duke e lavdëruar për luftën e tij të guximshme kundër turqve, i premtonte disa anije. Në të njëjtën kohë i zotohej që do t'i siguronte strehim Skënderbeut dhe familjes së tij, në rast se do të detyrohej ta linte vendin e tij.¹⁸

Nga ato që na japin dokumentet, Skënderbeu e vizitoi për herë të parë Raguzën në gjysmën e dytë të dhjetorit të vitit 1450. Me këtë rast, përsëri kërkoi ndihmë në të holla prej qeverisë raguzane, por kërkesa e tij sërish u refuzua. Edhe këtë herë atij iu dha vetëm një dhuratë prej 500 dukatë.¹⁹ Hezitimi i raguzanëve për t'i dhënë hua Skënderbeut, u pa edhe në fillim të vitit 1451, gjë për të cilën do të flasim më poshtë. Në rrethanat e krijuara, autoritetet e Raguzës i kërkuan Papës çlirimin e tyre nga barra e taksave të vitit *Jubilar* 1450, duke u shfajësuar me pretendimin se, sipas tyre, i kishin bërë krishterimit shërbime të mëdha, sidomos duke përkrahur Gjergj Kastriotin-Skënderbeun.²⁰

Në misionet e shumta diplomatike të Skënderbeut me shtetet evropiane u angazhuan shumë diplomatë, nga të cilët, për nga

¹⁷ Ibid., no.57.

¹⁸ Radonić, *Skenderbeg*, no.16.

¹⁹ “*Prima pars est de eundo ad Maius Consilium pro donando sibi ducatos quingentos*”, HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, Vol.XI (1448-1451), fol.272r-272v; Jorga, *Notes et extraits* II, p.443 not. 2; Radonić, *Skenderbeg*, no.34

²⁰ Udhëzimi i doktorit të shkëlqyer, magjistrin Gjjon Gazulli, i cili shkon te papa Nikolla V të kërkojë në emër të Senatit Raguzan lidhur me lirimin nga tributi i paraparë vjetor me rastin e vitit jubilar 1450, meqë Raguzë kishte merita të mëdha për ndihmën dhe përkrahjen e Skënderbeut në luftën kundër osmanëve. Raguzë, 27 shkurt 1451, HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XIV (1448-1449), fol.63v-66r; József Gelcich, Lajos Thallóczy, *Diplomatarium relationum Reipublicae Ragusanae cum regno Hungariae: Raguzë és Magyarország összekötteréseinek oklevéltára*, Budapest: Magyar Tudományos Akadémia, 1887, no.286; J. Radonić, *Dubrovačka akta i povelje - Acta et diplomata Ragusina I/1* (Zbornik za Istoriju, Jezik i Književnost Srpskog Naroda, Treće odeljenje; knj.III), Beograd: Mlada Srbija, 1934, pp.522-527.

rëndësia, dallohen vëllezërit Gazulli (Gjon, Pal e Andrea Gazulli), për të cilët, në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut ruhen dokumente të shumta.²¹ Prijësi i Arbërisë, Gjergj Kastrioti, duke vlerësuar lart rolin dhe aftësitë e Gjon Gazullit si dijetar dhe diplomat, e ngarkoi me një mision të veçantë në Romë. Në shkurtin e vitit 1451, Kastrioti e dërgoi rektorin e kishës së Raguzës, ambasadorin arbëror, Gjon Gazullin, me një mision të veçantë pranë Papës Nikolla V.²² Raguzanët e shfrytëzuan vizitën e Gazullit në Romë, për interesat e tyre. Gazulli u udhëzua që para Papës *Nikolla V* të kërkonte, në emër të Senatit Raguzan, lirimin nga *tributi* i paraparë vjetor, me rastin e vitit jubilar 1450-të, meqë *Republika e Shën Vlashit*, sipas tyre kishte merita të mëdha për ndihmën dhe përkrahjen e Skënderbeut në luftën kundër osmanëve, dhe ishte e rrezikuar nga turqit.²³ Humanisti arbëror, Gjon Gazulli, e kreu detyrën me sukses. *Papa Nikolla V*, gjeti një zgjidhje të caktuar kompromisi që t'i kënaqte të dyja palët. Më 13 prill të vitit 1451, shpalli nja dekret, me të cilën caktoi që ndihmat prej *indulgjencave*, të mbledhura në territorin e Raguzës, t'i ndanin përgjysmë Raguzës dhe Skënderbeut: një pjesë t'i jepej Skënderbeut për qëllimet e luftës, ndërsa pjesa tjetër të ruhej për komunën dhe qytetarët e Raguzës.²⁴ Mirëpo, sapo në Raguzë shpërtheu murtaja, e gjendur në kushte të vështira, qeveria e luti Papën që ta merrte parasysht situatën dhe ta shtynte shitjen e *indulgjencave* të sjella nga Gjon Gazulli. Në verën e vitit 1451, Papa u informua edhe nga ipeshkvi i Kotorrit, *Bonino de Tollentis*, mbi situatën e krijuar në qytet dhe për shitjen e *indulgjencave*.

²¹ Për Gazullët, Cfr.: Š. Jurić, “Prilozi biografiji Ivana Gazulića”, *Anali Historijskog instituta u Dubrovniku*, VIII-IX, Dubrovnik, 1962, pp. 447–479; J. Drançolli, *Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shek.XV*, Rilindja, Prishtinë 1984.

²² HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XIV (1448-1449), fol.63v-66r.

²³ Ibid.

²⁴ “...ad subventionem et auxilium dilecti filii nobilis uiri Georgii Castrioto alias Scandeborgh, domini Croye et Arbani, qui, sicut accepimus, perfidis Teucris uiriliter et animose resistere ac eos pro posse impugnare nori cessat, eorundem posteriorum litterarum serie deputauimus prefato Georgio, seu aci id per eum deputandis personis tradere et assignare tenerentur, prout in posterioribus litteris predictis plenius continetur.”, HR-DADU, *Acta Sancta Mariae Maioris*, F.I. 1451. no.31.

Ndonëse në gjysmën e dytë të vitit 1451 ishte pezulluar përkohësisht shitja e *indulgjencave* (për shkak të murtajës, konflikteve të raguzanëve me princin Stefan Vukçiq Kosaça, dhe për shkak të vajtjes së Gazullit të Skënderbeut),²⁵ pagesa u krye. Më 18 mars të vitit 1452 të autorizuarit të Skënderbeut, ipeshkvit të Arbërisë, Andrea Sumës, iu dhanë 4.893 perperë nga të ardhurat e *vitit jubilar*,²⁶ ndërsa gjysma tjetër, në bazë të *bullës* së Papës, iu nda Republikës.

Skënderbeu nuk u ndal në kërkim të mjeteve financiare nga Raguzë, edhe pse ai u refuzua, duke u mjaftuar vetëm me dhënien e lëvdatave për meritat e tij në mbrojtjen e krishterimit kundër turqve.²⁷ Gjatë vitit 1453 Skënderbeut iu dërguan letra,²⁸ pastaj u zhvilluan bisedime me bashkëpunëtorët e tij, madje *Vlladislau Hercegoviqit* iu dha edhe një barkë për t'ia dërguar Skënderbeut.²⁹ Të dërguarit të Skënderbeut, Pal Gazullit dhe një përfaqësuesi tjetër, iu dhanë 100 libra argjend, që gjendeshin të depozituara në Raguzë.³⁰

Më 25 shtator 1453 Qeveria Raguzane i dorëzoi Pal Gazullit afro 35 kilogramë argjend. Me këtë rast Pal Gazullin e shoqëronte *Teodor Jafeti*.³¹ Kjo tregon se qeveria kishte besim të madh te Gazullët. Po këtë të dhënë e ndeshim edhe te historiani i vjetër raguzan, *Gjon Marino Gondola*, i cili këtë ngjarje e vë në muajin

²⁵ I dërguari i Raguzës i kërkon Papës që, për shkak të sëmundjeve dhe armiqësisë së princit Stefanit, të shtynjë për disa kohë në territorin e Raguzës, mbledhjen e *indulgjencave*, një pjesë e të cilave i duhej dhënë Skënderbeut. (HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XV (1449-1453), fol. 166r)

²⁶ "...dominus Andreas Suma, Dei et apostolice sedis gratia dignissimus totius Albanie episcopus procurator, et procurator nomine magnifici et illustri domini Georgii Castrioti... fuit confessus et contentus se dicto procuratorio nomine habuisse et recepisse et sibi dicto... inter ducatos et monetas et raubas iperperos quatuor mille octingentes nonaginta tres ipsi domino Scandarbecho spectantes...", HR-DADU, *Div. Notariae*, vol.XXXVI (1451-1452), fol.88r.

²⁷ HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XV (1449-1453), fol. 109r; Jorga, *Notes et extraits* II, p.460; *Ibid.*, *Acta Con.Rog.*, vol.XIII (1452-1453), fol.53v.

²⁸ HR-DADU, *Acta Con.Rog.*, vol.XIII (1452-1453), fol. 168v; 234v

²⁹ *Ibid.*, fol. 170r.

³⁰ *Ibid.*, fol. 240.

³¹ "*Prima pars est de dando domino Paulo Gazulo et Theodoro Jafet, ambassiatoribus de Scanderbech, de argento domini despoti, quod est in depositum in comune nostrum*", *Ibid.*

shtator 1453, pa e saktësuar datën e nisjes së misionarëve në fjalë. Përveç kësaj, kronisti në fjalë, na njofton se në Raguzë, Skënderbeu së pari dërgoi ipeshkvin e Arbërisë, për të dërguar më pas edhe Pal Gazullin dhe *Teodor Jafetin*, misioni i të cilëve pati sukses të pjesshëm.³² Sipas një dokumenti të datës 8 shkurt 1453 Pal Gazulli shkoi në Raguzë si misionar i princit *Vladislav Kosaça*. Në këtë kohë, Raguza kishte rënë në luftë me princin *Stefan Vukçiq Kosaça* (1451-1454), kurse i biri i tij, *Vladislau*, ishte në marrëdhënie aleance me Raguzën. Nga kjo e dhënë del se Pali ishte një personalitet i popullarizuar në qarqet diplomatike raguzane dhe boshnjake.³³

Përkundër shumave monetare të përmendura, që Raguza i kishte dhënë kohë pas kohe Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, burimet dokumentare të arritura deri në ditët e sotme, nuk lejojnë të përllogaritësh shumë e përgjithshme që ka marrë Skënderbeu nga *Republika e Shën Vlashit*.

Përpyekjet dhe plani i papëve për ta kthyer Raguzën në një pikë kryesore të shpërndarjes së të hollave për kryqëzatën në Ballkan, si të tillë, edhe bazë kryesore për sulme kundër pushtuesve turq, ishin një shqetësim i përhershëm për tregtarët e kujdesshëm raguzanë. Prandaj, duke llogaritur statusin e saj në raport me sulltanin, Raguza hezitonte të kthehej në një bazë të tillë të financimit të hapur të luftës antiosmane, por që këtë e bënte me diplomaci, herë duke e miratuar, herë duke u tërhequr nga këto plane apo refuzuar krejtësisht. Përsëri me kujdes dhe diplomaci, ajo lejoi që brenda mureve të saj, me Skënderbeun apo njerëzit e tij, të bëheshin plane e marrëveshje, të zhvillohej tregtia e armëve, të kishte depozita dhe transaksione financiare në favor të luftës kundër osmanëve.

Marrëdhëniet ndërmjet Raguzës dhe Skënderbeut edhe nga fundi i viteve ‘50 të shek. XV, kishin të bënin, kryesisht me mjetet

³² *Chronica Ragusina Junii Restii (ab origine urbis ad annum 1451) item Joannis Gundulae (1451-1484), Digessit Speratus Nodilo* (Scriptores, 2; Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, vol.25), Zagrabiae: In taberna libraria eiusdem societatis typog., 1893, p.340.

³³ HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol. XV, fol. 51r.; HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIII, fol. 148r; S. Ćirković, *Herceg Stefan Vukčić - Kosača i njegovo doba*, SAN, knj.48, Belgrade 1964, pp.190-191.

financiare për luftën anti-osmane në Arbëri. Pikërisht, marrëdhëniet ekonomike, të cilat u përmenden më lart, preknin edhe lëmenj që kishin rëndësi të madhe strategjike për Skënderbeun: për shkak të rrethanave politike në shtetin e tij, mungonte jo vetëm paraja, por edhe mundësia e çfarëdo sistemi bankar. Në anën tjetër, për të blerë armatimin e nevojshëm i duheshin shuma të konsiderueshme parash, dhe për këto i nevojiteshin edhe shërbimet bankare. Pikërisht, një pjesë e dokumenteve i kushtohen kësaj problematike. Filialet e bankave të mëdha fiorentinase në Raguzë kryenin transaksione të tilla me rezervimin e duhur – pasi bëhej fjalë për tregti armësh në një qytet, i cili, zyrtarisht, ishte asnjans dhe i paguante sulltanit haraç. Skënderbeu mbante lidhje të ngushta me bankat *Pazzi*, *Strozzi* dhe *Albizzi*, të cilat kishin edhe interesim për tregtimin e drurit të Arbërisë.³⁴ Gjergj Kastrioti edhe shërbimet e bankës i kishte në Raguzë, ku kishte një depozitë që, sipas dokumenteve, shkonte deri në 2400 dukate, bankë në të cilën kishte depozita edhe Gjergj Brankoviqi.³⁵

Për të ardhurat e Skënderbeut dhe depozitat e tij që dilnin nga tregtia me drithin na dëshmon edhe një dokument i vitit 1463, ku si pikë nisjeje eksportuese, përmendet edhe Shufadaja. Këtu përmendet përfaqësuesi i Skënderbeut, *Teodori*, i cili mori në shërbim në Raguzë një anije me vela së bashku me gjashtë marinarë, për të dërguar një ngarkesë drithi nga Shufadaja për në portin e *Tranit*, përkatësisht *Barletës*.³⁶ Ashtu si dhe në kohët e Gjon Kastriotit, në derdhjen e Ishmit u shitej raguzanëve lëndë drusore, p.sh., tregtarëve *Radoje Millosheviq* dhe Antun Radeljiq nga Korçula, që administrohej nga venedikasit.³⁷ Shuma të konsiderueshme të mjeteve monetare që dilnin

³⁴ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol.XVIII, fol.133v, 150r; *Diversa cancellariae*, XLVI, fol.78r.

³⁵“...*Raian Celnicho a domino Paulo de Gazulis nunciis illustris domini Georgi Castriotti diti Schenderbegh in depositum in comune nostrum ducatos auri duo milia quadringentos...*”, HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol.XV, 214v.

³⁶ HR-DADU, *Div. Notariae*, vol. XLVII, fol. 22; Kasem Biçoku, “Rrugët nëpër vilajetin e Krujës në shek. XV dhe lokalizimi i Shufadasë”, *Monumentet*, 1(Tiranë, 1982), 41-62.

³⁷ HR-DADU, *Div. Notariae*, vol.XLVII, fol. 32r.

nga tregtia i dëshmon një blerje drithi që bënë tre pjesëtarë të familjes raguzane *Gonduli* në vitin 1464 nëpërmjet dy përfaqësuesish: nga kjo shitje shuma prej 1450 dukatesh kaloi në pronësi të Skënderbeut.³⁸ Krahas raguzanëve në skelat e vogla të Skënderbeut ndalonin edhe tregtarë nga Italia e Veriut, si bie fjala një *Baidesar de Rexina* nga Milano, i cili bleu grurë, elb dhe mel.³⁹ Skënderbeu u shiste drithë edhe aleatëve të tij në malësinë e varfër, kështu p.sh. princit *Vladislaut* të Hercegovinës ose *Stefan Černojeviqit* nga Zeta, i cili mori prej tij 140 starë drithë nëpërmjet portit venedikas të Kotorrit.⁴⁰

Të ardhurat nga tregtia me drithin, bagëtinë, lëndën drusore, nga pajtimet e doganave nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar të gjitha paratë e nevojshme. Ai detyrohej në disa raste të kërkonte edhe ndihmë nga jashtë, sidomos nga Raguzë. Mirëpo Republika tregtare e Raguzës nuk guxonte ta ndihmonte haptas prijësin arbëror. Raguzë i përkiste kurorës hungareze dhe, sikurse u tha, i paguante haraç sulltanit. Karvanet e Raguzës përshkonin territore të mëdha të Perandorisë Osmane; synimi më i lartë i raguzanëve ishte siguri i karvaneve me mallra të çmuara. Sado që qytetin e mbronin muret e tij të fuqishme, brenda të cilave kishin depozituar thesaret e tyre një numër princash ballkanikë, përfaqësuesit e Senatit, prapëseprapë, nuk dëshironin që të vihej ndonjëherë në sprovë qëndrueshmëria e fortifikimit. Raguzë ndodhej midis Perëndimit dhe Perandorisë Osmane. Ajo nuk duhej të kënaqte vetëm zotërinjtë dhe prijësit fisnikë të vendeve fqinje, në Bosnjë, Hercegovinë dhe Arbëri, por së fundi duhej të mbrohej edhe nga konkurrenca venedikase në det. Kërkesat e Skënderbeut për ndihmë në të holla dhe në armatime e vinin në situatë tepër të pakëndshme *Republikën e Shën Vlashit*.⁴¹ Në Raguzë nuk kishin dëshirë që të rrezikoheshin tregtitë fitimprurëse në Arbëri. Ata ishin të lumtur edhe që aty ndodhej një sundimtar (Skënderbeu) që luftonte kundër osmanëve, megjithatë ua kishin frikën spiunëve

³⁸ HR-DADU, *Div. Notariae*, vol. XLVIII (1464-1465), fol. 34r.

³⁹ HR-DADU, *Div. Notariae*, XLVII, fol. 3v-4r.

⁴⁰ O. J. Schmitt (avec la collaboration de G. Saint-Guillain), "Actes inédits concernant Venise, ses possessions Albanaises et ses relations avec Skanderbeg entre 1464 et 1468", *Turcica* 31 (1999), p. 260.

⁴¹ Božić, *Dubrovnik i Turska*, pp. 145-146.

osmanë në qytet dhe rrezikut që i kanosej jetës së tregtarëve të tyre në Perandorinë Osmane. Andaj qëndrimi i Raguzës karakterizohej nga luhatje të vazhdueshme, të cilat ndiqnin zhvillimet politike në Ballkan: më 1446 dhe 1447⁴² Republika e ndihmoi Skënderbeun me ndërmjetësim diplomatik dhe me armë. Por, kur kërkoi Skënderbeu më 1448 një hua për sulmin në *Betëjën e Dytë të Kosovës*, zotërinjtë e Këshillit të Vogël u trembën përpara një sfide të tillë ndaj sulltanit, megjithatë i dhanë Skënderbeut një shumë simbolike prej 200 dukatë ari, të përmendura më lart. Me 500 dukatë të tjerë, Skënderbeu u ndihmua nga Raguzë më 1450, me rastin e sulmeve osmane mbi Krujë, por pas kësaj, nga ana e Raguzës, procedohet me maturi duke u kufizuar vetëm në dhënien e lëvdatave. Qeveria e Raguzës vlerësoi dhe lartësoi meritat e Skënderbeut në mbrojtjen e Krujës, që sipas saj përbënte mbrojtje të vlerave të krishtera nga invazioni turk.⁴³

* * *

Mjete monetare, Skënderbeu u detyrua të siguronte edhe nga grumbullimet e përbashkëta ndërkombëtare në luftë kundër turqve. Në lidhje me aksionin e Papës *Kaliksi III* për luftë kundër turqve, më 5 maj 1456 në Raguzë erdhi si *nunc* i Papës, një kryegjakon nga Kotorri për të kërkuar ndihmë.⁴⁴ Autoritetet e Raguzës deklaruan se për shkak të ekspozimit ndaj sulmeve turke ata nuk mund të bënin asgjë, në radhë të parë për shkak se turqit kishin pushtuar një pjesë të mirë të despotatit serb, duke i reduktuar kështu, një burim të madh të të ardhurave.⁴⁵

Predikuesi apostolik i kryqëzatës në dalmaci, dhe veçanërisht në Raguzë, ishte *Mariono da Siena*. Ky, ishte emëruar nga përfaqësuesi i Papës, kardinali *Francesco Condulmer*, që kishte marrë

⁴² "...donando libras quingentas pulueris bombarde... donando libras quatuorcentum...", HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. X (1446-1448), fol. 102r; Radonić, *Skenderbeg*, no.14. Gjatë këtyre viteve, Skënderbeut iu dhanë disa njësi baroti.

⁴³ HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XV (1449-1453), fol.109r; Jorga, *Notes et extraits* II, p.460.

⁴⁴ HR-DADU, *Cons. Rog.*, vol. XV (1456-1458), fol.1v.

⁴⁵ HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol. XVI (1454-1460), fol.148r.

nga Papa detyra të caktuara. Mariano, në muajin tetor 1456 ndodhej në Kotorr, në pritje të fletëhyrjes nga Republika e Raguzës, dhe të cilën e merr më 29 tetor të të njëjtit vit.⁴⁶

Në mars 1457, kur *Marianum de Senis (Mariano da Siena)* filloi të predikonte krijimin e një kryqëzate, pati mjaft vullnetarë të Raguzës, të cilët dolën për të marrë pjesë në luftë dhe të paguanin shumën e indulgjencave prej tre dukatësh. Kështu, Raguzë u gjend në një situatë edhe më të vështirë se një vit më parë. Për të mos shqetësuar Papën, banorëve të Raguzës iu lejua që për një afat të caktuar kohor të propagandonin në favor të kryqëzatës. Përgjigjja ishte mjaft e madhe, kështu që tashmë në marsin e vitit 1457 inkasantët do të arrijnë të mbledhin deri në 4000 dukat vetëm në Raguzë.⁴⁷

Papa *Kaliksti III* parashikonte fillimin e një lufte të madhe kundër turqve në mars të vitit 1457. Për t'ia arritur këtij qëllimi legatët e tij dhe luftëtarët e kryqëzatave u përhapën në të gjithë Evropën. Por Republika e Raguzës ndërkohë ishte e bindur se ushtria tokësore, në atë kohë, ishte më e rëndësishme dhe kësaj parat e mbledhura duhej të kurseheshin për të. Në këto kushte, më 16 mars 1457, i dërgoi mbretit të Hungarisë një të dërguar të veçantë: françeskanin *Aleksandro da Ragusa*, për ti kërkuar që paratë e mbledhura në Raguzë nga *Mariano da Siena* të dërgoheshin për ushtrinë tokësore.⁴⁸ Tregtarët e Raguzës, kishin frikë se prania e predikuesve të kryqëzatës në qytetin e tyre do të shkaktonte ndërhyrjen e autoriteteve turke, prandaj tentonin që sa më shpejt që të ishte e mundur të largoheshin që aty. Derisa papa kishte një urdher për të predikuar kryqëzatën në Hungari, tashmë, në prill të vitit 1457, Raguzë këshillonte që këta predikues të largoheshin nga vendi i tyre.⁴⁹ Më 17 shtator 1457, përmes një *breveje* drejtuar kardinalit të kishës së Shën Engjëllit, *Juan de Carvajal*, Papa ia porosiste atij Gjergj Kastriotin, në luftën e të cilit thoshte se mbështeste mjaft shpresat, duke i dhënë kardinalit udhëzime për ndarjen e të dhjetave të mbledhura prej

⁴⁶ Rode, "Documenti Francescani di Ragusa", no.79.

⁴⁷ HR-DADU, *Cons. Rog.*, vol. XV (1456-1458), 102v.

⁴⁸ Rode, "Documenti Francescani di Ragusa", no.76.

⁴⁹ HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol.XVI (1454-1460), fol.122r, 119r.

kolektorëve papnorë për kryqëzatat mes mbretërve të Hungarisë e të Bosnjës dhe “*birit fisnik jo më pak të dashur - Skënderbeut, zot i Arbërisë*”.⁵⁰ Një ditë më pas, më 18 shtator, papa Kaliksti III i drejtohet me dy urdhëresa qytetit të Raguzës. Në njërën porosiste që t’i jepeshin agjentit tregtar *Martin Clarinit*, përfaqësues i bankës së tregtarëve fiorentinas “*Petri et Jacobi de Pazis et sociorum*” në Raguzë, 10.000 dukatë nga të hollat e mbledhura për kryqëzatën, të cilët t’i ktheheshin bankës në fjalë (nga e cila ishin marrë hua), kurse pjesa tjetër të ndahej në tri pjesë të barabarta dhe prej tyre, dy t’u jepeshin mbretërve të Hungarisë dhe të Bosnjës, ndërsa pjesa tjetër Skënderbeut. Raguzanët i propozuan sovranit të tyre, perandorit hungarez, që t’i kërkonte këto të holla. Papa i kërcënoi raguzanët se do t’i përjashtonte ata nga kisha “*tanquam sacrilegos et bonorum esslesiasticorum occupatores*”, nëse nuk i paguanin menjëherë shumën e caktuar.⁵¹ Sapo *nunci* i Papës, *Navarri*, mbërriti në Raguzë me *brevem papale*, Senati i Republikës u informua se mbreti hungarez dëshironte të vonohej pagesa, pavarësisht nga kërcënimi me shkishërim, derisa ai të vendoste se çfarë do të bëhej me paratë. Për këtë ata kërkuan këshillat e dy kardinalëve, kardinalit *Siena* dhe *Piccolominit* (papës së mëvonshëm), se si t’i përgjigjeshin reagimit të Papës, kur sovrani i tyre, mbreti i Hungarisë nuk i jepte paratë. Këto arsyetime të raguzanëve, Papa *Kaliksti III* i quajti si arsyetime boshe “*vanas excusationes*” dhe në dhjetor përsëri i kërcënoi me shkishërim.⁵² Në dhjetor të vitit 1457, Papa ndryshoi vendimin, ku u caktua që e tërë shuma e të hollave të dorëzohej në bankë, kurse Skënderbeut t’i premtuhej ndihma për vitin vijues.⁵³ Mirëpo, pesëmbëdhjetë ditë më vonë, papa u kthye prapë në vendimin e mëparshëm që shuma e mbetur prej 10.000 dukatesh të ndahej në tri pjesë të barabarta: mbretit hungarez, atij boshnjak dhe Gjergj

⁵⁰ A. Theiner, *Vetera monumenta Hungariam sacram Illustrantia. Maximam partem mundum edita ex tabulariis Vaticanis*. Tomus II (1352-1526), Romae: topis Vaticanis 1860, p.304.

⁵¹ Radonić, *Skenderbeg*, no.155.

⁵² *Ibid.*, no.159.

⁵³ *Ibid.*, no.160.

Kastriotit.⁵⁴ Letrat e Papa *Kalixstit III* tregojnë dëshirën e papës për të ndihmuar Skënderbeun dhe, njëkohësisht, shfaqin shqetësimin e tij për pamundësinë e dhënies së ndihmës që ai dëshironte. Këtë shqetësim e shfaqti edhe në raport me raguzanët, të cilët, sikurse u përmend, i kërcënonte me shkishërime, meqë ata nuk i jepnin një pjesë të të hollave që ishin caktuar për kryqëzatën. Raguzanët më 7 shkurt i dorëzuan *Navarros* paratë dhe kërkuan që vonesa e tyre të mos interpretohej si mosbindje ndaj Papës, por si rezultat i ndalimit nga mbreti.⁵⁵

Sidoqoftë, nga këto mjete të premtuara (Skënderbeu, nuk arriti të merrte as një të tretën e përmendur), më 6 shkurt të vitit 1458 Papa informoi përfaqësuesin e tij se Skënderbeut i ka dhënë ndihmë, ashtu siç ka kërkuar ky përmes të dërguarit të tij në shumën prej 5.000 florinj nga mjetet e apostujve.⁵⁶

Duke qenë në mes të dy zjarreve, ndërmjet turqve dhe venedikasve, tregtarët e kujdesshëm të Raguzës, përpiqeshin të mos i prishnin punët me asnjërën palë, madje mos t'i cenonin as marrëdhëniet e tyre me Skënderbeun. Gjatë gjithë kësaj kohe, qytetarët e Raguzës po përpiqeshin të mos shkaktonin dyshimin e turqve për veprimtarinë e tyre. Gjatë qëndrimit të Navarrës në qytet, Raguzë nuk ia dha barkën për të shkuar te Skënderbeu. Ata refuzonin çdo kërkesë të legatëve të papës që të merrnin pjesë në flotën e Papës, në operacionet ushtarake kundër turqve. Për këtë ata jepnin shumë arsye.⁵⁷ Kur në maj të vitit 1458, ata ranë dakord që të tërhiqeshin si dhuratë 2.400 dukatët e depozituar të Skënderbeut, Senati i Raguzës kërkoi që për këtë shumë të hollash të mos jepej kurrfarë dëftese nga *notariati* i Raguzës, nga frika se një dokument i këtillë mund të binte në dorën e turqve dhe kjo mund të bëhej pretext për hakmarrje ndaj tregtarëve të saj.⁵⁸ Mirëpo, kjo shkallë e lartë e vigjilencës nuk e pengoi Republikën që t'ua rekomandonte papës dhe argjipeshkvit të

⁵⁴ Idid., no.161.

⁵⁵ Radonić, *Skenderbeg*, no.166-167.

⁵⁶ Radonić, *Skenderbeg*, no.168; Božić, *Dubrovnik i Turska*, pp.146-148.

⁵⁷ *Chronica Ragusina Junii Restii*, p. 152.

⁵⁸ "...non dando ipsis nunciis aliquam scripturam", HR-DADU, *Acta Cons.Rog.vol.XV* (1456-1458), fol. 222v; *ibid.*, vol.XVI (1459-1461), fol.26v.

Raguzës, Skënderbeun, kur bashkëpunëtorët e Skënderbeut shkuan në Romë. Si shërbim i vogël, por i theksuar, ishte pritja e të dërguarit të Korvinit, Stupko, të cilin mbreti hungarez e dërgoi te Skënderbeu, e të cilit raguzanët ia dhanë një barkë për të lundruar nëpër Adriatik.⁵⁹

Më 9 qershor të vitit 1460, Senati i Raguzës iu përgjigj ambasadorit të Skënderbeut se Republika do t'i ofronte sundimtarit të Arbërisë mjetet e nevojshme transportuese kur të kalonte në Pulje (larg syve të spiunëve turq), por me shpenzimet e Skënderbeut.⁶⁰

I dërguari i Skënderbeut, Pal Gazulli, qëndroi në Raguzë nga fundi i marsit të vitit 1461, ku iu dorëzua përgjigjja në lidhje me kërkesat e tij. Raguzanët ishin të bindur që në raport me Skënderbeun duhej treguar një kujdes i veçantë, pasi Papa e konsideronte atë si një luftëtar kundër "*jobsimtarëve*". Prandaj, që në prill të vitit 1461, Senati i shkruante letër Skënderbeut, përmes së cilës, pa kurrfarë hezitimi, i ofronte strehim në Raguzë familjes së tij, në qoftë se turqit nuk e linin të qetë "*si accideret eum vexari a Turcis*". Gjergj Kastrioti-Skënderbeu kërkoi të vendosej në ishullin *Mërkana* përballë Raguzës, por përfaqësuesit e Raguzës vendosën nga fundi i prillit që strehimi i Skënderbeut të caktohej në ndonjë ujdhesë tjetër të Raguzës.⁶¹ Nuk kemi dokumente që dëshmojnë se Skënderbeu dhe familja e tij të kenë shkuar për t'u strehuar në atë kohë në Raguzë.⁶² Edhe në gushtin e vitit 1461, kur Skënderbeu përgatitej për të kaluar me ushtri në *Pulje*, për të ndihmuar të birin e Alfonsit, *Ferrantin*, që të mos humbiste fronin, Gjergj Kastrioti u prit solemnisht në Raguzë. Sipas urdhrit të papës, aty iu dorëzuan të hollat dhe argjendi, që ishin ruajtur në arkën shtetërore të Raguzës për organizimin e kryqëzatave, e përpos kësaj u vendos që trupat e tij të furnizoheshin me peksimet, kur të ktheheshin nga *Pulja*. Megjithatë, atij nuk iu dha një *fustë*, që ai e kërkoi. Ditëve të para të shkurtit të vitit 1462, pas disa muajsh qëndrimi në Itali, Skënderbeu u kthye dhe qëndroi përsëri në Raguzë. Atë e lutën që të kthehej në Raguzë, ku iu ofruan të holla e drithë për trupat që

⁵⁹ HR-DADU, *Lett. et Comm. di. Lev.*, vol. XVI (1454-1460), fol. 73; Gelcich - Thallóczy, *Diplom.Ragus.*, no.365; Jurić, *Gazulića.*, no.27.

⁶⁰ D HR-DADU, *Acta Cons.Rog.XVI* (1459-1461), fol.146r.

⁶¹ HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol. XVI(1459-1461), fol.241r; 243v; 251r.

⁶² Tadić, *Promet putnika*, p.288.

gjendeshin ende në qytetin e Tranit.⁶³ Suita e nderit duhej të lundronte me të nëpër det deri në Budvë. Prej aty dëshironte ta vazhdonte udhëtimin nëpër rrugë tokësore. Për shkak të stuhisë së madhe në det, Skënderbeu u detyrua të kthehej dhe të qëndronte për disa ditë të tjera në Raguzë. Ditët e para të vizitës, Skënderbeu protestoi për shkakun e disa barkave, por qeveria raguzane i dërgoi menjëherë një fisnik, i cili i kërkoi që të tërhiqte protestën, duke e shpërblyer për këtë me 100 perperë. U vu re mirë se raguzanët, me rastin e kësaj vizite “*nuk u frikësuan fare prej protestës turke për shkak të mikpritjes që i shprehën Skënderbeut, pasi i tërë aksioni i tij kësaj here kishte të bënte me konflikte të brendshme në Itali, të cilat sulltani i shikonte me simpati*”.⁶⁴

Ndonëse si Republika e Raguzës, ashtu edhe Skënderbeu kishin probleme me venedikasit, në prill të vitit 1463, Venediku, jo vetëm që i shkoi për shtat Skënderbeut, duke e lejuar që nëpër territorin e kontrolluar prej tij, të takohej me aleatin e tij, hercegun *Stefan Vukçiqin*, por në këtë drejtim mori masa edhe në lidhje me Raguzën.⁶⁵ Mirëpo, Republika e Raguzës iu përgjigj negativisht të dërguarve të mbretit të Bosnjës dhe të *herceg Stefanit*, që ishin nisur për të shkuar te Skënderbeu në mars të vitit 1463, kështu që i ktheu në rrugë. Edhe pse raguzanët ishin të gatshëm të bënin shërbime të vogla, sipas mendimit të këtyre tregtarëve, edhe këto shërbime në ato kohë ishin të mëdha. Raguzë, nga ana e saj, shfaqësohej se kishte konflikte me turqit për shkak të ardhjes së Skënderbeut në Raguzë.⁶⁶ Në vjeshtën e po atij viti raguzanët u identifikuan në Romë me Arbërinë e Skënderbeut sa u përket kushteve të volitshme për aksionet fillestare të ekspeditave ushtarake kundër turqve. Sepse, si Raguzë, po ashtu edhe Skënderbeu, mund t’i siguronin skelat derisa të bëhej z barkimi dhe vendosja e trupave.⁶⁷ Madje, edhe në qershorin e vitit 1464, *Republika e Shën Vlashit* në Budime u identifikua me Arbërinë e

⁶³ D HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol.XVII (1461-1463), fol.50v; Thallóczy - Gelcich, *Diplom.Ragus.*, p.754.

⁶⁴ Božić, *Dubrovnik i Turska*, pp.160-161.

⁶⁵ Radonić, *Skenderbeg*, no.242; Hrabak, “Dubrovnikasit”, p.455.

⁶⁶ *Chronica Ragusina Junii Restii.*, pp.363-366.

⁶⁷ Radonić, *Skenderbeg*, no.257.

Skënderbeut sa u përket rreziqeve prej osmanëve.⁶⁸ Duke qenë të rrezikuar drejtpërdrejtë prej valës së pushtimeve turke, Raguzë dhe Skënderbeu, në ato vite, mbajtën marrëdhënie shumë intensive bilaterale. Në tetor të vitit 1463 një nga fisnikët e Raguzës i dërgoi Skënderbeut disa ndërtues anijesh prej Raguzë.⁶⁹ Në anën tjetër nga Raguzë siguroheshin edhe mjeshtrë-ndërtues të kështjellave. Punimet ndërtimore Skënderbeu i ndërmori në prag të ofensivës së madhe të vitit 1463. Në dhjetor të atij viti, njeriu i tij i besuar prej Raguzë, *Pal Marini de Gondola mblodhi mjeshtrë ndërtimi edhe disa muratorë për të punuar për dy muaj në Rodon, sigurisht në ndërtimin e fortifikatave. Punimet e raguzanëve në ndërtimin e Rodonit zgjatën për disa vite, pasi më 9 shkurt të vitit 1465 në Kepin e Rodonit u dërguan për punë disa muratorë të tjerë.*⁷⁰ Kjo kështjellë, prej së cilës janë ruajtur ende disa mure, ka ngjashmëri me kështjellat dhe kullat e Raguzës.⁷¹

Ndonëse në shkurtin e vitit 1464 tregtarëve të Raguzës iu ndalua udhëtimi për në Turqi, atyre u jepeshin leje speciale të cilët dërgonin pëlhura në vendin e Skënderbeut, por me kusht që mallrat të mos i përhapin prej andej nëpër territorin turk.⁷² Me 5 nëntor 1466 raguzanët u dhanë edhe peksimet luftëtarëve të Skënderbeut.⁷³ Në atë kohë planifikohej përsëri vizita e Skënderbeut në Raguzë, respektivisht strehimi i familjes së tij në ishujt e Raguzës. Në prillin e vitit 1464 Skënderbeu i kërkoi Republikës që t'ia strehonte familjen. Republika iu përgjigj pozitivisht, duke i ofruar si strehim ishullin në *Mlet*. Si duket, Skënderbeu nuk e ka shfrytëzuar ofertën as kësaj here,

⁶⁸ Ibid., no.271.

⁶⁹ Më 15 tetor 1463, kontraktohet një marangoz raguzan i quajtur Andrea Thomasi de Zuppana që të ndërtojë një barkë në Arbëri për nevojat e Skënderbeut (HR-DADU, *Div.Cancellariae*, vol. LXXI, (1463-1464), fol. 91v.)

⁷⁰ HR-DADU, *Div.Cancellariae*, vol. LXXI, (1463-1464), fol. 117r; Ibid., vol.LXXII (1464-1465), fol.75v

⁷¹ Schmitt, *Skënderbeu*, p.183.

⁷² HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XVIII (1463-1466), fo.25v, 30v, 39r; Božić, *Dubrovnik i Turska*, p.253.

⁷³ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), fol.136v; Gelcich-Thallóczy, *Diplom.Ragus.*, p. 780

sepse në verën e po atij viti njoftoi se do të shkonte, kurse qeveria e Raguzës iu përgjigj në lidhje me këtë më 9 gusht.⁷⁴

Në verën e vitit 1465 turqit u orvatën që t'i ndajnë aleatët e krishterë, të cilët luftonin në atë kohë kundër tyre. Për këtë qëllim, turqit i ofruan paqe Venedikut. Në këtë aksion ishte i angazhuar Jakov Buniqi nga Ragusa. Ky aranzhim përfshinte, sigurisht, edhe Skënderbeun, meqë turqit dërgonin oferta paqësore edhe nëpërmjet tij. Venediku nuk reagoi menjëherë, por u përpoq të kuptojë se çfarë pikëpamje kishte Budima ndaj kësaj oferte.⁷⁵ Mbreti hungarez *Matia Korvini*, i refuzoi këto kombinime. Duke parë se aleati i vogël arbëror ishte i rrezikuar drejtpërdrejt, dërgoi në jug delegatin e vet nëpërmjet Raguzës.⁷⁶ Më 13 nëntor 1466 Senati i Raguzës ndihmoi përcjelljen e *Paladin Gondolas* në Hungari, ku shkonte për t'i dorëzuar porosinë Gjergj Kastriotit. Por, në të njëjtën kohë, e shtyu përgjigjen që do t'i jepej të deleguarit të mbretit hungarez, i cili shkonte te Skënderbeu,⁷⁷ kështu që i zgjati bisedimet dhe përgatitjet. Miqësia e vjetër dhe pozita e ngjashme kërkonin që senatorët raguzanë t'ia tërheqin vëmendjen Skënderbeut për kurthin që po i përgatitnin pushtuesit osmanë. Duke tentuar që mos t'i ekspozoheshin rrezikut të turqve, raguzanët, në ato momente, frikësoheshin prej dinamizmit të mbretit hungarez. Nuk përjashtohet mundësia që ata të jenë frikësuar edhe prej intrigave nga ana e venedikasve.

Skënderbeu, nga ana e tij, mundësinë për të blerë armë e shihte te Ragusa, e cila që më 1447 i kishte dhënë atij një sasi të çmuar baruti.⁷⁸ Mirëpo, tregtarët raguzanë, sikurse edhe në rastin e mjeteve financiare, kishin kujdes të mos binin në sytë e turqve. Gjatë muajve shkurt dhe maj 1466, në momentet kur Skënderbeu kërcënohej të thyhej nga turqit dhe ata po i ofroreshin rrezikshëm qytetit, Këshilli i

⁷⁴ Tadić, *Promet putnika*, p.290.

⁷⁵ Radonić, *Skenderbeg*, no.289; 296; 305; 309-310.

⁷⁶ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XVIII (1463-1466), fol.198v-199r; *Chronica Ragusina Junii Restii*, p. 372

⁷⁷ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), 138r;150r; Thallóczy-Gelcich, *Diplom.Ragus.*, pp. 780-781.

⁷⁸ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. X (1446-1448), fol. 102r; Radonić, *Skenderbeg*, no.14

Raguzës lejoji shitjen e një sasie të konsiderueshme të barutit. Por jo vetëm baruti kërkohej nga Raguzat. Skënderbeu kishte nevojë edhe për ushtarë të kualifikuar që dinin të përdornin artilerinë. Më 1466 Skënderbeu kërkoji paseshtur në Raguzë lejen për të siguruar atje një mjeshtrë artilerie (bombarder), por kjo u refuzua.⁷⁹

Më 2 nëntor 1466, Skënderbeu përsëri iu drejtua mikut të parë dhe më të afërt e të përhershëm – Raguzës. Mirëpo, Senati i Republikës ia delegoi një fisnik, me kërkesën që të mos vijë në Raguzë për shkak të frikës nga turqit (të cilët asokohe kishin pushtuar pjesën lindore të Hercegovinës dhe gjendeshin afër Raguzës). Senati i dërgoi Skënderbeut ushqime, e madje i dha leje barkës së tij të lundronte në portin e Raguzës.⁸⁰ Më 18 prill 1465, në pragun e luftës së Skënderbeut me ushtritë osmane, Senati i Raguzës i kishte ofruar, me vetiniciativë, që anëtarët e familjes së tij të strehoheshin në Raguzë, përkatësisht në ishullin e Mletit.⁸¹ Pra, në nëntor 1466, situata u keqësua shumë edhe për vetë Raguzën. Prandaj mund të jetë e kuptueshme se ata, së pari, kujdeseshin për sigurimin e tyre, domethënë frikësoheshin se me strehimin e një luftëtari të pathyeshëm kundër turqve, siç ishte Skënderbeu, do të shkaktonin depërtimin e ushtrive turke në territorin e Republikës së Shën Vlashit. Nuk dihet se çfarë ka bërë Skënderbeu ato ditë para Raguzës, por dihet se ai ka shkuar afër këtij qyteti, diku nga 1 prilli i vitit 1467, dhe se qeveria e Raguzës kishte zgjedhur për ta pritur tre fisnikë raguzanë: *Junius de Gradi*, *Jacobus de Gondola* dhe *Nicola de Bona*.⁸² Disa muaj më vonë, më 15 dhjetor 1467, u zgjodh delegacioni për të pritur të birin e tij, Gjonin,⁸³ por nuk është e sigurt nëse i biri i Skënderbeut ka hyrë në atë kohë në Raguzë.

⁷⁹ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), fol.13r;

⁸⁰ *Ibid.*, fol.134r-134v; Radonić, *Skenderbeg.*, no.338.

⁸¹ “...*de offerendo illustri domino Schenderbegho receptaculum pro familia sua in insula nostra Melite, prout alias fuit*”, HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XVIII (1463-1466), fol.150v. Radonić e ka lexuar gabimisht vitin, si viti 1466. Duhet të jetë 18 prill 1465 (Cfr.: Radonić, *Skenderbeg*, no.314).

⁸² HR-DADU, *Acta Cons.Min.*, vol.XVII (1466-1469), fol.71r.

⁸³ “*Ser Marinus Ben. de Gondola, ser Andreas Fran. de Sorigo electi ad eundum obviam filio domini Schenderbeghi*”, *Ibid.*, fol.109v.

Më lart u tha se Raguzë shërbente edhe si nxitje e ndërhyrjes së Skënderbeut në grindjet napolitane për fron. Më 9 qershor 1460, përpara Këshillit të Vogël u paraqit një përfaqësues i Skënderbeut me kërkesën për mbështetje që përmes Adriatikut të kalohet në Pulje.⁸⁴ Në fakt, problemet lindën lidhur me operacionin detar të Skënderbeut, për bartjen e 2000 luftëtarëve të tij drejt Puljes, gjë që duhej të kryhej përmes Raguzës. Aty Skënderbeu më 21 korrik 1461, bleu, në prani të kancelarit të qytetit *Ksenofon Filelfo*, për dyzet dukate një fustë (lloj anijeje) për rremëtarë. Meqë këto u vonuan, Skënderbeu mori me qira anije në Raguzë.⁸⁵ Vetëm në fund të gushtit, Skënderbeu dhe trupat e tij arritën në Raguzë, nga ku do të përcillej për në Pulje. Në Raguzë, ai u prit me brohoritje dhe me të gjitha nderet e një strukture hierarkike shtetërore dhe kishtarë, që i takonin një sovranit. Ky shtet i vogël (Raguzë) me traditë të madhe në lidhjet e ngushta me interesat, aspektet financiare e organizative të kryqëzatës, mund t'ia siguronte këto më së miri. Fisnikëria raguzane i hapi portat me dëshirë, pasi në njërin anë dëshironin fitoren e Ferrantes, në anën tjetër nga frika prej turqve, sapo kishin kërkuar t'u dërgohej drithë nga Arbëria. Së këndejmi, zotërinjtë e Këshillit ishin kujdesur që më 17 gusht 1461, prijësi arbëror të pritej siç e kërkonte rasti.⁸⁶

Këtë protokoll udhëtimi të këtij niveli e përshkruan edhe Barleti, ku ndër të tjera shkruan: “*Kur Skënderbeu arriti në Raguzë, u derdh i gjithë qyteti dhe i doli përpara një mizëri populli për ta pritur me duartrokkitje dhe gëzim shumë të madh. I përcjellë prej tyre, ai hyri në qytet dhe u prit me nderime dhe bujari. Të nesërmen, pasi u bënë, sipas zakonit, kremtime zyrtare dhe ceremoni fetare, i ra qytetit rreth e përçark, ndërsa ditën tjetër vazhdoi duke vizituar arsenalet navale, kështjellën dhe fortifikimet e qytetit...*”⁸⁷

Për të pritë princin arbëror, u ngrit një komision i përbërë nga fisnikët *Paladino de Lukari*, *Paul de Pozza* dhe *Nikola de Palmota*, siç thuhej në dokument, për ta nderuar e mirëpritur zotërinë e famshëm

⁸⁴ HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*XVI (1459-1461), fol.146r.

⁸⁵ HR-DADU, *Div. Notariae*, vol. XLV, fol.96v; Ibid., vol. XLIV, fol.137v

⁸⁶ HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol. XVII ((1461-1463), fol.2r; 5r.

⁸⁷ Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut* (botimi i tretë), Prishtinë: Rilindja 1989, p.394.

Skënderbe, i cili do të vijë në Raguzë. U përcaktua dhe u përgatit edhe shtëpia, ku duhej të vendosej Skënderbeu. Në Raguzë, Skënderbeu takoi edhe përfaqësuesin e *Ferrantes, Parpugnanon* (Giacomo De Parpagniano), i cili ishte dërguar me një anije të posaçme nga Ferdinandi për ta takuar dhe nxitur Skënderbeun që të vinte. Por Parpagniano kishte ardhur edhe për një qëllim tjetër, për të cilin informon kronikani raguzan, Resti. Ai vinte pas bisedimeve që kishin bërë në Napoli dy ambasadorë raguzanë, Bartolomeo Gozze dhe Nicola di Marino Gondola në lidhje me mundësinë e liritimit nga burgu të një personi që kishte kryer një vrasje dhe pritej dënimi i tij me vdekje. Kurse në një dokument tjetër thuhet se të dy ndërhyjnë pranë Këshillit të Vogël, për të liruar të dënuarin për vrasje *Nikolla Risinoviq*. Gjatë qëndrimit në Raguzë, Skënderbeut iu dorëzuan “*të holla dhe argjend*” fondi i mbledhur për kryqëzatë dhe iu dhanë 2000 biskota (bukë peksimadhe) për nevojat e ushtarëve.⁸⁸

Pas përfundimit të episodit të Puljes, në janarin e vitit 1462 Skënderbeu, vendosi të kthehej në Arbëri, duke lënë pas një pjesë të mirë të trupave ushtarake. Kthimi i tij në fund të janarit të vitit 1462, përsëri do të bëhej përmes qytetit të *Shën Vlashit*. Këshillit të qytetit të *Shën Vlashit* i kishin bërë përshtypje bëmat e tij në Itali, prandaj u bënë përgatitje edhe më madhështore se sa ato të vitit 1461. Sipas dokumentit, Këshilli vuri në dispozicion për kthimin e trupave dhe kuajve të tij një anije *balonerio*.⁸⁹ Me këtë rast, bie në sy skrupoloziteti protokollar i detajuar raguzan. U përcaktua itinerari i udhëtimit në territorin e Raguzës, ku Skënderbeut do t’i lejohej lirshëm të udhëtonte nga *Konavlja* deri në *Cavtat*, kurse prej Raguze do të shoqërohej nga nënkonti i Brenit me burrat e krahinës deri në *Cavtat* ku do ta priste

⁸⁸ HR-DADU, *Acta Cons. Min*, vol XV (1459-1462), fol.201v; HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol.XVII (1461-1463), fol.6v-7r.; *Chronica Ragusina Junii Restii*, pp.359-360.

⁸⁹ Balonerio, është një llojë anije tregtare e përdorur edhe nga tregtarët italianë, por edhe në Raguzë. Përveçse në dokumentin e përmendur, këtë llojë anijeje e gjejmë të përmendat shpesh gjatë shek.XV, në dokumentat raguziane: HR-DADU, *Lamenta de Foris*, Vol.XXXVII, fol.24; HR-DADU, *Diversa Notariae*, vol. LV, fol. 6v.-7; HR-DADU, *Diversa Notariae*, vol. LVII, fol. 70-70v; HR-DADU, *Cons. Minor.*, vol.XIV, fol.44, HR-DADU, *Cons. Minor.*, vol.XV, fol.234, etj.

mëkëmbësi i vendit, i cili do ta shoqëronte me 100 vetë deri sa ai të arrinte jashtë juridiksionit të qytetit.⁹⁰ Po ashtu, së paku tre fisnikë u vunë në shërbim që të qëndronin me të në çdo vend për t'i paguar shpenzimet e tij deri në *Lushticë* apo *Budvë* (deri në kufijtë jugorë të Raguzës), duke u lejuar të shpenzonin rreth 50 perperë në ditë për ta nderuar Skënderbeun gjatë qëndrimit. Pas pak kohe Skënderbeu arriti në Raguzë nga ku tentoi të vazhdonte menjëherë udhëtimin për në atdhe, por moti i keq nuk e lejoi. Raguzanët e këshilluan që, duke pasur parasysh se moti ishte shumë i keq dhe në ato kushte nuk mund të lundronte, të pranonte të kthehej në Raguzë. Për këtë, Këshilli i qytetit mori përsipër sigurimin e ushqimeve, në *Cavtat* do të nxirrej në treg furnizim i mjaftueshëm, dhe nëse Skënderbeu nuk do të ishte i gatshëm për t'u kthyer në Raguzë, u vendos që ta shoqëronin fisnikët raguzanë të pajisur më 50 perperë për shpenzime dhe biskota, aq sa ata ta konsideronin të mjaftueshme.⁹¹ Ndërkohë, me 9 shkurt 1462, përfaqësuesit e Këshillit diskutonin me Skënderbeun lidhur me zhvillimet në Ballkan përballë pushtimeve turke, duke u njoftuar nga përfaqësuesi raguzan, i cili sapo ishte kthyer, siç thuhej në dokument, nga Porta e Lartë. Dy ditë më vonë, Skënderbeu, kërkoi nga Këshilli lirim të pesë personave që ishin zënë rob nga peshkatarët në ujërat raguzane.⁹² Gjatë qëndrimit në Raguzë, më 26 shkurt 1462 Skënderbeu, mund të ketë takuar edhe rivalin e tij, Lekë Dukagjinin, i cili po ashtu gjendej në Raguzë. Dokumentet nuk na thonë se kur është kthyer Skënderbeu në atdhe, por nga regjistrat e Këshillit të Raguzës

⁹⁰ Dokumentat flasin për përgatitje për pritje-përcjelljen e Skënderbeut në Raguzë. Duke filluar nga 29 janari e deri më 11 shkurt regjistrohën 7 vendime të Senatit të Republikës së Shën Vlashit kushtuar pritjes dhe përcjelljes së Skënderbeut për në Arbëri.

⁹¹ HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol.XVII (1461-1463), fol. 33r, 51v, 52r, 56r, 62v.

⁹² Si pjesë e protokollit ishte paraparë edhe akti i mirëbërësisë: Pesë vetë që ishin kapur nga peshkatarët raguzan në ishullin Lagosta dhe që ndodheshin në burg, do të liroheshin me porosi të Skënderbeut. E gjithë kjo, ka qenë shenjë e prestigjit të lartë që një prijës të bënte veprime ekskluzive që anashkalonin vendimet e gjykatave. Pas aktit të mirëbërësisë vinte akti i "konfirmimit" të cilësisë së pritjes. Për këtë porositej fisniku Jakob de Gondola, që t'i lutej Skënderbeut që ky i fundit të lëshonte një dokument me firmën e me vulën e tij personale, me të cilin të tërhiqte akuzat që kishte bërë ndaj "anijeve" raguzane.

del se edhe në maj 1462 ai interesohej për sigurimin e ushqimeve për trupën e tij që ishte duke u kthyer.⁹³

Kur Skënderbeu deshi të shkonte për në Napoli, në fund të vitit 1464, përsëri iu desh të kërkonte një galerë në Raguzë.⁹⁴ Edhe në vitin 1465, kur marrëdhëniet me Venedikun ishin keqësuar sërish, Skënderbeu mori një anije shtetërore raguzane.⁹⁵ Jo vetëm ai, por edhe i dërguari i tij, Stefan Radojeviqi mori me qira në Raguzë dy anije të Budvës për një udhëtim drejt *Shibenikut* dhe *Splitit*. Në përpjekje për të ndërtuar një flotë të vetën anijesh, Skënderbeu, më 1455 mori në shërbim një meremetues dalmatinas anijesh, i quajtur *Blasius Ostojich*,⁹⁶ kurse zyrtari *Ninac*, në tetor 1463 kërkonte leje në Raguzë për të blerë dy barka dhe të merrte katër mjeshtër për secilën barkë për ndërtimin e anijeve në Arbëri. Këshilli i Raguzës, i frikësuar nga pushtimi i Bosnjës prej *Mehmetit II* dhe me shumë shpresë për kryqëzatën, miratoi kërkesën e përfaqësuesit të Skënderbeut.⁹⁷ Më 15 tetor 1463 përfaqësuesi i Skënderbeut, *Paladino de Gondola* mori në shërbim zdrukthëtarin *Andrea Thomasi de Zuppana*, të cion e përmendëm më lartë.⁹⁸

Kastrioti gjatë gjithë kohës vazhdoi të mbante kontakte qoftë me Raguzën, e cila më 9 shkurt 1465 i dha mjeshtër ndërtimi për përfundimin e kështjellës së Rodonit, qoftë me mbretin e Hungarisë, *Matia Korvinin*. Ky, në mes të verës 1465, dërgoi fratin Aleksandër si përfaqësues pranë Skënderbeut. Në dokument thuhej se me urdhër mbretëror, *Aleksandri* duhej të kalonte nëpër Raguzë dhe nga ana e tij (Matia Korvinit) kërkoj nga Republika që të dërgonte, edhe ajo, një ambasador të saj, i cili do të kontaktonte Skënderbeun. Raguza, nga

⁹³ HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol.XVII (1461-1463), fol. 33r, 51v, 52r, 56r, 62v, 91v.

⁹⁴ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol.XVIII (1463-1466), fol.7v.

⁹⁵ *Ibid.*, fol.133v.

⁹⁶ HR-DADU, *Div. Cancellariae*, vol.LXV(1455-1456), fol.133r.

⁹⁷ Senati i Raguzës i përgjigjet Ninacit, ambasadorit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, duke i ofruar atij lehtësira për të blerë dy barka dhe të marrë deri në katër mjeshtër për secilën barkë. (HR-DADU, *Acta Cons.Rog.*, vol.XVII (1461-1463), fol.276r-276v).

⁹⁸ HR-DADU, *Div. Cancellariae*, vol. LXXI, (1463-1464), fol. 91v.

ana e saj, e përkrahu këtë emërim dhe, më 12 gusht të këtij viti ngarkoi fisnikun *Paladino de Lukarin*, që ta shoqëronte fratin drejt Arbërisë në një anije raguzane, kurse, si përfaqësues i saj te Skënderbeu u dërgua Nikollë Bona.⁹⁹

Ndonëse nuk dihet saktësisht përmbajtja e *dërgatës* së tij, nga regjistrat e Këshillit të Vogël del që *Republika e Shën Vlashit* e pranoi kërkesën e Skënderbeut që të dërgonte me 13 nëntor 1466 fisnikun raguzan, *Paladino de Gondola* si i dërguar i Skënderbeut te *Matia Korvini*. Këshilli i Republikës, duke u treguar i matur në raport me turqit, e porositi që të mos transmetonte asgjë në emër të Raguzës. Edhe knjaz *Stefan Radojeviqit*, një tjetër përfaqësues i Gjergj Kastriotit, i lejoj udhëtimin drejt *Shibenikut* ose *Splitit*, prej nga do të vazhdonte rrugën për te *Matia Korvini*,¹⁰⁰ ndonëse në këtë kohë nuk mund të pritej shumë nga Hungaria.

Kur në vjeshtën e vitit 1466 Skënderbeu vendosi të udhëtonte vetë në Itali për të kërkuar ndihmë në luftën që po bënte, përsëri ai u nis përmes Raguzës, ku dikur ishte pritur me brohoritje. Por gjendja tani kishte ndryshuar. Tani përfaqësuesit e Këshillit i kërkuan që të zgjidhen tre fisnikë raguzanë, që të shkonin për t'u takuar me Skënderbeun, dhe t'i kërkonin atij që të mos shkonte në Raguzë, siç thuhet në dokument, për disa arsye të mira.¹⁰¹ Në të vërtetë, në një vendim të mëhershëm (2 nëntor 1466)¹⁰² pranohej të pritej

⁹⁹HR-DADU, *Div.Cancellariae*, vol.LXXII (1464-1465), fol.75v.; Radonić, *Skenderbeg.*, no.29; *Chronica Ragusina Junii Restii*, p. 372; HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XVIII (1463-1466), fol.198v-199r.

¹⁰⁰ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), fol.136v, 138r; Thallóczy-Gelcich, *Diplom.Ragus.*, p. 780.

¹⁰¹ "...*faciendi tres ex nobilibus nostris, qui vadant ad obviandum illustri domino Schenderbegh et eum rogent, quod non veniat Ragusium ob bonum respectum*", HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), fol.134r-134v; Radonić, *Skenderbeg.*, no.338.

¹⁰² Gjatë javës së parë të nëntorit anija e Kastriotit ndodhej në hyrje të portit të Raguzës. Më datë 2 nëntor 1466. Anëtarët e Këshillit të Vogël, fisnikët, *Ser Nicola Marino de Gondola*, *Ser Aloysius de Georgio dhe Ser Helias Pe. De Bona*, porositeshin nga Senati i Raguzës që të merrnin masa për ta pritur shkëlqesinë, zotin Skënderbe, e për të marrë vesh me të nëse ishte me e udhës që të mos zbriste në Raguzë (HR-DADU, *Acta Cons. Min.*, vol.XVII (1466-1469), fol.40v).

Skënderbeu, dhe për ta pritur ishte caktuar edhe një delegacion, por në të njëjtën ditë, ky vendim u kthye prapa. Në vend të saj, Skënderbeu u mbajt me ushqime, duke lejuar edhe që barka e Skënderbeut të hynte brenda zinxhirëve të portit.¹⁰³ Me sa duket, përsëri Raguzë mbante qëndrim *modus vivendi* duke mos pranuar të rrezikonte tregtinë e saj fitimprurëse në Ballkan dhe pozicionin e tregtarëve të vet në qytetet nën pushtimin osman për ta ndihmuar Skënderbeun. Përkundër qëndrimit tanimë të njohur të Raguzës, ajo u mundua t'i gjendej afër Kastriotit. Më 1 prill 1467 ishte caktuar një delegacion që të takohej me Skënderbeun. Po ashtu, më 15 dhjetor, gjatë kthimit të Gjonit (të birit të Skënderbeut) nga Venediku ku kishte shkuar për të kërkuar ndihmë, Këshilli i Raguzës kishte marrë vendim që t'i dërgonte dy fisnikë për ta vizituar djalin e Skënderbeut, dhe të nderohej me sende ushqimore.¹⁰⁴

Lajmi i fundit që vjen nga sfondi i dokumenteve raguzane për Skënderbeun, është ai i 1 marsit 1468, tre muaj pas vdekjes së tij, që në fakt, është varianti i dytë, që nuk përkon me variantin e parë, përkatësisht “variantin zyrtar” të Republikës së Venedikut. Varianti i dytë i vdekjes së heroit tonë, vjen nga diplomati dhe ambasadori i Mantuas në Raguzë, *Joannes Franciscus de Maffeis*. Për vdekjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ky diplomat, njoftonte markezin e tij në Raguzë, se “*Skënderbeu vdiq në betejë nga një shigjetë*”. Kjo bëri që në Raguzë dhe gjetiu, të përhapej lajmi, se gjoja një shigjetë i ka sjellë vdekjen Skënderbeut.¹⁰⁵ Ndërkohë, miku i dikurshëm i perandorit të fundit të Bizantit, historiani bizantin *George Sfranca* (Sfrantzes), na njofton se heroi kishte pasur “një vdekje të natyrshme”.

¹⁰³ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), fol.134v-134r.

¹⁰⁴ HR-DADU, *Acta Cons. Rog.*, vol. XIX (1466-1467), fol.292r. Senati i Raguzës e caktoi delegacionin në përbërje: Marinus Ben de Gondola dhe Anndrea Sargo, të cilët duhej të takoheshin me Gjonin, djalin e Skënderbeut (HR-DADU, *Acta Cons. Min.*, vol.XVII (1466-1469), fol.109v.)

¹⁰⁵ Radonić, *Skenderbeg.*, no.391.

Antal MOLNÁR
(Budapest)

**THE MEMORY OF SKANDERBEG AND THE
BEGINNING OF THE ALBANIAN CATHOLIC NATION
BUILDING**

The researches about the origins of the nations and of the nationalism underwent a considerable change of paradigm in the last ten years. Earlier, the scholars regarded the nations and the nationalism as the product of the industrial revolution in the 19th century and did not study their precedents.¹ However, several contemporary historians reduce the genesis of the nationalism to the Middle Ages and consider the medieval nations as the early versions of the modern ones.² In this

*Hungarian Academy of Sciences, Research Centre for the Humanities, Institute of History, molnar.antal@btk.mta.hu

**This paper has been written with the support of the research project number NKFIH K-129236, *Christianity versus Islam. At a Crossroads between Crusades and Coexistence in the 16th and 17th Centuries*.

¹ As a token reference to what is now an enormous body of literature, I mention the three most influential books, often cited by authors of Central European history: Anderson, Benedict. *Imagined Communities. Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*. London–New York: Verso, 1983; Gellner, Ernest. *Nations and Nationalism*. Oxford: Blackwell, 1983; Hobsbawm, Eric. *Nations and Nationalism Since 1780: Programme, Myth, Reality*. Cambridge: Cambridge University Press, 1990.

² Here, too, I refer to only three important texts: Armstrong, John. *Nations Before Nationalism*. Chapel Hill: University of North Carolina Press, 1982; Gorski, Philip S. “The Mosaic Moment: An Early Modernist Critique of Modernist Theories of Nationalism,” *American Journal of Sociology* 105 (2000): 1428–1468; Hirschi, Caspar. *The Origins of Nationalism. An Alternative History from Ancient Rome to Early Modern Germany*. Cambridge: Cambridge University Press, 2012.

presentation, I propose to connect these contemporary nationalism theories with the early modern history of the Balkan nations who lived under the Ottoman rule. As a matter of fact, the early modern nationalism registered in the case of the occidental nations can be found in the Balkan nations too. In Europe, both protestant and catholic denominations, and especially the ecclesiastical intelligentsia plaid a significant role in these processes, mostly in Central Europe.³ In the case of the Balkan Catholics, it was the Holy See and her organ for the missions, the Congregation of the Propagation of the Faith who promoted, with her nation-focused mission conception and strategy, the formation of the ideas about the national identities.⁴

Propaganda Fide's nation-oriented mission strategy had a formative effect on the missionaries' intellectual outlook and their relations with their own communities. Young people coming to Rome or other Italian colleges from the mission areas developed a sensitivity to their native language and culture and an awareness of their ethnic community's historical and political identity. Returning to their homelands, they retained this sensitivity in their mission work,

³ Molnár, Antal. "Autonomia ecclesiastica e identità nazionale in Croazia nel '600: il sinodo diocesano di Zagabria (1634)." *Incorrupta monumenta ecclesiam defendunt. Studi offerti a mons. Sergio Pagano, prefetto dell'Archivio Segreto Vaticano*. Collectanea Archivi Vaticani 106, a cura di Andreas Gottsmann, Pierantonio Piatti, Andreas E. Rehberg. Vol. I. *La Chiesa nella storia. Religione, cultura, costume* Tomo 2. Città del Vaticano: Archivio Segreto Vaticano, 2018. 1129-1140.

⁴ Pizzorusso, Giovanni. "Agli antipodi di Babele: Propaganda Fide tra immagine cosmopolita e orizzonti romani (XVII—XIX) secolo." In *Roma, la città del papa. Vita civile e religiosa dal giubileo di Bonifacio VIII al giubileo di papa Wojtyła*. Storia d'Italia. Annali 16, a cura di Luigi Fiorani e Adriano Prosperi, Torino: Einaudi, 2000, 479–508; idem. "I satelliti di Propaganda Fide: il Collegio Urbano e la Tipografia Poliglotta. Note di ricerca su due istituzioni culturali romane nel XVII secolo." *Mélanges de l'École Française de Rome. Italie et Méditerranée* 116, no. 2 (2004): 471–498; Pizzorusso, Giovanni, Sanfilippo, Matteo. *Dagli indiani agli emigranti. L'attenzione della Chiesa romana al Nuovo Mondo, 1492–1908*. Archivio storico dell'emigrazione italiana. Quaderni 1. Viterbo: Sette Città, 2005, 7–22; Pizzorusso, Giovanni. *Governare le missioni, conoscere il mondo nel XVII secolo. La Congregazione Pontificia de Propaganda Fide*. Studi di storia delle istituzioni ecclesiastiche 6. Viterbo: Sette Città, 2018, passim, particularly 125–163.

representing their flock in their letters to Propaganda Fide not only as endangered Catholics, but also as members of the ‘Illyrian’, Bosnian, Bulgarian or Albanian nations. They therefore wished to help their communities preserve their national identity, which was closely related to their Catholic faith. To do so, they naturally had to make a systematic study, both for themselves and for Rome, of the definitively national characteristics of their communities. In the reports and letters they sent to Propaganda Fide, they described in increasing detail their nations’ language, customs, geographical boundaries and key historical events, and made proposals for ways and means of giving them pastoral and cultural assistance.⁵

My study focuses to the Albanian case. By the Albanians, as by the Bosnians and the Bulgarians, there were the Catholic priests,

⁵ Cordignano, Fulvio. “Geografia ecclesiastica dell’Albania dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII.” *Orientalia Christiana Periodica* 36 (1934): 229–294; Tacchella, Lorenzo. *Le antiche sedi episcopali latine, greche e bulgare dell’Albania etnica e della Macedonia*. Milano: n.p., 1990. (Biblioteca dell’Accademia Olubrense 4.) The two-volume corpus published by Injac Zamputi is the most comprehensive collection of sources on the Albanian Catholic church in the seventeenth century: Zamputi, Injac. *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore e të mesme në shekullin XVII*. Burime dhe Materiale për Historinë e Shqipërisë 3. Vol. I. (1610–1634). Vol. II. (1634–1650). Tiranë: Universiteti Shtetëror, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1963–1965. A new edition of the corpus was published in 2018: Zamputi [Zamputi], Injac. *Relacione dhe dokumente për historinë e Shqipërisë (1610–1650)*. St. Gallen – Prishtinë: Albanisches Institut – Faik Konica, 2018. The page numbers quoted below are those of the new edition. An important complement to this corpus is a posthumously-published book, a continuation of Zamputi’s previous three-volume corpus (*Dokumente të shekujve XVI–XVII për historinë e Shqipërisë*. Vol. I–III. /1507–1621/. Tiranë: Akademia e Shkencave e Rps të Shqipërisë, 1989–1990) based on his manuscripts: Zamputi [Zamputi], Injac. *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623–1653)*. St. Gallen – Prishtinë: Albanisches Institut – Faik Konica, 2015. Peter Bartl has explored the Catholic church geography of Albania in the sixteenth to nineteenth centuries as part of his corpus of visitation and mission reports: Bartl, Peter. *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien*. Vol. I. *Diözese Alessio*. Albanische Forschungen 26, 1. Wiesbaden: Harrasowitz, 2007; Vol. II. *Diözese Durazzo*. Albanische Forschungen 26, 2. Wiesbaden: Harrasowitz, 2011; Vol. III. *Diözese Sappa*. Albanische Forschungen 26, 3. Wiesbaden: Harrasowitz, 2014; Vol. IV. *Diözese Pulati*. Albanische Forschungen 26, 4. Wiesbaden: Harrasowitz, 2017.

mainly the missionaries and the prelates educated in Rome and in the Illyrian College of Loreto, who created the early modern national identities.⁶ They used the Italian humanist patterns forged by the Albanian exiles in Venice.⁷ The most important part of this catholic national tradition was the cult of Skanderbeg, which survived in the humanist milieu as well as among the Albanian Catholic highlanders.⁸

The central figure in the formation of Catholic Albanian national identity was Pietro Massarecchi (Pjetër Mazreku) from Prizren, apostolic visitor in 1623 and Archbishop of Antivari from 1624 to 1634. He drew his national ideology from two sources. Firstly, he clearly saw that Albanian Catholicism could survive only if it connected into the main current of international Catholicism and distinguished itself from Illyrian – meaning South Slav – Catholicism. His activity clearly manifests the duality of Propaganda Fide’s mission strategy, which pursued the strategic principle of universality and a practical pastoral strategy focusing on the special needs of the nations.

Mazreku was constantly concerned with the special pastoral and cultural needs of his own people, the Albanians, and called on the Holy See to address these needs.⁹ His report on the Serbian missions of 1634 covered the Albanian situation and included a proposal for a full mission programme to assist them. Mazreku saw the only chance of preserving to lie in the training of a highly-qualified church intellectual elite. Another important new element for Mazreku was to raise the protection of Albanian identity to a matter of Balkan, indeed European significance. He considered it to be the key Catholic ethnic

⁶ Demiraj, Bardhyl. “Rishtarë shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Loretos. Klasifikimi i dokumentacionit arkivor.” *Shejzat – Pleiades*, Series Nova 2, no 1–2 (2017): 22–55.

⁷ Elsie, Robert. *History of Albanian Literature*. Vol. I. East European Monographs 379. New York: Columbia University Press, 1995. 27–31.

⁸ Zamputi, Injac. “Le nom et la tradition de Skanderbeg dans les efforts des Albanais pour la liberté durant les premiers siècles de la domination ottomane.” *Studia albanica* 4, no. 2 (1967) 85–94.

⁹ Molnár, Antal. *Le Saint-Siège, Raguse et les missions catholiques de la Hongrie Ottomane 1572–1647*. Bibliotheca Academiae Hungariae–Roma, Studia 1. Rome–Budapest: Accademia d’Ungheria in Roma, 2007, 192–198, 233–255.

group in the Balkans, with a military strength that could be crucial in fighting the Ottomans.¹⁰

Mazreku had done an inestimable service to the Kosovo Albanians with the education of Andrea Bogdani in the Illyrian College in Loreto. Andrea Bogdani became Archbishop of Ochrida, and later of Skopje, and compiled an Albanian grammar, which has not survived.¹¹ Like his uncle before him, he also sent several Kosovar students to Loreto. His nephew, Pietro Bogdani, became Bishop of Scutari and later Archbishop of Skopje, and was the author of the foremost seventeenth-century Albanian-language religious book, *Cuneus Prophetarum* (Padua, 1685). It was the first original Albanian-language book, and as such, the most important record of literary Albanian and Albanian thinking from the seventeenth century.¹² Thanks to Pietro Mazreku's national mission programme and support for the training of priests, Kosovo became the cradle of Albanian

¹⁰ Archivio storico della Sacra Congregazione per l'Evangelizzazione dei Popoli o de „Propaganda Fide” (=APF), Scritture Originali riferite nelle Congregazioni Generali (=SOCG) vol. 263, fol. 266r–284v. Full publication of the report: Zamputti, *Relazione*, 350–371. Excerpts published in: Јачов, Марко. *Стуси Конгрегације за пропаганду вере у Риму о Србима 1622–1644*. Зборник за историју, језик и књижевност српског народа. II одељење XXVI. Београд: САНУ, 1986, 212–216; Bartl, *Albania Sacra*, III. 114–118.

¹¹ Premrou, M.[irosrav]. “Katolički nadbiskupi u Skoplju.” *Glasnik Skopskog naučnog društva* 1 (1926): 329–334, 329–330; Redžepagić, Jašar. “Život, rad i pedagoški pogledi Andrea i Pjetra Bogdanija.” *Gjurmime Albanologjike* 2 (1965): 151–166, 151–154; Gasper, Gjini. *Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*. Teološko radovi 19. Zagreb: Kršćanska sadašnjost, 1986, 187–189.

¹² Bogdani, Pjetër. *Cuneus prophetarum a Pietro Bogdano. Patavii MDCLXXXV*. Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients 24. München: Rudolf Trofenik, 1977; Bartl, Peter. “Pjetër Bogdani und die Anfänge des albanischen Buchdrucks in Italien.” In idem. *Die Albaner in der europäischen Geschichte. Ausgewählte Aufsätze*. Albanian Studies 28, hrsg. von Bardhyl Demiraj und Robert Elsie. London: Centre for Albanian Studies, 2016, 177–199. Many of the sources on Pjetër Bogdani have been published: Marlekaj, Luigi. *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo. Con la riproduzione fotografica di centotrentadue documenti*. Paolo del Colle: Liantonio, 1989; Marquet, Odette. “Bogdani à la lumière des documents réexaminés.” *Zeitschrift für Balkanologie* 27 (1991): 26–44; idem. *Pjetër Bogdani Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*. Shkodër: Shtëpia Botuese “At Gjergj Fishta”, 1997.

national identity. Kosovar Albanian prelates were instrumental in shaping the Albanian national discourse, developing the Albanian language and literature, and organizing the Albanians into a military force. Taken together, this was a great contribution to the process by which ethnic, linguistic and cultural phenomena evolved into Albanian nationalism in the early modern sense.

The missionary bishops making use of the humanist legacy created the historical framework of this national consciousness. It was very important, because the imperialism of the other nations, especially the “Illyrian” (South Slave, later Croat) national thought tried to encompass the Albanian one.¹³ Frang Bardhi, bishop of Sappa¹⁴ compiled a very exhaustive polemical treatise against Ivan Tomko Mrnjavać, bishop of Bosnia and famous impostor and falsifier of documents, who tried to prove that Skanderbeg was his ancestor as well as a genuine Illyrian.¹⁵ In his work published in Venice in 1635,

¹³ Of the abundant literature, I mention only the two most recent monographs: Fine, John V. A. Jr. *When Ethnicity did not Matter in the Balkans. A Study of Identity in Pre-Nationalist Croatia, Dalmatia, and Slavonia in the Medieval and Early-Modern Periods*. Ann Arbor: The University of Michigan Press, 2006; Blažević, Zrinka. *Ilirizam prije ilirizma*. Zagreb: Golden marketing – Tehnička knjiga, 2008.

¹⁴ For Bardhi’s life and work, see the proceedings of the conference held in Pristina on the 400th anniversary of his birth: *Frang Bardhi. 400 – vjetori i lindjes*. Prishtinë: Institutit Albanologjik i Prishtinës, 2007. See also: Çobani, Tonin. *Frang Bardhi dhe Relacionet e tij. Botohet me rastin e 400-vjetorit të lindjes*. Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci, 2006. 21–65, 155–157. On the literary programme of the Albanian mission directed by Propaganda Fide, see: Bartl, Peter, “Albanischer Buchdruck in Italien (16–18. Jahrhundert).” *Münchner Zeitschrift für Balkankunde* 5 (1983–1984): 113–119; Elsie, *History*, 41–84 passim; Genesin, Monica, Matzinger, Joachim, “La pubblicazione dei primi testi in lingua Albanese nel contesto dell’attività editoriale della Polyglotta.” In *L’Albania nell’Archivio di Propaganda Fide*, 33–47.

¹⁵ [Mrnjavać Tomko, Ivan.] *Indicia vetustatis et nobilitatis familiae Marciae, vulgo Marnavitiæ Nissensis, per Joannem Tomkum, ejusdem gentis, collecta*. Romae: Typis Vaticanis, 1632. Still the only thorough biography of Tomko: Galla, Ferenc. *Marnavics Tomkó János boszniai püspök magyar vonatkozásai*. Budapest: Római Magyar Történetkutató Intézet, 1940. Latest on his work as a historian: Tvrtković, Tamara. *Između znanosti i bajke. Ivan Tomko Mrnjavać*. Biblioteka Hrvatska povjesnica, Monografije i studije III/39. Zagreb–Šibenik: Hrvatski institut za povijest – Gradska knjižnica “Juraj Šižgorić”, 2008.

Bardhi recuperates Skanderbeg to the Albanian nation, enumerating a long series of historical, geographical, political and ethnographical evidences. His book, the *Georgius Castrottus Epirotus ...* is the first historical work in which the Albanian nationality of Skanderbeg is presented and defended.¹⁶ In his dedication to the readers, he claimed that he had been obliged to take up his pen when the invincible leader of the Albanians was being detached from his nation and put up as a member of another nation.¹⁷ He wrote the book after his appointment as a bishop but before his return to Albania from Rome, for the honour of his homeland and his love of his compatriots. He sent a copy to Propaganda Fide,¹⁸ and Francesco Ingoli, the secretary of the

¹⁶ [Blancus, Franciscus.] *Georgius Castriotus Epiroensis vulgo Scanderbegh, Epirotarum Princeps fortissimus, ac invictissimus Suis et Patriae restitutus. Per Franciscum Blancum De Alumnis, Collegii de Propaganda Fide Episcopum Sappatensem, et Sardensem, necnon Pulatensium, aliorumque Albaniae Populorum Administratorem.* Venetiis: Typis Marci Ginammi, 1636. An Albanian translation has been produced in four editions between 1957 and 2007. Bardhi, Frang. *Skënderbeu. Apologji*, perktheu nga latinishtja Stefan I. Prifti. Tiranë: Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve, 1957. Several Albanian authors have recently analysed his apologia: Shpuza, Gazmend. “Veprat humaniste të Frang Bardhit – shprehje e evropianitetit skenderbegian të epokës.” In *Frang Bardhi*, 157–178; Lajçi, Lulëzim. “Lufta e Kosovës (1448) në «Apologjinë» për Skënderbeun të Frang Bardhit.” *Ibid.*, 201–217; Culaj, Lush. “Batleti si burim historiografik i Bardhit.” *Ibid.* 219–228; Bramo, Elvis. “Means of Linguistic Expression in Frang Bardhi’s Apology of Scanderbeg – On the Occasion of the 550th Anniversary of the Death of the National Hero.” *European Journal of Language and Literature Studies* 4, no. 3 (2018): 23–30.

¹⁷ “Porro quam graves me ad stringendum calamum incitaverint causae, cum fortissimum ac invictissimum Epirotarum seu Albanensiorum ducem Scanderbegum nationi suae Epiroensi denegari, alienaeque adscribi viderem, tibi benigne Lector, considerandum omitto. Quare si conatus mei inanes et irriti prorsus evaserunt, temerarii certe nullo pacto censendi sunt; cum scribendi desiderium reprimere nequaquam potuissem, nisi et mihi et Patriae meae deesse turpiter voluissem.” [Blancus,] *Georgius Castriotus*, 7.

¹⁸ “Essendo Giorgio Castriotto detto per li suoi fatti illustri Scanderbegh, nato nell’inclita città di Croia metropoli dell’Albania da progenitori Albanesi, secondo che attestano li scrittori di quei tempi e doppio, et secondo che corre oppenione commune del volgo, con ragion vien ad esser Albanese. Si che vedendolo con falssi fundamenti da monsignor Giovanni Tomco vescovo di Bosna ascritto alla nazione Schiavona, mi spinse tanto l’honor della Patria e natural affetto de paesani, che mi

Congregatio liked the book but found Bardhi's attack on Mrnavić to be coarse, and in general disapproved of two bishops quarrelling over such questions.¹⁹

In the first fifty pages of the book, Bardhi set Mrnavić's claims and falsified documents against the findings of the humanist historians, not unreasonably repudiating his opponent's credibility as a historian. He claimed that Mrnavić had turned against the whole previous historical tradition, and that his information was completely false and did not stand up to the most trivial historical criticism. In the final third of the book, he systematically covered all of the contemporary sources, historians and even poets who had mentioned Skanderbeg and his family as Albanian.²⁰ Dalmatian and Ragusan historians who vociferously proclaimed the glory of their own nations, such as Mauro Orbini, mentioned him as being Albanian rather than Illyrian.²¹ Bardhi also quoted the oral tradition of the inhabitants of Pulati and Dukagjini, mountainous Albanian regions inaccessible to the Ottomans.²² They remembered the Castriota family has being from their area. Bardhi claimed that the memory of Skanderbeg lived on among the Albanians, who sang of his heroic deeds whenever they came together, and called him the Dragon of Epirus.²³ He concluded

posi a legger tutti quelli scrittori possibili, che a tempo del detto Scanderbegh e doppo notavano l'huomini illustri, quali unitamente dicono Scanderbegum nostrum Epirotam seu Albanensium fuisse, et aggregari in modo d'appologia o historiola, che qui in Venetia con la charità di questa Serenissima Repubblica la posi in presente forma, accioché apponesse la verità." Bardhi to Francesco Ingoli, secretary of Propaganda Fide, Venice, 1 June 1636. APF SOCG vol. 15, fol. 350r. On the same subject, see: *ibid.*, fol. 348r, 349r.

¹⁹ APF SOCG vol. 15, fol. 353v.

²⁰ This of course does not mean that Skanderberg was not related to the Serbian dynasties: the Castriotas and Brankovićes had several common strands. This certainly did not make them Serbian-oriented, and they were not the ancestors of Ivan Tomko Mrnavić. Schmitt, Oliver Jens. *Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan*. Regensburg: Friedrich Pustet, 2009, 45.

²¹ [Blancus,] *Georgius Castriottus*, 53–76.

²² Dushi, Arbnora. "Historia gojore si mjet argumentimi në apologjinë për Skënderbeun të Frang Bardhit." In *Frang Bardhi*, 277–286.

²³ [Blancus,] *Georgius Castriottus*, 70–71. "Nec leve desumi potest argumentum ex incredibili amore Epirotarum erga Scanderbegum, qui profecto non ita eum

that either his opponent or everybody from the great authors and monarchs down to the entire Albanian people were mistaken.²⁴ Bardhi's work clearly shows the interaction between the humanist scholarly records nurtured by Albanian exiles in Venice and the oral tradition of the Catholic population of North Albania.²⁵

The constructions of the Skanderbeg story in these very far removed registers jointly constituted one of the most important points of reference for early modern Albanian Catholic national identity. It was in the Bardhi-Mrnavić dispute that Skanderbeg's national affiliation first came to the surface, presaging the Serbo-Croat-Greco-Albanian polemics surrounding his ethnic identity in the nineteenth-century.²⁶

supramodum dilexissent, ni Epirota ipse fuisset Scanderbegus. Constat hoc, quia non libenter sub alienae nationis duce Epirotae militant. Quod autem eum summe amaverint, patet quia saepissime eius milites (ut in historiis legimus) maxima subibant pericula ob eiusdem Scanderbegi conservationem, et usque ad hodiernum diem assidue nostrates colluquuntur de ipso, eiusque res gestas in conviviiis alta voce (ut diximus) canunt, atque praecipuo nomine, per antonomasiam, Scanderbegum nostrum, *Culscedra e Arbenit*, id est Draco Epiri appellant, quae voces, cum pronuntiantur, ipse solus Scanderbegus intelligitur." Ibid., 74–75. He mentioned the song extolling the heroism of Skanderberg and Leka Dukagjin in a report of 1637: "Hanno assai de costumi gentilli, et così more antiquorum nei loro convivii e per le vie e nel lavoro cantano con alta voce li fatti illustri dei loro huomeni grandi, e specialmente dell'invitissimo signor Giorgio Castriota detto Scanderbegh e dell'illustrissimo signor Lecha Ducagino lor prencipe e signore." Zamputi, Injac. "Mbi disa materiale të reja dokumentare të shekullit XVII." *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat Shoqerore* 12, no. 3 (1958): 170–215, 204–205; Bartl, *Albania Sacra*, III. 125.

²⁴ "Ex quibus omnibus necessario sequitur, quod si non errat Tomcus, dum dicit Scanderbegum fuisse Slavum, errant tot scriptores, principes ac reges, dum asserunt Scanderbegum Epirotam seu Albanensium fuisse. Utrum autem errent tot gravissimi et celeberrimi scriptores, tot illustrissimi excellentissimique principes, tot serenissimi atque potentissimi reges adducti, ac univeralis praesertim nostrae gentis existimatio, Tomcus, an qui pro suo instituto laborat, nemo est, qui non videat." [Blancus.] *Georgius Castriottus*, 75.

²⁵ Grajçevci, Fadil. "Frang Bardhi, vazhduesi i traditës humaniste të Marin Barletit." In *Frang Bardhi*, 245–252.

²⁶ Schmitt, *Skanderbeg*, 301–309.

Mazreku's mission programme and the Mrnavić-Bardhi conflict set the conceptual framework and substance for how Catholic prelates and missionaries thought about Albanian national identity in the seventeenth century. Finally, we must face the question of why this development stopped. The Catholic Albanian national identity failed to endure into the nineteenth century, when – like the Serbian Orthodox religious national ideal – it could have formed a kind of base or substrate for modern secular national consciousness. Neither did the late-nineteenth-century Albanian national awakening draw on this tradition. An explanation for this clearly demands further research.

One thing we already know is the cataclysm suffered by the Balkan Catholics, especially the commercial middle class and the church organization, at the end of the seventeenth century: the depredations of the Great Turkish War effectively wiped out the economic, social, military-political and intellectual force of the Balkan Catholics.²⁷

In the eighteenth century, the European powers and the Holy See, including the *Congregatio de Propaganda Fide*, showed less interest in Catholics living in the Ottoman Empire, partly because of the failure of military plans in previous centuries and partly because of the dwindling of the Catholic population itself.²⁸ Emigration, reprisals and forced Islamization rendered the people unable to sustain their national pride.²⁹ The Albanian Catholics, like the Bosnians and Bulgarians, suffered very serious losses, and in the eighteenth and nineteenth centuries, faced with the rising number and economic and social power of Muslim Albanians, they were unable to present a real Catholic alternative as the modern Albanian nation was being built.

²⁷ Molnár, Antal. "Le missioni balcaniche durante il pontificato di Innocenzo XI (1676–1689): dall'apogeo alla rovina." In *Innocenzo XI Odescalchi. Papa, politico, committente*, a cura di Richard Bösel et al. Roma: Viella, 2014, 193–207.

²⁸ Heyberger, Bernard. *Les chrétiens du Proche-Orient au temps de la réforme catholique. (Syrie, Liban, Palestine, XVII^e –XVIII^e siècles)*. Bibliothèque des Écoles Françaises d'Athènes et de Rome 284. Rome: École Française de Rome, 1994, 185–207.

²⁹ Bartl, Peter. Die katholische Kirche im Mittelalter und unter osmanischer Herrschaft. In: idem. *Die Albaner*, 557–575.

Nonetheless, as when examining the genesis of European nationalism, we cannot ignore the early manifestations of Albanian and other Balkan national consciousness, because without them we will be left with a deficient and one-sided view of its development in modern and recent times.

Teuta SHALA-PELI
(Prishtinë)

**PËR PJEKJET PËR ÇLIRIMIN E DRISHTIT NGA SUNDIMI
VENEDIKAS, NË KOHËN E GJERGJ KASTRIOTIT-
SKËNDERBEUT**

Në fund të shekullit XIV qyteti i Drishtit, i cili qeverisej nga familja feudale e Balshajve, u ndodh përball dy rreziqeve të mëdha: në njërin anë ishte Republika e Venedikut, e në anën tjetër ishin sulmet e njëpasnjëshme të ushtrisë osmane. Në vitin 1392, Gjergji II Strazimiri zihet rob nga ana e turqve, për t'u liruar ai u detyrua që t'u dorëzoi atyre disa territore në mesin e të cilave edhe qytetin e Drishtit.¹ Ndërsa, në vitin 1395, Gjergji II Strazimiri arriti që përsëri këto qytete t'i kthejë nën zotërimin e vet, mirëpo në vitin 1396 ai u detyrua që në bazë të një marrëveshje t'ua dorëzojë venedikasve qytetin e Drishtit së bashku me Shkodrën, duke u arsyetuar se një veprim të tillë po e bënte “në mënyrë që këto të mos binin në duar të turqve” (*ut ea non vadant ad manus Turchorum*).²

Edhe përkundër faktit se qyteti i Drishtit kaloi nën sundimin

¹ Ivan Božić, *Albania i albanci tokom XIII, XIV I XV veka*, në Glas: odeljenje istorjski nauka. Srpska Academia Nauka i Umetnosti, knj.III 1983, 59 (më tej: Božić, *Albania i albanci*); Branislav Millutinović, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, Prishtinë 1985/15, 43 (më tej: Millutinović “Drishti”).

² Giuseppe [Joseph] Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, 25 vol., Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1967-1972 (më tej: AAV), AAV, p. I, t. 2, nr. 611, 309; L.Tholloczy-C.Jericek-E.Sufflay, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. II, Vindobonae 1913-1918, ribotim në Prishtinë nga Ekskluzive 2002, (më tej: Acta Alb.), Acta Alb., II/555.

venedikas, megjithatë Republika e Venedikut nuk pati një sundim të qetë në këtë qytet. Përveç luftës së Balshajve për çlirimin e këtij qyteti dhe të qyteteve të tjera mesjetare shqiptare, qyteti i Drishtit pas vdekjes së Balshës III, përkatësisht prej vitit 1421 e deri në vitin 1442, u përball edhe me luftën e pretendentëve për trashëgimin mbi zotërimet e Balshajve. Prej vitit 1421 e deri në vitin 1442, vazhdimisht qyteti i Drishtit do të jetë ose nën sundimin e Venedikut dhe përballë përpjekjeve serbe si të despotit Stefan Lazareviç apo pasardhësit të tij Gjergj Brankoviçit për ta pushtuar, apo do të jetë nën sundimin serb dhe përballë përpjekjeve të Venedikut për ta marrë atë nën zotërimin e vet. Pra, për njëzetën vjet me radhë, qyteti i Drishtit do ta ketë një fat të tillë.³ Në vitin 1442, Drishti kalon prapë nën sundimin e Venedikut.⁴

Pas këtyre zhvillimeve, për qytetin e Drishtit fillon një periudhë e cila përfshinë ngjarje dhe procese të cilat dalëngadalë po sillnin ndryshime si në arenën politike ashtu edhe në atë ekonomike e më gjerë, ndryshime të cilat ndërliidhen me kthimin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në Shqipëri. Pas kthimit të Skënderbeut në Shqipëri, edhe familjet fisnike drishtase si familjet e tjera fisnike shqiptare të asaj kohe, e përkrahën Skënderbeun. Përkrahja e parë e tyre erdhi me pjesëmarrjen në Kuvendin e Lezhës, e thirrur nga Skënderbeu, më 2 mars të vitit 1444, në qytetin e Lezhës. Në kohën kur u mbajt Kuvendi në fjalë, siç është e njohur, qyteti i Drishtit ndodhej nën sundimin e Venedikut, por fillimisht një gjë e tillë nuk i pengoi fisnikët drishtas si, Pjetër Spanin dhe Lekë Dushmanin, që të marrin pjesë në këtë Kuvend.⁵ Mirëpo, në vitin 1447, nën ndikimin e

³ Teuta Shala-Peli, *Drishti në Mesjetë*, Instituti i Historisë, Prishtinë 2016, 159.

⁴ S. Ljubić, *Listine o odnosajih izmedju juznoga Slavenstva i mletacke republike. Knjiga IX: od godine 1423 do 1452* (MSHSM, Zagreb 1890), 157-159 (më tej: Ljubić, *Listine IX*); Иван Божић, *Немирно поморје XV века*, Београд 1979, 121.

⁵ Ljubić, *Listine IX*, 214-215; Jovan Radonić, *Đuard Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd, 1942, 8 (më tej: Radonić, *Đuard Kastriot*); Theodor Ippen, “Dy shekell e gjysmë nga historia e Shqipërisë, 1204-1444. Princërit e Janinës”, *Ditura nr.12*, Tiranë 1927-28, 384. Branislav Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, 1985/15, Prishtinë 1985, 59 (më tej: Millutinoviç, “Drishti nën sundimin”); Aleks

Venedikut, Pjetër Spani dhe Lekë Dushmani u shkëputën prej Lidhjes së Lezhës.⁶

Qyteti i Drishtit sikurse qytetet tjera të Shqipërisë së Veriut, nuk kishte një jetë të qetë politike jo vetëm para periudhës së Skënderbeut, por as edhe gjatë saj. Duke u mbështetur në burimet dhe literaturën, të cilat i referohen zhvillimeve politike në qytetin e Drishtit gjatë periudhës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, kemi vërejtur se në periudhën kohore 1443-1468, kishte disa tentime për ta shkëputur Drishtin nga sundimi venedikas. Lidhur më këtë, siç mësohet nga një letër e Senatit e majit 1445, vojvoda i Drishtit kishte tentuar t'ia dorëzonte qytetin kontit Stefan të Bosnjës, që atë kohë kishte zbritur në Shqipëri, duke pushtuar Tivarin. Por falë reagimit të kapitenit venedikas të Shkodrës, ky plan kishte dështuar. Venedikasit ia kishin rrëmbyer Tivarin Stefanit të Bosnjës, dhe po ashtu, kishin arritur të shtinë në dorë edhe Drishtin.⁷

Gjatë vitit 1447 raportet mes Skënderbeut dhe Venedikut ishin të acaruar aq fort sa që në dhjetor erdhi deri te shpërthimi i luftës mes tyre. Në këto rrethana, Skënderbeu me ushtrinë e Lidhjes së Lezhës, sulmoi shumë vende dhe rrezikoi gati të gjitha posedimet venedikase në Shqipërinë e Veriut, madje si rrjedhojë e rrethanave të krijuara kanosej edhe pushtimi i Drishtit.⁸ Gjendja e krijuar si pasojë e luftës së Skënderbeut me Venedikun për qytetin e Dejës, u reflektua edhe në Drisht. Në këtë situatë, Skënderbeu vendosi që të rindërtojë kështjellën e Balcit, e cila ndodhej afër Dejës dhe Drishtit. Pasi rindërtoi kështjellën në fjalë, Skënderbeu la atje një garnizon. Përkujdesjen ia besoi nipit të tij, Hamzait dhe Marin Spanit, ndërsa vetë vazhdoi rrethimin e Dejës.⁹ Ndërsa, Skënderbeu

Buda, *Studime për Skënderbeun*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë 2018, 127 (më tej: Buda, *Studime për Skënderbeun*).

⁶ Millutinoviç, "Drishti nën sundimin", 59; Buda, *Studime për Skënderbeun*, 133; Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Prishtinë 1982, 142 (më tej: Barleti, *Historia*).

⁷ AAV, p. III, t. 19, nr. 5096, 67; AAV, p. III, t. 20, nr. 5546, 185.

⁸ *Istorija Crne Gore*, II/2, Titograd 1970, 214; Millutinoviç, "Drishti nën sundimin", 59.

⁹ Barleti, *Historia*, 152.

rrethoi Dejën, Hamzai pa dijeninë e tij, sulmoj Drishtin,¹⁰ edhe pse për një veprim të tillë e kishte kundërshtuar mjaft ashpër Marin Spani.¹¹ Megjithatë, sulmi i Hamza Kastriotit përfundoi pa sukses, qyteti i Drishtit ishte forcuar me armë, ushtri e me të gjitha mjetet e nevojshme ushtarake për qëndresë, mbrojtja e qytetit iu kishte besuar Andrea Engjëllit.¹² Për t'u shpague për këtë dështim të tij, Hamzai urdhëroi të shkatërrohen pyjet, ullishtat e të mbjellat rreth Drishtit, të digjen e të rrënohen shtëpitë e ndërtesat jashtë mureve të saj.

Barleti rrëfen, se pasi e zbrazti në këtë mënyrë mllefin e vet ndaj drishtianëve, Hamzai nuk u kthye më në Balc: “sedra e tij nuk e linte të takohej me Marin Spanin, i cili e kishte parashikuar rrezikun e sulmit mbi Drisht dhe, për këtë, ia kishte ç’këshilluar atë Hamzait”.¹³ Natyrisht një veprim i tillë nuk u mirëprit nga Skënderbeu, i cili jo vetëm që e kritikoi Hamzain se e kishte marrë një veprim pa dijeninë dhe miratimin e tij, por në të njëjtë kohë ia kujton përgjegjësinë e tij për atë ndërmarrje të dështuar, madje duke i kërkuar llogari edhe për gjakun e shokëve.¹⁴

Lufta mes Skënderbeut dhe Republikës së Venedikut zgjati deri në tetor të vitit 1448, kur edhe u nënshkrua Traktati i Paqes midis tyre.¹⁵ Edhe pas nënshkrimit të paqes midis Skënderbeut dhe Venedikut, gjendja në qytetin e Drishtit nuk ishte e qetë. Gjatë asaj kohe Republika e Venedikut ishte detyruar të angazhojë forca të shumta për shkak të shpërthimit të revoltës rreth Drishtit, shkaqet e të cilës nuk dihen.¹⁶ Pothuaj në të njëjtën kohë, qyteti i Drishtit dhe rrethinat e tij u goditën nga një epidemi e jashtëzakonshme murtaje, që vazhdoi për plot 7 muaj dhe shkaktoi dëme të pallogaritshme.¹⁷

¹⁰ Daniele Farlato; Jacobo Coletto, et. al. *Illyrici Sacri*, vëll. VII, Venetiis 1817, 241, (më tej: *Illyrici Sacri VII*).

¹¹ Barleti, *Historia*, 153.

¹² *Illyrici Sacri VII*, 241.

¹³ Barleti, *Historia*, 157-158.

¹⁴ Barleti, *Historia*, 159.

¹⁵ *Burime të zgjedhura*, 267. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shekullit XV, dok. nr.20.

¹⁶ Millutinoviq, “Drishti nën sundimin”, 60.

¹⁷ AAV, p. III, t. 21, nr. 5785, 137.

Në këtë rast, drishtianët ishin të bindur se epideminë e kishin sjellë disa qytetarë që kishin ardhur nga Roma, ku me sa duket kishin shkuar për të marrë pjesë në “jubileun” e shpallur nga Papa atë vit.¹⁸ Për të gjithë këtë periudhë të jashtëzakonshme, banorët e Drishtit vuajtën pasojat shumë të rënda të një izolimi të egër, që pengoi hyrjen në qytet të furnizimeve me grurë, kripë dhe mallra të tjera të nevojshme. Vetë tregtarët drishtianë nuk guxonin t’i afroreshin Shkodrës apo qyteteve të tjera aty pranë, pasi priteshin me grurë apo edhe me shigjeta nga banorët e tyre, që qartësisht i trembeshin përhapjes së epidemisë edhe në qytetin e tyre për shkak të udhëtarëve të huaj që vinin nga zona e prekur, në këtë rast Drishti. Kjo përbënte një nga arsyet, përse në vitin 1452 qyteti i Drishtit, pas shuarjes së epidemisë, i kërkoi Senatit t’i lejoheshin drishtianëve disa lehtësi fiskale e doganore, për të kapërcyer pasojat e rënda që lanë pas luftës së Venedikut me Skënderbeun si dhe epidemia e murtajes.¹⁹ Gjendjen e vështirësonin edhe më shumë largimi i podestave të cilët e braktisnin qytetin duke lënë pas vete borxhe të mëdha.²⁰

Përveç sulmeve që i përmendëm më lart, duket të ketë pasur edhe përpjekje të tjera për t’ua shkëputur Drishtin venedikasve. Një të tillë e bëri edhe Bozhidar Dushmani. Në një dokument të 24 marsit të vitit 1451, thuhet se Bozhidar Dushmani (*Bosidarius de Dushmanis*) nga Drishti, i cili në bashkëpunim me disa të afërm të tij, veçanërisht me një Leka Dikanio (*Lecha dichanio*), u përpoq të shtinte në dorë disa fshatra që dikur i përkisnin Lekë Zaharisë së Danjës dhe tani i kishin kaluar Venedikut. Nëse do kishte mundur ta realizonte këtë plan të tij, për Dushmanin do të kishte qenë e lehtë të organizonte një kryengritje të madhe kundër Republikës (*de faciendo rebellare certas villas et loca nostra districtus Drivasti*).²¹

¹⁸ AAV, p. III, t. 21, nr. 5785, 137: “...per contagion de queli che fono a Roma, e condusse la mortalità in quella terra et in el territorio, laqual dura ultra mesi 7, in elqual tempo non fo possibile che algun drivastin ne del territorio in Scutari ne in alguna terra circunstante li fosse da recepto per algun so bisogno, anzi con sassi e freze vegniva expulsi in fin questo territorio”.

¹⁹ AAV, p. III, t. 21, nr. 5785, 130-138.

²⁰ AAV, p. III, t. 21, nr. 5785, 130; Millutinoviq, “Drishti nën sundimin”, 60.

²¹ AAV, p. III, t. 21, nr. 5659, 12.

Megjithatë, tentativa dështoi, Dushmani u zu rob nga qeveritari venedikas i Drishtit dhe u dërgua në Venedik ku u gjykua nga Këshilli i të 40-tëve. Vendimi i gjyqit thoshte se Dushmani u dënua që për 30 vjet të mos shkelte më në Shqipëri, dhe nëse do të kapej aty brenda këtij afati, do të dënohej me prerjen e kokës (*sibi inccidatur caput a spatulis*), po ashtu në vendim thuhej se ky dënim t'u transmetohej të gjithë rektorëve.²²

Në vitet në vijim dokumentet e kohës përmendin synimet e Skënderbeut për të marrë disa nga zotërimet e Venedikut që i kishte në Shqipëri. Në vitet e '50-ta sipas qeveritarëve venedikas në Shqipëri, Skënderbeu synonte për vete Drishtin dhe Tivarin.²³ Në vitin 1451 Skënderbeu luftonte kundër Venedikut, me këtë rast përmenden shkatërrime të bëra në rrethin e Durrësit, Shkodrës, Drishtit dhe të Lezhës.²⁴ Ndërsa, në një dokument të vitit 1458 përmendet synimi i Skënderbeut për të marrë Drishtin, Tivarin, Shkodrën si dhe zonat tjera në qarkun e Drishtit (*ac de intentione dicti Scandarbegi accipiendi drivastum et Antibarum*).²⁵ Si rrjedhim i këtyre ngjarjeve Senati i Venedikut merr vendim që sërish të nënshkruajnë një paqe e cila me disa cenime të vogla zgjati deri në vdekjen e Skënderbeut në vitin 1468.²⁶

Dhe krejt në fund burimet dhe literatura mbi bazën e të cilës është shkruar ky punim, dëshmojnë se përpjekje për shkëputjen e Drishti nga sundimi venedikas krahas Skënderbeut, u ndërmorën

²² AAV, p. III, t. 21, nr. 5659, 13: "... et sic Capto de procedendo posita fuit hec sola pars. Quod Jste Bosidar banniatu de omnibus locis nostris Albanie, per annos XXX^a, et si In dicto tempore se permiserit reperiri In Aliquo predictorum locorum, ad ducatur venetias, et sibi Inccidatur caput a spatulis In medio duarum Columnarum, et quod hec Condemnatio transmittatur omnibus Rectoribus predictis".

²³ *Historia e popullit shqiptar* I, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena 2002, 412-413.

²⁴ Millutinoviç, "Drishti nën sundimin", 60.

²⁵ AAV, p. III, t. 23, nr. 6637, 312: "...Et etiam per ea que habentur a comite nostro cararj in materia ista, ac de intentione dicti Scandarbegi accipiendi drivastum et Antibarum: quibus habitis sperat facile posse optinere scutarum et omnia alia loca nostra albanie...".

²⁶ Millutinoviç, "Drishti nën sundimin", 60.

edhe nga vet drishtasit siç përmendem rastin e Bozhidar Dushmanit. Mirëpo, edhe përkundër këtyre përpjekjeve, qyteti i Drishtit vazhdoi të mbes nën sundimin venedikas deri në vitin 1478, kur edhe përfundimisht kalon në sundimin osman.

Evalda PACI
(Tiranë)

**VEPRA E MARIN BARLETIT NË PIKËPAMJE
VËZHGIMESH NDËRDISIPLINORE. INTERPRETIME E
HOLLËSI STUDIMORE RRETH NJË NDËRMARRJEJE
LAPIDARE**

Një korpus veprash që mban autorësinë e një humanisti dhe mjeshtri të shkrimtarisë si Marin Barleti, gëzon prej kohësh vëmendjen e studiuesve të disa disiplinave. Sigurisht që kur përpilohen vepra që shtysën e kanë nga motive historike, ngjarje dhe episode që kanë lënë gjurmë në historinë e një populli, e aq më tepër në periudhën në të cilën jetoi dhe mori formimin personal autori ynë, prirja për të pasqyruar vetë përmbajtjen e tyre do të mbështetet fort dhe nga mjete artistike dhe elemente rrëfimi që bëjnë të mundur të realizohet një tërësi që ka të bëjë së pari me historiken, por dhe me epiken dhe legjendaren. Në shekullin e kaluar nuk ka munguar tërheqja e vëmendjes nga studiues të viseve të afërta me vendin tonë që në shkrimet përkatëse të botuara në të përkohshme me rëndësi për kërkimet shkencore në viset ballkanike nënvizonin rëndësinë që kishte fakti i përfshirjes dhe i trajtimit të personalitetit të Marin Barletit në korpuse enciklopedike me emër në atë kohë.¹

Botimi i një punimi studimor mbi Marin Barletin dhe veprat e tij nga studiuesi Francisc Pall(1938) shënoi një hap të rëndësishëm dhe në pikëpamje të rikthimit të vëmendjes ndaj individualitetit dhe profilit të tij, ndërkohë që kishte mjaft për të thënë e për të

¹ Baldacci A., *Di un importante studio su Marino Barlezio*, në *Dalmatica*, maj 1940, f.17-26.

konkluduar duke u nisur nga pjesë të caktuara të vetë botimeve në fjalë dhe pasazheve konkrete të tyre.

Vëmendja e Marin Barletit drejtohet ndaj figurave që në njëfarë mënyre janë bërë dhe motivuese për të përpiluar veprat që e bënë të njohur atë si një ndër humanistët më në zë të kohës në të cilën jetoi, duke sjellë më pranë lexuesit dhe bibliofilit ngjarje që sa cekin atdheun tonë, po aq kanë të bëjnë me kontekstin ballkanik dhe me historinë e viseve tej Adriatikut, të lidhura ngushtë me tonat që në antikitetin e hershëm, një periudhë kohore që ndërmendet prej vetë Barletit dhe nëpërmjet emërtimeve që kanë të bëjnë me fise të hershme dhe popullsi që dhe sot e kësaj dite përfaqësojnë e konsiderohen si gjurmë të një lashtësie etnike për studimet tona albanologjike. Në trajtesat historike që kanë objekt të vëmendjes pikërisht periudhën e Katërqindës dhe veçanërisht përfshirjen e vendeve të caktuara në një luftë që nisej nga pretendime territoriale dhe këndvështrime politike, vihet theksi mbi rolin e shteteve të caktuara evropiane dhe pozicionin e gjithsecilit ndaj synimeve të otomanëve për ekspansion që kapërcente kufijtë e viseve shqiptare.²

Një mori elementesh flet për prirjet e autorit në këto vepra: përkujdesjen që ai ka treguar ndaj ravijëzimit të personazheve të përveçme dhe që e kanë shënuar me aktet dhe personalitetin e tyre historinë e rrethimeve që bënë të mundur të njiheshin për trimëri dhe qëndresë vendasit dhe prijësit e tyre; aspekte të një përshkrimi sa fizik, aq dhe me terma e artifice të tyre që autori vetë i ka vjelë dhe duke u konsultuar me modele të kohës së tij; gjurmë të trajtesave të mëhershme që janë iniciuar shumë kohë më parë nga autorë të antikitetit greko-romak e që autori ynë duket se i ka njohur në një mënyrë të konsiderueshme; kujtesën e shprehur ndaj vendesh dhe momentesh që bëjnë të kuptosh afërsinë që autori vetë kishte me ngjarjet në fjalë në pikëpamje të përfshirjes psikologjike dhe emocionale; orientimin ndaj përshkrimesh episodike që në pikëpamje

² Shih ndër të tjera dhe Abulafia D., *Sfondi historik i Rrethimit të Shkodrës*, përkthyer nga dr. Arben Bushgjokaj, në Marin Barleti, *Rrethimi i Shkodrës*, përktheu Henrik Lacaj, përgatiti për botim David Hosaflook, Botime Onufri, Tiranë, 2012, f.1-8.

shifrash e të dhënash në njëfarë mënyre nënvizojnë dramaticitetin e ndeshjes mes popujsh e kulturash, një ndeshje që me sa duket ishte paraprirë dhe nga ngjarje të mëparshme në kontekstin ballkanik.

Në të vërtetë, argumentet që Barleti ka bërë objekt vëmendjeje në veprat e tij përfshijnë si viset tona, ashtu dhe një kontekst më të gjerë që kushtëzohet pa dyshim dhe nga zhvillimet që ndodhnin si pasojë e ndeshjes me një fuqi të madhe të kohës siç ishte Perandoria Otomane. Autori vetë e ka vetëdijën për një fakt të tillë duke qenë se ka rezervuar dhe përpiluar dhe një arsenal emërtesash që portretizojnë mëtuesin këmbëngulës ndaj trojeve dhe fortesave arbërore, të konsideruar si një armik që nuk duhej nënvlerësuar për shumë arsye, qoftë në pikëpamje të përgatitjes ushtarake që përshkruhet deri në hollësi e detaje të imëta, qoftë dhe në pikëpamje të psikologjisë që transmeton përmes metodologjisë së veprimit dhe ndikimit ndaj të rrethuarve.

Protagonistët e veprave të Barletit pa dyshim që i kanë kushtuar vetë autorit një shkallë të pazakontë angazhimi, duke qenë se dallohet fare mirë që në përshkrimin e episodeve që lidhen me ta përpunohen elemente të ligjëratave që vihen në gojën e tyre, shoqëruar dhe me hollësi të natyrës gjuhësore që plotësojnë më së miri çdo kontekst në të cilin ata paraqiten si aktorë. Portretizimi me anë përftesash gjuhësore i personazheve dhe i situatave të përveçme që janë rimarrë dhe nga studiues të mëvonë të periudhës në fjalë, sigurisht mund të përbëjë një argument për t'u thelluar nëse bëhet fjalë për të studiuar më tej shkrimtarinë e Barletit dhe aspekte thelbësore të saj, ndërkohë që pikërisht në këtë rasë konsultimi me variantet referenciale në gjuhë të tjera e veçanërisht me ato në gjuhën latine do ta mbështeste më së miri një pistë të tillë hulumtimi. Pa dyshim që episode të caktuara nga historia e Skënderbeut janë ngulitur në kujtesën historike dhe falë përfshirjes dhe përshkrimit gjegjës të bërë në krerët e veprës së Barletit dhe një fakt i tillë mund të nënvizohet dhe provohet për disa syresh.³

³ Me të drejtë biografi dhe studiuesi Francisc Pall dallon qartë pozicionimin e këtij autori në të dyja veprat e tij. Pall shfaq mendimin se Barleti nuk ka të njëjtën afërsi në pikëpamje pranë me ngjarjet që trajton dhe analizon përkatësisht në *Rrethimin e*

Është e vështirë të mund të shterohet në pikëpamje studimore një autor si Marin Barleti. Burime të vyera paraqesin në këtë drejtim dhe realizimet e veprave të tij në disa variante në gjuhën shqipe, duke përfaqësuar secili një opsion më shumë për të konsideruar faktin që pasuria e një veprë a e disa veprave që përpilohen në një linjë të përafërt në pikëpamje konceptimi dhe të ngjarjeve që qëndrojnë në themel të tyre, mund të vihet në dukje më tepër dhe më qartë pikërisht nga një mozaik i tillë variantesh ekzistuese, nga të cilat ato që disponojmë në gjuhën tonë përbëjnë një mundësi të artë për ta lexuar dhe kuptuar nga afër vetë autorin dhe projektin e tij ndërkohë që i dedikohej *Rrethimit të Shkodrës* dhe *Historisë së jetës e bëmave të Skënderbeut*, heroit tonë kombëtar.

Çdo variant ekzistues i veprave të tilla e aq më tepër kur gjendet në më shumë gjuhë të ndryshme, përbën një mundësi më vete për të kuptuar më tej shkallën e receptimit të mesazhit të veprës në fjalë dhe të vetë prirjeve që transmetohen duke gjurmuar në detaje e hollësi nga më të ndryshmet vetë artin e të shkruarit të autorit përkatës. Shkenca e filologjisë ka shënuar përparime konkrete pikërisht nëpërmjet hulumtimit të thelluar të teksteve të veprave të caktuara dhe është pasuruar në parime dhe metodologji studimore dhe përmes shënimit të të dhënave konkrete që janë vjelë nga realizime të ndryshme, të cilat në vetvete duke u bërë objekt teknikash tipografike apo teknike nga ana e përpiluesve apo dhe e shtypësve të tyre kanë pasqyruar dhe shkolla më vete që janë bërë objekt studimi nga kjo disiplinë e rëndësishme.

Sa i përket sjelljes së veprave të Barletit në më shumë se një variant në gjuhën shqipe, duhet nënvizuar fakti që pikërisht në to gjurmohet dhe një kontribut i çmuar nga ana e shqipëruessve dhe e

Shkodrës dhe në *Historinë e jetës dhe bëmave të Skënderbeut*. Shih në veçanti Pall F., *Le fonti del Barlezio*, në *Marino Barlezio, uno storico umanista*, 1938, f.43: Mentre il Sacerdote compose il surriferito lavoro massimamente in base alla sua esperienza, qui, nella biografia del Castriota, si trovano invece poche reminiscenze, poichè l'autore non fu partecipe alle gesta dell'Eroe. Quindi non ne può parlare sulla base di ricordi personali e soltanto nelle allusioni sull'assedio di Scutari e nella descrizione sommaria delle varie regioni e luoghi dell'Albania, che aveva visitato egli stesso.

përgatitësve të botimeve në fjalë në pikëpamje të përpunimit të një leksiku mjaft specifik e që ka funksionin e orientimit të lexuesit në një periudhë tipike që shënohet nga të tilla ngjarje e nga të tilla ndeshje mes popujsh, popullsish të hershme e kulturash po aq të hershme.

Një diferencim i thellë në këtë pikëpamje vërehet që në përshkrimet e kampeve përkatëse, dhe të tilla fakte nuk sillen në mënyrë të rastësishme nga autori i veprës. Ndërmarrja e veprave të tilla jo vetëm që motivohet nga një shtysë që qe mjaft konkrete për Marin Barletin, por duhet mbështetur nga një formim i veçantë që autori vetë e ka dëshmuar jo thjesht me paraqitjen e një formimi gjuhësor e kulturor që duket se e ka arritur përmes një shkollimi specifik të realizuar në viset tej Adriatikut.⁴ Të mos harrojmë interpretimet dhe shprehjet përkatëse me të cilat Francisc Pall në studimin e sipërpërmendur të tij mbështet pikërisht të tilla përshkrime të Barletit, duke qenë fort i qartë fakti që ky studiues ka receiptuar thellësisht episode të veçanta dhe ka dalluar në to përfshirjen e autorit dhe lidhjen emocionale me atdheun e vet.⁵

I gjithë ky kompleksitet detajesh përcillet dhe nga vetë angazhimi i shqipëruesve tanë, që nuk munguan të përafrojnë me lexuesin dhe me studiuesin e disa disiplinave ngjarje të pashlyera për kujtesën kombëtare si *Rrethimi i Shkodrës* apo elemente të një biografie që nuk shënoi vetëm Arbërinë, por një kontekst më të gjerë që ka të bëjë sa me Evropën, aq dhe me Ballkanin në veçanti. Secili paraqitet me veçoritë e një profili prej studiuesi, jo vetëm të një shqipëruesi e përkthyesi që përballet me tekste që ngërthejnë në vetvete karakteristika që në vështrimin e filologut përçojnë më shumë se tiparet e një periudhe të caktuar. Ndërthuren në proces të punës së tyre kompetencat e skribit, historianit, klasicistit,

⁴ Shih në veçanti Lucia Nadin, *Marin Barleti: shënime biografike. Mjedisi fetar padovano-vicentin mes shekujve XV-XVI*, në *Shqipëria e rigjetur, zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shekullin XVI*, përktheu: Pëllumb Xhufi, Botime Onufri, Tiranë, 2012, f.98-128. Shih gjithashtu Lucia Nadin, *Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggi veneto-scutarini*, në *Shëzjat*, n.1-2, 2016, f.46-60.

⁵ Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti, 1938, f.5-6.

medievalistit, njohësit të historisë së librit dhe të botimeve të periudhës në të cilën u realizuan dhe u ribotuan veprat e Barletit, njohësit dhe hulumtuesit të ndërgjegjshëm të një arsenali të posaçëm leksikor dhe nomenklaturash që ka të bëjë me armaturat dhe strategjitë ushtarake të kohës, por dhe me fortifikimet dhe me sistemet e mbrojtjes së fortesave dhe kështjellave në raste rrethimesh dhe luftimesh të zgjatura.

Nga varianti në variant mund të receptohet një angazhim i tillë, që bën të mundur të realizohet një lexim i përmasave historiografike, por dhe letrare, dhe epike i veprave të Marin Barletit. Duke pasur një formim që përkon me kohën në të cilën mori elemente të një edukimi sa fetar e teologjik, aq dhe gjuhësor e letrar, autori ka përdorur shprehje tipike që e bëjnë dhe interpretues burimesh që duket se ka konsultuar apo dëgjuar. Sigurisht që referimi ndaj këtyre burimeve nuk plotëson domosdoshmërisht pritshmëritë e lexuesit të ditëve tona, por një fakt i tillë shpjegohet fare mirë dhe me formatin në të cilin veprat e Barletit paraqiten e që në pikëpamje gjinore nuk mund të ishin buletine të mirëfillta lufte, të cilat dhe ishin përpiluar ndërkohë që zhvilloheshin ngjarjet që përshkruhen në këto vepra. Barleti sigurisht ka një qëndrim të vetin ndaj ngjarjeve që ka ndërmarrë të trajtojë e të përshkruajë dhe në këtë pikëpamje, nuk pritet të gjejmë në krerët e veprave të tij përshkrime të zhveshura nga ndjenja apo motivime që e kanë nxitur dhe shoqëruar dhe në proces të përpilimit të tyre. Nga ana tjetër, dhe formimi meshtarak dhe përgatitja në fushë të teologjisë së krishterë nuk mund të mos linte gjurmë dhe në pikëpamje të shprehjes konkrete në pjesë apo paragrafe të caktuara të veprës, duke u bërë kësisoj dhe transmetuese të aspekteve themelore të personalitetit të vetë autorit të veprës.

Studimi në këtë pikëpamje dhe i modeleve tekstore që qëndrojnë në themel të introduktimit të veprave të tij dëshmon më së miri motivimin e këtij të fundit dhe vetë qëndrimin që do të mbajë më tej, ndërsa do të përshkruajë në detaje episode luftarake, ligjërata të mbajtura nga personazhe që i zotërojnë si protagonistë dhe heronj pikërisht këto episode dhe vetë ngjarjet në tërësi.⁶

⁶ Të tilla personazhe gjenden të ndërmendura që në indeksin analitik të lëndës së

Dedikimet konkrete që përmbahen në hyrje të veprës *De obsidione Scodrensi-Rrethimi i Shkodrës (1504)*, dëshmojnë mirëfilli prirjet dhe motivimin e autorit tonë, njëkohësisht dhe shtysën konkrete që ai kishte pasur në pikëpamje të përpilimit të një vepre të tillë.⁷

Përbën një tekst i tillë një tjetër model tekstor që mund të merret si objekt referimi në proces të hulumtimit të tipareve përmbajtjesore të letrave dedikatore që shoqëronin pothuaj në çdo rasë botime të kësaj natyre, aq më tepër në një pozicion në të cilin e ka gjetur veten autori ynë, që shpreh pothuaj në çdo paragraf të kësaj hyrjeje të *Rrethimit të Shkodrës* ndjenja që i burojnë si nga përjetimi sërish i ngjarjeve që kishin të bënin me atdheun e vet, ashtu dhe me vetëdijen që pikërisht këto të fundit duheshin konkretizuar në një vepër të shkruar e që të kishte parasysh sa me rëndësi do të paraqitej për pasardhësit botimi i saj.

Gjurmimi i të dhënave mbi Barletin është bërë jo rrallë dhe nëpërmjet leximit të thelluar dhe të vëmendshëm të episodeve të veprave të tij. Dhe F.Pall, një prej biografëve më në zë të këtij autori interpreton mbi bazën e të dhënave që mund të vilen duke lexuar pjesë të caktuara nga këto vepra.⁸ Vështirësitë në pikëpamje të disponimit të të dhënave biografike në lidhje me Marin Barletin e ndonjë autor tjetër të së njëjtës periudhë, janë plotësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, ndërkohë që kërkimet në lidhje me ta kanë qenë më konkrete dhe më të përqendruara në drejtim të selive ku

veprës, që mund të konsultohet si paraprirës i përmbajtjes së saj në botimet gjegjëse në gjuhën latine.

⁷ Pall F., *Lo scrittore Barlezio; le ragioni che l'indussero a scrivere*, në *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucuresti, 1938, f.106: Nella prefazione dell'Assedio di Scutari, Marino stima suo dovere "Stoici hominis et boni civis" di eternare l'eroica difesa della città, mirando con questo non soltanto a una soddisfazione del suo spirito, ma anche al diletto dei lettori. La gratitudine verso la patria lo stimolava a renderle quest'omaggio, per non lasciar dimenticare l'eroismo dei suoi concittadini, ma, al contrario, celebrarlo, per mezzo dello stile, come un bell'esempio, degno per quanto concerne il perseverare nella fedeltà verso I Capi, in ispecie verso la Repubblica di San Marco.

⁸ Pall F., *Vita del Barlezio*, në *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucuresti, 1938, f.1-9.

mund të jenë dokumentuar informata në lidhje me veprimtarinë meshtarake apo akademike të secilit.⁹ Sa i takon dokumentimit më të saktë të të dhënave biografike të personaliteteve të asaj kohe, duhet vënë në dukje që dhe në raste të tjera jepen jo rrallë me afërsi data konkrete që kanë të bëjnë me to dhe me momente kryesore të jetës apo veprimtarisë së tyre personale apo profesionale.

Marin Barleti përfaqëson një prej autorëve më të studiuar nga ana e historianëve dhe medieualistëve, ndërkohë që dija e filologjisë ka dhënë padyshim një kontribut të pamohueshëm dhe në lidhje me orientimin ndaj interpretimesh më të thelluara të teksteve të veprave të tij. Roli i shqipëruessve që janë marrë me *Rrethimin e Shkodrës* dhe me *Historinë e jetës dhe bëmave të Skënderbeut*, konsiderohet dhe rimerret në vëzhgimet tona çdo herë që kemi në dorë për qëllime konsultimi variantet në gjuhën shqipe që duke u bërë dhe objekt ribotimi, kanë ardhur sërish në vëmendjen e filologut, i cili shqyrton dhe vë në dukje modifikimet që vihen re në pasazhe të ndryshme të kapitujve a krerëve të caktuar të veprave në fjalë, ndryshimet që mund të jenë realizuar dhe me vetëdije nga ana e kujdesuesve të këtyre botimeve, elementet që duke qenë ideuar të ndihmojnë dhe të mbështesin brendësimin e teksteve në fjalë, dhe mund të jenë vendosur në pjesë përmbyllëse të botimeve, duke pasuar gjithë shtjellimin e përmbajtjes. Veprat e Barletit e në veçanti ato që ne disponojmë në gjuhën shqipe, janë sjellë në më shumë se një variant ribotimi dhe larmia e tyre përbën një pasuri të çmuar që duhet bërë objekt vëmendjeje dhe në kuadrin e studimeve që përqendrohen mbi autorë dhe tekste, në veçanti në ato studime që duke qenë se zhvillohen mbi vepra të Pesëqindës apo Gjashtëqindës, kanë parasysht që plotësimi i të dhënave që duhet të jenë sa më konkrete

⁹ Shih në veçanti Nadin L., *Marin Barleti: shënime biografike. Mjedisi fetar padovano-vicentin mes shekujve XV-XVI*, në *Shqipëria e rigjetur, zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shekullin XVI*, përktheu: Pëllumb Xhufi, Botime Onufri, Tiranë, 2012, f.98-128. Shih gjithashtu dhe Nadin L., *Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggi veneto-scutarini*, në *Shëzjat*, n.1-2, 2016, f.46-60.

dhe të përcaktuara qartë, paraqet dhe vështirësi në pikëpamje dokumentimi.

Marin Barleti mbetet një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm të shekullit në të cilin jetoi, i konsideruar i tillë në trajtesat përkatëse që pasqyrohen në manuale dhe botime që kanë objekt të tyrin pikërisht periudhën në fjalë dhe autorë të veçantë, ndër të cilët dhe disa që kanë përpiluar dhe realizuar veprat e tyre në një gjuhë librore dhe kulturore *par excellence*, siç ishte latinishtja në atë kohë. Për fatin tonë të mirë, elemente në dukje teknike që kanë të bëjnë me realizimin tipografik të veprave të tij, frontespici me figuracionin e pasur që padyshim mbart nëntekste të qarta që i referohen brendisë dhe vetë motivimit për ta shkruar një vepër të tillë, janë bërë objekt trajtimesh serioze dhe të thelluara, duke shpënë më tej dhe kërkimet mbi vetë periudhën në fjalë, mbi qerthujt kulturorë që mbështetën të tilla iniciativa botimi dhe që kishin për zemër si konkludimin e suksesshëm në të tilla realizime të natyrës tipografike, aq dhe përkrahjen e biografëve dhe shkrimtarëve që me përgatitjen e tyre në të vërtetë i shërbyen dhe historisë së vendit nga mendohet se kishin ardhur.

Veprat e Marin Barletit duket se u përpiluan në një kontekst favorizues në shumë pikëpamje, ndërkohë që dhe studimi i rrethanave në të cilat ato u konkretizuan shpie në konkludime mbi një panoramë më të gjerë që mbetet dhe dëshmi e rëndësishme që kishte në atë kohë kultura e shkrimit, por dhe përjetësimi i një kujtese me rëndësi dhe vlerë kombëtare.

Bibliografi

- Bardhi F., *Skënderbeu (Apologji)*, (përktheu nga latinishtja Stefan I.Prifti), Tiranë, 1967.
- Barleti M., *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, (përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga S.J.Prifti), Tiranë, 1964.
- Barleti M., *Historia e Skënderbeut*, (përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan Prifti), botim i dytë, Tiranë, 1967.
- Barleti M., *Historia e Skënderbeut*, (botim i tretë, përkthyer nga S.I.Prifti), Tiranë, 1982.
- Barleti M., *Historia e Skënderbeut, Libri XI, Botimi IV, shqipëroi Stefan Prifti*, Infbotues, Tiranë, 2005.
- Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës, përkthye prej origjinalit latinisht nga H.Lacaj, Botimi i dytë i plotësuar*, Tiranë, 1967.
- Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës (përktheu H.Lacaj); përgatiti për botim D.Hosaflook*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
- Ceka H., *Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftave të Skënderbeut sipas Barletit*, Buletin për Shkencat Shoqërore, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952.

-
- Kamsi W., *Rrethimi i parë i Shkodrës(1474)*, në *Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës*, n.7, 1968.
 - Marlekaj L., *Scanderbeg nelletradizioni popolari albanesi*, Bari, 1969.
 - Nadin L., *Migrazioni e integrazione: ilcasodegliAlbanesi a Venezia(1479-1552)*, Bulzonieditore, Romë, 2008.
 - Nadin L., *Albaniaritrovata.Recuperi di presenzealbanesinellacultura e nell'arte del Cinquecentoveneto,përktheu Pëllumb Xhufi*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
 - Nadin L., *Religiosi albanesi nelleterredella Serenissima tra Quattrocento e Cinquecento: unoscenario di incredibileampiezza, tra storia di chiese e storie di arte*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2013.
 - Nadin L., *Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggiveneto-scutarini*, në *Shêjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
 - Pall F., *Marino Barlezio, unostoricoumanista*, Bucaresti, 1938.
 - Pall F., *I Rapportiitalo-albanesi intornoallametà del secolo XV (Documenti inediticonintroduzione e note storiche-critiche)*, Estrattodall'ArchivioStoricoper le Province Napoletane, Terza serie, Vol.IV, SocietàNapoletana di storiapatria, Napoli, 1966.

- Pall F., *Di nuovosulle biografie scanderbegiane del XVI secolo*, në *Revuedesétudessud-esteuropéennes*, n.1, 1971.
- Pipa A., *Umanistiitalo-albanesi*, në *Albanica, Numër special*, 1992.
- Plasari A., *Skënderbeu, një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare”Gjergj Fishta”, Tiranë, 2010.
- Plasari A., *Shqipëria dhe shqiptarët në Europën e Piut II*, IDK, Tiranë, 2014.
- Petrotta G., *Popolo, lingua e letteraturaalbanese (a cura di M.Mandalà)*, EdizioniMirror, Palermo, 2003.
- Roques M., *Recherches sur lesancienstextesalbanais*, Paris, 1932.
- Sirdani M. O.F.M., *Skanderbegu mbas gojdhânash*, në *Zâni i ShnaNdout*, n.III, 1920.
- Sirdani M. O.F.M., *Kerkimembîvorrin e Skanderbegut*, në *Hylli i Dritës*, n.4, 1932.
- Sirdani M.O.F.M., *Nji rival i Skanderbegut*, në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.
- Sirdani M.O.F.M., *Në shkafajisetSkanderbegu*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 1935; n.3, 1935; n.11, 1935; n.1, 1936; n.2, 1936; n.3, 1936.

-
- Sirdani M. O.F.M., *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017.
 - Zamputi I., *Lezhja, Rodoni, Durrësi dhe përpjekjet e fundit për rimëkambjen e principatave shqiptare*, në *Studime historike* n.1, 1964.
 - Zamputi I., *Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për historinë e Shqipërisë për tre shekujt e parë të pushtimit turk*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n.3, 1955.
 - Zamputi I., *Shënime mbi disa aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk*, në *Studime historike* n.1, 1965.
 - Zamputi I., *Elemente të vetëdijes shqiptare në përpjekjet për liri, për gjuhën shqipe e për arsim në shekujt XVI-XVII*, në *Studime historike* n.3, 1965.

Csaplár-DEGOVICS KRISZTIÁN
(Budapest)

**THE FIRST APPEARANCE OF THE HUNYADI-
SKANDERBEG ALLIANCE IN THE ALBANIAN
HISTORIOGRAPHY**

In 2003, a Swiss reporter produced a documentary in the Albanian-speaking world on the role Skanderbeg played in people's thinking. The interviews made in Albania and Kosovo were particularly interesting. Regardless of the fact whether the interviewees were Sunni, Bektashi, orthodox Christian or Catholic; soldiers or civilians, ministers or football players, the questions were answered in a similar fashion. In a large number of cases, even the vocabulary of those questioned was identical: Skanderbeg was tall, handsome, a brilliant strategist, a well-known diplomat, the ruler of the independent Albania in the Middle Ages, the defender of Europe against the Ottomans, a good father and a man with honour, an icon of all generations. Hopefully, it is not a grave mistake on my part to suppose that 15 years after this documentary was made, the place of Skanderbeg in the mental map of the people has not significantly changed in Albania and Kosovo.

Skanderbeg plays, however, a significant role not just in the contemporary Albanian thinking. The corpus of historical publications written on him is even more respectable. What is more, Skanderbeg does not only have a historical past, he was a beloved figure of the European literature as well. The book of Barletius on

Skanderbeg's life,¹ as a contemporary bestseller published in the 16th century was translated into many European languages and inspired a large number of literary and artistic works in France, Italy, Spain, Portugal and England. These literary works (nativity plays, dramas, novels, heroic poems, epics or philosophical writings) made his name well-known in the old continent.

Why did Skanderbeg become the joint hero of Christianity in the 15th century? Why not János Hunyadi, who was a well-known strategist of this historical period as well? My lecture aims not to seek answers to these questions. My purpose is to respond to another question, namely when the thesis of the close friendship and alliance between Skanderbeg and János Hunyadi entered the Albanian historiography.

The historical view on Skanderbeg among the Albanians regained new importance in the early 19th century. The national movements of Europe made their impact on the arbëreshë minority in South-Italy, who, instead of becoming part of the unifying Italian nation, were initiators of the Albanian national awakening. Jeronim de Rada wrote his well-known epic on the 'Unfortunate Skanderbeg' ('Scanderbeccu i pafaan') in the 1830's which was published ten times up to 1844.² De Rada describes Scanderbeg in this epic as a brave patriot, a just, faithful and hospitable man, king and saviour of Albania, and as a strategist who made peace in Italy.

However, it was the foundation of the League of Prizren,³ not the epic of de Rada, that made a more significant impact on the altering cult of Skanderbeg. During the great oriental crises in 1878 the Albanians were forced to face with the fact that the Ottoman Empire was not anymore able to defend its territory against the

¹ Barletius, Marinus. *De vita, moribus ac rebus praecipue adversus Turcas, gestis Georgii Castroti*. Strasburg, 1537.

² De Rada, Girolamo. *Scanderbeccu i pafaan*. Napoli, 1844.

³ Prifti, Kristaq. 'Lidhja e Prizrenit dhe çështja e bashkimit kombëtar të shqiptarëve (1878–1881)' *Studime Historike* 63. Nr. 1-2 (1998): 135-147; Prifti, Kristaq red. shk. *Historia e Popullit Shqiptar II. Rilindja kombëtare*. Tiranë: Toena, 2002. 134-228; Bartl, Peter. 'Die Liga von Prizren im Lichte vatikanischer Akten.' *Südostforschungen* 44 (1988): 145-186.

aspirations of the neighbouring Christian countries. To save the integrity of their ethnical regions, the Albanian representatives founded the League of Prizren in 1878 which set up its own military forces. Although the League was defeated in 1881, its foundation gave impetus to the national awakening, the *Rilindja*.⁴ The intellectuals decided to follow the European patterns and organize a modern nation from the Albanians. To form this new social framework it was inevitable to rethink the concept of the national awareness.⁵

Because of the four denominations, the two great dialects and the special geographical situation, the communication conditions were extremely poor among the society, and therefore the appearance of the written national history seemed to be an important joint value from a national perspective. This was the very moment when the members of the *Rilindja* began to communicate on the national past and this was the moment when Skanderbeg found his rightful place in the national pantheon. It was first of all the works of Naim Frashëri and Fan Noli that eternalized the history of Skanderbeg.⁶ They both highlighted the significance of the state-building virtues of the national hero, and his fights against the Ottoman Empire.

But when exactly did the figure of János Hunyadi appear in the cult of Skanderbeg? Since it is known, based on the research of Noel Malcolm and Peter Bartl, that the majority of theses of the Albanian historiography did exist at the turn of the century, the answer should be found in such works that were published prior to 1914.⁷

⁴ Csaplár-Degovics, Krisztián. *Az albán nemzettévalás kezdetei(1878-1913). A Rilindja és az államalapítás korszaka*. Budapest, ELTE BTK TDI, 2010. 117-244.

⁵ Prifti, *Historia e Popullit Shqiptar II*, 204-215.

⁶ Frashëri, Naim. *Istori' e Skender-beut*. Bukarest: Drita, 1898; Noli, Fan Stilian. *Historia e Skenderbeut (Gjerg Kastriotit) - mbretit te shqiperise 1412-1468*. Boston: Dielli, 1921.

⁷ Kostandin Çekrezi, Kristo Dako, Faik Konica in: Malcolm, Noel. 'Myths of Albanian National Identity. Some Key Elements, as Expressed in the Works of Albanian Writers in America in the Early Twentieth Century.' In *Albanian Identities: Myths and History* eds. Schwandner-Sievers, Stefanie / Fischer, Bernd. Bloomington: Indiana University Press, 2001. 70-87; Bartl Peter. 'Zum

In 2007, a young Albanian historian, Raim Beluli, following the research of Armin Hetzers and Nathalie Clayers,⁸ analysed a remarkable corpus of sources in the Austrian National Archive.⁹ After scrutinizing a number of archival documents Beluli wrote his book in 2008.¹⁰ In his monograph the author reconstructed the history of an Albanian reading published in 1898, which was addressed exactly to the members of the national awakening and which was written in a popular and readable style.¹¹ The reading entitled ‘The history of Albania from a gheg who loves his country’ was printed anonymously under the name of a fictitious printing house. The author of this mysterious reading was no-one else, but an outstanding member of the Austro-Hungarian albanology, the Hungarian Lajos Thallóczy.¹²

Geschichtsmythos der Albaner.’ In *Mythen, Symbole und Rituale – Die Geschichtsmächtigkeit der Zeichen in Südosteuropa im 19. und 20. Jahrhundert* eds. Dahlmann, Dittmar / Potthof, Wilfried. Frankfurt/M: Peter Lang, 2000. 119-139.

⁸ Clayer, Nathalie. *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d’une nation majoritairement musulmane en Europe*. Paris: Karthala, 2007. 416-419, 528-531, 590-591; Hetzer, Armin. ‘Ludvig von Thalloczy dhe perpjekja e pare shkencore per nje Histori te Shqiperise.’ *Hylli i Drites* 28, Nr. 4 (2008): 58-76.

⁹ ÖStA HHStA PA, XIV. Albanien, Kt. 20-22.

¹⁰ Beluli, Raim ed. *Ludwig von Thalloczy, Te ndodhurat e Shqypnis prej nji Geqe don vendin e vet*. Perktheu

nga gjermanishtja: Stefan Zurani. Transkriptoi, dokumentoi dhe komentoi Raim Beluli. Shkodra: Botime françeskane, 2008.

¹¹ *Të ndodhurat e Shqypnis prej nji Geqe që don vendin e vet*. Skenderie, 1898. (In reality: Vienna: Adolf Holzhausen, 1998)

¹² Csaplár-Degovics, Krisztián. ‘Lajos von Thallóczy und die Historiographie Albaniens.’ *Südost-Forschungen* 68 (2009): 205-246; Csaplár-Degovics, Krisztián. ‘Ludwig von Thallóczy und die Albanologie: Skizzen eines Experiments zur Nationsbildung.’ In *Lajos Thallóczy der Historiker und Politiker: Die Entdeckung der Vergangenheit von Bosnien und Herzegowina und die moderne Geschichtswissenschaft* ed. Gottsmann, Andreas et al. Budapest-Sarajevo: ANUBiH – HAS, 2008. 141-164

The year of the edition, 1898, is a symbolic date. Austria-Hungary started its first political action in 1896 to support the Albanian national movement. The idea of writing a historical reading as part of this action stemmed from Theodor Ippen, the Austro-Hungarian general consul of Shkodra.¹³

Ippen, who was an eminent representative of the albanology as well, addressed his proposition directly to Agenor Gołuchowski, the joint minister of foreign affairs in 1897. According to Ippen, the reading should have been published for a number of reasons. On the one hand, it could demonstrate that the Albanian history is glorious and not identical with that of the Ottoman Empire. On the other hand, it could make a significant contribution to the creation of a unified Albanian alphabet. Since the historian Lajos Thallóczy had been collecting relevant historical data on the Albanians, argued Ippen in his letter to Gołuchowski, the archival sources of a reading were available.¹⁴


The reading of Thallóczy was re-published by Raim Beluli

The joint minister of foreign affairs agreed to the plan with two restrictions: the reading could not have anti-Ottoman attitudes, and the participation of the Monarchy in this project had to be anonymous. Thallóczy was glad to assume the task of writing the reading and not later than September of 1898 he completed his German-language manuscript. The reading of Thallóczy was translated into Albanian by Zef Curani.¹⁵ The first 600 examples of the book were printed in December of the same year. The publishing costs were covered, interestingly, not by the Ballhausplatz, but by the

¹³ Wernicke, Anneliese. *Theodor Anton Ippen*. Wiesbaden: Harrassowitz, 1967.

¹⁴ ÖStA HHStA PA XIV. Albanien, Kt. 20, Letter from Ippen to Gołuchowski, Shkodra, 18. mai 1897, No. 14. Geheim, Politischer Gegenstand: Abfassung einer albanesischen Geschichte (published in Beluli, *Të ndodhurat*, 55-57.

¹⁵ Misja, Vladimir. *Stefë Curani: Jeta dhe vepra (1865-1941)*. Shkodër: Shtjefni, 2006.



joint ministry of finance led by the Hungarian Benjamin Kállay.¹⁶ The ‘History of Albania’ had a positive reception in the Albanian territories; the National Archive of Austria resides detailed statistics on the Albanian readership.¹⁷ The exact impact on the national movement calls, however, for a refined research. It is only known, that Thallóczy’s book was a popular reading: its style enriched the Albanian language and national ideologies with new terms and expressions,¹⁸ and it was the first publication which aimed to create scientific framework

for the Albanian historical theses and which was based on unpublished archival sources of Austria-Hungary and Italy.

¹⁶ Ress, Imre. ‘Versuch einer Nationenbildung um die Jahrhundertwende. Benjámín Kállays Konzeption der bosnischen Nation.’ In *Nation und Nationenbildung in Österreich-Ungarn 1848–1938. Prinzipien und Methoden* ed. Stagl, Justin et al. Wien: LIT Verlag, 2006. 59–72.

¹⁷ ÖStA HHStA PA, XIV. Albanien, Kt. 20, 1. Note des Gesamt. Finanzmin., 15. September 1897, mit Hofrat Thallóczys „Geschichte Albaniens, 2

¹⁸ Csaplár-Degovics, ‘Lajos von Thallóczy und die Historiographie Albaniens,’ 240.



Lajos Thallóczy (1857-1916)
historian, official of the joint
ministry of finance



Theodor Ippen (1861-1935)
Austro-Hungarian General
consul in Shkodra

In his reading Thallóczy wanted to stress three important statements: 1. the Albanians were always an independent national entity that insisted on its autonomy; 2. the Albanians have a glorious history; 3. the Albanians have a political future. On the whole, Thallóczy wrote a ‘supra-denominational’ book in order to facilitate the way of his Catholic, orthodox Christian, Sunni and Bektashi readers to identify themselves with the common Albanian past. His book contained many illustrations which could serve as basis for creating new national symbols of all Albanians (emblems, flags; sigils and helmet of Skanderbeps). ‘The history of Albania from a gheg who loves his country’ deserves attention from a number of reasons. The book was published with the intention of promoting the national idea and facilitating the birth of the unified Albanian historical thinking. To establish ‘common knowledge’ it was

inevitable to harmonise ‘the parallel histories’ of Christian and Muslim Albanians. If you like, the historical perspectives and traditions of Christians needed to be familiarized with the Muslims, and viceversa.¹⁹

Thallóczy solved this problem without presenting concepts of enemy for the Albanians. It means that the potential basis for Thallóczy on which the new national solidarity should have been built up was the corpus of positive values that bound the Albanians together, rather than the creation of historical enemies from the neighbouring nations. Such values were: the common origin, language, national virtues and the thousand-year-old common history.²⁰ Thallóczy’s work borrowed his vocabulary and style partly from the contemporary heroic songs (*këngë kreshnikës*), but the book was affected by the thinking, works and results of the *Rilindja* as well. Thallóczy’s reflections on the Albanian language strongly suggest that he was aware of the literary activities of the *arbëreshë* authors and of the *Frashëri*-families. The ‘supra-denominational’ perspective of the book is a clear illustration that the work of Pashko

¹⁹ „Na jena tue diftue si e ka shkue jeten i gjithë fisi i jone, pa da se c’fare besimi ka pase o ka njeni e tjetri. Ne dac i Krishten, ne dac Muhametan, na jena te gjithë nji gjakut, e prandej vllazen; e s’asht pune qe besimi mund te daje gjakun, vec gjithsecili e ka per shpirt te vet, e ne ket bote do te rrojme bashkarisht. Edhe Zoti i urdhnon gjithëkuj me dasht t’afërmin e vet. Pse mos te duhena pra na Shqyparet, Muhametane e te Krishtene, pse mos te mblidhena te gjithë bashke, me u mundue me i zgjate doren te dashtunit dheut t’one, qe na ka rrite me shujte te vet? Pse mos me ja fole na te drejten vllaznive t’one muhametana, tue thane qe keta kane diftue gjithmone burrnine e Shqyparit ne sherbim ne Turkut? A thue do te na vije marre me kallzue se gjku i jone ka mbërrijte nder kambe e madhnite nalta ne Stamboll? Po te shikjojme holle, e shofim atehere qe Muhametanve t’one i dukena, sado kudo, ma te aferm na, se c’do tjetër komb i mbretinise se Turkut. Na e dijme te gjithë se jena te tane shka flasim Shqyp, bijte e nji nanës qe s’harrohet, te Arbnise se shkrete, qe ka mbete pa djelm te thuesh, pse te huejt na kane da per me rregullue punen e vet, tue na shti fjalën e tue rrite menine nder ne brez mbas brezit.“ Thallóczy, *Te ndodhurat e Shqypnis*, 142; Csaplár-Degovics, ‘Lajos von Thallóczy und die Historiographie Albaniens,’ 229, 232, 235.

²⁰ Thallóczy, *Te ndodhurat e Shqypnis*, 132-150; Csaplár-Degovics, ‘Lajos von Thallóczy und die Historiographie Albaniens,’ 241-242.

Vasa ('The Truth on Albania and the Albanians,' 1878)²¹ made an impact on Thallóczy as well. (It is a question, whether the reading of Thallóczy had its influence on the theoretical work of Sami Frashëri? *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*, 1899.)²² What were the real novelties of Thallóczy's reading? One of the novelties was the author's attitude towards the name changes of the ethnic territories over the centuries.



Të ndodhurat e Shqipërisë prej një Gege që don vendin e vet. Skenderie, 1898. (Wien: Adolf Holzhausen, 1898)

²¹ Vasa, Pashko (Wassa Effendi). *Albanien und die Albanesen. Zur griechische Frage. Eine historisch-kritische Studie.* Berlin, 1879.

²² Frashëri, Sami. *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë.* Bukarest: Drita, 1899; Kaleshi, Hasan. 'Sami Frashëri në letërsinë dhe filologjinë turke.' *Gjurmime Albanologjike* (Prishtinë) 2. Nr. 2 (1968): 72-104.

To Thallóczy's way of thinking the Albanians were always present in their territories. Irrespective of whether their territories were called Illiria, Arbanas, Arbëria, Tosknia or Geghnia (and they as Illirians, Arbër or Shqiptar) behind these names was always to be found 'our field', 'our national territory', i.e. 'Albania' (*trualli jonë; territori kombëtar; Shqypnie*).²³

Another novelty was, as mentioned above, that Thallóczy was able to fit the Muslim and Christian historical perspective together. Among other things he harmonized the Christian and Muslim chronological orders in his book. His chronology follows basically the Christian perspective, but from the 7th century on, Thallóczy listed the Muslim chronology as well.

What is more, both the Muslim and Christian Albanians had their own world of heroes; it was Thallóczy's intention to break down the borders between these worlds. In order to strengthen the new national awareness, Thallóczy aimed to turn the hitherto Christian and Muslim heroes into common heroes. As Thallóczy formulated: 'we have to get to know who were our Christian and Muslim heroes of our heroic songs' (*burra idhujsh të Krishtenë a Muhamedana*).²⁴

The third novelty to be highlighted here was that the author paid a specific attention to the description of the points of contact between the Albanian and Hungarian national histories.²⁵ Thallóczy drew attention to the fact that the territories populated by Illyrians included the Carpathian Basin in ancient times as well. The second contact point to be investigated was when the Hungarian king, Louis I (the Great) from the House of Anjou occupied the Kingdom of Naples with two great campaigns (1348, 1350). The third contact point was of particular importance: the anti-Ottoman fights of János Hunyadi and his son, Matthias Corvinus were harmonized with those of Skanderbeg in a European context. Thallóczy drew more parallel between the activities of these national heroes (like their role played

²³ Thallóczy, *Te ndodhurat e Shqypnis*, 123-142.

²⁴ Thallóczy, *Te ndodhurat e Shqypnis*, 87.

²⁵ Thallóczy, *Te ndodhurat e Shqypnis*, 90, 136, 157, 160, 165.

during the siege of Kruja in 1454, and of Nándorfehérvár / Belgrade in 1456). All in all, it was the reading of Lajos Thallóczy, in which János Hunyadi and Skanderbeg became brothers-in-arms first time in the Albanian-speaking historiography. It must be stressed again: this book was the very first Albanian-speaking historical reading which was based on unpublished archival sources collected by Lajos Thallóczy, Konstantin Jireček and Milan Šufflay.²⁶ (Concerning the topics described above it is worth mentioning that Zef Curani translated the national name of Hungarians as ‘magjar’ into Albanian, and not as ‘hungarez’.²⁷)

It must be highlighted that the book of Thallóczy was far from being the unique source of the story of close alliance and friendship between Hunyadi and Skanderbeg. The story was broadly spread via the institutional activities of the Austro-Hungarian cultural protectorate over the Catholic Albanians and the so-called ‘Albanian actions’ of the Ballhausplatz.²⁸ As part of the cultural protectorate rights, Austria-Hungary supported the reconstruction and building of Catholic parishes and schools in Albanian territories in the late Ottoman period. In general, the costs were covered by Austria, and the technicians (master masons, fresco painters) were delegated from Hungary. It was the time of the turn of century that the Catholic Albanian churches were first decorated with ‘twin frescos’ of Skanderbeg and Hunyadi. One of these ‘twin frescos’ is today to be found in the cathedral of Prizren.

In addition to the above, text books used by both Catholics and Muslims in the schools of the cultural protectorate also promoted the idea of the Hunyadi-Skanderbeg alliance. As part of the ‘Albanian actions’ of the Ballhausplatz, the Albanian-language journals financed by Austria-Hungary (like the *Albanie* of Faik

²⁶ Thalloczy, Ludovicus / Jireček, Constantinus / Šufflay, Nicolaus eds. *Acta et diplomata res*

Albaniae mediae aetatis illustrantia. Vol.1-2. Vindobonae, 1913-1918.

²⁷ Thalloczy, *Te ndodhurat e Shqypnis*, 90, 136, 157, 160, 165.

²⁸ Csaplár-Degovics, Krisztián. ‘Österreichisch-ungarische Interessendurchsetzung im Kaza von Tirana.’ *Südost-Forschungen* (71) 2012: 130-135.

Konica in Brussels)²⁹ propagated the story of these heroes of the 15th century.

On the whole, as early as the independent national state was founded in 1912-1913, the idea of the Hunyadi-Skanderbeg alliance was part of the Albanian historical thinking. To illustrate this statement, let me refer to two facts. Fan Stilian Noli, as he delivered his opening speech at the conference of Triest organised by astrophile Albanian patriots in March of 1913 to find a duke for Albania,³⁰ based his train of thoughts on the idea of the Hunyadi-Skanderbeg alliance:

‘These were hard times of those of Skanderbeg, but he had an ally, the Hungarian Hunyadi. We have now [...] a more powerful ally, emperor Francis Joseph I.’³¹

On the other hand, another brilliant representative of the Austro-Hungarian albanology, the Hungarian Franz Baron Nopcsa propagated the story of Skanderbeg and Hunyadi as well.³² In doing so, he aimed to create his own personal cult among his Albanian friends. The Nopcsas were namely related to the historical Hunyadies. Both families had the right to hold the black raven with a golden ring in its beak in their coat of arms from the 15th century on.³³

²⁹ ÖStA HHStA PA, 19. Nachlasse, Nachlass Kral, Kt. 1, Memoire über Albanien 1901–1905, 14–16.

³⁰ *Resoconto e note sul Congresso Albanese di Trieste*. 1-4 Marzo 1913. Milan, 1913.

³¹ „Schwer waren die Zeiten Skanderbegs gewesen, aber er hatte einen Verbündeten gehabt, den Ungar Hunyady. Wir [...] haben einen noch mächtigeren Verbündeten, den Kaiser Franz Josef I.” Speech of Fan Noli. Kriegsarchiv in Vienna, Nachlaß Conrad von Hötzendorf, Akt. 82., Report of Manussi IV, Trieste, 2.03.1913, without no., Albanerkongress in Triest (day 2).

³² Nopcsa, Ferenc (1877-1933).

³³ Nagy, Iván. *Magyarország családai címerekkel*. 8. kötet. Pest: Ráth Mór, 1861. 162-163.



**Coats of arms (emblems) of
the Nopcsa Family (15th
century)**



**Coats of arms (emblems) of
János Hunyadi (1453)**

Eduart CAKA
(Tiranë)

**ASPEKTE TË SITUATËS POLITIKO-EKONOMIKE TË
HAPËSIRËS SHQIPTARE GJATË SHEK. XV BAZUAR NË
REGJISTRAT KADASTRALË OSMANË TË KËSAJ
PERIUDHE**

Hyrje

Shek. XV zë një vend të rëndësishëm në historinë e shqiptarëve. Përveç faktit se kjo periudhë përkon me epokën e Skënderbeut, rëndësia e këtij shekulli lidhet edhe me ndryshime të tjera politiko-ekonomiko-shoqërore, siç ishte instalimi i pushtetit osman, vendosja e Venedikut në pjesën perëndimore të hapësirës shqiptare dhe rivalitetit turko-venecian, procesi i islamizimit dhe fenomene të tjera të ngjashme me të cilat u përballën shqiptarët në këtë kohë. Pikërisht këto janë edhe disa prej arsyeve që historiografia shqiptare i ka kushtuar një rëndësi të veçantë si studimit të shekullit në fjalë.

Sigurisht që në krye të listës së arkivave dhe të literaturës së nevojshme për studimin e kësaj periudhe vijnë ato osmane. Kjo, për faktin e thjeshtë se në shek. XV një pjesë e konsiderueshme e hapësirës shqiptare gjendej nën sundimin osman dhe në duart e administratës perandorake kalonin të gjitha ndryshimet e karakterit ekonomik, shoqëror e ushtarak që ndodhnin në këto zona. Parë nga ky këndvështrim, veprat e kronistëve osmanë kanë qenë pikë referimi e shumë studiuesve shqiptarë të cilët kanë pasur si objekt kërkimi

shek. XV.¹ Këtu vlen të theksohet fakti se literatura në fjalë nuk është shkruar me ndjeshmëritë dhe objektivizmin e historianit të sotëm, por me tendencën e hartuesit për të “lartësuar” palën e vet dhe “poshtëruar” kundërshtarin. Sipas Emecen, për kronistët osmanë të shek. XV, rrëfimi dhe lartësimi i aktiviteteve ushtarake të drejtuesve osmanë dhe transmetimi i këtyre të dhënave tek brezat pasues thuhet ishte perceptuar si një detyrë hyjnore.² Me gjithë subjektivitetin dhe parregullsitë që e karakterizojnë literaturën në fjalë, këto burime sërish mbeten të rëndësishme për të kuptuar mësymjet osmane drejt hapësirave shqiptare dhe rezistencën e këtyre të fundit.

Më i saktë se informacioni që japin kronikat është dokumentacioni i madh osman që gjendet nëpër arkivat e ndryshme të vendeve që më herët kishin qenë pjesë e Perandorisë Osmane. Në këtë kontekst, dokumentacioni arkivor osman, duke nisur qysh nga gjysma e dytë e shek. XX është përdorur edhe prej autorëve shqiptarë. Por, klasifikimi arkivor ka bërë që prezantimi dhe përdorimi i këtij dokumentacioni prej studiuesve shqiptarë të jetë më i paktë dhe, të jetë shfrytëzuar në vitet e mëvonshme. Kështu, me klasifikimin dhe digjitalizimin e dokumentacionit arkivor edhe të dhënat që vihen në dispozicion të studiuesve janë shtuar duke krijuar mundësinë e ndriçimit objektiv dhe të argumentuar të fenomeneve dhe ngjarjeve të rëndësishme që ndodhën gjatë sundimit osman në këto hapësira.

Për të ardhur në shek. XV, vlen të theksohet fakti se burimet më të rëndësishme osmane të cilat mbartin të dhëna në lidhje me këtë shekull janë defterët kadastrorë osmanë. Kjo, për vetë faktin se akti i

¹ Lidhur me rëndësinë që paraqesin kronikat në fjalë për studimin e shek. XV shih. *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV (Burime osmane)*, përgatitur për botim nga Selami Pulaha, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1968, f. 11-18. Gjithashtu shih. Suraiya Faroqhi, *Approaching Ottoman History; An Introduction to the Sources*, Cambridge University Press, Cambridge: 1999, f. 145-149.

² Feridun M. Emecen, “Osmanlı Tarihinin Başlangıcı: İlk Manzum Tarihler”, *Türk Tarihinin Asırlık Çınarı Halil İnalçık'a Armağan*, ed. Mehmet Öz- Serhat Küçük, Türk Kültürünü Araştırma Enstitüsü Yayınları, Ankara 2017, f. 115.

parë që osmanët kryenin pas instalimit të pushtetit të tyre në një zonë të caktuar ishte regjistrimi i popullsisë dhe të ardhurave të atij vendi dhe, vendosja e sistemit të timarit.³ Si për periudhën e përpilimit ashtu edhe për saktësinë e informacionit që përmbajnë, defterët kadastrorë osmanë paraqesin një rëndësi të veçantë në studimin e hapësirës shqiptare të shekujve XV-XVI.

Regjistra kadastralë osmanë të shek. XV që i përkasin hapësirës shqiptare

Pikësëpari duhet të theksojmë se interesi i studiuesve shqiptarë mbi defterët osmanë të karakterit kadastror ka qenë i madh. Këtë mund ta kuptojmë nga datat e tërheqjes së regjistrave në fjalë prej arkivave turke dhe përkthimi i tyre në gjuhën shqipe.⁴ Kështu, në vitet '60 të shek. XX, u realizua përkthimi i katër regjistrave kadastralë osmanë që i përkasin shek. XV. Ato janë:

- a. *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, i përgatitur dhe botuar në Ankara nga osmanologu Halil Inalcik nën titullin “Sûret-i defter-i sancak-i Arvanid” dhe përkthyer në gjuhën shqipe nga Mykerem Janina.⁵

³ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Institutit i Historisë, Botimet Toena: 2002, f. 380-381; Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Institutit i Historisë, Tiranë: 1988, f. 29-31; Halil Inalcik, “Krahina e Krujës dhe e Dibrës rreth vitit 1467”, *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968)*, vëll. I, Tiranë: 1969, f. 181.

⁴ Të njëjtën gjë nuk mund ta themi lidhur me përdorimin e këtyre burimeve në monografitë dhe veprat e përgatitura nga studiuesit tonë. Burimet në fjalë janë përdorur gjerësisht në librin për *Pronësinë Feudale* të S. Pulahës, vepër e botuar në vitin 1988, pothuajse dy dekada pas përkthimit të këtyre defterëve në gjuhën shqipe. Faktorët që mund të kenë ndikuar në këtë gjë janë të ndryshëm, duke nisur që nga planifikimi i monografive që u jepeshin studiuesve në periudhën komuniste e deri tek përgatitja që duhet të kishte studiuesi për interpretimin dhe punimin e defterëve të tillë ku nevojiteshin njohuri shtesë në linguistikë, gjeografi, ekonomi, statistikë etj.

⁵ Për përkthimin dhe botimin e kësaj vepre në gjuhën shqipe shih. *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, përgatiti për botim Halil Inalcik, përktheu

- b. *Regjistri i Përmetit dhe i Korçës i vitit 1431* që përfshin zonat e Përmetit, Korçës, Konicës dhe Grebenës i përkthyer nga Vexhi Buharaja.⁶
- c. *Regjistri i Dibrës i vitit 1467*, i cili përfshin zonat përreth Dibrës, përkthyer nga Vexhi Buharaja.⁷
- d. *Defteri i Regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, botuar në vitin 1974 nga studiuesi Selami Pulaha.⁸

Ekzistenca dhe tanimë edhe botimi i regjistrave që përmendëm më lart, do të bëjë të mundur që studiuesit do të kenë në dorë një korpus të plotë e një pasqyrë të hollësishme të aspektit kadastral e ekonomik të një pjese të konsiderueshme të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV.

Megjithatë, duhet theksuar se si konfigurimi i sanxhaqeve ashtu edhe shtrirja gjeografike e vendeve të Ballkanit në ditët e sotme ka bërë që një pjesë e zonave ku shtriheshin etnikisht shqiptarët të mbetet jashtë kufijve politikë. Në këtë kontekst, për të pasur një panoramë sa më të gjerë të shtrirjes gjeografike, aspektit demografik, ekonomisë dhe elementëve të tjerë të ngjashëm të shqiptarëve gjatë shek. XV, lind nevoja të hulumtohen edhe defterë të tjerë kadastrorë të kësaj periudhe të cilat u përkasin zonave që sot nuk bëjnë pjesë brenda kufijve politikë të Shqipërisë. Kështu, të dhëna plotësuese kryesisht për pjesët verilindore gjejmë edhe në defterin e timareve për zonat e Përlepit dhe të Kërçovës të vitit 1445.⁹ Në defterin me titull *1445 Tarihli Paşa Livası İcmal Defteri*, të përgatitur për botim nga Halil İnalçık, Evgeni Radoshev dhe Uğur Altuğ, i cili përbëhet

Mykerem Janina, botuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2017.

⁶ Kopja e përkthimit të defterit në fjalë gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë me indikacionin (AIH: A. III. 323).

⁷ Kopja e përkthimit të defterit në fjalë gjendet në Arkivin e Institutit të Historisë me indikacionin (AIH: A. III. 315).

⁸ Selami Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e R. P. të Shqipërisë, Tiranë 1974.

⁹ Feridun Emecen, “Defter-i Köhne: Pirlepe-Kırçova Kesiminin En Eski Timar Defteri (1445-1445)”, *Osmanlı Araştırmaları*, XLIII (2014), f. 341-474. Në lidhje me të njëjtin defter gjithashtu shih. *1445 Tarihli Paşa Livası İcmal Defteri*, Halil İnalçık, Evgeni Radoshev, Uğur Altuğ, Türk Tarih Kurumu Yay., Ankara: 2013.

nga 7 defterë që datojnë në vitin 1445, për historinë e Shqipërisë, kryesisht asaj juglindore, paraqesin rëndësi të veçantë defterët e Selanikut e të Kosturit. Sërish në lidhje me pjesët jugore vlen të përmendet edhe Defteri i Sanxhakut të Tërhallës i vitit 1454-1455 i cili gjithashtu na jep të dhëna të rëndësishme në lidhje me shtrirjen e shqiptarëve.¹⁰ Ndërsa, për pjesën e viseve lindore dhe kryesisht të Kosovës së sotme, vlen të theksohet kontributi i orientalistit, Iljaz Rexha, i cili ka prezantuar defterin e vilajetit Vilik, të vitit 1455, dhe atë të sanxhakut të Vlçternit (Vushtrisë) të vitit 1487.¹¹

Të dhënat politiko-ekonomike që na japin regjistrat kadastralë osmanë

Duke marrë parasysh saktësinë e të dhënave që na japin defterët e sipërhënuar, është e mundur të evidentohen disa të dhëna lidhur me aspektin politik, ekonomik, shoqëror e demografik të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV të cilat po i radhisim si vijon:

- Defterët në fjalë na japin të dhëna mbi vendosjen e sundimit osman në hapësirën shqiptare. Megjithëse futja e zonave të ndryshme nën sundim ka vazhduar thujtë të gjithë shek. XV, data më e hershme e vendosjes së osmanëve mund të merret dekada e fundit e shek. XIV e cila përkon me salltanatin e Jilldirim Bajezidit. Ky aspekt vërtetohet nga një numër timarësh që i përkasin zonës Përmet-Korçë, timare të cilat, sipas regjistratit osman të kësaj gjeografie kanë vijuar të trashëgohen edhe në periudhat e mëvonshme.¹²

¹⁰ *Hicri 859 Tarihi Suret-i Defter-i Sancak-ı Tırhala*, c. I-II, Neş. Melek Delilbaşı, Muzaffer Arıkan, Türk Tarih Kurumu Yay., Ankara: 2001.

¹¹ Iljaz Rexha, *Vendbanimet dhe popullsia albane e Kosovës (sipas Defterëve Osmanë të shekullit XV)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2016.

¹² Për më shumë të dhëna lidhur me timaret e shpërndara në periudhën e Jilldirim Bajezidit shih. Defteri i Përmetit dhe i Korçës, përkthyer nga Vexhi Buharaja, Arkivi i Institutit të Historisë (më tej AIH), dosja nr. A. III. 323, f. 28, 53, 58, 73, 74, 75. Gjithashtu shih. Nicoara Beldiceanu, *XIV. Yüzyıldan XVI. Yüzyıla Osmanlı Devletinde Timar*, Çev. Mehmet Ali Kılıçbay, Teori Yay., Ankara: 1985, f. 15.

- Studiuesit, vendas dhe të huaj, bashkohen në mendimin se vendosja e plotë e sundimit osman në hapësirën shqiptare ka ndodhur në disa etapa ku, në fillim ka pasur një periudhë vasaliteti të një pjese të konsiderueshme të aristokracisë vendase.¹³ Me kalimin e kohës, si rezultat i pakënaqësive dhe përplasjeve të krerëve vendas me autoritetet osmane do të ketë përplasje dhe rezistencë ndaj vendosjes së plotë të sundimit osman në këtë gjeografi, gjë e cila solli edhe reagimet dhe mësymjet e ashpra osmane ndaj elementit shqiptar. Këtë gjë, e vërteton më së miri fakti se në regjistrat kadastrale osmanë të shek. XV, ka me dhjetëra fshatra të rrënuara, shkatërruara e të braktisura nga popullsia të cilat në vitet e mëvonshme do të ju jepen timarlinjve të rinj për t'i gjallëruar e ripopulluar.¹⁴

- Gjatë shek. XV, e gjithë hapësira shqiptare ka qenë në revolta dhe kryengritje të vazhdueshme të cilat kanë kulmuar me kryengritjen e madhe të viteve '30 të udhëhequr nga Gergj Arianiti¹⁵, ajo e Zenebishëve rreth një dekadë më vonë dhe epokën 25-vjeçare të Gjergj Kastrioti-Skënderbeut. Kështu, vazhdimësia e revoltave të ngjashme, përveç të dhënave që na japin kronikanët turq, vërehet dhe konfirmohet edhe nga datat dhe shënimet që janë bërë në regjistrat osmanë të kësaj periudhe.

- Gjatë shek. XV vërejmë se një pjesë e konsiderueshme familjeve aristokrate shqiptare janë inkorporuar brenda aparatit shtetëror osman.¹⁶ Këtu mund të përmendim Muzakajt,¹⁷ të cilët

¹³ Pulaha, *Pronësia feudale*, f. 29-30; Inalcik, *Krahina e Krujës dhe e Dibrës*, f. 181.

¹⁴ Për më shumë të dhëna mbi braktisjen e zonave dhe fshatrave të ndryshme dhe, dhënien më vonë për ripopullim të këtyre shih. *Historia e popullit shqiptar*, f. 384; *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. XXXVI. Në regjistrin e arvanidit ka 16 fshatra të zbrazur dhe të braktisur, ndërsa në atë të Përmetit dhe të Korçës numri janë 11 të tilla. Gjithashtu, duhet theksuar se numri i truallishteve të braktisura është shumë më i madh se ai i fshatrave që dhamë. Si rrjedhojë e luftërave të shumta që u zhvilluan, numri më i madh i fshatrave të shkatërruara e të braktisura hasen në defterin e zonave të Dibrës të vitit 1467.

¹⁵ *Historia e popullit shqiptar*, f. 383-385; *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. XII-XIII; Pulaha, *Pronësia feudale*, f. 34; *Lufta shqiptaro-turke*, f. 8.

¹⁶ Për më shumë të dhëna lidhur me këtë temë shih. *Historia e popullit shqiptar*, f.

kishin zotërime që fillonin nga pjesët e brendshme të Shqipërisë për të vijuar deri në zonat e Kosturit, Skurajt, një pinjoll i të cilëve, Isa Beu rezultoi si bejlerbej i Anadollit në vitin 1444¹⁸, të bijtë e një fisniku tjetër shqiptar, Ashtinit, Jakubi dhe Mustafai ishin kthyer në myslimanë dhe zotëronin timare.¹⁹ Madje, pjesë e kësaj tendence vërejmë të jenë bërë edhe familja e Kastriotëve ku Skënderbeu, siç do ta shohim edhe më poshtë, do të shërbente si subash në Krujë përpara se të kthehej për të nisur rezistencën e tij por, nipi i tij, Hamzai do të vijonte të ishte pjesë e aparatit shtetëror osman deri në fundin e jetës. Parë nga ky këndvështrim, regjistrat kadastrorë na paraqesin të dhëna të detajuara lidhur me kohën e shërbimit, postin që mbanin, por edhe timaret që zotëronin një pjesë e kësaj aristokracie të cilët me kalimin e kohës qenë bërë pjesë e aristokracisë osmane.

- Çështja e islamizimit të shqiptarëve ka qenë vazhdimisht një temë e cila ka tërhequr vëmendjen e studiuesve shqiptarë e të huaj. Përveç shkaqeve që çuan në konvertimin e popullatës shqiptare në myslimanë, me rëndësi është edhe evidentimi i periudhës kohore kur nisi ky proces. Pikërisht këtu na vijnë edhe në ndihmë defterët osmanë me karakter kadastral të shek. XV. Në këta regjistra hasim emra timalinjsh shqiptarë për të cilët shënohet se kanë pranuar besimin islam.²⁰ Fenomene të tilla hasim në të katër regjistrat

390-391. Pulaha, *Pronësia feudale*, f. 35-38; Halil İnalcık, “Stefan Dušan’dan Osmanlı İmparatorluğuna: XV. Asırda Rumeli’de hıristiyan sipahiler ve menşeleri”, 60. *Doğum yılı münasebetiyle Fuad Köprülü Armağanı*, Dil ve Tarih-Coğrafya Fakültesi, İstanbul: 1953, f. 217, 225-229; Halil İnalcık, “Arnavutluk’ta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey İsyasının Menşei”, *Fatih ve İstanbul*, cild. I, İstanbul: 1953, f. 159-161.

¹⁷ Jakup Bej Muzaka mbante postin e sanxhakbeut të Arvanidit në vitin 1441. Shih. Halil İnalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar I*, Türk Tarih Kurumu Basımevi, Ankara: 1954, f. 162.

¹⁸ İnalcık, *Fatih Devri*, f. 162.

¹⁹ İnalcık, *Fatih Devri*, f. 148.

²⁰ D. Egro jep përqindjen e timarlinjve me besim mysliman për katër defterët si më poshtë: në defterin e Arvanidit (1431) 11.6 %, në të Përmetit-Korçës (1431) 28.4%, në atë të Dibrës (1467) 9 %, në sanxhakun e Shkodrës 7% dhe në Vilçik-ili 3.9%.

kadastrorë për hapësirën shqiptare të shek. XV që i prezantuar më sipër. Në këtë kontekst, defterët osmanë na nxjerrin përpara faktit se procesi i islamizimit të popullsisë shqiptare, duke nisur në një pjesë të mirë nga shtresat e larta, ka nisur në shek. XV.

- Në kapitullin hyrës të defterit të regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, S. Pulaha është përpjekur të gjejë një kufi etnik të hapësirës gjeografike të banuar prej shqiptarëve në zonat e marra nën regjistrim tek ky regjistër. Kështu, duke u bazuar në të dhënat onomastike që paraqiten në regjistër, ai ka arritur të përcaktojë tre breza (zona) emrash të cilat, në njëfarë mënyre shënjojnë edhe kufirin etnik shqiptaro-sllav.²¹ Si në regjistrin e sipërpërmendur ashtu edhe në monografinë e tij mbi pronësinë feudale, vërejmë se Pulaha nuk ka pasur mundësinë të konsultojë defterë të tjerë osmanë që i përkasin shek. XV, për zona që gjenden më në veri të hapësirës së banuar prej shqiptarëve siç mund të jetë regjistri i vilajetit të Vilikut i vitit 1455, dhe ai i sanxhakut të Vulçiternit (Vushtrisë) që i përket vitit 1477. Të dy dokumentet janë botuar vitet e fundit nga I. Rexha dhe na paraqesin të dhëna të reja lidhur me shtrirjen e popullsisë shqiptare dhe vendbanimet e tyre në këto zona.

- Defterët kadastralë na japin të dhëna me shumë rëndësi edhe për popullsinë e qyteteve, kalave dhe fshatrave shqiptare gjatë shek. XV. Përveç historisë së qyteteve shqiptare, këto të dhëna i shërbejnë studiuesit edhe në trajtimin dhe hulumtimin e fenomeneve të tjera që kanë të bëjnë me periudhën në fjalë. Bie fjala për studimet e karakterit demografik. Në fakt, një punim i ngjashëm i cili ka në fokus vetëm zonat që përfshinte sanxhaku arvanid është realizuar nga

Për më shumë të dhëna shih. Dritan Egro, *Islam in Albanian Lands during the First Two Centuries of the Ottoman Rule*, PhD Thesis, Bilkent University, Ankara: 2003, f. 191. Sigurisht që një pjesë e madhe e timarlinjve myslimanë ishin të ardhur dhe nuk i përkisnin etnisë shqiptare por, ka edhe disa raste kur timarliu në fjalë është shqiptar. Këtë e vërejmë qartësisht nga emërtimi “arnavud” që është vendosur përpara emrit të tyre.

²¹ Për detajet shih. Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut*, f. 33-34.

bizantinologu Johannes Koder.²² Kështu, në bazë të një metodologjie që ai ndjek, studiuesi në fjalë del në përfundimin se sipas regjistrit të sanxhakut arvanid, popullsia e këtij sanxhaku varion nga 79 978 deri në 137 106 mijë banorë taksapagues me një dendësi popullore prej 7.4 deri në 12.8 për kilometër.²³ Në fakt, tentativa të studimeve të ngjashme duke përdorur metoda të studimeve demografike bazuar në regjistrat kadastralë apo atyre të taksave i hasim edhe në historiografinë tonë.²⁴ Por, ajo çka duam të theksojmë këtu ka lidhje me faktin se të njëjtat studime, këtë herë në një kuadër më të gjerë, mund të bëhen edhe me regjistrat osmanë të hapësirës shqiptare të shekullit në fjalë për të nxjerrë një numër të përafërt të popullsisë shqiptare të kësaj periudhe.

Skënderbeu në defterët kadastralë osmanë

Jeta dhe veprimtaria e Gjergj Kastrioti-Skënderbeut është studiuar gjerësisht nga autorë vendas dhe të huaj. Por, pjesa dërrmuese e burimeve arkivore dhe literaturës së përdorur për trajtimin e jetës dhe veprës së tij është mbështetur në burimet perëndimore duke krijuar një zbrazëti në dokumentacionin lindor që kryesisht ka konsistuar në referimin e kronikave osmane që flasin për Skënderbeun. Sigurisht që kjo gjë, ka bërë që ne të mos kemi të dhëna të hollësishme mbi periudhën e fëmijërisë e rinisë së Gjergj Kastriotit deri në fundin e viteve '30 të shek. XV. Sigurisht që figura dhe vepra e Skënderbeut bazuar në dokumentacionin arkivor osman do të kërkonte një studim më vete por, ajo çka duam të theksojmë këtu ka të bëjë me faktin hulumtimi i regjistrave kadastralë na jep të dhëna mbi figurën e Skënderbeut. Më konkretisht, në regjistrin e sanxhakut të Arvanidit gjenden tre shënime që i atribuohen vetë

²² Johannes Koder, "Defter-i Sancak-i Arvanid si burim të dhënash demografike mbi Epirin në kapërcyellin prej sundimit bizantin në atë osman (me dy harta dhe gjashtë tabela)", *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2017, f. 41-60.

²³ Koder, *Defter-i Sancak-i Arvanid si burim të dhënash*, f. 48.

²⁴ Selami Pulaha, "Aspekte të demografisë historike të trevave shqiptare gjatë shekujve XV-XVI", *Studime Historike*, nr. 3, Tiranë: 1985, 175-185.

Skënderbeut në kohën kur ai ishte ende pjesë e aparatit shtetëror osman. Shënimet në fjalë janë:

1. Fshati Marmur, shtëpi: 17, të ardhura 1195.
(Shënim) Ky fshat iu dha si shtesë babait të Haxhi Zaganoz Beut në bazë të urdhëresës së Skënderbeut, birit të Gjonit mbledhja e llogarisë është në varakun e katërt, më poshtë.²⁵
2. Me qenë se kur hyri në kala veproi drejt, iu shtua në bazë të letrës që përmban urdhrin e kadiut të Krujës dhe të Iskenderbeut.²⁶
3. Edhe nëntë copë fshatra, sipas tahvilit të Skënderbeut, birit të Gjonit u morën nga vilajeti i Dimitër Gjonimës dhe timari u regjistrua në regjistrin e tokës së Gjonit. Në rast nevojë të shihet atë regjistër.²⁷

Në regjistrin e timareve për zonat e Përlepit dhe të Kërçovës gjithashtu hasim një shënim tjetër mbi Skënderbeun, por, këtë herë për kohën kur ai gjendej në rivalitet dhe përplasje me osmanët. Sipas shënimit në fjalë, Nikolla dhe Gjoni, djem të dizdarit të ndjerë të kalasë së Koxhaxhikut, Andre Murës iu është marrë nga duart timari që zotëronin për arsye se të lartpërmendurit i ishin bashkuar Skënderbeut.²⁸ Shembulli i mësipërm jo vetëm që tregon shtrirjen që pati lëvizja e Skënderbeut, por na jep të kuptojmë edhe një herë se të dhëna me rëndësi për historinë e Shqipërisë gjenden edhe në defterë të kësaj periudhe për zona të cilat sot ndodhen jashtë kufijve politikë.

Një burim tjetër i rëndësishëm që mbart të dhëna mbi përplasjet që Skënderbeu kishte me ushtritë osmane është edhe Defteri Emëror i Zonave të Dibrës i vitit 1467. Kështu, nga të dhënat në regjistër vërejmë se trupat osmane kishin arritur të depërtonin deri tek fshatra a kështjella shumë të afërta me Krujën, e cila që edhe

²⁵ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. 220.

²⁶ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. 229.

²⁷ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. 234.

²⁸ Në shënim nuk jepet data se kur është marrë nga duart timari në fjalë prej tyre porse si datë e kalimit të timarit tek personat e sipërpërmendur i përket muajve nëntor/dhjetor të vitit 1452. Shih. Emecen, *Defter-i Köhne*, f. 370.

kryeqendra e zotërimeve të Skënderbeut.²⁹ Përveç kështjellës së Elbasanit së ngritur në pjesën jugore të saj, tanimë Kruja kishte humbur edhe rrethina të rëndësishme të cilat shërbenin për mbrojtjen e kryeqendrës së Skënderbeut siç qenë zonat e Matit e të Kurbinut në veçanti, por i gjithë koridori Krujë-Dibër në përgjithësi. Sulmet e pandërprera dhe luftërat e zhvilluara në këtë hapësirë siç duken e kishin rrënuar ekonomikisht, por edhe në aspektin demografik, aspekt i cili dëshmohet nga brendësia e vetë defterit.

Parë nga ky këndvështrim, regjistri paraqet një numër të konsiderueshëm fshatrash të cilat rezultojnë të braktisura. Vetëm nga fshatrat që vareshin prej Krujës dhe që ndodhen të regjistruara në këtë defter vërejmë 22 fshatra të cilat janë të braktisura.³⁰ Fshatra të braktisura gjithashtu hasim edhe në zonat e Dibrës, kryesisht përreth luginave ku kishte pasur beteja, ose në hapësirat të cilat ishin mbi vijën e itinerarit që ndiqnin ushtritë osmane për të marshuar drejt Krujës. Kjo panoramë, më shumë se shkretimin ekonomik të hapësirave të sipërpërmendura nxjerr në pah një bjerrje demografike që pësuan zonat e Krujës, Matit e Dibrës gjatë kësaj periudhe.

Nga të dhënat në defter hasim edhe një timarli të quajtur Jakup, shqiptar i myslimanizuar i cili kishte arritur të kapte njërin prej komandantëve të afërt të Skënderbeut, Moisi Dibrën.³¹ Parë nga ky këndvështrim, defterët kadastrorë të shek. XV, jo vetëm që na japin të dhëna rreth avancimit osman në hapësirën shqiptare dhe vendosjes së sundimit të tyre në këto zona por, gjithashtu mbartin informacione me rëndësi edhe për zhvillimin e historiografisë skënderbegiane.

²⁹ Në pjesën e defterit të botuar nga Selami Pulaha vërejmë se osmanët kishin arritur deri në Gur të Bardhë, fshat derbend në një distancë të afërt me Krujën, gjithashtu edhe zonë banimi shumë e afërt me kalanë e Petralbës. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke*, f. 326; *Historia e popullit shqiptar*, f. 454.

³⁰ Bëhet fjalë për fshatrat Asani (Hasanaj), Bilanik, Makrik, Ozgurdish (Zgërdhesh), Virjon, Shëngjergj, Barkanesh, Kurtsek (Kurçaj), Burin (Burrani), Bogmesh, Qinam, Kallmet, Pinjari (Pinar), Patëza (Tapiza), Krahskoza (Shkozë), Domi (Domja), Dolna Kashar, Bobotish, Bobiq, Bojtul, Kllaksh, Mazarak (Mazrek).

³¹ Shih. *Defteri emëror i Dibrës i vitit 1467*, Timari nr. 6.

Përfundim

Defterët e karakterit kadastral janë burimet më të rëndësishme osmane për shek. XV për të njohur historinë e kësaj perandorie. Për fatin tonë të mirë, defterët më të hershëm të këtij lloji në të gjithë hapësirën e Perandorisë Osmane u përkasin zonave shqiptare dhe datojnë në vitin 1431-1432. Kështu, një pjesë e regjistrave kadastrorë të shek. XV që përfshijnë hapësirën shqiptare janë tërhequr nga arkivat osmane për t'u përkthyer nga studiuesit shqiptarë gjatë viteve '60 të shekullit të kaluar. Me botimin e tyre dhe me analizimin edhe të regjistrave të tjerë të të njëjtit shekull për zonat fqinje, sot e kemi më të lehtë të kuptojmë kohën se kur hapësira shqiptare u futën nën sundimin osman, fazat e instalimit të sistemit të timarit, rezistencën e popullsisë, gjendjen ekonomiko-politike por edhe aspekte të tjera të ekonomisë, politikës, kulturës e gjuhës që kishin shqiptarët në këtë periudhë. Regjistrat në fjalë gjithashtu na japin të dhëna tejet të rëndësishme edhe në lidhje me epokën e Skënderbeut, periudhë e cila zë një vend parësor dhe tejet të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar.

Qerim DALIPI & Besim MORINA
(Shkup-Prishtinë)

**RRETHANAT SOCIO-ETNIKE NË NAHIJEN E TETOVËS,
SIPAS REGJISTRIMIT TË VITEVE 1467-1468**

Abstrakt: Mbi bazën e regjistrimit kadastral osman të viteve 1467-1468 bëhet përpjekje të ndriçohen aspektet socio-etnike që karakterizuan nahijen e Tetovës në këtë kohë. Në këtë kontekst, pasi sqarohen rrethanat e përfshirjes së nahijes së Tetovës në kuadër të qarkut të Shkupit dhe më pas të pashasanxhakut të Shkupit, hidhet dritë mbi regjistrimin osman, shtrirjen territoriale dhe vendbanimet që ishin në kuadër të saj, numrin e banorëve dhe të timarlinjve, rrethanat fetare etj. Gjithashtu, duke shfrytëzuar literaturë relevante mbi antroponimet dhe patronimet, por edhe mbi toponimet arbërore, të cilat gërshetohen me ato të pranishme në këtë nahije, nxirret në sipërfaqe struktura etnike, në veçanti prania e arbërve në trojet e tyre etnike.

Fjalët kyçe: regjistrimi osman i viteve 1467-1468, nahija e Tetovë, fshatrat, timarlinjt, struktura etnike.

Aty nga fundi i shek. XIV, respektivisht midis 1. IX. 1391 dhe 6. I. 1392, qyteti i Shkupit ra nën sundimin e osmanëve,¹ të cilët e shndërruan atë në bazë ushtarake prej nga niseshin ekspeditat

¹ Душанка Бојаниќ-Лукач, *Како Турците го презеле Скопје*, në: “Зборник на Музеј на град Скопје”, II-III, Скопје, 1965-1966, 5-7.

kundër viseve të fqinje. Në fakt, Shkupi u bë seli e *qarkut*, përkatësisht e *krahinës* (uxh) osmane (sanxhakut), njësi administrative me karakter të theksuar ushtarak dhe të përkohshëm, që pushteti osman i organizonte në krahinat kufitare të Perandorisë. Në krye të qarkut të Shkupit qëndronte *krahinari* (uxh-beu), i cili kishte për detyrë të mbikëqyrte vasalët fqinj dhe po t'i jepej mundësia edhe të sulmonte dhe të pushtonte territoret e tyre.²

Në kuadër të qarkut të Shkupit, bënte pjesë edhe nahija e Tetovës. Mirëpo, pas themelimit të sanxhakut të Bosnjës (1463), qarku i përmendur pushoi së ekzistuari.³ Nahija e Tetovës dhe disa të tjera (rreth 20 nahije), u përfshinë në kuadër të pashasanxhakut të Shkupit, që shtrihej në juglindje deri në Selanik.⁴

Vendosja e pushtetit osman u shoqërua me procesin e regjistrimeve kadastrale, që pushteti osman i organizonte kohë pas kohe. Regjistrimi bëhej nga një komision i veçantë, i dërguar nga kryeqendra e Perandorisë Osmane. Ai, në bashkëpunim me autoritetet e pushtetit vendor-nahijes, regjistronte të gjithë vendbanimet, bashkë me popullsinë e tyre, tatimet, si dhe të gjitha të ardhurat feudale, duke përpiluar regjistrin e hollësishëm (*defter-i mufassal*). Në bazë të këtij regjistri, përmes seleksionimit të të dhënave, komisioni përpilonte edhe regjistrin tjetër kadastral, atë përmbledhës (*defter-i icmâl*).⁵ Në punimin tonë, ne i referohemi

² Qerim Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)*, Tetovë, 2012, 172, 216, 229, 231; Драги Ѓорѓиев, *Скопје од турското освојување до крајот на XVII век*, Скопје, 1997, 19-25.

³ Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, 52.

⁴ *Historia e popullit shqiptar*, I, Tiranë, 2002, 379. Ndonjë autor tjetër mendon se bëhet fjalë për pashasanxhakun e Edrenesë, i themeluar që në kohën e pushtimeve të para osmane në Gadishullin Ballkanik (Александар Стојановски, *Административно-територијалната поделба на Македонија под османлиската власт до крајот на XVII век*, in “Гласник“ – Институт за национална историја, год. XVII, бр. 2, Скопје, 1973, 133).

⁵ Gjerësisht për këtë shih: *Krajište Isa-bega Isakovića - Zbirni katastarski popis iz 1455. godine*, priredio Hazim Šabanović, Sarajevo, 1964, XXXII-XXXIII; *Турски документи за историјата на македонскот народ – Опширен пописен дефтер № 4 (1467-1468)*, под редакција на Методија Соколовски – Александар Стојановски, Скопје, 1971, 8 (në tekstin e mëtejme: *Опширен пописен дефтер*

regjistrin të hollësishëm, i cili përmban të dhëna edhe për nahijen e Tetovës, ndërsa u përpilua gjatë viteve 1467-1468.⁶

Në bazë të emrave të fshatrave që bënin pjesë në kuadër të nahijes së Tetovës, mund të përcaktohen edhe kufijtë e përafërt të saj. Kështu, në lindje dhe verilindje ajo kufizohej me vilajetin e Shkupit, në jug (të Gostivarit) me nahijen e Kërçovës, në jugperëndim me nahijen e Rekës dhe në perëndim dhe veriperëndim me malin Sharr.⁷

Popullsia në Perandorinë Osmane ndahej në dy shtresa bazë: *askere* dhe *raja*. Shtresa askere (ushtarake) përbëhej nga të gjithë ata që ushtronin funksione ushtarake-administrative (funksionarët, nëpunësit dhe kleri mysliman) dhe ishin të liruar nga pagesa e taksave. Ndërsa, shtresa raja përbëhej nga të gjithë ata që paguanin taksa dhe nuk merrnin pjesë në luftë.⁸ Rrjedhimisht, përfaqësues të këtyre shtresave ishin të pranishëm edhe në nahijen e Tetovës.

Qendër administrative dhe ushtarake e nahijes ishte qyteti i Tetovës. Në krye të nahijes qëndronte *subashi* Sylejman Beu, i cili varej nga sanxhakbeu, ndërsa ushtronte pushtetin ushtarak dhe administrativ. Pranë subashit ishte *kadiu*, i cili ushtronte postin e gjykatësit, kurse varej nga sulltani. Nën komandën e subashit ishte *çeribashi*, i cili kishte për detyrë t'i udhëhiqte timarlinjtë gjatë kohës së ekspeditave ushtarake⁹ Është karakteristikë se garnizoni osman ishte i stacionuar në kështjellën e Sobrit dhe është evidentuar si "*ruajtësit e kështjellës së Sobrit*". Ai numëronte 12 veta, me në krye komandantin - *dizdarin*. Përfaqësues tjetër i klasës askere që ushtronte detyrat e tij në këtë kështjellë ishte funksionari i fesë

Nq 4); Qerim Dalipi, *Nahija e Kërçovës* sipas regjistrimit të viteve 1467-1468 (Aspekte shoqërore), në: *Gjurmime albanologjike*, seria e shkencave historike, nr. 47/2017, Prishtinë, 2017, 29-30.

⁶ *Опишрен пописен дефтер Nq 4*, 293.

⁷ *Po aty*, në më shumë vende.

⁸ Noel Malcolm, *Kosova – Një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë, 2001, 98.

⁹ *Опишрен пописен дефтер Nq 4*, 293, 333, 395; krh.: *Historia e popullit shqiptar*, I, 379-380, 516; Драги Ѓоргиев, *Скопје од турското освојување до крајот на XVII век*, Скопје, 1997, 34; Александар Матковски, *Отпорот во Македонија*, I, Скопје, 1983, 386.

islame - *imami*. Të gjithë këta posedonin timare të përbashkëta, me përjashtim të dizdarit që zotëronte timar të veçantë.¹⁰

Baza e sistemit ushtarak osman ishte sistemi i spahinjve, respektivisht sistemi timar. Spahinjtë nuk kishin rrogë. Atyre për të jetuar dhe për të kryer shërbimin ushtarak u jepeshin, në zotërim nga shteti, ngastra toke - *timare*. Në fshatin ose fshatrat që përbënin timarin banonin fshatarët (*raja*), zotëruesit e tapive, të cilët u paguanin spahinjve taksa të caktuara. Varësisht nga të ardhurat që realizonte spahiu (timarliu) përcaktoheshin edhe obligimet e tij ndaj shtetit.¹¹ Meqë kjo çështje është e lidhur ngushtë me sistemin tatimor të timarit,¹² i cili nuk është objekt trajtimi në punimin tonë, në këtë rast e theksojmë se në nahijen e Tetovës 2 timare ishin dhuruar në zotërim me *berat* (dekret) të sulltanit, kurse 32 të tjera me berat të pashait. Midis këtyre të fundit ishte edhe një timar që përbëhej vetëm nga një *mezër* dhe ishte i regjistruar si jashtë regjistrit. Për 10 timare, midis të cilave edhe për atë të kadiut dhe njërit të çeribashit, nuk thuhet se nga kush ishin dhuruar. Tridhjetepesë timare zotëroheshin nga një spahi veç e veç.¹³ Megjithatë, nëse merret parasysh konstatimi se çeribash i nahijes ishte Sylejmani¹⁴ (emri i tij në regjistër të timari i çeribashit nuk përmendet), del se 2 nga 35 timaret në fjalë zotëroheshin nga ky i fundit. Gjashtë timare zotëroheshin nga 2-5 spahinj. Në tri timare të tjera nuk ishin përfshirë fshatra, por ato përbëheshin nga spahinj të vjetër të krishterë, të cilët kishin bashtinat e tyre, kundrejt shlyerjes së obligimit ushtarak ndaj shtetit osman. Kështu, në timarin e parë ishin përfshirë 7 spahinj të krishterë, si:

¹⁰ *Опширен пописен дефтер* Nq 4, 399-403.

¹¹ Skender Rizaj, *Historia e përgjithshme - Koha e re (1453-1789)*, Prishtinë, 1985, 53.

¹² Timaret, ziametet dhe një has, pavarësisht sasisë së të ardhurave vjetore, i kemi shënuar ashtu siç janë të evidentuara në regjistër.

¹³ *Опширен пописен дефтер* Nq 4, në më shumë vende. Mezrat (truallishtet) ishin toka djerrë të fshatrave, dikur të banuara, por që ishin braktisur nga popullsia. Ato mund të punoheshin e të mbilleshin nga fshatrat fqinje, dhe ishin të regjistruara si të ardhura të timarit (*Historia e popullit shqiptar*, I, 518; Александр Матковский, v.c., 361).

¹⁴ *Тетово и тетовско низ историјата*, I, Тетово, 1982, 144, 147.

Gjurkoja, i biri i Kojës; Pavli, nip nga i vëllai i Gjurkos; Dimitri, i biri i Milovanit; Brajo, i biri i Dimitrit; Dushmani, i biri i Dimitrit; Nikolla, i biri i Dimitrit dhe Bozhidar, i biri i Dimitrit. Rrjedhimisht, këtë timar e përbënin xhaxhai dhe nipi, si dhe babai me katër djem.

Ata obligoheshin që për çdo vit nga një prej tyre të merrte pjesë në ekspeditat ushtarake. Në timarin e dytë ishin përfshirë po ashtu 7 spahinj, si: Nikolla, i biri i Brajkos, me vëllezërit e tij Dimitri dhe Vojnuku; Kostantini, i biri i Vllajçiqit dhe i vëllai i tij Raguta; si dhe Nakoja, i biri i Dragosllavit dhe i vëllai i tij Nikolla. Njëri nga ata duhej të merrte pjesë për çdo vit në ekspedita ushtarake si xhebëli. Në timarin e tretë bënin pjesë 9 spahinj të vjetër të krishterë: Miladini, i biri i Nenadit me djemtë e tij: Kragujin, Kostantinin dhe Jankun; i vëllai i tij Gjorgji me djemtë e tij: Nikollën dhe Dimitrin, si dhe Gjorgji, i biri i Kostantinit, me të birin e tij Dimitrin. Edhe në këtë rast, njëri nga ata duhej të merrte pjesë çdo vit në ekspedita ushtarake si xhebëli. Në regjistrin e viteve 1467-1468, janë të regjistruara edhe 1 has (ai i subashit Sylejman Beu), 2 ziamete, 1 vakëf dhe 2 mylqe (prona private).¹⁵

Në nahijen e Tetovës, pjesa dërrmuese e timarlinjve që realizonin të ardhura më të mëdha nga timaret e tyre, në përputhje me ligjet osmane, shkonin në luftë të shoqëruar me një ose me disa *xhebëli* (kalorës). Timarlinjtë që realizonin të ardhura të vogla, ishin të pakët në numër dhe merrnin pjesë në luftë të vetëm, ndërsa spahinjtë e kështjellës së Sobrit shërbenin si ruajtës të saj.¹⁶

Në viset malore, banorët e fshatrave përreth caktoheshin t'i ruanin grykat nga sulmet e cubave. Këta rojtarë quheshin *derbenxhinj* (grykëtarë) dhe i ruanin udhëtarët, tregtarët, karvanët dhe titullarët e ndryshëm që kalonin nëpër grykat malore. Për shërbimet që ofronin, ata gëzonin disa lehtësime në të paguarin e taksave.¹⁷ Rrjedhimisht, dy fshatra derbenxhinjsh kishte edhe në

¹⁵ *Описуилен пописен дефтер* № 4, në më shumë vende.

¹⁶ *Po aty*, në më shumë vende. Gjerësisht për këtë çështje shih: Selami Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Tiranë, 1988, 226.

¹⁷ *Историја народа Југославије*, II, Београд, 1960, 27; Skender Rizaj, *Historia e përgjithshme ...*, 57.

nahijen e Tetovës. Njëri ishte fshati Veshallë, në veriperëndim të Tetovës, respektivisht në bjeshkët e malit Sharr. Ai bënte pjesë në kuadër të hasit të subashit të Tetovës, kurse numëronte 70 shtëpi. Megjithatë, me detyrën e ruajtësit të grykave ishin ngarkuar 25 kryefamiljarë, kurse të tjerët ishin të detyruar t'i paguanin taksa subashit. Fshati tjetër ishte ai i Mavrovës, në jugperëndim të Gostivarit, i cili zotërohej nga një spahi, kurse numëronte 20 shtëpi.¹⁸

Krahas derbenxhinjve, një pozitë të rëndësishme zinin edhe *doganxhinjtë* (ruajtësit e fajkonëve). Detyrat e doganxhinjve ishin të ndryshme: disa ishin të angazhuar që të zinin 1-2 fajkonë në vit, të përkujdeseshin dhe t'i stërvitnin ato, dhe më pas, përmes eprorit të tyre (çeribashit ose doganxhibashit), t'i dërgonin në oborrin e sulltanit. Të tjerë ishin të detyruar t'i ruanin foletë dhe fajkontë e vegjël, ndërsa quheshin *juvaxhi*. Doganxhinjtë, çofshin ata të krishterë ose myslimanë, pajiseshin me një berat të veçantë nga sulltani, përmes të cilit përcaktoheshin obligimet dhe lehtësirat për përmbushjen e detyrimeve të marra. Ata të cilët i realizonin obligimet përkatëse, fitonin lehtësira në të paguarit e taksave. Nga ana tjetër, nëse nuk arrinin që të realizonin obligimet përkatëse, ata duhej të paguanin një taksë të veçantë vjetore.¹⁹

Sipas regjistrimit të viteve 1467-1468, në timarin e çeribashit të nahijes së Tetovës, që besohet se ishte Sulejmani, ishin të regjistruar 100 doganxhinj (respektivisht familje) nga 19 fshatra të kësaj nahijeje, të cilët i paguanin taksa përkatëse eprorit të tyre.²⁰

¹⁸ Numrin e shtëpive do të nxirret duke mbledhur numrin e kryefamiljarëve me numrin e vejaneve si kryefamiljare. Megjithatë, në rastin e këtyre dy fshatrave, vejane si kryefamiljare nuk kishte të regjistruara. Nga ana tjetër, në fshatin e parë kishte të regjistruar 4 beqarë dhe në të dytin 2 beqarë (*Опширен пописен дефтер* № 4, 302-303, 366-367).

¹⁹ *Тетово и тетовско ...*, 141-143.

²⁰ Në timarin e çeribashit ishin të regjistruar 100 doganxhinj nga 19 fshatra të nahijes së Tetovës: Pallçishti (11), Vrutoku (10), Nikshenci (9), Leshnica (8), Strimnica (7), Otushishti (5), Zdunja (6), Novosella (6), Piroku - Pirgu (6), Reçani (5), Koshenci (5), Debreshi (4), Çellopeku (4), Zherovjani (3), Kopanica (3) Tenova (2), Altomani (2), Tudenci (2), Jançishti (2). Në timarin e çeribashit ishin përfshi edhe 5 doganxhinj nga fshatrat e vilajetit të Shkupit: Orlanca, Jazirca, Dërnkoeci, Gërçeci dhe Matka (*Опширен пописен дефтер* № 4, 395-398).

Njëherësh, në një fshat ishin regjistruar 4 *juvaxhi* në zotërim të *pashës*, dhe në dy fshatra 4 doganxhinj në zotërim të *mirmiranit* (*pasha* me dy *tuga*). Ata nuk ishin të ngarkuar me pagimin e taksave.²¹

Një kategori tjetër tejet e rëndësishme ishte ajo e *voj nukëve*, të cilët ishin kryesisht nga radhët e të krishterëve, por kishte edhe raste kur ata ishin nga radhët e myslimanëve. Voj nukët ndaheshin në dy kategori: në të sulltanit dhe në të thjeshtë. Të parët shërbenin në kalorësinë e sulltanit, i ruanin kuajt, i kositnin livadhet dhe bimët e tjera për ushqimin e kuajve pranë oborrit perandorak. Ata e shoqëronin kalorësinë perandorake gjatë ekspeditave ushtarake, duke u kujdesur për të. Voj nukët e thjeshtë zakonisht shërbenin si ruajtës të kuajve gjatë kohës së luftës. Nëse ishte e nevojshme, ata hapnin hendeqe, jepnin roje në vise të thella ose dërgoheshin si pararojë. Si kompensim për këtë shërbim, ishin të liruar nga të gjitha pagesat e rregullta ndaj shtetit. Disa studiues mendojnë se voj nukët ishin të armatosur me mburojë dhe shtizë. Ata ishin nën komandën e çeribashit, i cili varej nga sanxhakbeut.²²

Në nahijen e Tetovës, numri i voj nukëve arrinte në 37 veta, dy nga të cilët ishin myslimanë. Ata bënë pjesë në kuadër të timarit të çeribashit, ndërsa ishin nga fshatra 17 fshatra të ndryshme të nahijes. Njëherësh, siç thuhet në regjistër, ata i paguanin spahiut taksën e *yshyrit*.²³

Qyteti i Tetovës ishte i ndarë në dy lagje: të myslimanëve dhe të krishterëve. Lagjja e myslimanëve numëronte 41 familje, kurse ajo

²¹ Pashai kishte në zotërim 4 *juvaxhi* nga Dobrogoshti (Dobrogoshi), ndërsa mirmirani (*pasha*) nga 2 doganxhinj nga Kopanica dhe Dobrogoshti (Dobrogoshi). (*Po aty*, 395, 409-410). Mund të supozohet se bëhet fjalë për të njëjtin *pasha*, që duhet të ketë qenë bejlerbe i Rumelisë.

²² *Тетово и тетовско ...*, 145-146.

²³ Sylemani, i biri i Abdullahut, kishte në zotërim 37 voj nukë nga 17 fshatra të nahijes së Tetovës: nga Pallçishti i Poshtëm 7, nga Çerkovjani 5, nga Tearca 4, nga Çellopeku dhe Jançishti nga 3, nga Kopanica, Piroku (Pirgu) dhe Bërvenica nga 2, dhe nga Stajkoci, Pallatica, Reçica e Vogël, Meli, Jança, Barbosi (Barboshi), Novosella, Petrushina dhe Kalishti nga 1 (*Опишрен пописен дефтер № 4*, 393-395).

e të krishterëve 180 familje, 16 beqarë dhe 43 të veja. Numri i përgjithshëm në të dyja lagjet, duke mos numëruar beqarët si kryefamiljarë, ishte 264 familje, respektivisht 264 shtëpi.²⁴

Konsiderohet se në shoqërinë osmane një familje numëronte prej 4 deri 8 anëtarë, ndërsa si mesatare merret familja me 5 anëtarë.²⁵ Në këtë kuadër, nëse në rastin e Tetovës merret një mesatare prej 5-6 anëtarësh, atëherë del se ky qytet numëronte rreth 1 300-1 600 banorë.

Hasin e subashit Sylejman Beu e përbënin qyteti i Tetovës dhe 7 fshatra.²⁶ Ziameti i Muhamet Beut numëronte 26 fshatra, por me gjasë dy nga ato Sellarca dhe Leshnica ishin pjesë fshatrash, meqë ato janë evidentuara edhe në dy timare përkatëse.²⁷ Ziameti i Mehmed Beut përbëhej prej 25 fshatrash, njëri nga të cilët me sa duket ishte pjesë fshati (Otushishti), meqë i njëjti ishte në zotërim edhe të një spahiu.²⁸ Në kuadër të një vakëfi bënte pjesë vetëm 1 fshat.²⁹ Njëri zotërim privat (*mylk*) përbëhej nga 2 fshatra të mëdha, ndërsa tjetri nga 3 fshatra, njëri nga të cilët me sa duket ishte pjesë fshati - Përsheci, meqë i njëjti ishte në zotërim edhe të një spahiu. Në kuadër të mylkut të fundit ishte edhe 1 mezër, por ajo ishte vënë në

²⁴ *Po aty*, 294-296.

²⁵ Ilber Ortayli, *Familja në shoqërinë osmane*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2014, 13.

²⁶ Fshatrat që përbënin hasin e subashit Sylejman Beut ishin: Leshka, Varvara, Sobri, Podbregu, Gostivari, Treboshi dhe Veshalla (*Ониуцен понуцен дефтер No 4*, 293-303).

²⁷ Fshatrat që përbënin ziametin e Muhamet Beut ishin: Barboshi, Pallatica, Sërmnova, Zhernovjani, Leshnica, Sallareva, Jedoarci, Novakovci, Bistrica, Morovishta (Pirgu - Piroku), Strimnica, Zhelina, Gajre, Turçani i Vogël, Zdunja, Zagradja, Bogovina, Banjica e Poshtme, Saraçina, Forina, Korita, Çajla, Rajanci, Sellarca, Jedoarci i Vogël dhe Pallçishti (*Po aty*, 303-318, 334, 389).

²⁸ Fshatrat që përbënin ziametin e Mehmed Beut ishin: Leshnica e Epërme, Kopanica, Rotinca, Raveni, Orçusha, Sushica, Siriçina, Tudenci, Vërbica e Vogël, Otushishti, Pallçishti i Epërm, Jellashniku, Nerashiti, Bellovishta, Starosello, Çegrani, Novosella (në veriperëndim të Gostivarit), Balindolli, Kunova, Novosella (në jugperëndim të Tetovës), Kalishti, Dvorci, Çerkovjani, Leunova, Nikiforova (*Po aty*, 318-332).

²⁹ Është fjala për vakëfin e Seçuk Beut që e zotëronte imami Hizër, në kuadër të të cilit bënte pjesë vetëm fshati Lypjan me 12 shtëpi (*Po aty*, 404).

zotërim të një *imareti* si vakëf.³⁰ Tri fshatra: Gradeci, Nikishnica dhe Kalugjeri, që administrativisht i takonin nahijes së Tetovës, në fakt zotëroheshin nga një timarli i vilajetit të Shkupit, dhe ishin të regjistruara në pjesën e regjistrimit për këtë vilajet.³¹ Pra, gjithsej ishin 63 fshatra dhe 4 pjesë fshatrash, ndërsa fshatrat dhe pjesët e fshatrave të tjera ishin të përfshira në kuadër të timareve të nahijes së Tetovës, të cilës i takonin edhe 2 kisha.

Meqë pjesët e fshatit përbënin një fshat të vetëm, ne konsiderojmë se duhet të trajtohet kjo çështje me qëllim që të konstatohet përafërsisht numri i fshatrave që ndodheshin në kuadër të nahijes së Tetovës. Rrjedhimisht, duke e trajtuar çështjen e përmendur është vërejtur një larmi mënyrash e regjistrimit të fshatrave. Kështu, në raste të caktuara përmenden pjesët përkatëse të fshatit³² dhe në raste të tjera i njëjti fshat, me numër shtëpish dhe të ardhurash të ndryshme, është regjistruar dy ose tri herë, që do të thotë se bëhet fjalë për dy, përkatësisht tri pjesët e tij.³³ Në një rast është regjistruar njëra pjesë e fshatit dhe mungon pjesa tjetër e tij.³⁴ Ka dhe një rast specifik, ku është regjistruar fshati (Reçica) dhe dy pjesët e tij, mirëpo në regjistër është evidentuar edhe një vojnuk në Reçicë të Vogël, në timarin e Sylejmanit. Kjo na çon të mendojmë se bëhet fjalë për dy fshatra, se Reçica përbënte një fshat (Reçica e Madhe?!) dhe dy pjesët e fshatit me të njëjtin emër po ashtu përbënin

³⁰ Në kuadër të mylkut të Mehmed Beut, i biri i Mehmed Pashës, bënin pjesë dy fshatra: Vrapçishti me 242 shtëpi (familje) dhe 17 beqarë dhe Tunçvishti me 145 shtëpi dhe 6 beqarë. Mylku i Mahmud Beut, i biri i Mehmed Pashës, përbëhej nga tri fshatra: Gallata me 55 shtëpi dhe 3 beqarë, Pozharani me 40 shtëpi dhe 2 beqarë, Përsheci me 45 shtëpi dhe 2 beqarë, si dhe nga mezra Luzhan, e cila ishte vënë në zotërim si vakëf. (*Po aty*, 407-409).

³¹ *Po aty*, 480-482.

³² Pjesë fshatrash të regjistruara veç e veç në zotërim të feudalëve të ndryshëm: Selca nga katër pjesë; Ponorishti nga dy pjesë (*Po aty*, 338, 342, 357-359, 403).

³³ Fshatrat e njëjta të regjistruara nga dy herë: Leshnica, Sellarca, Jelodoli - ndoshta Jellovjani (?!), Përsheci (është shënuar Prshovci dhe Proshevcii). Fshati Otushisht ishte i regjistruar tri herë (*Po aty*, 305, 316, 323, 334, 351, 368-369, 376, 389).

³⁴ Është fjala për njëren pjesë të fshatit Peshtericë (*Po aty*, 403). Kjo nënkupton se ky fshat duhet të ketë pasur edhe pjesën tjetër të tij, por nuk dihet se cili e zotëronte atë.

një fshat (Reçica e Vogël?!).³⁵ Sido që të merret ky rast, për të mos e mbingarkuar punimin, emrat e fshatrave të evidentuara në feudet përkatëse, por që janë të pranishëm edhe te feudet e zotëruesve të doganxhinjve dhe të voj nukëve, nuk do t'i paraqesim si pjesë fshatrash, meqë bëhet fjalë për fshatra në të cilët gravitonin ata (voj nukët dhe doganxhinjtë).

Nga sa më sipër (shih edhe shënimet 32-35) rezulton se në nahijen e Tetovës kishte 1 fshat të regjistruar në dy pjesë, 1 fshat në katër pjesë, 4 fshatra ishin të regjistruara nga dy herë, 1 fshat tri herë, në një rast ishte regjistruar vetëm njëra pjesë e fshatit, si dhe 1 fshat dhe dy pjesët e tjera të këtij fshati (që siç është thënë më lart mund të numërohet si dy fshatra). Pra, bëhet fjalë për 21 pjesë fshatrash (përfshirë këtu edhe ato 4 pjesë fshatrash të përmendura më lart), që në fakt përbënin 9 ose 10 fshatra. Rrjedhimisht, po t'u shtohet këtyre 9-10 fshatrave edhe fshatrat e përmendura më lart (gjithsej 63) dhe 72 të tjera që ishin të shpërndara nëpër timaret e tjera të nahijes së Tetovës, rezulton se në të kishte gjithsej 144-145 fshatra.

Nga ana tjetër, 135 ose 136 fshatrat dhe 21 pjesë të fshatrave, siç i kemi trajtuar më lart (gjithsej 156), kishin madhësi të ndryshme. Me rastin e kategorizimit të tyre ne do të përdorim emërtimin fshat, ndërsa në poshtë shënime do t'i shënojmë ashtu siç janë të regjistruara në regjistër. Veç kësaj duhet theksuar se me rastin e regjistrimit janë evidentuar kryefamiljarët, gratë që u kishin vdekur burrat (vejanet kryefamiljare) dhe beqarët. Në të vërtetë, kryefamiljarët dhe vejanet kryefamiljare përfaqësonin numrin e shtëpive në fshat, kriter që e kemi përdorur në të gjitha rastet kur japim numrin e shtëpive në fshatra. Konsiderohet se numri i beqarëve nuk duhet marrë parasysh, pasi ata njëherë ishin të përfshirë në kuadër të familjes. Megjithatë, është vështirë të thuhet se kjo qasje ndaj “beqarëve” është e qëlluar, kur përllogaritet numri i popullsisë.

³⁵ Reçica dhe dy pjesët e tjera të këtij fshati (*Po aty*, 365-366, 384). Është e sigurt se që në këtë kohë (1467-1468) ekzistonin Reçica e Madhe dhe Reçica e Vogël, meqë kjo e fundit ishte evidentuar si e tillë me një voj nuk në timarin e Sylejmanit, që kishte në zotërim edhe voj nukë të tjerë nga disa fshatra të nahijes së Tetovës (*Po aty*, 393). Pra fshatin e përmendur me dy pjesët e tij do ta numërojmë si dy fshatra (Reçica e Madhe dhe Reçica e Vogël).

Kjo për faktin se termi “*mucerred*”, përveç që ka kuptimin “beqar”, kishte edhe kuptimin “vetmitar” dhe “varfanjak”.³⁶ Sidoqoftë, duke numëruar kryefamiljarët dhe vejanet kryefamiljare, po japim numrin e fshatrave me numrin e shtëpive përkatëse. Kështu, njëzetedy (22) fshatra numëronin nga 1 deri 10 shtëpi;³⁷ tridhjetenëntë (39) nga 11 deri 20 shtëpi;³⁸ dyzetedy (42) nga 21 deri 40 shtëpi;³⁹ njëzetedy (22) nga 41 deri 60 shtëpi;⁴⁰ pesëmbëdhjetë (15) nga 61 deri 81 shtëpi,⁴¹

³⁶ Александар Стојановски - Драги Ѓоргиев, *Населби и население во Македонија – XV и XVI век*, Скопје, 2001, 6.

³⁷ Sërmnova (10), Bistrica (3), Rajanci (1), Jedoarci i Vogël (10), Tudenci (5), Novosella – në veriperëndim të Gostivarit (7), Novosella - në jugperëndim të Tetovës (10), Piskupia (4), Radusha (1), Brezna (9), Rasohaçi (10), Lashçe – Lahce (9), Pallçishti i Poshtëm (7), Jança (1), Petrushina (1), Tearca (4), Debreshi (4), Nikshenci (9), Koshenci (5), Tenova (2), Altomani (2), Peshtarica – njëra pjesë (5). Në këto fshatra ishin të regjistruar edhe 5 beqarë (*Опишурен пописен дефтер No 4*, në më shumë vende).

³⁸ Varvara (18), Sallareva (18), Novakovçi – Novaqe (11), Gajre (20), Zagradi (20), Saraqina (14), Çajla (13), Orçusha (14), Sushica (12), Siriçina (19), Vërbica e Vogël (11), Otushishti (12), Belovishti (19), Starosello (13), Çegrani (16), Kunova (12), Çerkojani (13), Nikiforova (19), Sanakosi (13), Selca – njëra pjesë (14), Selca – njëra pjesë (19), Trojani (13), Dërmniku (18), Liseci (18), Reçica – njëra pjesë (18), Reçica – njëra pjesë (17), Mavrova (20), Përsheci (19), Zaganoci (13), Setola (19), Stajkoci (11), Lomnica (18), Rakoeci (15), Leshnica (18), Gorjani (20), Zlokuqani (20), Selca – njëra pjesë (14), Lypjani (12), Nikishnica (15). Në këto fshatra ishin të regjistruar edhe 35 beqarë (*Po aty*, në më shumë vende).

³⁹ Treboshi (36), Barboshi (39), Pallatica (25), Zherovjani (33), Jedoarci (27), Strimnica (39), Turçani i Vogël (35), Zdunja (21), Banjica e Poshtme (36), Korita (37), Kopanica (30), Rotinca (25), Raveni (34), Jeloshniku (32), Nerashti 31, Balindolli (26), Kalishti (26), Dvorci (24), Sellarca (26), Peçkova (35), Kërpanja (25), Selca – njëra pjesë (25), Bllaca (26), Smërdeshnica (36) Liseci (?) i Poshtëm (39), Koshenci i Epërm, Falishti (32), Hvalishti i Epërm (29), Otushishti (40), Jançishti (39), Botoçani (40), Otunja (22), Jelodoli - ndoshta Jellovjani?! (32), Uzurmishti (23), Jazhinca (26), Çiprijani (21), Toplica (34), Zhilca (24), Radioci (23), Stençe (28), Pozharani (40), Kalugjeri (27). Në këto fshatra ishin të regjistruar edhe 64 beqarë (*Po aty*, në më shumë vende).

⁴⁰ Gostivari (51), Leshnica (53), Bogovina (43), Forina (42), Sellarca (41), Pallçishti (58), Pallçishti i Epërm (59), Meli (50), Vërtoku (46), Vëllkovia (45), Teova (52), Jelodoli - ndoshta Jellovjani?! (55), Ponorishti - njëra pjesë (53), Ponorishti - njëra pjesë (59), Siniçani (52), Otushishti (54), Banjica e Epërme (44), Vërbica (42), Shemshova (52), Kamjani (60), Gallata (55), Përsheci (45). Në këto

pesë (5) nga 81 deri në afro 100 shtëpi,⁴² shtatë (7) nga 101 deri në afro 150 shtëpi.⁴³ Fshatrat më të mëdha ishin katër: Miletina (151 shtëpi dhe 7 beqarë), Dobroshti (181 shtëpi dhe 10 beqarë), Leshka (222 shtëpi dhe 11 beqarë) dhe Vrapçishti (242 shtëpi dhe 17 beqarë).⁴⁴

Po të merret mesatarja prej 5-6 anëtarë për familje, atëherë del se fshatrat me 1-20 shtëpi numëronin nga 5-6 deri më 100-120 banorë; fshatrat me 21-40 shtëpi numëronin mbi 100-120 deri më 200-240 banorë; fshatrat me 41-60 shtëpi numëronin mbi 200-240 deri më 300-360 banorë dhe fshatrat me 61-80 shtëpi numëronin mbi 300-360 deri në rreth 400-480 banorë, fshatrat me 81-100 shtëpi numëronin nga mbi 400-500 deri në rreth 600 banorë, fshatrat me 101-150 shtëpi numëronin nga mbi 500-600 deri më 750-900 banorë. Fshatrat më të mëdha të përmendura më lart, numëronin nga mbi 750-900 deri më 1200-1450.

Është me rëndësi të theksohet se me rastin e mbledhjes së numrit të kryefamiljarëve, vejaneve dhe beqarëve për më shumë fshatra që bënin pjesë në kuadër të një timari ose hasi në ndonjë rast ka mospërputhje të shumës së përlllogaritur nga shumat respektive të fshatrave veç e veç. Për të evituar këtë lëshim që është bërë gjatë regjistrimit, ne do t'ju referohemi shumave për çdo fshat veç e veç. Mbi këtë bazë rezulton se në hasin e subashit Sylejman Beut kishte 797 shtëpi, në ziametin e Muhamet Beut 774 shtëpi, në ziametin e Mehmed beut 629 shtëpi dhe në timaret dhe mylqet e tjera kishte diç më shumë se 4 390 shtëpi. Pra, gjithsej kishte mbi 6 590 shtëpi. Nëse

fshatra ishin të regjistruar edhe 56 beqarë (*Po aty*, në më shumë vende).

⁴¹ Sobri, (70), Podbregu (66), Veshalla (70), Pîrgu - Piroku (63), Vratnica (70), Zhelina (62), Leshnica e Epërme (75), Gjergjevishti (63), Xhepçishti (66), Sllatina (68), Dobërdolli (75), Vica (75), Rogaçeva (63), Odri (79), Prelubishti (66). Në këto fshatra ishin të regjistruar edhe 47 beqarë (*Po aty*, në më shumë vende).

⁴² Reçani (83), Turçani i Epërm (85), Leunova (86), Dobrogoshi (96), Negotina (97). Në këto fshatra ishin të regjistruar edhe 18 beqarë (*Po aty*, 331, 335-336, 354-355, 362-363, 370-371).

⁴³ Çellopeku (130), Poroj (117), Reçica (123), Bërvenica (103), Urviçi (109), Tumçevishti (145), Gradeci (108). Në këto fshatra ishin të regjistruar edhe 40 beqarë (*Po aty*, 332-333, 353-354, 384-385, 387-388, 399-400, 406-407, 480-481).

⁴⁴ *Po aty*, 296-298, 356-367, 363-365, 404-407.

ky numër shumëzohet me 5-6 anëtarë për familje rezulton se numri i banorëve arrinte nga rreth 33 000 deri në afro 40 000 banorë. Këtij numri mund t'i shtohen edhe rreth 325 beqarë.

Në pjesën më të madhe të rasteve fshatrat e nahijes së Tetovës janë identifikuar dhe ekzistojnë edhe sot, pavarësisht se ndonjëri mund të ketë ndryshuar edhe emrin e tij. Megjithatë, një numër i caktuar i fshatrave nuk janë ubifikuar ose janë zhdukur gjatë shekujve.⁴⁵

Sundimi osman u përcoll edhe me procesin e islamizimit. Ai qe diç më i fuqishëm në qytetin e Tetovës, ku njëra lagje ishte e banuar me myslimanë (41 shtëpi) dhe tjetra me të krishterë (223 shtëpi). Gjatë kësaj kohe (1467-1468), tre kryefamiljarë ishin të posaislamizuar. Në dy raste prindërit e tyre mbanin emra të krishterë (Hamza, i biri i Melkut; Hamza, i biri i Donçit). Në rastin e tretë, prindi i kryefamiljarit mbante emrin “Abdullah” (Ismaili, i biri i Abdullahut)⁴⁶ që do të thotë “rob i zotit”⁴⁷ dhe zakonisht konsiderohej personi i posaislamizuar.⁴⁸ Nga ana tjetër, nëse përllongarit numri i banorëve, sipas kriterit të përmendur më lart, rezulton se nga rreth 1 300-1 600 banorë, sa kishte ky qytet, rreth 200-250 (15%) ishin myslimanë, kurse rreth 1 100-1 350 (85%) të krishterë. Për dallim nga Tetova, në fshatrat e nahijes së Tetovës islamizimi thuajse ende nuk kishte filluar. Në 4 fshatra numëroheshin

⁴⁵ Fshatra të paubifikuara ose të zhdukura: Sobri, Zlokuqani, Peshterica, Meli, Smërdeshnica, Dërmniku, Hvalishti i Epërm, Botoçani, Jedoarci i Vogël, Lypjani, Zaganoci, Petrushina, Nikishnica, Kallugjeri, Barboshi, Bistrica, Rajanci, Dobrogoshi (Dobrogoshti), Ponorishti, Rasohaçi, Çiprijani, Piskupia, Koshenci i Epërm, Vërbica, Vërbica e Vogël, Çerkovjani, Jança, Nikshenci, Altomani (*Po aty*, shih poshtëshënimet përkatëse në më shumë vende).

⁴⁶ *Po aty*, 293-296.

⁴⁷ Методија Соколовиќ, *Исламизација у Македонији у XV и XVI веку*, in: “Историјски часопис”, XXII, Београд, 1975, 75-76; Muhamet Tërnavë, *Përhapja e islamizimit në territorin e sotëm të Kosovës deri në fund të shekullit të XVII*, in: *Gjurmime albanologjike*, seria e shkencave historike, IX-1979, Prishtinë, 1980, 49.

⁴⁸ Александар Стојановски, *Градовите на Македонија од крајот на XIV до XVII век*, Скопје, 1981, 86.

vetëm 11 kryefamiljarë myslimanë, nga të cilët dy kryefamiljarë ishin vojnukë.⁴⁹

Përkundër faktit se shumica absolute e popullsisë ishte e krishterë, nga radhët e saj kishte vetëm një spahi. Është fjala për Manolin që kishte në zotërim një timar prej dy fshatrash.⁵⁰ Tre zotërues timarësh ishin të krishterë të posaislamizuar. Për njërin, i cili quhej Mehmed, thuhet se ishte “mysliman i ri”. Spahiu i dytë quhej Mustafa, i biri i Filipit, ndërsa i treti Sylejman, i biri i Abdullahut.⁵¹ Këta shembuj tregojnë se shumica absolute e bujarëve të vegjël vendas ishin privuar nga e drejta e zotërimit të timareve ose ishin konvertuar në fenë islame, ose të paktën ishin konvertuar fëmijët e tyre.

Një problem më vete paraqet çështja e përkatësisë etnike e banorëve të nahijes së Tetovës, meqë në regjistër janë evidentuar vetëm emrat e kryefamiljarëve. Pra, në bazë të këtyre emrave dhe të emrave të prindërve të tyre (patronimeve), mund të bëhet përpjekje që të nxirret në pah karakteri etnik i popullsisë që banonte aty. Megjithatë, kjo çështje është mjaft komplekse, për shkak të rrethanave nëpër të cilat kishin kaluar arbitrit gjatë mesjetës. Në të vërtetë, arbitrit, gjatë periudhës para osmane, duke qenë në kuadër të shtetit bizantin dhe në etapa të caktuara nën sundim bullgar dhe atë serb, (por edhe nën ndikimin që vinte nga Papatia, sidomos viset veriperëndimore - Q. D.), në regjistrat osmanë të shek. XV-XVI, janë regjistruar me emra karakteristikë arbërorë, si dhe me emra të krishterë të sferës latino-romane dhe greko-bizantine dhe nje shquese të shqipës, që dallojnë nga emrat me forma sllave. Veç kësaj, duke filluar nga shek. XIII, arbitrit e besimit ortodoks qenë pagëzuar me emra tipikë sllavë dhe të krishterë të sferës greko-bizantine, ashtu sikurse serbët, bullgarët, vllehtë dhe minoritete të tjera. Për këtë arsye, për arbitrit e ritit ortodoks është e pamundur të

⁴⁹ Në Vëllkovi kishte 6 kryefamiljarë myslimanë, në Dërmnik 3, dhe nga një kryefamiljar (vojnuk) të besimit mysliman ishin regjistruar në Bërvenicë dhe në Novosellë (*Описане пописен дефтер Nq 4*, 293-296).

⁵⁰ Timari i Manolit përbëhej nga fshatrat Poroj dhe Dobrogosh (*Po aty*, 353-355).

⁵¹ *Po aty*, 353-355.

nxiirret përkatësia e saktë etnike, ashtu siç nuk mund të përcaktohet përkatësia etnike e shqiptarëve myslimanë në shekujt e mëvonshëm, meqë si pjesëtarë të besimit islam mbanin emra orientalë-islamë. Dhe një aspekt tjetër për arbrit ortodoksë është fakti se kisha sllave, edhe pas vendosjes së administratës osmane, e vazhdoi veprimtarinë e saj fetare, duke i pagëzuar fëmijët e tyre me emra tipikë sllavë dhe të krishterë me forma sllave, deri në gjysmën e parë të shek. XVII, kur filloi të dobësohet veprimtaria e saj.⁵²

Një çështje tjetër mbi të cilën duhet vënë theksin është edhe ajo e deshifrimi dhe e transkriptimeve nga studiuesit sllavë, të cilët kanë botuar regjistra osmanë, duke i përthyer në gjuhët sllave përkatëse, midis të cilëve është edhe ai që i referohemi ne, i përkthyer në maqedonisht. Paleografët respektivë, gjatë deshifrimit të regjistrave, siç ka konstatuar studiuesi Iljaz Rexha, emrat e të krishterëve, por edhe ata sllavë, që i mbanin edhe kryefamiljarët arbërorë dhe prindërit e tyre, që ishin të regjistruar me nyjat shquese të shqipes **i** dhe **a**, si p.sh. *Aleksi, Petri e Petr, Pavli, Tusha* etj., i kanë transkriptuar dhe përshtatur me forma popullore sllave, si: *Aleksa, Petre, Pavle, Tasha* etj. Po ashtu edhe emrat tipikë sllavë, me forma të shqipes, si: *Bojki, Gjurki, Raki, Stajki, Vladi* etj., i kanë transkriptuar dhe përshtatur në frymën e gjuhës sllave, si: *Bojko, Gjurko, Rajko, Stajko, Vladko* etj. Gjithashtu, mund të përmenden edhe disa shembuj ku antroponimet dhe patronimet arbërore nuk janë deshifruar në mënyrë të saktë nga studiuesit e përmendur: *Tominko* si *Pomenko*, *Jano* si *Janko*, *Lazor* si *Lazar*, *Pulo* si *Bojo*, *Rad e Radi* si *Rade* etj. Nga këta shembuj mund të shihet se të krishterët, të regjistruar me forma të shqipes, janë përshtatur në transkriptim me forma sllave, ashtu siç janë përshtatur edhe një sërë antroponimesh dhe patronimesh karakteristike arbërore.⁵³ Kështu, është zvogëluar dukshëm fondi i emrave të krishterë dhe sllavë, nga aspekti etnik, që i kanë mbajtur arbrit ortodoksë, si dhe emrat karakteristikë të tyre, në nahijen e Tetovës.

⁵² Iljaz Rexha, *Vendbanimet dhe popullsia albane e Kosovës (sipas defterëve osmanë të shekullit XV)*, Prishtinë, 2016, 36-37.

⁵³ *Po aty*, 39-40, 65, 68.

Në funksion të objektivitetit, në regjistrin të cilit i referohemi ne, bënë përjashtim emri *Dimitri*,⁵⁴ i cili është transkriptuar në këtë formë, pra me një shquese të shqipes. Po ashtu, krahas emrit Lazar, në disa raste haset e transkriptuar edhe forma tjetër e këtij emri - *Lazor*; si dhe krahas emrit Janko, hasen të transkriptuara edhe format tjera të këtij emri, si *Jane*, *Janosh* dhe *Jançe*.⁵⁵

Në kuadër të problematikës në shqyrtim duhet përmendur edhe faktin se emrat duhet marrë me rezervë, për shkak se midis etnive të ndryshme të Ballkanit ekzistonin ndikime të ndërsjella, ashtu që emra të njëjtë hasen si te etniteti arbëror, ashtu dhe te etnitetet e tjera. Për këtë arsye, asnjëherë nuk mundet që me saktësi të plotë, në bazë të emrit personal të individit përkatës, të përcaktohet edhe përkatësia e tij etnike. Kjo vlen sidomos për emrat e krishterë që ishin të përhapur te të gjithë etnitë e Ballkanit.⁵⁶ Një shembull tipik mund të merret nga regjistri përkatës për nahijen e Tetovës, ku emri Dimitri shoqërohet me apelativet përkatëse etnike: *Dimitri Arbanas*, *Dimitri Serbi*, *Dimitr-i*, i biri i *Vllah*-ut etj.⁵⁷

Në rrethana të këtilla mjaft komplekse, është e arsyeshme t'i referohemi ballkanologut Konstantin Jireček, i cili, duke analizuar emrat në *krisobulën* e Stefan Deçanit (1330) dhe në *regjistrin kadastral venedikas* të Shkodrës (1416), thekson se nga emrat personalë të arbërve mesjetarë mund të shihet se bëhet fjalë për popullsi të vjetër të krishterë, me kulturë qytetare, që ishte më afër grekëve bizantinas dhe romanëve dalmatin, sesa të sllavëve. Sipas tij, emrat më të shpeshtë arbërorë ishin: *Alexa* (arbërisht *Lesh*), *Andreas*, *Bencho* (*Benedictus*), *Costantinus*, *Dminko* (*Dominicus*), *Dmitr* (*Demetrius*), *Giergi*, *Gin* ose *Ghin*, *Gon* ose *Jon* (poashtu *Jovan*), *Lazar*, *Leo*, *Marin*, *Marko*, *Mauricius* (*Morichi*), *Mihael*, *Peter*, *Paul*, *Pelegrin*, *Sergius*, *Stephan*, *Zacharias* dhe ngjashëm. Ndërsa

⁵⁴ *Опишурен пописен дефтер Nq 4*, në më shumë vende.

⁵⁵ *Po aty*, në më shumë vende.

⁵⁶ Krh.: Драги Ѓорѓиев, *Населението во македонско-албанскиот граничен појас (XV-XVI век)*, Скопје, 2009, 88.

⁵⁷ *Опишурен пописен дефтер Nq 4*, 306, 399, 404.

nga emrat sllav përmend: *Dabizhiv, Radomir, Radogost, Bogdan, Vojin, Vlad, Golem*.⁵⁸

Në nahijen e Tetovës, krahas antroponimeve dhe patronimeve sllave, si: *Bogdan, Bogosllav, Bozhidar, Bozhiq, Branisllav, Cvetko, Dabizhiv, Dobre, Dobrosllav, Dobrosllava, Dragan, Dragosllav, Miladin, Milica, Mirosllav, Petko, Radosllav, Radosllava, Stojko, Vlad-o, Vladisllav* etj., hasen edhe antroponime dhe patronime vllahe, si: *Dançul, Shishman, Vllah, Vllash, Vllajko, Vllajço* etj. Se në çfarë mase ishin të përhapur emrat (antroponimet dhe patronimet) që kryesisht i mbanin arbit, jemi përpjekur që këtë ta argumentojmë përmes numrit të vendbanimeve në të cilat ishin të regjistruar emrat përkatës, shifra të cilat do të jepen në poshtëshënime. Me këtë rast, mund edhe të na jetë përvjedhur ndonjë lëshim, prandaj çdo vërejtje dhe plotësim nga opinioni shkencor, do të ishin të mirëseardhura dhe do të kontribuonin në ndriçimin sa më objektiv të kësaj çështjeje. Po ashtu e shohim të arsyeshme të vëmë në pah se në kuadër të numrit të vendbanimeve (përfshirë këtu edhe pjesët e tyre veç e veç), ku ishin të shpërndarë emrat përkatës do të bëjë pjesë edhe qyteti i Tetovës. Rrjedhimisht, në nahijen e Tetovës, hasen edhe disa nga emrat e përmendur më lart nga Jireçeku që i mbanin kryefamiljarët arbërorë dhe prindërit e tyre (antroponimet dhe patronimet). Kështu, në numër të madh ishin emrat *Dmitr* (në formën *Dimitri*), *Jovan, Stephan* (kryesisht në formën *Stepan* dhe rrallë në formën *Stefan*), *Peter* (në formën *Petre*), *Jon* (në format *Jon, Jonç-o/e* e *Jonko*);⁵⁹ në numër të konsiderueshëm: *Gin (Gjin)* në format *Gin, Gen-e/o* e *Genç-e, Gon (Gjon), Lazar, Marko*⁶⁰, në numër më të vogël: *Mihael* (në format *Mihail* dhe *Mihal*), *Costantinus* (në format *Kostantin* dhe *Kostadin*),

⁵⁸ *Зборник Константина Јиречека*, II, уредник Георгије Острогорски, Београд, 1962, 50.

⁵⁹ Emri *Dimitri* ishte i pranishëm në më shumë se 110 vendbanime, emri *Jovan* në më shumë se 100 vendbanime, emri *Stephan* në rreth 90 vendbanime, emri *Petri* në afro 70 vendbanime dhe emri *Jon* në rreth 50 vendbanime (*Опширен пописен дефтер* Nq 4, në më shumë vende).

⁶⁰ Emri *Gin* ishte i përhapur në rreth 25 vendbanime, ndërsa emri *Lazar* në më shumë se 20 vendbanime të ndryshme, emrat *Gon* dhe *Marko* në rreth 35 vendbanime të ndryshme (*Po aty*, në më shumë vende).

Andreas (në formën *Andreja*), *Giergi* (*Gjergj*) në formën *Gerg*⁶¹ dhe në numër simbolik: *Aleksa*, *Lesh* (në formën *Lesh-ko*).⁶² Nga ana tjetër, në numër më të madh ishte i përhapur emri *Nikolla*⁶³ që, sipas studiuesit Muhamet Tërnavë, “përdorej padyshim nga banorët arbërorë”.⁶⁴ Emër i përhapur në mesin e arbërve ishte *Pulo*, por që në regjistër është transkriptuar në formën sllave *Bojo*.⁶⁵ Në një numër të kufizuar vendbanimesh ishte i pranishëm emri karakteristik i formës shqipes *Proj*, që në regjistër haset në format *Projo* dhe *Projçe*.⁶⁶ Në një numër të kufizuar vendbanimesh haset edhe forma tjetër e këtij emri, me formatin sllav *ko*, *Projko*.⁶⁷ Emri *Burrnik* që në regjistër është transkriptuar në formën *Tornik* po ashtu haset në numër të kufizuar vendbanimesh.⁶⁸ Midis rasteve të tjera, mund të veçohet emri sllav, me forma të shqipes, *Bojki*, por që është transkriptuar në formën sllave *Bojko*, ndërsa ishte i përhapur në shumë vendbanime.⁶⁹ Në mesin e shumë emrave të tjerë të krishterë ose sllavë që i mbanin arbrit e kësaj nahijeje, duhet theksuar se një kategori tjetër emrash hasen me mbasesat e gjuhës shqipe: **a, an, ash, esh, osh, ush**,⁷⁰ si

⁶¹ Emrat e përmendur në tekst ishin të pranishëm në rreth 10-20 vendbanime të ndryshme (*Po aty*, në më shumë vende).

⁶² Emrat e përmendur në tekst ishin të pranishëm nga rreth 2 deri në rreth 5 vendbanime të ndryshme (*Po aty*, në më shumë vende).

⁶³ Emri *Nikolla* ishte i pranishëm në më shumë se 125 vendbanime (*Po aty*, në më shumë vende).

⁶⁴ Muhamet Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, 120-121.

⁶⁵ Emri *Bojo* ishte i pranishëm në mbi 40 vendbanime (*Опишрен пописен дефтер N₀ 4*, në më shumë vende). Krh.: Iljaz Rexha, v. c., 68.

⁶⁶ Emri *Proj*, në format *Projo* dhe *Projçe*, ishte i pranishëm në rreth 7 vendbanime (*Опишрен пописен дефтер N₀ 4*, në më shumë vende). Atë e trajton si emër vetjak arbëror: Qemal Murati, *Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në Maqedoni*, Tiranë, 1993, 86.

⁶⁷ Emri *Projko* ishte i pranishëm në më pak se 10 vendbanime (*Опишрен пописен дефтер N₀ 4*, në më shumë vende). Krh.: Iljaz Rexha, v. c., 39.

⁶⁸ Emri *Tornik* ishte i pranishëm në afro 10 vendbanime (*Опишрен пописен дефтер N₀ 4*, në më shumë vende). Krh.: Iljaz Rexha, v. c., 68.

⁶⁹ Emri *Bojko* ishte i pranishëm në rreth 60 vendbanime (*Опишрен пописен дефтер N₀ 4*, në më shumë vende). Krh.: Iljaz Rexha, v. c., 39.

⁷⁰ Krh.: Iljaz Rexha, v. c., 14, 109-110.

p.sh.: *Bogoja, Bratan, Petrash, Malesh, Radosh, Bogush, Petrush etj.*⁷¹

Krahas rasteve të sipërpërmendura, në nahijen e Tetovës hasen edhe emra tipikë ose që mund të cilësohen si arbërorë. Midis tyre, më të përhapur ishin *Koja* (në format *Koj-o, Koj-ço* dhe *Koj-çin*) dhe *Melo* (në format *Melo* dhe *Melko*) që ishin të pranishëm në një numër të madh vendbanimesh.⁷² Ndërsa, emrat *Nika* (në në formën *Nik-o* dhe *Nik-sha*), *Dushman, Dika* (në formën *Dik-o*) *Martin* hasen në një numër më të vogël vendbanimesh.⁷³ Në raste të rralla, nga 1-2 deri në më pak se 10 vendbanime të ndryshme, hasen këta emra karakteristikë që i mbanin arbit, si: *Leka, Kola, Progoni, Tanushi, Zguri, Bali,*⁷⁴ *Shoku, Lale, Lalush,*⁷⁵ *Daci, Gega, Dashi, Dukagjini, Dola, Tole*⁷⁶ dhe shumë emra të tjerë.

Në raste të caktuara janë evidentuar apelativet në vend të mbiemrit, si: *Arbanas* dhe *Arnaut/d* (*Lazar Arbanas, Gjuro Arbanas, Dimitri Arbanas, Nenaç Arbanash, Gon Arbanas, Dano Arbanas,*

⁷¹ *Опишурен пописен дефтер Nq 4*, në më shumë vende.

⁷² Emrat e përmendur në tekst ishin të pranishëm në rreth 50 vendbanime të ndryshme (*Опишурен пописен дефтер Nq 4*, në më shumë vende). *Koja* radhitet në mesin e emrave arbërorë (Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë, 1983, 59), ashtu sikurse emri *Melo* (Qemal Murati, *Dëshmime onomastike...*, 105).

⁷³ *Nika* në mbi 20 vendbanime, *Dushman-i* në mbi 15 vendbanime, *Dika* në rreth 15 vendbanime dhe *Martin-i* në mbi 10 vendbanime (*Опишурен пописен дефтер Nq 4*, në më shumë vende). Këta emra radhiten në mesin e emrave arbërorë me sa vijon: *Nika* (Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës ...*, 25, 59), *Dushman-i* (Adem Handžić, *Nekoliko vjesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV veka*, in: "Simpozium për Skënderbeun - Simpozijum o Skenderbegu", 9-12 maj 1968, Prishtinë - Prishtina, 1969, 201-209), *Dika* (Qemal Murati, *Dëshmime onomastike...*, 70), si dhe *Martin-i* (Ramiz Abdyli, *Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve të shek. XV-XVI*, Shkup, 1994, 134).

⁷⁴ *Опишурен пописен дефтер Nq 4*, 301-302, 310, 316, 321, 324, 329, 350, 354, 362, 372, 375-376, 405-406, 408. Krh.: Qemal Murati, *Dëshmime onomastike ...*, në më shumë vende.

⁷⁵ *Опишурен пописен дефтер Nq 4*, 303, 353, 364, 383. Krh.: Iljaz Rexha, v. c., 62, 65, 68.

⁷⁶ *Опишурен пописен дефтер Nq 4*, 294, 307, 315, 338, 363-364.

Martin Arbanas, Pejo Arbanas, Gon Arnaud, Dola Arnaud, Nikolla Arnaud, Nikolla Arnaud, Pavle Arnaud, Gjijn Arnaud).⁷⁷

Emrat karakteristikë të arbërve paraqiten në simbiozë me emra të krishterë (*Nikolla*, i biri i *Koj-ës*; *Dimitri*, i biri i *Nik-ës*; *Jovan-i*, i biri i *Leshk-ut*; *Gin-i*, i biri i *Pavli-t*; *Nikolla*, i biri i *Gon-it*; *Gon-i*, i biri i *Andrea-s*; *Stepan*, i biri *Dik-ës*; *Nikolla*, i biri i *Progon-it*, *Nikolla*, i biri i *Gin-it*; *Dimitri Dushman*, *Nikolla*, i biri i *Arbanas-it*; *Nik-a*, i biri i *Dimitri-t*; *Jovan-i*, i biri *Gin-it*; *Nikolla Arnaud-i*; *Jovan-i*, i biri i *Gerg-it*; *Luka*, i biri i *Gon-it* etj.); me emra sllavë (*Dushan-i*, i biri i *Leshk-ut*; *Bozhidar-i*, i biri i *Proj-it*; *Gin-i*, i biri i *Radosllav-it*; *Nik-a*, i biri i *Radosllav-it*; *Dobrosllav-i*, i biri i *Dik-ës*; *Dabizhiv-*, i biri i *Progon-it*; *Miladin-i*, i biri i *Progon-it*; *Cvetko*, i biri i *Kol-ës*; *Vlatko*, i biri i *Gin-it*; *Koj-a*, i biri i *Novak-ut*; *Gon-i*, i biri i *Vlatko-s*; *Bogdan-i*, i biri i *Dushman-it*; *Dushman-*, i biri i *Radosllav-it*; *Radosllav-i*, i biri i *Gon-it*; *Dragosllav Gerg-i*; *Radosllavi-i*, i biri *Lek-ës*; *Novak-u*, i biri i *Lek-ës*; *Stojko Gon-i*; *Nik-a*, i biri i *Milan-it*; *Bogdan-i*, i biri i *Progon-it*; *Gon-i*, i biri i *Bozhin-it*; *Vladisllav Dik-a*; etj.), si dhe me emra vllleh (*Nik-a*, i biri i *Vllajç-it*; *Dushman-i*, i biri i *Dançul-it*; *Dançul-i*, i biri i *Dac-it*; *Vllajk-u*, i biri i *Koj-ës* etj). Nga ana tjetër, nuk mungonin rastet kur antroponimi dhe patronimi ishin që të dy tipikë arbërore (*Lik-a*, i biri i *Gin-it*; *Dushman-*, i biri i *Dik-ës*; *Kol-a*, i biri i *Arbans-it*; *Gin-i*, i biri i *Gon-it*; *Lek-a*, i biri i *Gerg-it* etj).⁷⁸

Në mesin e spahinjve të vjetër (zotërues të bashtinave), siç janë përmendur më lart, ishin të pranishëm antroponime dhe patronime karakteristike që i mbanin në veçanti arbit, si: *Koja*, *Pavli*, *Dimitri*, *Dushmani*, *Nikolla*, *Kostantini*.⁷⁹

Po ashtu, është karakteristikë se emri *Muhamed*, që e mbanin një zaim dhe një spahi, ky i dyti ishte evidentuar me një shquese i të shqipes - *Muhamedi*. Emri *Mehmed*, që e mbanin një zaim dhe gjashtë spahinj, njëri nga këta të fundit ishte evidentuar *Mehmedi*.⁸⁰

⁷⁷ *Po aty*, 294-297, 305-306, 308, 313, 331-333, 336, 358, 362-363, 375, 401, 480.

⁷⁸ *Po aty*, në më shumë vende.

⁷⁹ *Po aty*, 395.

⁸⁰ *Po aty*, 303, 340, 344, 355, 360, 367, 382, 404, .

Ngjashëm ishte situata edhe në mesin e banorëve të paktë myslimanë. Kështu, përderisa në Tetovë ishte i regjistruar emri *Mehmed*, në një fshat të nahijes së Tetovë ishte i evidentuar *Mehmedi*.⁸¹

Autoktonia dhe prania e arbërve në nahijen e Tetovës, mund të mbështetet, aq sa është e mundur, edhe në prova nga fusha e toponimeve. Pavarësisht, se treva e Tetovës disa shekuj gjatë mesjetës i ishte ekspozuar sllavizmit të toponimeve në kohën e sundimit bullgar dhe serb, një numër i caktuar prej tyre megjithatë kishte arritur të mbijetonte, duke ruajtur etimologjinë arbërore. Rrjedhimisht, një numër i caktuar toponimesh që janë evidentuar në regjistrin e viteve 1467-1468, janë me etimologji shqiptare. Radhisim këtu vendbanimet: *Gajre*, *Përshec*, *Poroj*,⁸² *Balindoll*, *Bllacë*, *Bozovcë*, *Çajla*, *Xhepçisht*, *Leshkë*, *Leshnicë*, *Lomnicë*, *Mel*, *Nikshnicë*, *Trebosh*, *Veshallë*, *Vrapçisht* etj.⁸³

Mbi bazën e toponimeve shqiptare dhe në veçanti të emrave që në përgjithësi i mbanin arbrit, siç janë trajtuar më lart, del se ata ishin të pranishëm në shumicën e vendbanimeve të nahijes së Tetovës. Njëherësh në vendbanime të kësaj nahijeje ishin të pranishëm edhe sllavët dhe vllehtë, por arbrit me siguri përbënin shumicën e popullsisë. Megjithatë, përqindja e tyre është e pamundur të caktohet. Kjo për shkakun se madje në vendbanime të caktuara hasen emra tipikë për të dy, përkatësisht për të tri etnitë. Në këtë kuadër po radhisim vetëm disa shembuj për emrat më tipikë të këtyre etnive: kështu p.sh. në lagjen e krishterë të Tetovës, midis kryefamiljarëve, ishin të regjistruar edhe *Gon Arnaud*-i dhe *Radoja Serb*-i, në Pirok: *Nenaç Arbanash*-i dhe *Gjuro Serb*-i; në Zhelinë: *Nikolla*, i biri i *Progon*-it, *Rdosllav Serb*-i, *Bojo*, i biri i *Dançul*-it; në Leunovë: *Nikolla Arnaud*-i dhe *Pejo Serb*-i; në Çellopek: *Martin Arbanas*-i dhe *Dançul*-i, biri i *Todor*-it; në Poroj: *Kol*-a, i biri i *Arbananas*-it dhe *Bogdan Serb*-i; në Tumçevisht: *Pejo*, i biri i *Arbanas*-it dhe *Nikolla Serb*-i; në Gradec: *Gjin Arnaud*-i dhe *Vllajçe*

⁸¹ *Po aty*, 294, 345.

⁸² Iljaz Rexha, v. c., 60, 65.

⁸³ Qemal Murati, *Dëshmime onomastike ...*, 10-11, 13-14, 17-18, 20-21, 25-26.

Trajana, si dhe raste të tjera. Dukuria e pranisë së emrave të tjerë karakteristikë të etnive të përmendura karakterizon edhe shumë vendbanime të tjera të nahijes së Tetovës.⁸⁴

Përfundimi

Nahija e Tetovës bënte pjesë në kuadër të pashasanxhakut të Shkupit, kurse në krye të saj qëndronte subashi, i cili kishte në zotërim hasin përkatës. Qendër administrative ishte qyteti i Tetovës. Sistemi timar përbënte bazën e sistemit ushtarak të spahinjve, të cilët, varësisht nga të ardhurat që realizonin nga timaret, shlyenin obligimet ndaj shtetit. Doganxhinjtë kujdeseshin për rritjen dhe stërvitjen e fajkonëve, kurse derbenxhinjtë i siguronin rrugët që kalonin nëpër gryka malore, pranë të cilave ndodheshin fshatrat e tyre. Shumica dërrmuese e banorëve i përkisnin fesë së krishterë dhe vetëm një pakicë e vogël fesë myslimane.

Megjithatë, pjesa më e madhe e timarlinjve ishin myslimanë, ndërsa veç një ishte i krishterë dhe disa spahinj të vjetër kishin në zotërim vetëm bashtinat e tyre. Kryefamiljarët ishin të regjistruar sipas përkatësisë fetare, prandaj duke analizuar përhapjen e emrave midis popullsisë, rezultoi se arbit mbanin emra të sferës latino-romane dhe emra të sferës greko-bizantine dhe sllave. Kryefamiljarët dhe prindërit e tyre arbërorë, mbanin edhe emra karakteristikë dhe tipikë të sferës shqiptare, si dhe emra të krishterë dhe sllavë me nyja të gjuhës shqipe **i** dhe **a**, apo me mbaresat e gjuhës shqipe: **an**, **ash**, **esh**, **osh**, **ush**. Këta shembuj dhe prania e një numri të caktuar toponimesh arbërore, provojnë autoktoninë dhe praninë shumicë të arbërve në nahijen e Tetovës.

⁸⁴ *Опшурен пописен дефтер* № 4, 294-295, 308, 331, 332-333, 309, 353-354, 406, 407.

Bedri MUHADRI
(Prishtinë)

**BETEJA E DYTË E KOSOVËS, MË 1448, SIPAS AUTORËVE
SHQIPTARË TË KOHËS: MARIN BARLETI, DHIMITËR
FRANGU**

Ndër ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare të shekullit XV, padyshim, radhitet edhe Beteja e Dytë e Kosovës (1448). Kjo Betejë është zhvilluar ndërmjet dy fuqive (perandorive) më të mëdha të asaj kohe, Perandorisë Osmane dhe Mbretërisë Polake-Hungareze. Kjo ngjarje, historike tërhoqi vëmendjen e shumë kronistëve, historianëve dhe njëherësh la gjurmë në shumë dokumente të kohës. Rëndësia e kësaj lufte për historinë e popullit shqiptar është se u zhvillua në qendrën e Dardanisë, në Kosovë, dhe se përmes kësaj ngjarje ndërkombëtare mund të kuptohet qartë roli që kishin shqiptarët në atë kohë, me në krye Skënderbeun, në Evropë.

Skënderbeu, udhëheqësi i shtetit shqiptar dhe Janosh Huniadi, udhëheqësi i koalicionit të krishterë danubian, në kuadër të Mbretërisë hungarez të mbretit Vladislav, me luftërat e tyre heroike, kanë shënuar ngjarjet më të rëndësishme në Evropë, në gjysmën e dytë të shekullit XV. Realiteti i tyre është se këta heronj të mëdhenj evropianë të asaj kohe që luftuan pandërprerë gjatë tërë jetës kundër Perandorisë Osmane, asnjëherë nuk ia dolën që t'i bashkojnë forcat kundër forcave osmane, asnjëherë nuk ia arritën që së bashku ta udhëheqin luftën kundër sulltanëve, asnjëherë ndoshta edhe nuk janë takuar, por, gjithmonë në mes tyre si udhëheqës të luftës çlirimtar ka

ekzistuar në radhë të parë interesi dhe dëshira për luftë të përbashkët kundër Perandorisë Osmane.

Janosh Huniadi që nga viti 1446, kishte rolin e mëkëmbësit të mbretit të Hungarisë (e zëvendësonte mbretin e mitur Ladislav Pathumsi) dhe tani mund të realizonte pretendimin për t'iu hakmarrë osmanëve lidhur për disfatën e pësuar në Betejën e Varnës, më 1444. Që nga viti 1447, Huniadi orvatet që të formonte aleancë. Ai kërkoi përkrahje nga, Venediku, mbreti i Aragonës dhe Napolit, po që orvatjet e tilla dështuan. Huniadi kërkoi aleatë edhe nga sundimtarët e Ballkanit. Sipas kronistëve, Huniadi dërgoi emisarë te Skënderbeu i cili kishte pranuar dhe pajtohej plotësisht të bashkëpunonte më të.¹ Në “Kronikën Raguzane” të Juni Restit, flitet për një aleancë shqiptaro-hungareze. Në një shënim që mban vitin 1447, Skënderbeu cilësohet “*princ i Epirit*” dhe se “*ky princ shqiptar ishte bërë një shkëmb ku përplaseshin dhe thërrmoheshin të gjitha orvatjet osmane që drejtoheshin në dëm të krishterimit*” (*Questo principe Albanese era divenuto lo scoglio nel quale naufragavano tutti li sforzi Ottomani diretti a danno della cristianita*).

Për këtë arsye, thuhet në kronikë, një vit më vonë (1448), Huniadi dhe Skënderbeu, të cilët J. Resti i cilëson “*dy kampionët më të fuqishëm të krishterë të atyre kohëve*” (*li piu famosi campioni cristiani di quei tempi*), lidhën marrëveshje për t'u bashkuar në Sllavoni dhe për të ndërmarë që andej fushatën e përbashkët kundër armatave osmane”.² Asokohe, Huniadi iu kishte drejtuar edhe despotit të Rashës, Gjergj Brankoviqit, i cili përgjigjen ia kthen “*se ishte i lidhur me marrëveshjen për paqe me Portën*”. Nuk kishte dëshirë të ngritët kundër sulltanit, besimin e të cilit e bleu, sepse e dinte se ajo është më e rëndësishme se shoqërimi me Oborin hungarez. Despoti serb refuzoi të marrë pjesë në Betejë.³ Më 16 prill 1446, nga Ragusa u nisën dy letra, një në drejtim të baronëve hungarezë, tjetra në drejtim të Papës së Romës, me të cilat Këshilli i saj përcillte dëshirën që kishte parashtruar Skënderbeu për një

¹ Noel Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001, 92.

² Kristo Frashëri, *Skënderbeu jeta dhe vepra*, 2002, 152.

³ *Istorija srpskog naroda II*, Beograd, 1994, 263.

aleancë me Hungarinë.⁴ Laonik Halkokondili, bashkëkohës i këtyre ngjarjeve, thekson se Huniadi iu dërgoi përfaqësues Skënderbeut dhe Gjergj Aranitit, sundimtarit të shquar shqiptar, duke pasur qëllim që të bashkohej me të në një marrëveshje të vendosur më parë⁵.

Lidhur me aleancën paraprake të Skënderbeut me Huniadin, na njofton edhe historiografi i Oborrit Mbretëror të Matijash Korvinit (i biri i Huniadit dhe mbretit të Hungarisë, në vitet 1458-1490) Antonio Bofinit. Sipas Antonio Bofinit, aleanca ushtarake midis hungarezëve dhe Skënderbeut (*Sandorbegum, Albanesem Principem*) u lidh pak para se të fillonte fushata e vitit 1448 (*literis vexare quocum adversus Turcam aaulo ante foedus cercusserat*). Në bazë të marrëveshjes, kur hungarezët do të sulmonin nga Veriu, ai “Sandorbegos” do t’i godiste turqit nga viset ilirike (*ille al Illyrico*).

Kjo besohet se është arsyeja përse këtë radhë hungarezët nuk do të marshonin, si në vitet 1443 e 1444, nga Juglindja, por nga Jugu nëpër serbi e Kosovë. Skënderbeu që i vetmi që iu përgjigj ushtarakisht kësaj ftese të Huniadit për fushatë kundër osmanëve. Se vërtet Skënderbeu kishte planifikuar t’i ndihmonte Huniadit në luftën e dytë të Kosovës, më 1448, dëshmojnë një mori burimesh dhe fakte të kohës. Sipas dokumenteve të kohës, Skënderbeu, udhëheqësi i shtetit shqiptar, i sajuar pas Kuvendit të Lezhës 1443, në vitin 1448 kishte hyrë në luftime të drejtpërdrejta me Republikën e Venedikut, për çështjen e Danjës, ku Skënderbeu tentoi që ta rimerr atë qendër të rëndësishme shqiptare në bregdet. Burimet dokumentare e mbështesin njoftimin e Barletit, se diku në afërsi të lumit Drin u zhvillua një betejë e ashpër, në përfundim të së cilës venedikasin, të udhëhequr nga Daniel Gjurici, pësuan një disfatë të rëndë. Barleti thotë se beteja u zhvillua në të hyrë të vjeshtës, kur kishin mbaruar të mbjellat (pohim që nuk është i saktë). Zhvillimi i ndeshjes së Drinit jo në vjeshtë, siç thotë Barleti, por në korrik siç thotë Biemi (më 23 korrik), vërtetohet edhe nga një akt i Senatit të Venedikut që mban datën 29 korrik 1448, ku thuhet se Skënderbeu, sapo mori vesh

⁴ Frashëri, 156.

⁵ *Burimet tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë shek. X-XV*, përgatitur nga K. Bozhorri dhe F. Liço, Tiranë, 1975, 331-332.

arritjen e ushtrisë osmane, u largua nga viset e zotërimeve venedikase dhe shkoi për të mbrojtur shtetin e vet (*statum suum accessit*). Në të njëjtën, republika i porositi funksionarët e saj në Shqipëri, përfshirë edhe Andrea Venerion, që t'u jepte strehim në zotërimet e saj fshatarëve dhe personave të këputur, që ndodheshin në rrezik të masakroheshin nga osmanët, kurse ndaj bujarëve shqiptarë të mbanin tjetër qëndrim.⁶

Fitorja e Skënderbeut mbi venedikasit në afërsi të Drinit, vërtetohet nga Traktati i Paqes, që u nënshkrua midis tyre, më 4 tetor 1448, në të cilën thuhet ndër të tjera, se zoti shqiptar detyrohej t'ia kthente “*të gjitha fshatrat matanë Drinit që ndodhen në krahinën e Sinjorisë së Venedikut, (domethënë në krahun e djathë të Drinit - K. Frashëri) që kishte në dorë zoti Skënderbe*”.⁷ Zhvillimi i ndeshjes së Drinit, jo në vjeshtë, siç thotë Barleti, por në korrik, siç pohon Biemmi (më saktë në 23 korrik), vërtetohet edhe nga një akt i Senatit të Venedikut që mban datën 29 korrik 1448, ku thuhet se Skënderbeu, sapo mori vesh arritjen e ushtrisë osmane, u largua nga viset e zotërimeve venedikase dhe shkoi për të mbrojtur shtetin e vet (*statum suum accessit*). Nga letra e fisnikut raguzan, Pasquale de Sorgo, shkruar nga kampi i Huniadit, më 11 shtator 1448, mësojmë se tek ai arritën disa ambasadorë nga Shqipëria, të cilët njoftuan se, sapo të fillonte fushata, shqiptarët do t'i sulmonin turqit me 20 000 veta. Pavarësisht se shifra duket e fryrë, misioni i ambasadorëve tregon se Skënderbeu kishte ndërmend të merrte pjese në luftën e madhe që po përgatitnin hungarezët. Për këto arsye, ai vendosi të hiqte dorë nga rrethimi i Danjës dhe të pranonte paqen e propozuar nga Senati i Venedikut. Paqja u nënshkrua, më 4 tetor 1448, në kampin ushtarak të Skënderbeut pranë Lezhës (*in exercitu magnifici Scanderbeg apud Alexium*), ku qenë grumbulluar edhe zotë të tjerë të vendit, si duket anëtarë të Besëlidhjes së Lezhës. Megjithatë, palën shqiptare këtu e përfaqësonin Skënderbeu dhe Nikollë Dukagjini, të shoqëruar nga Andrea, peshkopi i Arbërisë, dhe nga Gjergj Pellini, abat i Shën Mërisë së Rotecit, i cili në këtë kohë kryente funksionet e

⁶ Frashëri, *Skënderbeu*, 156.

⁷ Po aty, 155.

kancelarit të Skënderbeut për marrëdhënie me Sinjorinë. Republika përfaqësohej nga proveditori i përgjithshëm i Venedikut në Shqipëri, Antonio Venerio dhe Pal Loredani konti dhe kapiteni venedikas i Shkodrës. Traktati në origjinal ruhet në Arkivin e Venedikut.

Në fillim të tekstit thuhet se këtë paqe “*Senjoria e shkëlqyeshme e Venedikut*” e lidh me “*të madhërismin Skënderbe dhe me zotëri të tjerë të Shqipërisë*”. Më poshtë nga pala e zotëve shqiptarë, përveç Skënderbeut, shtohet edhe emir i “*të nderueshmit Nikollë Dukagjini*”. Të dy këtë përfaqësonin jo vetëm veten e tyre, por “edhe zotët e tjerë të Shqipërisë”. Dukej haptas se paqja lidhej midis Republikës së Shën Markut dhe Besëlidhjes së Lezhës (ndonëse emir i saj nuk zihet fare në gojë). Anëtarët e saj, me përjashtim të Pal Dukagjinit dhe birit të tij, Lekë Dukagjinit, ndodheshin në kampin e Skënderbeut. Këtu Skënderbeu nuk përmendet me asnjë titull pushtetar, madje as me titullin e dikurshëm “zot i Dibrës dhe i Matit”, por vetëm me emrin Skënderbe.⁸ Kjo do të thotë se Republika e Venedikut vazhdonte të injoronte Lidhjen e Lezhës, ndonëse aty pranë Skënderbeut ndodheshin anëtarët e saj. Nga pikëpamja politiko-juridike ky ishte qëndrim kontradiktor i Republikës, pasi nga njëra anë ajo pranonte të nënshkruante një traktat paqeje me Skënderbeun, në emër të zotëve të Shqipërisë, kurse në anën tjetër, atë nuk e njihte si kryetar i Lidhjes së tyre.

Sipas Traktatit të 4 tetorit 1448, Danja i mbetej Venedikut, kurse Republika i siguronte Skënderbeut dhe më tej trashëgimtarëve të tij (pra vetëm Skënderbeut dhe jo zotëve të tjerë), një pension prej 1 400 dukatesh në vit, i cili do të paguhej në Ditën e Shën Mitrit (26 tetor); e përjashtonte nga taksa doganore e Durrësit për 200 kuaj të ngarkuar me kripë në vit; i siguronte Gjergj Arianitit disa privilegje tregtare që gëzonte më parë në Durrës; garantonte strehim në tokë venedikase në rast se Skënderbeu dhe aleatët e tij do të dëboheshin nga Shqipëria prej armiqve të tyre; i jepte copë për dy palë rrobe skarlati në vit për personin e Skënderbeut (*al perfato signor Scanderbego agni anno veste do de scarlatin*); kurse Skënderbeu përveçse do të hiqte dorë në favor të Venedikut nga Danja dhe tokat

⁸ Po aty, 159.

që kishte pushtuar në krahun e djathtë të lumit Drin, do t'i jepte Sinjorisë, si shenjë homazhi, dy langonj dhe dy fajkonj në vit (*do levrieri et do astori mudadi, come se soleva far per antiqua usanza*).⁹

Në fund të tekstit të Traktatit, thuhet se në kampin e Skënderbeut zotët e Shqipërisë (*i signori de l'Albania*) vendosën që Skënderbeu të nisej sa më parë me një ushtri sa më të madhe për t'u bashkuar me Janosh Huniadin në fushatën që po ndërmernte kundër ushtrisë osmane prapa krahëve. Për këtë qëllim krerët shqiptarë i kërkuan Sinjorisë që t'i jepte para kohe, brenda 15 ditëve, pensionin vjetor që prej 1 400 dukatësh.¹⁰

Pra, ekzistonin interesat dhe përpjekjet në mes Huniadit dhe Skënderbeut për bashkim të forcave ushtarake në luftë kundër turqve. Por, Skënderbeu për shkak të rrethanave të brendshme dhe të jashtme në vend, nuk do të mundet të merr pjesë në betejën e zhvilluar në Kosovë, më 1448.

Huniadi edhe përkundër përpjekjeve nuk kishte gjetur përkrahje të duhur në shtetet italiane. Kështu, derisa Sulltan Murati II, në korrik të vitit 1448, sulmoi Shqipërinë me një armatë të madhe në luftë kundër Skënderbeut, Huniadi e pa këtë si moment të volitshëm për të marrë rrugën e ndeshjes me osmanët. Ai mbledhi një ushtri prej afër 50 000 ushtarësh, që ishin kryesisht hungarezë, dhe reparte të vogla vlakase (rumune), si dhe mercenarë gjermanë dhe çekë.¹¹ Në depërtimin e ushtrisë hungareze nëpër Serbi e pengoi Gjergj Brankoviqi, i cili ishte në raporte vasaliteti me Sulltan Muratin II. Duke qenë besnik i Muratit II, Gjergj Brankoviqi, kishte arrit që përmes rrjetit të agjenturës së tij, në kampet ushtarake të Huniadit të informonte Muratin II për efektivat e ushtrisë së udhëhequr nga Janosh Huniadi.¹²

Nga fundi i shtatorit 1448, Huniadi hyri në Serbi, duke mos e përfillur fare Gjergj Brankoviqin, duke marshuar përgjatë luginës së Moravës. Gjatë depërtimit të ushtrisë së Huniadit nëpër Rashë,

⁹ Po aty, 160.

¹⁰ Po aty, 160.

¹¹ Malcolm, *Kosova*, 92.

¹² Po aty, 92.

Gjergj Brankoviqi lajmëroi Sulltan Murati II, duke i dhënë informata sekret mbi përbërjen e ushtrisë së Huniadit. Këto informata ishin dërguar nëpërmjet Pascuale de Sorgos, i cili ishte në shërbim të Gjergj Brankoviqit. Gjergj Brankoviqi i kishte pasur njoftimet më të hershme lidhur me kontaktet e Skënderbeut dhe Huniadit dhe ato njoftime i kishte marrë përmes të deleguarit të tij Pasquale de Sargo, një bujar raguzan që kishte qëndruar në kampin hungarez. Sargo, i kishte shkuar tri herë në bisedime me Huniadin, por nuk kishte arritur marrëveshje bashkëpunimi.¹³ Nga një letër, e datës 5 shtator 1448, e dërguar nga Sargo prej kampit të Huniadit, kuptojmë se në Betejën e Dytë të Kosovës do të marrin pjesë edhe shqiptarët. “... *Selgianech Turchus suo cum exercitu potimo ordine paratus est Panones vero, qiu et Hungari vicitantur, Appoliniuque el Transilvani una simul et Albaneses unanimiter sancto patri fidelitatem iuvavere* ...”¹⁴

Ky përfaqësues na del si i dyshuari kryesor që i përcjell informatat te Brankoviqit lidhur me qëllimet e Huniadit, të cilat pastaj ky ia përcjell Muratit II. Një letër e datës 11 shtator 1448 e dërguar nga Pasqualis Juni de Sargo drejt Brankoviqit, jep hollësi për gjendjen e ushtrisë së Huniadit. Në raportin e Sorgos përfshihet edhe informacioni se te Huniadi kishin arritur emisarët e Skënderbeut të cilët i kishin premtuar atij 2 000 ushtarë.¹⁵ Sulltan Murati II, i informuar për lëvizjet e ushtrisë së Huniadit, me kohë u tërhoq nga rrethimi i Krujës që kishte planifikuar, duke grumbulluar ushtrinë e tij për të qenë në gatishmëri.

Në këtë kohë Skënderbeu ishte i zënë me luftime me Venedikun rreth çështjes së qytetit të Danjës, por, duke parë pamundësinë e zhvillimit të luftës në dy fronte, ai lidhte paqe sa më shpejtë me Venedikun më 1448, në mënyrë që t'i kishte duart e lira për të vepruar në Kosovë së bashku me hungarezët.

¹³ Jahja Drançolli, “Kosova më 1448 sipas kronikave dhe historive të moçme të Raguzës”, *Kosova, 17*, Prishtinë, 1988, f. 263.

¹⁴ Drançolli, “Kosova më 1448”, 263.

¹⁵ Po aty, 263.

Në fillim të shtatorit të vitit 1448, Huniadi gjendej në qytezën Kovin përballë Smedervës, ku ishte selia e Gjergj Brankoviçit. Këtu forcave hungareze u ishte bashkëngjitur edhe vojvoda i Vllahisë, Dani, me 8 000 luftëtarë si dhe rreth 200 topçinj çekë dhe disa vullnetarë gjermanë. Në mesin e ushtarëve të Huniadit gjendej edhe Daudi, pretendent ky për fron në postin e sulltanit. Po ashtu, si pjesëmarrës në Betejën e Dytë të Kosovës, përmendet edhe një kroat i familjes fisnike De Luka.¹⁶

Nga qyteti Kovini, Huiadi gjatë shtatorit të vitit 1448 i kishte dërguar Papës Nikolla V, disa letra me radhë, duke kërkuar ndihmë më të madhe nga ai. Papa i sugjeronte që ekspedita të shtyhej për vitin tjetër, Huniadi arsyetohej se ai ishte i detyruar të luftonte, sepse lufta i ishte imponuar. Huniadi duke pas nevojë për aleatë u mundua që ta bindte edhe Gjergj Brankoviçin që t'i bashkëngjitej në luftën e përbashkët, por pa sukses. Kështu ai më 28 shtator u nis drejt jugut me rreth 24 000 hungarezë, kroatë, rumunë, çekë, për t'u takuar me Fushën e Kosovës me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe së bashku për ta sulmuar Muratin II.

Gjergj Brankoviçi kishte vendosur që të mos merrte pjesë në ekspeditën e Huniadit, aq më tepër duke dashur që ta ruante vasalitetin me osmanët si dhe duke i pasur parasysh raportet jo të mira të mëhershme me Huniadin. Në të vërtetë, Gjergj Brankoviçi kishte pasur më herët grindje të thella me Huniadin rreth disa pronave në jug të Hungarisë, të cilat Janoshi i kishte pushtuar nga ai, nga që Gjergj Brankoviçi kishte pranuar vasalitetin osman.¹⁷ Huniadi, duke kaluar Danubin në afërsi të Kovinit, përgjatë luginës së Moravës arriti në Krushevc e nga aty përmes Kopaonikut kaloi në luginën e Toplicës për të dalë te Sitnica afër Prishtinës, pikërisht në vendin ku ishte zhvilluar Beteja e Parë e Kosovës, më 1389. Huniadi duhet të ketë arritur në Fushën e Kosovë kah mesi i shtatorit të vitit 1448 dhe ishte ndalur aty, qoftë për t'i pushuar trupat e veta nga

¹⁶ Muhamet Mala, "Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII", (Tezë doktorate, Universiteti i Prishtinës 2006), 216.

¹⁷ Mala, "Shqiptarët dhe Evropa", 216.

udhëtimi disa javësh, qoftë për të pritur Skënderbeun¹⁸. Sipas shënimeve të Matej Mazrekut, nga viti 1762, Huniadi kishte arritur edhe në Janjevë ku në shenjë falënderimi Zotit për fitoret e tija, kishte marrë pjesë në meshë në Kishën e Shën Nikollës. Mbi qëndrimin e tij në Janjevë tradita popullore kishte mbajtur gjallë këtë kujtim me shekuj.

Skënderbeu përkundër detyrimeve dhe angazhimeve të shumta ndaj aksioneve pushtuese osmane në Shqipëri në këtë kohë, ku gjendej para një ekspedite osmane në drejtim të Dibrës e që ishin të shtyrë edhe nga Venediku për shkak të konfliktit me Danjën. Skënderbeu me forcat e veta rreth 1 200 deri 1 500 veta, posa mori lajmin për qëllimin e Huniadit e ndërpreu ekspeditën në Dibër dhe u drejtua kah Kosova. Qëllimi i Skënderbeut ishte që ta ndiqte nga pas sulltanin dhe t'i ndihmonte Huniadit.¹⁹

Më 17 tetor 1448, ushtria e Huniadit u gjend përballë një fronti të gjerë të forcave osmane pothuajse në të njëjtin vend ku 59 vite më parë ishte zhvilluar një betejë tjetër po aq e famshme. Huniadit dhe koalicioni i tij po priste ardhjen e Skënderbeut dhe ushtrisë shqiptare. Ka pikëpamje sipas të cilave Murati II, duke pasur frikën e koalicionit i kishte preferuar paqe Huniadit, duke i premtuar 100 000 dukatë shpërblim dhe kompensimin e harxhimeve ushtarake, nëse hiqte dot nga ekspedita, por Huniadi kishte refuzuar. Më 17 tetor 1448, u zhvilluan disa konfrontime të vogla ndërmjet trupave hungareze dhe atyre osmane. Në këtë rast theksohet se pararojat e Huniadit kishin zënë rob një turk dhe e dërguan që ta shoh taborin ushtarak, veçanërisht topat e mëdhenj që i kishte ushtria hungareze e pastaj e la atë që të ikën i lirë, në mënyrë që ta informonte sulltanin për forcën hungareze dhe njëherësh ta demoralizonte ushtrinë turke.

Beteja vendimtare u zhvillua, më 18 tetor 1448. Pretendenti i fronit osman, Dauti, që ishte në koalicion me Huniadin, i kishte propozuar që edhe natën të mos e ndalte luftën, sidomos ndaj jeniçerëve, me pretendim se ata do të marrin arratinë dhe do të thyeshin lehtë. Huniadi e pranoi propozimin dhe natën i sulmoi

¹⁸ Po aty, 217.

¹⁹ Po aty, 267.

jeniçerët, por ata nuk morën arratinë por u kundërpërgjigjen me sukses. Të nesërmen, më 19 tetor 1448, në mëngjes filloi beteja nga krahu i djathtë i të krishterëve dhe ai i majtë osman. Në betejë u vra Ivan Sekeli (nip i Huniadit), i cili kishte luftuar trimërisht. Thuhet se vrasja e tij ndikoi negativisht në moralin e të krishterëve. Vojvoda Dan i Vllahisë iu dorëzua sulltanit.

Huniadi i çorganizuar në tërheqje nëpër Serbi, drejt Danubit zihet rob dhe i dorëzohet Gjergj Brankoviçit, i cili e burgos.²⁰ Sipas dëshmive të Giacomo di Luccarit, Gjergji me këtë rast kishte urdhëruar që Huniadi të mbytej në lumin Resava dhe vetëm pas ndërhyrjes së Pasqual Sorgos, që ishte emisar i despotit dhe ambasadorit Damiano Giorgi, ky kishte mbetur gjallë.²¹

Nga kjo del se Skënderbeu nuk ishte në arenën e zhvillimit të luftës. Ç'është e vërteta, Skënderbeu ishte nisur drejt frontit të luftës. Rreth 20 milje larg nga Fusha e Kosovës, Skënderbeu hasi në ushtrinë e shpartalluar hungareze e cila po ikte nga fushëbeteja. Skënderbeu hasi në pengesa meqë Gjergj Brankoviçi i kishte mbyllur të gjitha rrugët dhe shtigjet, me të vetmin qëllim që ta pamundësonte bashkimin e këtyre forcave me ato të Huniadit, në frontin e përbashkët kundër “dhëndrit” të tij Muratit II. Prandaj, për të mos mbetur pa u dënuar për këtë krim, shkruan Barleti: “Skënderbeu i cili ndodhej në kufijtë e Misisë, e mori vesh me pikëllim shpartallimin dhe shkatërrimin e ushtrisë së hungarezeve dhe, “... për të marrë hakun për pabesinë e Gjergjit (Despoti Gjergj Brankoviçi), u vërsul kundër viseve armike të Despotit, u vuri zjarrin e i shkatërroi me shpatë anë mbanë”.²² Skënderbeu vë në pah Barleti, trupave ushtarake hungareze e poloneze të shpartalluara u ofroi ndihmë me ushqim e banim. Pasta, u ndihmoi në transportimin e tyre me anije në qytetin e Raguzës, prej nga ky ata kanë mundur të kthehen në vendlindjet e veta.²³

²⁰ Po aty, 269.

²¹ Drançolli, “Kosova më 1448”, 257.

²² Marin Barleti, *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut*, Rilindja, 1982, 125

²³ Po aty, 125.

Në historiografi lidhur me këtë betejë të rëndësishme zakonisht është shtruar edhe çështja e vonesës së Skënderbeut për të marrë pjesë në betejë për shkak të bisedimeve me Venedikun²⁴. Mirëpo, nëse mbështetemi në marrëveshjen e 4 tetorit 1448 në mes të Skënderbeut dhe Venedikut, Skënderbeu me ngut kërkonte të arrihej një paqe për të shkuar në ndihmë të koalicionit të Huniadit. Mund të supozojmë se Skënderbeu me të deleguarit e Huniadit ishte marrë vesh që beteja të fillonte më 19 tetor, duke pasur gjithnjë parasysh kërkesën e Skënderbeut që më datën 4 tetor 1448, kërkoi 15 ditë kohë për paradhënie të 1 400 dukatëve nga ana e Venedikut. Mirëpo, siç dihet, beteja filloi më 17 tetor dhe përfundoi më 19 tetor, kur edhe Skënderbeu u paraqit në Kosovë. Si duket informacionet e Brankoviqit e imponuan hyrjen në luftë para kohe dhe kështu ndodhi edhe disfata.²⁵

Kjo ngjarje zuri ven në shkrimë të kronistëve të kohës. Kronisti më i njohur për këtë betejë mbetet Marin Barletit me veprën: *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, e cila ndriçon pos tjerash, edhe Betejën e Dytë të Kosovës, më 1448. Por, Marin Barleti ngatërron ekspeditën e Varnas me Betejën e Dytë të Kosovës, duke i parë në të njëjtën kohë, pra, në vitin 1444, pa e përmendur fare luftën e dytë të Kosovës, më 1448²⁶. Mirëpo, këto të dhëna mund të çngatërrohen dhe të gjendet kufiri ku përfundojnë të dhënat që flasin për Betejën në Varna, më 1444, dhe ku fillojnë ngjarjet që flasin për Betejën e Dytë të Kosovës, 1448.²⁷

“Kështu ai vit, (1444) ishte i shënuar, shkruan Barleti, me humbjen e krishterëve në Betejën e Varnës. Por, hungarezët duke e harruar atë humbje, po përgatiteshin me tërë fuqinë e vet për të hyrë në luftë me turqit (fjala është për përgatitjen e luftës, më 1448). Kështu, mbreti i Hungarisë dhe Polonisë, Vladislavi, përgatiti një ushtri të madhe me në krye Janosh Hiniadin, që kishte ardhur bashkë me vllehtë e vet”. “Me gjithë këtë, për përgatitjen e një lufte të madhe

²⁴ Mala, “Shqiptarët dhe Evropa”, 270.

²⁵ Po aty, 271.

²⁶ Barleti, *Historia e jetës*, 113-116.

²⁷ Po aty, 113-121.

duheshin ndihma të tjera. Emri dhe fitoret e korrura nga Skënderbeu, u bënë përshtypje të gjithëve. Dhe u pajtuan të gjithë se po ta kishin atë me ushtrinë e tij që “kullonte ende gjak” jo vetëm se do të forcoheshin radhët e të krishterëve, por u pa edhe si mundësi reale për fitore kundër turqve”, shkruan Barleti. Prandaj, për këtë qëllim, mbreti Vladislav, i shkruan letër Skënderbeut, njofton Barleti. “Vladislavi, mbret i Hungarisë dhe i Polonisë, i dërgon shumë të fala Skënderbeut, princit të arbërve”. Në letër, sipas Barletit, Vladislavi, shkruan: “... trimëria jote..., ia ka shtuar shumë fuqinë krishterimit...”, “Prandaj në kohën e sotme, le të më lejohet ta them pa i ardhur kujt rëndë, ti më dukesh padyshim i vetmi princ që je pajisur me të gjitha..., po deshe të na ndihmosh me ushtrinë tënde fitimtare, të ftojnë gjithë princat e burrat kryetrima të Hungarisë dhe të Polonisë, për shpëtim të krishterimit”²⁸.

Skënderbeu me konsultim të brendshëm të bashkëpunëtorëve të vet, e ndër më të dalluarit Pal Engjëlli, sipas Barletit Skënderbeu i shkruan mbretit Vladislav, “*Skënderbeu, princ i epirotëve, i dërgon shumë të fala Vladislavit, mbretit të Hungarisë dhe të Polonisë... Dhashtë Zoti i madh e i vërtetë që unë, o Vladislav, të mund të t’i sjellë vetë gjithë ato forca që mendoj... për këtë luftë... atëherë Evropa nuk do të dergjej më...*”. Skënderbeu i premton se me 30 mijë ushtarë do të jem në mundësi për t’iu bashkuar forcave aleate krishtere në luftë kundër turqve²⁹. Kur është fjala për letërkëmbimin ndërmjet Vladislavit dhe Skënderbeut, deri më sot nuk është gjetur dokumenti, me çka edhe studiuesi i njohur hungarez, Pall, e mohon këtë letërkëmbim, apo e sheh si trillim të Barletit. Por, nisur nga fakti se Skënderbeu veçse edhe ishte në kontakt me Vladislavin për kryqëzatë antiosmane, dhe duke pas parasysh se Skënderbeu në këtë kohë veçse ishte personalitet shumë i njohur në luftë kundër turqve, padyshim se mbreti Hungarez, Vladislavi, edhe do të këtë bërë letërkëmbim me Skënderbeun, i cili shihej si forca e mundshme për fitore të koalicionit të mbretit të Polonisë, Vladislavit.

²⁸ Po aty, 113-114.

²⁹ Po aty, 119-120.

Për mosgatishmërinë e Gjergj Brankoviqit dhe për mos hyrje në koalicion të krishterë kundër turqve, M. Barleti shkruan: “Ky Gjergj Vukoviqi (Gjergj Brankoviqi, ishte i pabesë që solli aq shumë pengesa e turbullira të shumta hungarezëve dhe krishterimit”³⁰.

Vladislavi, duke marrë zemër nga letra e Skënderbeut..., kaloi Vllahinë dhe Danubin dhe mbërriti me forcat e krishtera në Varna. Barleti e ngatërron Varnën me Kosovën ku edhe do të zhvillohej Beteja e vitit 1448, kur thotë se: “Ky është vend fushor, që ndodhet në kufijtë e Misisë, nga ana e andejme, i njohur tanimë prej kohësh për kërdrinë e sa e sa ushtrive, dhe një truall i urryer edhe për luftëtarët më trima”.³¹ Pra, këtu kemi të bëjmë me territorin e Kosovës që gjendej në kufijtë e Misisë që i referohet kufirit perëndimor të Ilirisë që do të thotë së në atë kohë territori i Kosovës bënte pjesë në territorin e shtrirjes gjeografike ilire. Po ashtu, Barleti Varnën e ngatërron me Kosovën, gjegjësisht Fushën e Kosovës me Varnën, ku është zhvilluar ajo beteja e vitit 1389, që Barleti e quan si vend të njohur për zhvillim të luftërave kundër turqve.

Marin Barleti njoftoi dhe për veprimin e Skënderbeut, pasi që u gjend në afërsi të vendit ku u zhvillu beteja. “Lajmi për kërdrinë e të krishterëve mori dheun e bëri bujë kodo. Skënderbeu, i cili ndodhej ende në kufijtë e Misisë, e mori vesh me pikëllim shpartallimin dhe shkatërrimin e ushtrisë së hungarezëve dhe, pasi u mundua për një kohë të gjatë, vendosi të kthente prapa ushtrinë dhe të nisej. Me gjithë këtë, që të mos mbetej fare pa u ndëshkuar me dhimbjen që shkaktoi dhe për pabesinë e Gjergj Brankoviqit, për të marrë hakun Skënderbeu u lëshua menjëherë me ushtrinë e tij kundër viseve armike të Dhespotit, dhe i shkaktoi dëme ushtrisë së Dhespotit”.³² Marin Barleti na njofton për veprimet e Skënderbeut me ushtarët hungarezë dhe polakë të cilët ishin të thyer pas disfatës së pësuar. Gjatë kohës që kthehej në Epir, i dalin përpara hungarezët dhe polonezët që kishin mbetur gjallë nga ajo kërdrë, të cilët ai (Skënderbeu) i priste me bujari dhe me plot kujdes. Pasi i ndihmoi

³⁰ Po aty, 121.

³¹ Po aty, 122.

³² Po aty, 122, 124

me të holla e me ushqime për shumë ditë me radhë, siç ndodhi në një fatkeqësi të tillë, i ngarkoi pastaj me anije dhe i dërgoi në Raguzë, nga ku u kthyen në Hungari. Këto ngjarje Barleti i përshkruan me rastin e Betejës në Varnë 1444, që do të thotë së ka ngatërruar kohën pasi këto ngjarje dhe ky veprim i Skënderbeut ka ngjarë në luftën e Kosovës, më 1448.³³ Edhe një pjesë tjetër e ushtarëve të Huniadit, të cilët u gjenden në malet e Çiçavicës, në afërsi të Vushtrrisë, iu ofrua ndihmë nga dukë Bogdani, një stërgjysh i Pjetër Bogdanit, të cilët pa vështirësi shmangën rrezikun nga ushtria osman që i ndiqte.³⁴

Krahas M. Barletit, kemi një burim tjetër historiko-letrar, Dhimitër Frangun. Studiuesi i njohur Fan Noli, na bënë të ditur se ekzistonte një libër me titull: *“Trimëritë e shkëlqyera e të lavdëruara dhe fushatat vitorioze që bëri kundër turqve, zoti Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbej, princ i Shqipërisë”*, e përkthyer italisht prej një dorëshkrimi latinisht nga prifti shqiptar, atë Dhimitër Frangut, arkëtarit të Skënderbeut dhe e botuar në Veneti, më 1545, prej një anonimi dhe pastaj e ndrequr dhe e botuar përsëri italisht prej kontit, Xhiovan Maria Monardo, në Veneti, më 1591, 1610, 1646 dhe 1679.³⁵ Vepra e Frangut, është në një masë të madhe e varur nga vepra e Barletit. Edhe ky, në përshkrimin e Betejës së vitit 1448, e ngatërron me betejën në Varnës, më 1444. *“Në të njëjtën kohë, Ladislavi, mbreti i Hungarisë, përgatitej me një ushtri të madhe që të shkonte në Varna, për të luftua kundër Sulltan Muratit, mbretit të turqve. Kur mbreti hungarez e mori vesh fitoren e madhe të Skënderbeut, i shkruan me fjalë të ngrohta dhe të njerëzishme tue lutë me shkua në ndihmë të tij, me një numër sa më të madh njerëzish e forcash që mund të mblidhte”*.³⁶ Pasi e lexoi letrën, Skënderbeu i mblodhi oficerët dhe komandantët e ushtrisë së tij, dhe kërkoi nga ata që të japin mendimin e tyre në lidhje me kërkesën e mbretit Ladislav. Ata iu përgjigjen *“se e shikonin shumë me vend të ndihmohej në atë*

³³ Po aty, 124.

³⁴ Luzim Lajqi, *Studime historike 1*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006, 48.

³⁵ Petrika Thëngjilli, *Skënderbeu arritje, mangësi, pikëpamje të ndryshme*, Prishtinë, 2012, 466.

³⁶ Dhimitër Frangu, *Veprat e lavdishme të Skënderbeut*, Tiranë, 2005, 60.

luftë ai mbret i nderuar". Skënderbeu, pasi e mori këtë përgjigje, i shkruan mbretit Ladislav, se "do të kishte gjithë ndihmën dhe përkrahjen e mundshme të tij".³⁷ Skënderbeu menjëherë filloi përgatitjen e ushtrisë për t'i shkuar në ndihmë hungarezëve. Skënderbeu thirri Pal Dukagjinin dhe princat e tjerë shqiptarë të Lidhjes së Lezhës, e mblodhi 30 mijë ushtarë. Pas përgatitjeve të duhura, filloi marshimin. Por, sipas Frangut, Skënderbeu u pengua nga despoti i Serbisë, Gjergj Vukotiqi (Gjergj Brankoviçi, B. Muhadri), i cili mbylli të gjitha shtigjet, nga do të kalonte Skënderbeu me ushtrinë e tij për ta ndihmuar mbretin hungarez.³⁸

Burimet bizantine zënë vend të rëndësishëm në trajtimin e Betejës së Dytë të Kosovës. Në radhë të parë këtu duhet përmendur historianin bizantin, Laonik Halkokondilin (1423-1487). Ky autor në veprën e tij *Tregime historike*, përshkuan me mjaft hollësi ngjarjen e Betejës së Dytë të Kosovës. "... Në kohën kur Murati II do të sulmonte me të gjitha forcat (Sfetigradin - qytet në Shqipëri), për të dytën herë arriti prej Gjergjit, prijësit të tribalëve (serbëve), lajmi se Jani (Janosh Huniadi), mbasi kishte grumbulluar peonët, kaloi Istrin (Danubin) dhe po marshonte kundër tij (sulltanit). Ky, kur mori vesh këto, u përgatit me shpejtësi të madhe dhe shkoi atje, ku, sipas informatave që kishte, do të kalonte Jani...".³⁹ Po ky autor, na jep edhe kundërshtimin e Gjergj Brankoviqit që t'i bashkëngjitej koalicionit kundërosman që po përgatitje nga popujt e Evropës. "...Ata (Janosh Huniadi me ushtri), pra mbasi u përgatitën, kaluan Istrin (Danubin) dhe ftonin prijësin e tribalëve (Gjergj Brankoviqin) që të merrte pjesë së bashku me ta në këtë luftë. Ai u përgjigj se nuk e shihte të mjaftueshme përgatitjen kundër ushtrisë së Sulltan Muratit ... dhe tha se (Gjergj Brankoviçi) kishte frikë më tepër nga ai (Murati), sesa nga peonët...". "Mbasi mori këtë përgjigjeje, Jani u nis dhe marshoi përpara dhe duke hyrë në tokën e sulltanit arriti në Prishtinë dhe vendosi kampin e vet në Fushë-Kosovë, ku Murati

³⁷ Po aty, 61.

³⁸ Po aty, 61.

³⁹ *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, Tiranë, 1976, 331.

luftoi dikur me Llazarin...”.⁴⁰ Kronisti bizantin, Halkokondili, informon edhe bashkëpunimin e mundshëm që do të realizojë mes Janosh Huniadit dhe Skënderbeut dhe të Aranit Komenit. “... *Jani dërgoi delegatë te Skënderbeu dhe te Arianiti dhe mendonte që pasi ata të afroreshin në vendet e afërta të Evropës, të bashkoheshin...*”.⁴¹

Kjo ngjarje me karakter ndërkombëtar zë vend të dukshëm edhe në veprën e kronistit bizantin Dukas (1400-1470), “*Historia turko-bizantine*”. Dukasi shkruan për ardhjen e ushtrisë së Huniadit në Kosovë. “... *Kur Jani mori vesh këtë, kaloi në bregun tjetër të Istrit, nga një rrugë tjetër dhe, mbasi kaloi të gjitha ngushticat erdhi në drejtim të Nishit ose drejt në Kosovë...*”⁴². Dukasi si dhe shumë kronistë të tjerë shkruan për atë se si beteja është zhvilluar edhe natën në mes të dy ushtrive në luftën e tyre në Fushë-Kosovë, ...dhe mbasi luftuan natën, në mëngjes, kur ishte ende errësirë... ai (Jani) iku fshehurazi, sepse pa ushtrinë turke që ishte superiore... atëherë Murati duke parë çadrat e hungarezëve të shpërndara ...u vërsul mbi ta...”.⁴³

Lufta e dytë e Kosovës zë vend të rëndësishëm edhe te kronistët serbë, si bie fjala të Konstantin Mihajloviqi nga Ostrovica, i lindur më 1430, i cili në *Kujtimet e jeniçerëve*, që i shkroi në Poloni, na ofron të dhëna në hollësi, jo vetëm për pushtimin osman të Novobërdës (1455), me ç’rast u mor jeniçer nga osmanët, por edhe për ditën e fillimit dhe të mbarimit të luftës së dytë të Kosovës, 1448. Po ashtu, ofron hollësi për mos angazhimin e Gjergj Brankoviqit në ekspeditën kryqtar kundër Sulltan Muratit II.⁴⁴ Gjurmë të parë për Betejën e Dytë të Kosovës nga kronikat dhe historitë e moçme të burimit raguzan, ndeshim te kroniku anonim i Raguzës i shekullit XV, i cili, duke bërë fjalë për ekspeditën në Varna, më 144, tërthorazi flet edhe për Betejën e Dytë të Kosovës.

Burime të dorës së parë për këtë ngjarje, padyshim paraqet korrespondenca e Janosh Huniadit (30.12.1448) me dekanin Nikolla

⁴⁰ Po aty, 332.

⁴¹ Po aty, 332-333.

⁴² Po aty, 356.

⁴³ Po aty, 356-357.

⁴⁴ Lajqi, *Studime historike*, 39.

Loshocki, ku shkurtimisht përshkruhet disfata e ushtrisë së Huniadit në Kosovë, si dhe ikja e tij në Smederevë. Edhe kronika bashkëkohëse e J. Turocit dhe historia e A. Bonfinit, sjellin të dhëna me interes për luftën e dytë të Kosovës, më 1448. Historiani raguzan, Mauro Orbini, në veprën e tij *“Ill Regno de gli Slavi” (Mbi mbretërinë e sllavëve)*, të cilën e botoi në vitin 1614, jep të dhëna interesante edhe për Kosovën, dhe Arbërinë mesjetare në kontekst të historisë së popujve tjerë. Orbini përshkruan në masë të madhe të dhënat e Marin Barletit. Ky autor jep hollësi për ekspeditën e Janosh Huniadit në Kosovë, më 1448. E përshkruan gjerësisht qëllimin e Huniadit që kryqëzatës kundër osmanëve t’i bashkohej edhe despoti i Rashës Gjergj Brankoviçi, pasi edhe kishte arrit të krijonte një front të gjerë duke përfshirë edhe shqiptarët në luftë kundër osmanëve. *“...Dërgoi lajmëtarët e vet te Gjergj Brankoviçi, për ta bindur që ta shoqëronte në këtë fushatë të ndershme dhe të shenjtë”*.⁴⁵

Përgjigjja nga ana e Gjergj Brankoviçit, sipas Orbinit, ishte shumë negative dhe nuk pranonte të ishte pjesë e koalicionit. Ky qëndrim kishte hidhëruar tej mase Huniadin, sa që sipas shkrimeve të Orbinit, *“Huniadi ishte zotuar se në rast se do të fitonte, personalisht me duar të veta do të mbyste Gjergjin e pabesë dhe mosmirënjohës, ndërkaq mbretërinë e tij do t’ia dorëzojë një tjetrit më të denjë se ai”*.⁴⁶ Në njoftimet e mëtejme te Orbinit, flitet për informimin e tij bërë Sulltan Muratit II, për ekspeditën e Janosh Huniadit.⁴⁷ Me informata të shumta vjen edhe kronisti raguzan me origjinë arbërore nga Lezha Giacomo Pietro di Lucari me veprën e tij *“Capioso ristretto degli Annali di Ragusa” (Pasqyrë e gjerë e Analeve të Raguzës)*, të botuar në Venedik 1605.⁴⁸ Ky autor, ndonëse ngjarjen për luftën e dytë të Kosovës e vë në vitin 1447, pra një vit para se të bëhej kjo luftë, jep përshkrim të gjerë rrjedhave të kësaj lufte. Ai flet

⁴⁵ Jahja Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës*, Zagreb, 2008, Misioni katolik shqiptar në Kroaci, 99.

⁴⁶ Po aty, 100.

⁴⁷ *“Menjëherë pas nisjes së Huniadit, Gjurgji i bëri me dije Muratit përmes shumë legatëve për inkursionin hungarez dhe numrin e ushtrisë së tyre...”*, Drançolli, *Arbërit ndërmjet*, 100.

⁴⁸ Po aty, 104.

për një luftë të rreptë, të cilën e fituan turqit. Po ashtu, edhe G. Luccari, si shumë kronistë të kohës, për disfatën e koalicionit kudërosman në Kosovë, më 1448, e fajëson despotin serb Gjergjin.⁴⁹

Historian i njohur raguzan ishte edhe Junii Restii (1669-1735) me veprën *Chronica Ragusina (Kronika e Raguzës)*. Ky autor duke bërë fjalë për ngjarjet e vitit 1447, thotë se Skënderbeu bashkë me Janosh Huniadin qenë shtylla pengesë për mbrojtjen e Ballkanit dhe me gjerë nga turqit. Ky autor thekson se kjo ngjarje u zhvillua në vitin 1448.

Për këtë ngjarje të rëndësishme, studiuesi N. Malcolm, shkruan: “Kjo, Beteja e Dytë e Kosovës, është një nga ato ngjarje që mund të kishin ndryshuar historinë e Ballkanit. Në qoftë se është e vërtetë se beteja zgjati tri ditë, atëherë ky është një tregues se forcat e të dyja palëve gati kishin qenë të barabarta.⁵⁰ Ardhja e Skënderbeut, i cili kishte përvojë të luftës antiosmane dhe kishte korrur suksese të konsiderueshme, me kohë do të kishte qenë vendimtar. Po të kishte pësuar ushtria turke në këtë betejë, “tërë historia e Ballkanit do të mund të ndryshonte””.⁵¹

Rrethanat diktuan që trupat ushtarake të këtyre trimave të asaj kohe të mos ndodhen të bashkuar në fushën e betejës kundër trupave turke. Por, megjithatë angazhimi dhe heroizmat e njëmendta të mëdha të Skënderbeut dhe Huniadit, kundër të njëjtit armik - Perandorisë Osmane ia lehtësonin njëri-tjetrit detyrat historike që kishin marrë - çlirimin, pavarësinë dhe lirinë e vendit.

⁴⁹ Drançolli, *Arbërit ndërmjet*, f. 105.

⁵⁰ Malcolm, *Kosova - një histori*, 93.

⁵¹ *Po aty*, 93.

Don Dominik QERIMI, SDB
(Prishtinë)

**MARRËDHËNIA E GJERGJ KASTRIOTIT-
SKËNDERBEUT ME SELINË SHENJTË, KLERIN DHE
KISHËN KATOLIKE**

Gjatë historisë çështja e marrëdhënies së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Selinë e Shenjtë, me klerin dhe Kishën Katolike, që janë objekt i kësaj kumtese, është parë si pjesë të pandashme e një çështjeje shumë më të gjerë dhe më të ndërlikuar: çështjes fetare në jetën dhe veprimtarinë e tij. Kjo çështje gjatë historisë është parë dhe gjykuar me kritere të ndryshme, varësisht nga rrethanat ideologjike dhe pushtetit politik të kohës. Mjafton të përmendim qasjen ndaj kësaj çështjeje nga ana e studiuesve në periudhën e komunizmit dhe atë të post komunizmit:

1. *Në periudhën komuniste*¹- Aq i madh ka qenë aversiteti ndaj çdo çështjeje fetare, saqë i vetmi rast në të cilin është trajtuar çështja fetare në jetën dhe veprimtarinë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ka qenë për të theksuar mungesën e ndihmës nga ana e papatit dhe hipokrizinë me të cilën Selia e Shenjtë e ka trajtuar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe kauzën e tij. Andaj, çdo marrëdhënie e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Selinë e Shenjtë, me papët dhe klerikët e Kishës Katolike, shihej dhe interpretohej vetëm si një përpjekje e shfrytëzimit të ndërsjellët për të arritur qëllimet e veta. Sipas këtij

¹ Petrika Thëngjilli, *Skenderbeu arritje, mangësi, pikëpamje të ndryshme*, Artini, Prishtinë 2012. f. 385-400.

botëkuptimi, marrëdhënia e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Selinë e Shenjtë dhe përfaqësuesit e saj, ishin vetëm një instrument për të ruajtur pushtetin dhe për të mbrojtur vendin e tij.

Ky regjim në thelbin e tij më shumë se ateist ishte regjim antiteist, andaj antifetar dhe antikishtar, andaj e trajtonte si armik çdo fe dhe përfaqësues të saj, por në hapësirën tonë, Kishën Katolike e kanë parë si armikun më të madh dhe më të rrezikshëm. Dëshmi e kësaj armiqësie gjatë këtij regjimi është edhe numri i madh i martirëve klerikë², veçanërisht i klerikëve të Kishës Katolike.

2. Në periudhën *pas rënies së komunizmit* dhe asaj të *pasluftës në Kosovë* - me ngritjen e disa çarqeve dhe rrymave me nostalgji filoosmane dhe me prirje filoislamike, nga njëra anë janë munduar ta paraqesin Gjergj Kastriotin-Skënderbeun duke theksuar vetëm aspektin e luftës së tij në mbrojtje të krishterimit - me qëllimin e vetëm që të nxiten të gjithë shqiptarët e besimit islam ta refuzojnë figurën e tij si hero kombëtar, duke dashur të bindin të gjithë se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu nuk ka luftuar për kombin shqiptar, por vetëm në mbrojtje të krishterimit, duke e konsideruar si armik të islamit. E gjithë kjo, nuk është bërë dhe nuk bëhet për të paraqitur realitetin dhe të vërtetën e motiveve të luftës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, por është vetëm një “preludium” për t’i nxitur shqiptarët e besimit islam që ta mohojnë se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu është hero i tyre.

3. Veçanërisht në dhjetë vitet e fundit, jemi duke asistuar në disa debate mediatike të atyre që si kundërpërgjigje kanë kaluar në tre ekstreme, për sa i përket marrëdhënies së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me fenë dhe përfaqësuesit e saj në jetën dhe veprimtarinë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut:

a) *Relativistët dhe sinkretistët* - Çështjen fetare në jetën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut janë munduar ta minimizojnë deri në atë pikë, sa ta anashkalojnë krejtësisht në trajtimet që i bëjnë jetës

² Zef Simoni (Imzot), *Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri nga 1944-1990*; në: Krishterimi ndër shqiptarë, Simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, f. 368-389; Markus W. Peters. *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Ylber, Tiranë 2010.

dhe veprimtarisë së tij. Sipas qëndrimit të tyre, çështja fetare në jetën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut nuk ekziston dhe nuk duhet të ekzistojë fare. Sipas tyre janë të tjerët (veçanërisht biografët e tij të parë, andaj klerikët katolikë) ata që Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, jetës dhe veprave të tij, i kanë dhënë ngjyra fetare.

b) *Çmitizuesit* - një grup “studiuësish”³ që nga njëra anë kanë shpallur për mision të tyre shkencor çmitizimin e figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, nga ana tjetër nuk bëjnë as dallimin minimal mes “legjendës” dhe “mitit”. Të tillë, pseudo-studiuës, analist dhe “showman” nuk kanë bërë tjetër, veçse kanë shpërftyruar figurën e tij⁴, duke shndërruar gjithçka në një mit, andaj duke vënë në dyshim edhe vetë ekzistencën e tij si person dhe figurë historike.

c) *Mbrojtësit e “status quo-së”* - një grup studiuësish të cilët, në emër të mbrojtjes së vlerës së çmueshme të *harmonisë fetare*, me çdo kusht duan që Gjergj Kastriotin-Skënderbeun ta zhveshin nga çdo petk dhe aspekt fetar. Në emër të ruajtjes së *status quo-së*, në emër të mbrojtjes së harmonisë ndër-fetare në popullin tonë, e kanë theksuar dhe vazhdojnë ta theksojnë vazhdimisht faktin se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu paskëshe qenë: së pari ortodoks, pastaj është bërë, mysliman dhe në fund ka vdekur si katolik. Madje ka të tillë që thonë se ai të tre këto bindje i ka jetuar në të njëjtën kohë.

Të tre këto grupe të lartpërmendura çështjen e fesë në jetën dhe veprimtarinë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut e shohin jo vetëm si të panevojshme, por edhe të rrezikshme. E si mundet një shkencëtar ta shohë si të rrezikshme studimit, hulumtimin dhe kërkimin e së vërtetës? E vërteta është pikërisht ajo që një shkencëtar lufton për ta

³ AA.VV. *Përpyekja* 28-29, Skënderbeu i kërkimit shkencor; Schmitt, Oliver Jens, *Skënderbeu*, K&B, Seria albanologjike, Tiranë 2009; Petrika Thëngjilli, *Op. Cit.* f. 401-422; Liperi, Dhosi. *Mitologjia Skënderiane*, Skënderbeu Legjendar, Emar, Tiranë 2014; Shehri, Dhurata, *Rrugëtimi i një miti në letërsi*, në Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në historinë e shqiptarëve, Tiranë, 2005.

⁴ Kristo Frashëri, *Skënderbeu i shpërftyruar*, Dudaj, 2009; Ardian Ndreca, *Kur “Skënderbeu” nuk asht historia e Skënderbeut*, Onufri, Tiranë 2008; Sandër Lleshi, *Skënderbeu, ose misioni i pamundur i Schmitt-it*, Onufri, Tiranë 2009.

zbuluar me çdo kusht, me bindjen se “E vërteta do të na bëjë njerëz të lirë!” (Gjn 8, 32).⁵

Mendoj se është me vend që të kujtoj një nga parimet themelore të të bërit histori: të mos gjykohet dhe interpretohet e kaluara me mentalitetin dhe kategoritë e së tashmes, por çdo person, ndodhi, tekst apo objekt studimi, të vendoset në kontekstin dhe rrethanat e kohës së vet.

Në hapësirën dhe kohën në të cilën jetojmë, jemi të mësuar në mënyrë të natyrshme të bëjmë dallimin e qartë mes pushtetit politik dhe fesë. Megjithatë ne e dimë se gjatë historisë kjo çështje ka qenë shumë e ndërlikuar dhe në shumë vende të botës kjo çështje ende nuk është e qartësuar në tërësi edhe pse sot jemi në shek. XXI. Edhe vetë kontinenti i Evropës, që është pioniere në këtë fushë, ka filluar të trajtojë këtë çështje nga viti 1122 me “*Marrëveshjen e Wormsint*”⁶ aty ku u përcaktua definitivisht çështja e emërtimeve, kufizimet e autoritetit mbretëror dhe të autoritetit kishtar, por është dashur të presë shekullin XVII që të mbërrijë një teori të plotë të ndarjes mes shtetit dhe Kishës, e pushtetit civil nga pushteti shpirtëror/fetar. Me kalimin e kohës, ndarja e këtyre dy pushteteve ka mbërritur deri në atë pikë sa, në Revolucionin Francez ka mbërritur kulmin e saj, duke e vënë shtetin dhe Kishën si dy pushtete armiqësore mes tyre. Ide e mbështetur dhe e çuar në ekstrem në kohën e regjimit komunist.

Megjithatë, duhet të kemi të qartë se për botëkuptimin e një epoke, siç ishte ajo në të cilën ka jetuar dhe vepruar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, çështja e fesë ishte pjesë e pandashme nga çështjet tjera të jetës së çdo perandorie, mbretërie, principate, fisi, familjeje. Çështja fetare ishte pjesë e pandashme e jetës së përditshme, qoftë asaj individuale qoftë asaj shoqërore dhe politike. Sipas J. M. Robert, “*Në ato vite të devocionit të thellë fetar, ‘Feja ishte vetë qëllimi i jetës!’*”⁷. Në mesjetë perandoritë, mbretëritë, principatat, popujt,

⁵ Shkrimi Shenjt, Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, Konferenca Ipeschkvore e Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 1315.

⁶ Ludwig Hertling, Angiolino Bulla, *Storiadella Chiesa*, Citta’ Nuova, Roma 1967, f. 196-197.

⁷ J. M. Roberts: *A Concise History of the World*, New York: Oxford Univers, Press, 1995, f. 177.

janë identifikuar me një gjuhë, me një territor, me lidhjen e gjakut dhe me një fe. T'i përkasësh një feje nuk ishte një element dytësor apo i parëndësishëm, por në të vërtetë tregonte edhe përkatësinë dhe identitetin e një shoqërie dhe një personi. E dimë mirë se shumë herë njerëzit është dashur të ndryshojnë fenë e tyre, si dëshmi e përkatësisë dhe besnikërisë së tyre ndaj perandorisë, mbretërisë apo principatës. Në këtë epokë kohore që po trajtojmë mbizotëronte shumë parimi "*Cuius regio, eius religio*" - "*I atij që është pushteti, i atij është edhe feja*", edhe pse ky parim u formuluar zyrtarisht në "Paqen e Habsburgut", më 1555⁸. Andaj, të thuash se në mesjetë elementi fetar ishte i parëndësishëm për një gjeneral, princ apo mbret, siç ishte Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, është një e padrejtë që i bëhet epokës në të cilën ai ka jetuar, popullit, tokës dhe kulturës që ka mbrojtur.

Në atë kohë ishte krejtësisht e natyrshme që mbretëritë evropiane të identifikoheshin me krishterimin, sepse të tillë ishin, dhe ishte krejtësisht e natyrshme që Perandoria Osmane të identifikohesh me islamin, sepse e tillë ishte. Edhe njëra edhe tjetra kishin ndërtuar botëkuptimin e organizmit shtetëror, shoqëror, familjar dhe individual të mbështetur njëra në parimet e krishterimit e tjetër në parimet e islamit. Andaj, të luftosh një mbretëri evropiane do të thoshte të luftosh një mbretëri të krishterë dhe anasjelltas, të luftosh Perandorinë Osmane do të thotë të luftosh një perandori islame.

Duhet kujtuar se perandoritë dhe mbretëritë e asaj kohe nuk mbështeteshin vetëm në elementin etnik - e aq më pak kombëtar, meqë koncepti dhe çështja kombëtare ende nuk kishte lindur - dhe se perandoritë, mbretëritë dhe principatat e asaj kohe, në shumicën e rasteve përbëheshin nga popuj me gjuhë, racë dhe etni shumë të ndryshme nga njëra-tjetra (mjafton të kujtojmë këtu konglomeratin e etnive dhe popujve të panumërt që përbënin Perandorinë Osmane). Elementi fetar, bashkë me atë ekonomik, territorial dhe fisnor, ishin elementet më të forta unifikuese të asaj perandorie, mbretëri apo principate.

⁸ Ludwig Hertling, Angiolino Bulla, Op. cit., f. 322-323.

Evropa Perëndimore - ajo Evropë e cila që nga viti 800, me kurorëzimin e Karlit të Madh, deri në fillimin e shek. XIX me luftërat e Napoleonit, quhej “Imperiumchristianum”⁹- dhe në veçanti Selia e Shenjtë përmes udhëheqësve të saj, e shihnin Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, jetën dhe veprimtarinë e tij si një “*Athleta Christi - atlet i Krishtit*” (ushtar, mbrojtës, luftëtar i Krishtit), “*gjeneral i guximshëm*”, “*mbrojtës i Evropës*”, “*mbrojtës i fesë së krishterë*”, mbrojtës i qytetërimit evropian,¹⁰ që në atë kohë do të thoshte qytetërim i krishterë katolik. Ndërkohë që papa Eugjeni IV, në planet tij për të organizuar një kryqëzatë antiosmane e shihte si element kyç Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe ushtrinë arbërore¹¹. Në letrën e tij të shkruar, më 28 dhjetor 1457, pas betejës së Albulenës, papa Kalisti III, e quan kështu Gjergj Kastriotin-Skënderbeun: “*Mbrojtësi i krishterimit dhe kapiten i përgjithshëm i Selisë së Shenjtë!*”¹²dhe dërgon nuncin Giovanni Navarro për të mbledhur para për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Ndërkohë që pasardhësi i tij, Piu II, kështu shpreh bindjen e tij për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun: “*Ai (Skënderbeu) konsumoi gjithë jetën e vet tue luftue për kauzen e krishtenë*”¹³.

Janë pikërisht këta papët, në veçanti Kalisti III¹⁴ dhe Piu II,¹⁵ që e afirmuan figurën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut pranë kancelarive të mbretërive perëndimore, që në fillim ishin shumë skeptikë për personin dhe qëllimet e tija. Janë pikërisht këta papët, ata që më shumë se asnjë tjetër e mbështetën atë me ndihma, por mbi

⁹ Owen M. Phelan. *The formation of Christian Europe: The Carolingians, Baptism, and the Imperium Christianum*, Oxford, 2014.

¹⁰ AA. VV., *Gjergj Kastrioti “Athleta Christi” (Përzgjedhje studimesh të klerikëve katolikë)*, Botime Françeskane, Shkodër 2018.

¹¹ Alessandro Serra, *Shqipëria dhe Selia e Shenjtë në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*, Drita, Prishtinë 2018, f. 21-25.

¹²Ibid.,f. 41

¹³Fan Stylian Noli: *GeorgeCastriotiScanderbeg (1404-1468)*.International Universities Press, New York: N.Y., 1947. f. 74.

¹⁴Giuseppe Valentini, M. Schiambra, I.Parrino. *Papa Kalisti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe kryqëzata (1455-1458)*, Plejad, Tiranë, 2009.

¹⁵Aurel Plasari, *Skënderbeu, një histori politike*, Instituti Shqiptar i studimeve Gjergj Fishta, Tiranë 2010, f. 554-600.

të gjitha nxitën mbretëritë e krishtera që ta mbështesnin atë me ndihma ekonomike dhe ushtarake. Pjesa më të madhe e historianëve që janë marrë me këtë çështje pohojnë, pa asnjë mëdyshje, të mbështetur në faktet e dokumentuara, se ndihma e papëve ndaj Skënderbeut ishte më e madhe se e çdo shteti tjetër të veçantë: Farlati, Marinesco, Cungnoni, Pastori, Gegaj dhe Noli... për të përmendur vetëm disa prej tyre, por këtë çështje e ka trajtuar në mënyrë të hollësishme edhe Kristo Frashëri në monografinë e tij¹⁶.

Në lidhje me këtë çështje është shprehur shumë qartë edhe peshkopi ortodoks, historiani i mirëfilltë dhe shembullor, Fan S. Noli, i cili ndonëse nuk i përkiste kishës katolike dhe nuk kishte ndonjë interes personal për të mbrojtur, pohon: *“Kampioni i Krishtenimit”, ai luftoi kryesisht nën urdhërat direktë të Papëve të ndryshëm dhe vetëm rastësisht nën urdhnat e Fuqive të tjera, edhe këtë vetëm kur kishte autorizimin e Papëve për një qëndrim të këtyllë*”. Noli e përcakton me mjeshtri faktin se *“Feja (katolike) shërbeu gjithashtu edhe si një hallkë për lidhjen me botën e Perëndimit”*.¹⁷

Nuk duhet harruar asesi faktin se identiteti i popullit shqiptar: organizimi politik dhe shoqëror, historia, kultura, tradita, arti... ishin të gjitha të lidhura ngushtë me elementi fetar të krishterë (ku me ndikim të Kishës Lindore të Kostandinopojës e ku në ndikimin e Kishës Perëndimore të Romës) tash 15 shekuj. Andaj, është e pamundur dhe, më lejoni të them “paksa qesharake” - të thuash se për një popull që ka ndërtuar historinë e tij për 15 shekuj mbi kulturën filozofinë dhe konceptin e shoqërisë dhe të individit që ka besimi i krishterë, elementi fetar ishte një element i parëndësishëm. Çdo argument dhe fakt historik e kundërshton këtë gjë. Ajo që dua të them është se feja ka qenë element jo vetëm i rëndësishëm, por thelbësor jo vetëm i jetës dhe veprës së Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, por edhe i të gjithë atyre që kanë qëndruar dhe luftuar përkrah, apo kundër tij. Por, kuptohet jo i vetmi element dhe jo i vetmi motivim, sepse jam i bindur se aq sa ka luftuar për të

¹⁶Krh. Kristo Frashëri, *Skënderbeu jeta dhe vepra*, Toena, Tiranë 2002.

¹⁷Op. Cit. f. 74.

mbrojtur kauzën e krishterë, aq ka luftuar për të mbrojtur edhe tokën dhe pronat e tij, tokën dhe pronat e babait të tij; lirinë e familjes, të afërmeve, principatës dhe popullit të tij; traditën, kulturën, gjuhën dhe historinë e vendit të tij. Është e padrejtë, është e padrejtë historike, të thuhet se Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ka luftuar vetëm për një motiv/arsye. Dhe është pothuajse e pamundur që sot të themi me saktësi shkencore, siç duan të bëjnë disa pseudo-historianë, se cili ka qenë motivi parësor që e ka shtyrë Gjergj Kastriotin-Skënderbeun të jetë ai që ka qenë dhe të bëjë atë që ka bërë.

Por, kuptohet se kjo gjë nuk ka të bëjë me marrëdhënien e tij vetëm me klerikët e Kishës Katolike, por edhe me klerikët e saj. Një mbret, princ apo udhëheqës shtetëror i asaj kohe, duhej të ishte shumë i kujdesshëm se me kë bashkëpunon dhe mbi kë mbështetet në udhëheqjen e vendit/popullit të tij. Me siguri se pas organizimit ushtarak, dy detyra nga detyrat më delikate ishin: përgjegjësia për pasuri dhe përgjegjësinë diplomatike, për marrëdhëniet me aleatë. Këto ishin dy elemente që vinin në lojë tërë pushtetin e një udhëheqësi.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, ndërkohë që udhëheqjen ushtarake e drejtonte vet, në politikën e tij të brendshme dhe të jashtme nuk mund të mos mbështetej në mendje më të ndritura të epokës së vet, në Arbëri dhe përtej. Për të kujtuar vetëm disa prej tyre: *Dhimitër Frangu* prift katolik nga Drishti, që ka shërbyer pranë Skënderbeut dhe si funksionar financash, dhe ka shkruar në veprën e tij origjinale latinisht, të përkthyer në italisht pas vdekjes pa emrin e tij, Venedik 1539 “Commentariodelle cose de turchi, et del S. Georgio Scanderbeg, principe di Epyrro” - Komentari për punët e turqve dhe të zotit Gjergj Skanderbeg, Princ i Epirit¹⁸; ishte i dërguari i posaçëm në Romë, pas rënies së Kostandinopojës, që mori ndihma nga Papa. Tre vëllezërit dhe intelektualët *Pal Gazulli*¹⁹ (ai që e quanin mendja e Kastriotit) dhe vëllezërit e tij *Gjini (doktor i*

¹⁸Dhimitër Frangu, *Luftërat e turqve kundër Skënderbeut*, Globus R, 2000, Frangu, Dhimitër, *Veprat e lavdishme të Skënderbeut*, Arbëria, 2001.

¹⁹Jahja Drançolli, *Arbrit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës*, Misioni katolik shqiptar në Kroaci, Zagreb 2008; dhe Jahja Drançolli, *Shteti mesjetar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*, Dukagjini, Pejë 2001.

shkencave dhe astronom shumë i çmuar, profesor i Universitetit Al'Bo' të Padovës) dhe *Andreu*, të cilën ishin të specializuar në marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Raguzën, shtetin e Papës dhe Mbretërinë e Hungarisë.

Arqipeshkvi i Durrësit, humanisti dhe diplomati i “politikës së jashtme dhe të brendshme” të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, *Pal Engjëlli*²⁰, falë ndërhyrjes së të cilit, me nxitjen dhe mbështetjen e Piut II, i pajtoi Dukagjinast me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun.

Martin Segoni - ishte ipeshkëv i Ulqinit, me origjinë nga Novobërda (Artana). Dihet se më 1475 doktori në Padovë, se “fëmijërinë duhet ta ketë kaluar në trojet shqiptare, i endur dhe i lëkundur nga luftërat e Skënderbeut. Në oazat e humanizmit shqiptar duhet të ketë marrë mësimet e para, ato të mesmet në Raguzë, për të kryer studimet në qendrat universitare të Italisë Veriore. Deri më 1474 shërbeu si prift në kishën katolike të Shën Mërisë të Novobërdës; *Gjergj Pelini* benediktin i Novobërdës²¹, ambasador i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut pranë Republikës së Venedikut (krh. Jahja Drançolli); *Pjetër Perlati*, prifti katolik matjan, që drejtonte garnizonin e Sopotnicës (Sfetigradit).

Nunci i papës *Giovanni Navaro*, 1457 shkoi për të mbledhur në Shqipëri dhe vendet fqinje ndihma në të holla për GJKS; *Antonio de Oliveto*, një françeskan me detyrën e nuncita postoi në viset e Shqipërisë dhe të Skllavonisë (Dalmacisë) të caktuar nga papa Nikolla V, posa e mora emërimin e tij si papë (1447); ai u zëvendësuar më 21 shtator 1451 nga një françeskan tjetër shqiptar *Eugjen Suma*.

Ndre Snatiku; *Abati Lazër*; të pranishmit në nënshkrimin e mandatit të Skënderbeut për Papën, të datës 28 tetor 1458, të lëshuar në Rodon në vendin e Shën Mërisë, që në prani të Pal Gazullit ishin edhe atë *Pjetër Duka*, abat prothosengulator (i betuar); vëlla *Bardhi*,

²⁰Paolo Angelo (2004) [1539], *La vita di Scanderbeg di Paolo Angelo (in Italian)*, translated by Laporta, Alessandro; *Giovio, Paolo, Galatina: M. Congedo*; Lorenzo Tacchella: *Giorgio Castriota Skanderbeg e i romani pontefici nel sec. 15. Paolo Angeli arcivescovo di Durazzo e ambasciatore di Skanderbeg a Venezia nel 1467*. U. Seregni, Milano 2000.

²¹Aurel Plasari, Op. Cit., f. 559-563.

priori i Kuvendit të Shkodrës nga Urdhri i predikuesve (domenikan); dhe nunci apostolik në Shqipëri, *Rione Celnicho*; Noteri, *Johannes Borcius de Grillis*, prift i ipeshkvisë së Durrësit, notar publik që firmos mandatin.

Që lufta e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ka pasur një karakter fetar, madje shumë të fortë, kjo nuk ka asnjë dyshim as më të vogël. Megjithatë të përpiqesh që arsye e luftës së tij ta ngushtosh vetëm në petkun fetar, e cilitdo profesion qoftë ajo, mendoj se është një e padrejtë e madhe që i bëhet atij, veprës së tij, bashkëluftëtarëve të tij dhe popullit shqiptar qoftë të kohës së tij qoftë të kohës së mëvonshme duke na përfshirë edhe ne që jemi këtu të pranishëm. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ka jetuar, luftuar dhe vdekur:

1. Në mbrojtje të fesë, gjegjësisht të fesë së krishterë, që për popullin arbëror, të lëkundur mes erërave të Lindjes dhe Perëndimit, ishte pjesë e identitetit të tij tash katërmbëdhjetë shekuj.

2. Në mbrojtje të atdheut: popullit, principatës, fisit, familjes dhe tokës së tij dhe të paraardhësve të tij; duke e mbrojtur dhe duke mos e braktisur atë edhe atëherë kur iu afruan shumë propozime dhe alternativa qoftë nga Perëndimi qoftë nga Lindja.

3. GjK-S luftoi për të mbrojtur vlerën e *gjuhës, kulturës, traditës,...* historisë së popullit të vet dhe falë luftës së tij për këto vlera, ne sot gëzojmë atë liri që më mundëson mua të flas mbi këtë foltore, e ju të jeni të pranishëm në këtë manifestim.

4. GjK-S luftoi për të ruajtur "*besën*", duke qëndruar besnik ndaj popullit dhe aleatëve të tij, në listën e të cilëve në vend të parë ishte Selia e Shenjtë, përmes papëve Nikollës V, Eugjenit IV, Kalistit III, Piu II, Pali II; Mbretëria e Napolit (përmes Alfonsit V dhe Ferdinandit II); Venediku (kur u leverdiskej atyre); Janosh Huniadi, Republika e Raguzës, Mbretëria e Hungarisë, Dukati i Burgonjës, Mbretëria e Sicilisë... e shumë, e shumë të tjerë. Kurrë dhe në asnjë moment nuk e ka tradhtuar ndonjërin prej tyre edhe atëherë ku është dashur t'ua kthejë shpatën për të mbrojtur vendin dhe popullin e tij.

Andaj në fund do doja t'i bëja vetes dhe juve një pyetje: Kush është Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe kujt i përket ai?

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu së bashku me Nënë Terezën kanë qenë dy kometa, dy kometa që kalojnë çdo pesëqind vite mbi qiellin

e “zymtë” të historisë sonë. Por, dy kometa dritën e të cilave e ka parë gjithë Evropa për heroizmin dhe guximin e besnikërisë së njerit dhe dashurinë që bëhet shërbim i pakushtëzuar i së tjetrës. Dy kometa që kanë kaluar mbi qiellin tonë, por rrezet e dritës të së cilëve ende vezullojnë në sytë e shpirtit tonë.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu është i çdokujt dhe i askujt! Gjergj Kastrioti-Skënderbeu është i çdo personi që i do dhe i mbron vlerat që i ka dashur dhe mbrojtur Gjergj Kastriotin-Skënderbeun: familja, atdheu, liria, besimi, gjuha, kultura dhe historia. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu është i çdo shqiptari! Po aq sa është i një shqiptari katolik, është edhe i një shqiptari ortodoks, mysliman, relativist, sinkretist, ateist etj. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu është i çdo evropiani, i çdo njeri vullnetmirë në këtë botë, i cilitdo shtet dhe cilitdo kontinent qoftë, është i çdo njeri kudo qoftë në këtë botë që i do vlerat dhe virtytet për të cilat Gjergj Kastrioti-Skënderbeu jetoi, luftoi dhe vdiq. Duke kujtuar “klithjen” e Voltairit, që po komentonte rënien e Kostandinopojës në duart e Mehmet pushtuesit: “*O po të kishin vepruar perandorët grekë si Skënderbeu, Perandoria e Lindjes ende do të mund të ishte e qëndrueshme*”,²² do dëshiroja që këtu të bëja një parafrazim: “O po të kishte populli i Kosovës, i Shqipërisë, i Evropës dhe i botës sot një Gjergj Kastriot-Skënderbeu”.

Dua të përfundoj me një citat nga “*Mesazhi i ipeshkvijve të Shqipërisë për Vitin kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut, 17 janar 2018*”: “*Ne duam të falënderojmë Zotin që, falë burrave dhe atdhedashësve si Skënderbeu, sot kemi lirinë, kemi një atdhe... Skënderbeu nuk harroi rrënjët e tij shoqërore dhe shpirtërore, as u josh nga pushteti që i jepej. Si i tillë Skënderbeu nuk i përket vetëm një grupi njerëzish, një krahine apo një feje, por të gjithë atyre që e ndjekin lirinë si një aspiratë të brendshme për të cilën ia vlen çdo sakrificë*”.²³

²² François-Marie Arouet - Voltaire, *Candide*, The university of adelaide, 1759, chap. XXVII.

²³ “*Mesazhi i ipeshkvijve të Shqipërisë për Vitin kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*”, Radio Vatikani, zëri i Papës dhe i Kishës në dialog me botën, në: http://sq.radiovaticana.va/news/2018/01/18/mesazhi_i_ipeshkvijve_t%C3%AB_shqip%C3%ABris%C3%AB_p%C3%ABr_vitin_e_sk%C3%ABnderbeut/1359448

Adem BUNGURI
(Tiranë)

TË DHËNA TË REJA MBI DISA FORTIFIKIME TË PERIUDHËS SË SKËNDERBEUT NË RAJONIN E DIBRËS

Objekt i këtij punimi janë rezultatet e vrojtimeve sipërfaqësore të kryera nga autori në disa nga fortifikimet e kësaj periudhe, topografikisht të lokalizuara në rajonin e Dibrës¹. Ai synon jo vetëm paraqitjen para opinionit shkencor të këtyre rezultateve, por edhe korrigjimin e ndonjë mendimi vulltarist që nuk i përgjigjet të vërtetës historike. Që në fillim duhet të vemë në dukje konstatimin tonë mbi përputhjen e plotë të përshkrimeve të Barletit me topografinë e kalave të Skënderbeut në terren, aq sa shpesh mbetesh i mahnitur nga detajet dhe saktësia e tyre. Kalatë dhe strukturat fortifikuese që lidhen me periudhën e Skënderbeut në rajonin e Dibrës, janë:

1. Kalaja e Koxhaxhikut (Zhupë-Dibër)
2. Kështjella e Modricit (Dibër)
3. Kalaja e Skudrinës (Rekë-Dibër)
4. Kalaja e fshehtë e Skënderbeut (Çidhën e Poshtme-Dibër)

¹ Dokumentacioni grafik është përgatitur kryesisht nga topografi P. Naipi (kalaja e Koxhaxhikut, Modricës, dhe Skudrinës) dhe pjesërisht nga Dr. E. Hobdari (Kulla e Skënderbeut), ndërsa fotografitë janë të autorit. Me këtë rast, falenderojmë të gjithë bashkëpunëtorët që më kanë shoqëruar dhe ndihmuar gjatë vizitave në monumentet e mësipërm.

5. Qyteza e Valikardhës (Vajkal-Bulqizë)
6. Kulla e Skënderbeut (Vajkal-Bulqizë).
7. Qyteti i Stelushit (Qafë-Murrë) në kufirin midis Dibrës dhe Matit (fig. 1).




Fig. 1. Harta e disa fortifikimeve të periudhës së Skënderbeut

Sipas vlerësimit kronologjik ato mund të ndahen në dy kategori:

- a. Fortifikime mesjetare, gjasisht të periudhës së Skënderbeut, me depozitime më të hershme të periudhës prehistorike dhe asaj të vonë antike.

b. Fortifikime të lidhura ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Në kategorinë e parë përfshihen: Kalaja e Koxhaxhikut, Kalaja e Skudrinës, qyteza e Valecardës, qyteti i Stelushit, ndërsa në kategorinë e dytë kështjella e Modricës, kalaja e fshehtë e Skënderbeut në Çidhën të Poshtme dhe kulla e Skënderbeut në Vajkal. Në këtë punim do të trajtohen shkurt disa prej monumenteve të mësipërm.

1. Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër) (x-41°44', y-20°59', z-1160m)

Kalaja e Koxhaxhikut ndodhet në krahinën e Zhupës, midis Dibrës dhe Strugës, në krahun e djathtë të Drinit të Zi, në skajin lindor të Dibrës (Maqedonia e Veriut). Ajo është vendosur në një kreshhtë shkëmbore me lartësi absolute 1160m dhe relative 360m, që ngrihet në luginën midis fshatrave Koxhaxhik në juglindje dhe Breshtan në veriperëndim, malit të Stogovës në lindje dhe përroit të Koçistës në veri. (fig. 2-4).



Fig. 2-4. Pamje të kalasë së Koxhaxhikut

Kalaja ka një pozicion të favorshëm strategjik në zotërim të rrugës Ohër-Dibër. Nga sipërfaqja e saj kontrollohet lehtësisht lugina e Drinit të Zi, nga kështjella e Modricës në jug deri në malin e Bardhë e atë të Pratit në veri, si edhe i gjithë krahu i djathtë i Drinit të Zi, nga kodrat e Zhupës në jug deri në qytetin e Dibrës së Madhe në veri, nga kalonte rruga antike dhe ajo mesjetare Koxhaxhik-Dibër. Rruga e Drinit të Zi bashkon dy arteriet më të rëndësishme rrugore transballkanike të periudhës romake: vian Egnatia në jug (Ohër) dhe atë Lissus-Naissus në veri (Kukës). Duke qenë degëzimi verior i via Egnatias, rruga e Drinit të Zi përfaqëson një korridor mjaft strategjik për të gjitha periudhat prehistorike dhe historike. Pozita topografike e kalasë së Koxhaxhikut përputhet plotësisht me përshkrimin e Barletit mbi qytetin e Sfetigradit, aq sa ngjan si fotokopje e tij.

Ai e cilëson këtë qytet si „ vend fort i mbrojtur dhe gati i paafrueshëm”,² dhe tregon se “...vendi atje ishte aq i pjerrët, sa s’ të zinte këmba dhë gjëkund e s’kishe ku të mbaheshe, veçse me ndonjë litar të fortë”³, dhe se: “rreth murevet s’kishte veçse një rryp shumë të ngushtë që ishte shesh, kurse pjesa tjetër e malit, që vinte menjëherë, ishte fund e krye një rrëpirë e hatashme”⁴. Ai shkruan se “Qyteti (i Sfetigradit) ishte malor e i ndërtuar në majë të një shkëmbi shumë të lartë, pa asnjë burim uji përbrenda, por edhe pa ndonjë lum afër për ta përdorur. Kishte vetëm një pus brenda, të hapur e të ndërtuar në mes të qytetit, nga kujdesi i lashtë i popullit për dobi vetjake e të njerëzve dhe sidomos për nevojat e luftës... Roja e gjitha përbëhej nga ushtarë dibranë”⁵. Sipas Barletit kështjella e Sfetigradit (Koxhaxhikut) ka pasur madhësinë e kështjellës së Stelushit si dhe një pozitë topografike krejt të ngjashme me të, gjë që është konfirmuar nga gërmimet arkeologjike⁶. Kalaja e Koxhaxhikut ruan gjurmë të banimit të saj gjatë periudhës së Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm, periudhës së vonë antike dhe asaj

² BARLETI (1537) 1964, VI, 235.

³ *Idem*, V, 198.

⁴ *Idem*, VI, 237.

⁵ *Idem*, V, 220.

⁶ ANAMALI 1967,105-110.

mesjetare, si dhe pjesë të sistemit fortifikues të dy periudhave të fundit.

a. Periudha e Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm (shek. XII-IX para Kr.)

Kësaj periudhe i takojnë 5 fragmente enësh. Ata u gjetën në sipërfaqen e kalasë dhe në shpatet jugore të saj. Tre prej tyre janë punuar me brum të kuq argjilor, të përzier me kokriza rënore dhe guralecë të vegjël, me pjekje të njëtrajtshme por jo të plotë, me faqe të lëmuar mesatarisht, dhe ngjyrë kafe në të kuqëremtë, ndërsa ndeshen dhe ato me brum kafë në bezhë. Përfaqësojnë tipin e enëve dyvegjake, me vegjë të ngritura mbi buzë (*fig. 5a-b*), tip mjaft i përhapur në periudhën e Bronzit të Vonë dhe atë të tranzicionit Bronz-Hekur, si në territorin e Shqipërisë (Maliq III⁷, Nezir VI (Mat)⁸, Gajtan III⁹, Zagorë II (Shkodër)¹⁰ e të Kosovës (Vlashnje, Hisar)¹¹, ashtu edhe në atë të Pelagoonisë (grupi pelagonas)¹² etj. Vetëm një prej pareteve ruan dekorin shiritor në trajtë brinjësh plastike, të zbukuruara me shtypje gishti dhe thellime bigle (*fig. 5a, 3, fig. 5b, 5*), teknikë dekorative kjo mjaft karakteristike për poçerinë e epokës së Bronzit në Shqipëri¹³ dhe në një areal mjaft të gjërë ballkanik¹⁴. Megjithëse mjaft të pakta, ata e cilësojnë kalanë e Koxhaxhikut si një vendbanim kodrinor të periudhës së Bronzit të Vonë dhe fillimit të epokës së Hekurit. Vendbanime të tilla të vendosura në maja kodrash dhe të fortifikuara me mure prehistorike,

⁷ PRENDI 1977-1978,13, tab. VIII, 2, IX, 5; PRENDI 1966, pl. XVII, 1, 6; PRENDI 1982, pl. IV, 9; PRENDI 1974, 107, tab. VIII, 1-5, IX, 3.

⁸ ANDREA 1990, 38, tab. XVI, 15-16.

⁹ JUBANI 1972, tab. X, 5.

¹⁰ ANDREA 1996, 31, tab. VII, 3.


¹¹ BUNGURI-GASHI 2004, "AiA",Tiranë, Prishtinë; BUNGURI-GASHI 2006,"AiA", Tiranë, Prishtinë.

¹² GARAŠANIN 1983b, 788, tab. CIX, 1-2.

¹³ PRENDI 1977-1978, 13.

¹⁴ GARAŠANIN 1983a, 463-470, fig. 33, II, 1, 4 dhe III, 1, 4.

njihen si kala të tipit Gajtan¹⁵, tip ku duhet të përfshihet edhe Koxhaxhiku, pavarësisht nga mungesa e fortifikimit prehistorik, që për shkak të mbrojtjes së fuqishme natyrore, duket se nuk ka qenë i nevojshëm.



1.4 - KOKHAXHIK

Fig. 5a-b-Fragmente enësh të Bronzit të Vonë të kalasë së Koxhaxhikut

¹⁵ ISLAMI- CEKA 1965, 448-449.

b. Periudha e vonë antike (shek. V-VI pas Kr.).

Kalaja ruan një sistem të thjeshtë fortifikues, që i përket periudhës së vonë antike dhe asaj mesjetare. Ky fortifikim gjendet në pjesën më të lartë të kreshtës shkëmbore të kalasë dhe përbëhet nga muri rrethues, një kullë katrore dhe hyrja pranë saj. Kreshta e kalasë mbyllet me një platformë të sheshtë afërsisht poligonale, me kalime të buta në këndet, që brenda mureve ka përmasa 58x34m, perimetër 145m dhe sipërfaqe rreth 1600m². Kjo platformë e fortifikuar, e njohur si “citadela”, ka rrënje plotësisht shkëmbore nga jugperëndimi, perëndimi dhe veriperëndimi, ndërsa nga anët tjera pjerrësia e shpateve të saj është shumë e madhe dhe thuajse e pangjtitshme. Shtegu i vetëm që mundëson ngjitjen në kala, gjendet në anën verilindore të citadelës, prej ku realizohet komunikimi me varoshin dhe viset përreth. Linja e murrit të çitadelës ndjek vijën kufizuese të kreshtës, përveç anës jugore, ku përfshin brenda sipërfaqes së mbrojtur dhe dy tarraca të ngushta, të përshtatshme për banim. Murri shfrytëzon aftësitë mbrojtëse të terrenit, duke përfshirë brenda tij shkëmbinj të lartë natyrorë, kur ato gjenden në linjën e murit, dhe ndërpritet aty ku ka rënie të rrëpita e të pangjtitshme dhe s’ka nevojë për mbrojtje. Sot ruhen 7 trakte të mureve rrethuese, që i kemi emërtuar sipas germave të alfabetit: A, B, C, D, E, F dhe G, me gjatësi përkatësisht 2.00m, 3.50m, 6.00m, 2.10m, 9.00m, 6.00m dhe 22m dhe perimetër të lexueshëm 50.60m. Gjendja aktuale e tyre paraqitet sipas tabelës së mëposhtme :

Trakti	Murri A	Murri B	Muri C Kulla	Murri D	Muri E	Murri F	Murri G	Shuma
Gjatësia	2.00m	3.50m	6.00m	2.10m	9.00m	6.00m	22m	50.60m
Lartësia	1.50m	1.20m	1.50m	0.50m	3.00m	3.00m	0.40m	0.40-3.00m
Gjërësia	?	?	1.40m	?	1.70m	1.60m	?	1.40-1.70m

Në kushtet e vrojtimit sipërfaqësor, është e vështirë veçimi tipologjik i murreve të periudhës së vonë antike prej atyre mesjetare, pasi murret e periudhës së parë janë mbuluar nga ato të mëvonshme, janë shembur ose dëmtuar. Megjithatë, duke u mbështetur në elementët më të sigurtë teknikë, mendojmë se periudhës së vonë antike i përket muri i parë i jashtëm i traktit C, me gjatësi të përgjithshme 6m. Është fjala për murin e jashtëm të kullës së vetme të fortifikimit, në të cilin ruhen dy fasada muresh që veshin njera tjetrën, të lidhura përkatësisht me periudhën e vonë antike dhe atë mesjetare. Gjithashtu me këtë periudhë mund të lidhen edhe gjurmë të shkëputura të murit jugor, të vendosura më në brendësi se sa muri mesjetar, por për të sqaruar këtë duhen kryer gërmime pastrimi. Muri është ndërtuar me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, sipas teknikës *opus incertum*. Llaçi është i një cilësie të mirë, i përzier me shumë rërë të imtë lumi dhe pak gëlqere paraprakisht të stazhionuar. Lartësia e ruajtjes së murrin lëviz nga 0.40-0.80m, ndërsa gjërësia e saktë, nuk mund të matet, pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat. Fortifikimi i periudhës së vonë antike, i konstatuar edhe nga studiuesë të tjerë¹⁶, është aktualisht fortifikimi më i hershëm i kalasë së Koxhaxhikut. Megjithëse në ndonjë rast kjo kala është cilësuar edhe si “*aglomeracion urban i halshtatit ilir, i fortifikuar me blloqe gurësh kuadratik*”¹⁷, nuk gjetëm gjurmë të fortifikimit të periudhave më të hershme ilire apo asaj urbane. Gjithashtu nuk gjetëm as fragmente enësh të periudhës së vonë antike.

c. Periudha mesjetare (shek. XIV-XV pas Kr.)

1. Sistemi fortifikues. Kalaja është rifortifikuar thuajse tërësisht në periudhën mesjetare, kur janë plotësuar pjesët e dëmtuara të mureve dhe janë rindërtuar trakte të reja të tyre. Ata në pjesën më të madhe të perimetrit mbivendosen mbi linjën e mureve të periudhës së vonë antike, plotësojnë pjesët e shembura të tyre, dhe në rastin më

¹⁶ Микүльчич 1999, 404.

¹⁷ ВІТРАКОВА – GROŽDANOVA 1966, 199.

të mirë, i përforcojnë ato me këmisha të jashtme, siç ndodh në fasadën jugore të kullës së vetme të kalasë. Me këtë periudhë lidhen të gjitha traktet e ruajtura, A-G, me gjatësi 50.60 m, përfshirë këtu edhe murin e dytë të jashtëm të kullës të përmendur më lart. Muret janë ndërtuar sipas teknikës *opus incertum* me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, të një cilësie të mirë. Llaçi përveç rërës së imtë të lumit përmban edhe shumë gëlqere të stazhionuar. Ai është përdorur me bollëk dhe përveç fugave me gjërësi 2-3cm, mbulon dhe një pjesë të faqes së jashtme të gurëve. Gurët nuk krijojnë rreshta horizontale dhe nuk nivelohen me copa gurësh të thyer. Gurët e fasadës së jashtme shpesh kanë rënë në faqet e kreshtës dhe murri nuk ruhet i plotë. (fig.6a-b)



Fig. 6a-b. Pamje të murit jugor-trakti E).

Lartësia e ruajtjes së murit lëviz nga 0.40 deri në 2.50- 3.00m, ndërsa trashësia e tij, e matur me vështërsi vetëm në tri pika është 1.40-1.70m. Duhet theksuar se trashësia e murit është e vështirë të matet saktë, pasi faqja e brendshme e tij është e veshur nga dherat e pjerrësisë së kodrës (fig. 7-8).



Fig. 7-8. trakt i murit F dhe D.

Një trashësi e përafërt e mureve rrethuese është ndeshur kala të tjera mesjetare të vendit tonë si në Krujë (0.80-1.50m), në Shurdhah (1.30-2.60m), në Daulë të Krujës (0.75 m, 0.90 m, 1.10m, dhe 1.80m)¹⁸, në Stelush(1.50-1.80m) dhe po aq në Petralbë(Gur i

¹⁸ SARAÇI 1987, 205; ADHAMI 1971, 87; SPAHIU - KOMATA 1974, 263.

Bardhë)¹⁹ etj. Kulla e vetme juglindore me përmasa 6.00x6.00m, duket qartë se është rifortifikuar në periudhën mesjetare, pasi muri i periudhës së vonë antike, vshet në këtë periudhë në anën e jashtme jugore nga një mur i dytë përforcues, me trashësi 1.40m (fig. 9-10).



Fig.9-10-Muri I dhe II i jashtëm i kullës-trakti C.

Hyrja e kalasë duhet të jetë në anën e majtë të kësaj kulle, pasi aty kalon shtegu i vetëm që lidh kalanë me varoshin. Në faqen e jashtme të murit jugor, në segmentin E shihet një vrimë cilindrike me

¹⁹ Sipas vrojtimeve të autorit në kalanë e Stelushit dhe në atë të Petralbës.

diametër 6cm dhe thellësi të lexueshme 1.00m, e cila i takon mbetjeve të skelerisë metalike të ndërtimit (*fig.11*).



Fig. 11- pamje e vrimës së skelerisë së ndërtimit

Vrima të tilla skelash, me formë rethore dhe përmasa të njëjta (6x6cm), që e përshkojnë murin në të gjithë trashësinë e tij, janë ndeshur edhe disa në ndërtime të tjera mesjetare të Shqipërisë, si në kalanë e Stelushit²⁰, kalanë e Ndroqit etj. Seksioni i tyre i njëjtë në të gjithë trashësinë e murit, dëshmon se për ndërtimin e këtyre skelerive janë përdorur tuba hekuri, teknikë e futur në ndërtimin e kalave nga arkitektët bizantinë. Në pjesën e brendshme veriore të “citadelës” gjenden rrënojat e një godine, prej të cilës shihet vetëm një trakt muri me gjatësi 1.70m, dhe lartësi të faqes së jashtme 1.10m. Gjërësia nuk mund të matet saktë pasi faqja e brendshme është e mbuluar nga dherat, por nuk e kalon 1.00m. Teknika *opus mixtum* e ndërtimit të tij ndryshon nga ajo e murreve rrethuese. Në strukturën e tij, përveç gurëve, gjenden rrallë edhe tulla me trashësi 4cm, të periudhës së vonë antike, të ripërdorura pa ndonjë rregull, të lidhura me llaç gëlqeror me shumë gëlqere dhe pak rërë. (*fig. 12*).

²⁰ Sipas vrojtimeve të autorit në murin e dytë rrethues të kalasë së Stelushit.



Fig. 12-trakt i murit të një godine kulti në citadelë

Paraprakisht mund të supozohet se godina mund të lidhet me ndonjë objekt kulti, ndoshta me kishën e Shën Mërisë²¹, por ai mbetet të konfirmohet ose jo nga gërmimet. Në anën jugore të kalasë, në pjesën më të ulët të saj dhe njëherësh më të mbrojtur nga erërat, gjenden gjurmë themelesh të godinave me gjërësi 0.60m, sa duket me karakter ushtarak (*fig. 13*).

²¹ BARLETI 1537 (1964), IV, 192. "Perlati (Pjetër Perlati-komandant i Sfetigradit-AB) mori masat...pastaj, nga një portë e vogël, që e ka emrin "Dibrane", i priti barbarët në qytet. U fut brenda vetëm purpurati (një nga këshilltarët e sulltan Muratit II-AB) bashkë me tre ushtarë dhe dy shërbëtorë, të cilët përmes sheshit të qytetit, i shpuri në faltoren e Shën Mërisë, ku, pasi thiri më pleqtë e qytetit, urdhëroi të bëhej mbledhja".




Fig. 13. Skicë planimetricke e kalasë.

Gjithashtu në gjysmën jugore të syprinës së saj gjenden pranë njeri tjetrit dy gurë të mëdhenj natyrorë, me sipërfaqe të sheshtë, që ruajnë në mesin e tyre nga një vrimë cilindrike me përmasa

0.30x0.30 x 0.20m dhe 0.20x0.16 x 0.15m, të përdorura si dybeqe për shtypjen e barutit²² (fig.14).




Fig. 14. Pamje e dybekut nr. 1 të kalasë

Në pikpamje kronologjike, besojmë se fortifikimi mesjetar i kalasë së Koxhaxhikut lidhet me periudhën e Skënderbeut dhe është i njëkohshëm me fortifikimet e kryera prej tij në Krujë, Petrelë, Guri i Bardhë (Petralbë) dhe Stelush²³. Me këtë periudhë përputhen teknika

²² LLESHI 2005, 205, fig. 8.

²³ KARAIKAI 2016, 155: "Fortifikimet në të cilat vuri dorë Skënderbeu, ishin në

e ndërtimit të mureve rrethuese e përshkruar më lart, trashësia e vogël e tyre, mospërdorimi i tullave në përbërje të murreve, cilësitë teknike të llaçit, që shquhet për mbizotërim të gëlqeres në raport me rërën, përdorimi i skelerive prej tubash hekuri, si edhe shumica e materialit të imtë qeramik të gjetur në këtë kala. Në periudhën mesjetare kalaja mendohet të ketë qenë pajisur dhe me dy kalime të nëndheshme në trajtë tunelesh sekrete, element ky i pranishëm në mjaft fortifikime mesjetare.

2. *Varoshi*. Në anën verilindore të kalasë, pas një qafe të ngushtë, në një disnivel kuatash prej afro 20m, hapet një tarracë e gjërë me kushte mjaft të përshtatshme për banim, e njohur me emrin “*varosh*”. Në këtë tarracë me sipërfaqe afro 0,7ha (diametri veri-jug-145m, diametri lindje-perëndim- 47m) shtrihej qyteti mesjetar, i lidhur organikisht me kalanë. Edhe varoshi ka një pozitë të shkëlqyer natyrore dhe mjaft strategjike. I mbrojtur nga perëndimi dhe veriu prej rrënjeve shkëmbore të faqeve të tij, ai ka një pjerrësi të lehtë lindore. (*fig. 15*). Në varosh ruhen gjurmë të shumta banesash me formë katërkëndëshe, të orientuara nga lindja, zakonisht të mbështetura në shkëmbenj natyror. Në pjesën qendrore më të dukshme të tij, shihen themelet e një godine katërkëndëshe me përmasa të jashtme 7.00 x4.50 m, të shënuara nga gurë të mëdhenj, me gjërësi 0.90m. (*fig.16a-b*)



Fig. 15-Pamje e varoshit.



Fig. 16a-b-gjurmë themelesh godinash në varosh.

Ana lindore e varoshit kufizohet nga gjurmët e një murri të gjatë tarracimi, që ka shërbyer si trase edhe për rrugën e karrove që ngjitej në varosh, e cila është qartë e dukshme (fig.17).



Fig. 17-Gjurmë të trasesë së rrugës së varoshit.

Trakte të kësaj rruge shihen edhe në lëndinën fushore në jug të kalasë, ndërkohë që bashkimi i tyre nëpër shpatin e pjerrët të kodrës, në terren ende nuk është gjetur. Gjurmë të banesave apo të godinave të ndryshme, ruhen gjithashtu edhe në rrëzën jugore të kreshtës së kalasë, jashtë varoshit, aty ku fillon lëndina e madhe fushore prej disa hektarësh. Duket se ato janë vendosur atje në kohën e lulëzimit të qytetit, kur ai njohu rritjen më të madhe të tij. Sipas studiuesëve, qyteti ka qenë furnizuar me ujë të pishëm nga gurra “Kërmzesu”(turqisht-uji i kuq) e kodrës Byk-Duruk, vetëm 4km në lindje të kalasë²⁴. Ujësjellësi përbëhej prej qyngjesh qeramike, fragmente të cilave janë gjetur herë pas here nga banorët lokalë, por të parujtura, për vlerësimin e tyre kronologjik. Furnizimi i kalave mesjetare me uji nga burime të jashtme realizohej me tubacione qyngjesh qeramike, ndërsa ruajtja e tij me anë sterash të ndërtuara me kujdes brenda zonës ushtarake²⁵.

²⁴ LLESHI 2005, 200; MURRA 2005, 134.

²⁵ KOMATA 1982, 225-226, fig. 6-7; KARAISKAJ 1985, 59 vv, fig. 5.

3. *Varreza* . Në rrafshinën e madhe kodrinore që shtrihet në jug të kalasë së Koxhaxhikut, shtrihet një varrezë e madhe me sipërfaqe mbi 2ha. Ajo përbëhet nga varreza e poshtme në jug dhe ajo e epërme në veri, me ndryshime të qarta midis tyre, si në aspektin arkitektonik ashtu edhe në atë konceptual, religjioz dhe kronologjik. Sipas një vlerësimi paraprak, ata duket se lidhen me dy periudha të ndryshme përdorimi, që kronologjikisht u referohen shek. XV dhe XVIII pas Kr. Periudhës së parë të shek. XV-të, mendojmë se i përket varreza e poshtme, në pjesën jugore të lëndinës së varreve. Ajo përbëhet nga qindra varre me konstruksion të njëjtë dhe orientim lindje-perëndim. Varret janë konturuar me gurë në të gjitha anët, pa gurë të veçantë kufizues te koka dhe te këmbët (*fig. 18*).



Fig. 18-Pamje e pjesshme e varrezës së poshtme

Krahas varreve individualë, ka edhe shumë varre masiv. Ato kanë formë drejtkëndëshe ose katërkëndëshe dhe ndryshojnë vetëm nga përmasat e tyre, disa prej të cilave janë: 2.00x2.90m, 3.50x4.00m, 4.00x5.50m, 4.00x6.00m, 6.00x4.50m, 5.00x8.80m etj. (*fig. 19*)



Fig. 19-Pamje e pjesshme e varreve masiv të varrezës së poshtme

Megjithëse e pastudiuar në pikpamje arkeologjike, varreza e poshtme hap diskutime dhe shtron nevojën e gërmimeve arkeologjike²⁶. Periudhës së dytë të shek. XVIII-të, i takon varreza e epërme, e vendosur në pjesën veriore të lëndinës së varreve, ku përdoret tipi i varrit individual me gurë kufizues vetëm tek koka dhe këmbët, në disa prej të cilëve gjenden edhe epitafe në osmanisht.

4. *Qeramika*. Periudhës mesjetare paraosmane (shek. XIV–XV pas Kr.) i përkasin fragmentet më të shumta të enëve, të mbledhura në sipërfaqen e kalasë e të varoshit, si dhe në shpatet lindore e jugore të kreshtës së saj. Në pikpamje teknologjike, veçohen dy grupe enësh :

a. Enët e grupit të parë, që mbizotërojnë, janë punuar me baltë bezhë në gri dhe gri në të zezë, të pastruar nga lëndët e huaja, dhe kanë pjekje e lëmim të mirë. Janë kryesisht enë kuzhine, të

²⁶ Mundësia hipotetike e lidhjes së varrezës së poshtme me mesin e shek. XV pas Kr. është e pakonfirmuar arkeologjikisht dhe mbështetet vetëm në tipin konstruktiv të varreve si dhe në parimin logjik se varret e masive përdorëshin vetëm në raste luftrash, sëmundjesh epidemike apo fatkeqësishë natyrore.

përdorura për zierje dhe shpesh ruajnë njollat e tymosjes dhe të zjarrit.

b. Enët e grupit të dytë me baltë të okër të hapur në rozë, janë më të ralla. Kanë brum të pastër me ngjyrë rozë, pjekje e lëmim të mire dhe paraqiten të zbukuruara me pikturim paste të bardhë. U takojnë enëve të tavolinës e të pijes. Format kryesore të enëve të grupit të parë janë vorbat, që ndeshen në dy variante : vorba me grykë konike dhe buzë të profiluara për puthitjen e kapakut, me përdorim më të gjërë (fig. 20a, 1-5; fig. 20b, 1-5, 7-8) dhe vorba me grykë konike dhe buzë të hapura anash (fig. 20a, 6; fig. 20b, 6).




Fig. 20a-b. Fragmente vorbash mesjetare të Koxhaxhikut

Të dy variantet mbështeteshin mbi funde të sheshtë apo lehtë konkav (fig. 21, 1-3). Ato janë pajisur me vegjë shiritore vertikale, që dalin nën grykë, në ndonjë rast të zbukuruara me thellime thike (fig. 21, 4-5). Një pjesë e vorbave paraqiten të zbukuruara me inçizim vijash të çarkut, që e qarkojnë enën horizontalisht (fig. 21, 6-10; fig. 22, 1-4). Në një rast të vetëm ndeshet kombinimi i vijave të çarkut dhe një rreshti thellimesh me bigël, dekor ky i njohur në

kulturat tona mesjetare të shek. XII-XIV²⁷. (fig. 21, 11; fig. 22, 5) si dhe shiriti plastik i zbukuruar me gropëzime gishti (fig. 22, 6).




Fig. 21-Fragmente fundesh dhe dekoresh mesjetare

Vorba të ngjashme, të zbukuruara me këto motive, janë zbuluar gjithashtu në kalatë e Skënderbeut në Stelush (Qafë-Murrë)²⁸, në Gurin e Pishkashit (Prenjas), në kalanë e Petrelës (Tiranë) dhe në qytetin e Shurdhahut²⁹, në kalanë e Krujës³⁰, në

²⁷ KOMATA 1969, 222-226, tab. VII, 1-7, 10-14, VIII, 16-17, 20-23; KARAIKAI 1979-1980, tab. IX, 3.8.

²⁸ ANAMALI 1967, 4, 106; ANAMALI 1969, 249 – 253

²⁹ KOMATA 1969, 222-226, tab. II, 1, 4, 6, 7; IV, 1, 3, 7; V, 1-4; VII, 1-4, 8, 10, 11; VIII, 4..

³⁰ KOMATA 1982, tab. V, 1-4, 7, 9-10.

kalanë e fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Krujës³¹, në gradishtën e Symyzës (Korçë)³² etj, të datuara në shek. XIV-XV pas Kr.




Fig. 22. Dekore të qeramikës mesjetare të Koxhaxhikut

Në grupin e dytë të qeramikës me brum okër në rozë, përmendim qafën e një kane me grykë konike, me brum të pastër rozë, të zbukuruar me pikturim mat të bardhë shiritash horizontal e vertikal (fig.20, 8; fig. 22, 9). Tipi i kanave me qafë të gjatë vazhdon nga qeramika e vonë antike në atë mesjetare dhe ndeshet në kalanë e

³¹ SARAÇI 1987, 211-212, tab. II,1-7, III, 1-7, IV, 1-6.

³² KARAIŠKAJ 1979-1980, tab.IX, 3.

Stelushit, të Pishkashit dhe të Petrelës³³, në kalanë e Krujës³⁴, si dhe në vise të tjera të Ballkanit³⁵. Nga brumi dhe analogjitë, përfaqëson një import me origjinë nga Mesdheu Lindor, gjasisht nga punishtet qeramike të Qipros dhe datohet pas shek. XIV³⁶. Të njëjtës periudhë i përkasin edhe dy fragmente enësh të zbukuruara me pikturim shiritash të bardhë (fig. 22, 10-11) si dhe dy vegjë shiritore vertikale, me zbukurim të thellimesh thike në qendër të kombinuar me shirita anësor të pikturuar me pastë të bardhë (fig. 22, 7-8).

Të dhënat arkeologjike të paraqitura më lart, dëshmojnë se kalaja e Koxhaxhikut përfaqëson një kala ilire të periudhës së Bronzit të Vonë dhe Hekurit të Hershëm. Në periudhën e vonë antike ajo fortifikohet për herë të parë me mure mbrojtëse, dhe rifortifikohet në periudhën mesjetare gjatë shek. XIV-XV pas Kr. Kjo është edhe periudha më intensive e jetës në këtë kala, ku mendojmë se është plotësisht i mundur lokalizimi i qytetit mesjetar të Sfetigradit³⁷. Këto të dhëna rrëzojnë pohimin e pavërtetë të K. Biçokut se: *“Pranë këtij fshati është një shkëmb i lartë që ka shërbyer si pikë vrojtimi. Thuhet se aty ka qenë kalaja...Në Koxhaxhik nuk ka gjurmë kështjelle të ndërtuar me gurë dhe as që mund të ngrihej një kështjellë e tillë në një lartësi aq të madhe. Në Koxhaxhik kështjella ka qenë prej druri”*³⁸.

³³ KOMATA 1969, 226.

³⁴ KOMATA 1982, 1, 227, tab. II,1-2.

³⁵ KOMATA 1969, 226, shën. nr. 21.

³⁶ STERN 1997, 48-50, fig. 9, a-b.

³⁷ BUNGURI 2009, 27-56.

³⁸ BIÇOKU 2003, 26-27, 29. Këtë pohim voluntarist, studiuesi i lartpërmendur përpiqet ta mbrojë edhe në vitet e mëvonshme, duke kaluar deri në shkëlqe të etikës akademike. Citoj: *“Prendimet e Hazis Ndreut, Adem Bungurit dhe të Muzafer Bislimit për ekzistencën e murreve të një kështjelle në Koxhaxhik...janë vetëm dëshira dhe deklarime të tyre të papërgjegjshme, që nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën”* (Krhs. BIÇOKU 2006, 73-74. Shënimet 47, 48 dhe 49). Vazhdon citimi: *“Koxhaxhikun e kam vizituar për herë të parë më 2 mars të vitit 2003 dhe për së dyti më 8 korrik të vitit 2006. Vizita e dytë ka rëndësi të veçantë, sepse u preu rrugën spekulimeve të mëtejshme për ekzistencën e murreve të kështjellës së Koxhaxhikut”*. Vazhdon citimi (7 rrjeshta më poshtë): *“Në Koxhaxhik nuk ka asnjë gjurmë kështjelle të ndërtuar me gurë. Fotografia e “murreve të kalasë së Koxhaxhikut” e botuar prej H. Ndreut dhe prej A. Bungurit është një sajesë e*

2. Kështjella e Modricës (Dibër) (x-41°36', y-20°57', z-996m)

Kështjella e Modricës³⁹ ndodhet në majën e një kreshte shkëmbore me lartësi 996m, afër fshatit homonim, në krahun e majtë të Drinit të Zi dhe përroit të Modriçës (Maqedonia e Veriut). E ngritur përballë kalasë së Koxhaxhikut, me të cilën ka komunikim pamor, fortesa ka një pozitë të zgjedhur strategjike dhe kontrollon luginën e Drinit dhe rrugën Ohër- Dibër. (fig. 23).

tyre". (Krhs. BIÇOKU 2006a, 74; BIÇOKU 2006b, 81). Mirëpo, murret e kalasë së Koxhaxhikut ekzistojnë jashtë dhe pavarësisht dëshirës së njerëzve, dhe e tregojnë qartë autorin e vërtetë të "deklarimeve të papërgjegjshme, që nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën". Këtë pohim të pasaktë, ai vazhdon ta mbrojë edhe në një punim të viteve të fundit, ku shkruan: "Pranë këtij fshati në veri është një shkëmb i lartë (kur i sheh anën perëndimore), të cilin, kur e sheh nga lindja, i shquhet maja e thepisur e një kodrine, të cilës mund t'i ngjiten vetëm alpinistët dhe në të nuk ka gjurmë ndërtimesh" (Krhs. BIÇOKU 2016, 89), përfundim që e përsërit edhe disa rreshta më poshtë: "Nuk ka gjurmë guri të kështjellës së Koxhaxhikut, edhe pse ajo është përmendur deri në fillim të shek. XVIII, çka tregon se ajo nuk ka qenë ndërtuar me gurë". (Krhs. BIÇOKU 2016, 91). Pavarësisht pohimeve të tilla antishkencore, kalaja e Koxhaxhikut është aty dhe ruan pjesë të sistemit të dikurshëm fortifikues, që mund të shihen nga kushdo që ka dëshirë të merret me studimin e kësaj kalaje. Identifikimi ose jo me Sfetigradin, megjithëse për mua është jashtë çdo dyshimi, është çështje dytësore dhe e diskutueshme midis studiuesëve. E rëndësishme dhe e detyrueshme për studiuesit është paraqitja e saktë e monumentit të cilit i referohemi, pasi liria e mendimit lypset të jetë në koherencë të plotë me faktet arkeologjike dhe historike.

³⁹ Fortesa e Modricit është vizituar nga Jastrebov (Krhs. JASTREBOV 1904, 125) dhe më vonë nga H. Sharofi, i cili shkruan se : " Skënderbeu për ti bërë ballë rezikut që i shkaktoj humbja e Sfetigradit, themeloi dhe ndërtoi me të shpejtë fortesën e Modriçit, në krah të majtë të Drinit, ballë për ballë me Sfetigradin, që ishte në krah të djathtë të Drinit. Kjo fortesë e mbyllte grykën e Drinit dhe kontrollonte lëvizjet e ushtrisë turke e i lajmëronte kështjellat e tjera me anë të topit". (Krhs. SHAROFI (1968), 2003, 49) etj.



Fig. 23- pamje e kodrës së fortesës së Modricës

Kreshta ku gjendet fortifikimi ka mbrojtje të fortë natyrore, sipërfaqe të vogël rreth 300m^2 , perimetër 102m, diametrin veri-jug 50m dhe atë lindje-perëndim 45m. Ajo ka qenë e fortifikuar me murre, gjurmët e rrënuar të të cilit mund të ndiqen vetëm në anën lindore dhe atë verilindore, në një gjatësi prej 26m. Murri ka shfrytëzuar aftësitë mbrojtëse të terrenit dhe ka mbushur hapësirat midis shkëmbinjëve natyror (fig.24).



Fig. 24- Gjurmë të murit lindor të fortesës




Fig. 25-skicë planimetrike e fortesës së Modricës.

Trakti më mirë i ruajtur, me gjatësi 2.00m, lartësi 0.80m dhe gjërësi 1.00m gjendet në anën verilindore, pranë sterës. Muri është ndërtuar sipas teknikës *opus incertum* me gurë lumorë dhe të terrenit, të lidhur me llaç gëlqerorë të përzier me rërë zalli të pasitur, cilësisht mjaft i dobët, gjë që ka ndikuar në mosruajtjen e linjës së murit. Kjo veçori teknike tregon për ngutje në ndërtimin e saj (gëlqerja është përdorur menjëherë pas shuarjes), gjë që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, kjo fortesë u ndërtua me nxitim nga Skënderbeu, pas rënjes së Sfetigradit, për të kontrolluar vijën e Drinit të Zi, që për Skënderbeun kishte rëndësi strategjike⁴⁰. Përshkrimi i

⁴⁰ Duke treguar për lëvizjet e ushtrisë së Skënderbeut kundër kampit armik në Ohër, pas rënjes së Sfetigradit, Barleti shkruan se : “ai (Skënderbeu) në të ngrysur

kësaj fortese nga Barleti është i gjallë dhe i plotë : “ *Ishte një mal, banorët e quajnë Modrisë, thikë e rrëpirë, i cili, për shkak të lartësisë së vetë, vështronte përpara tokat e turqve në një hapësirë të madhe. Atje ai vendosi të ngrinte një kështjellë, dhe ta mbushte me luftëtarë, të cilët, me krismën e përdredhoreve të lajmëronin kur të vinin armiqtë. Atje do të shkonin për strehim edhe gjithë sa ishin afër*“⁴¹. Më poshtë ai shton se ndërtimi i kështjellës „ *filloi e mbaroi në qetësinë më të madhe, pa ngjarë gjë gjatë asaj kohe nga ana e armikut,*“⁴². Në anën verilindore të fortesës, u gjet një sterë uji me planimetri drejtkëndore, me brinjë 1.80x2.50m, thellësi të matshme 3.30m⁴³ dhe vëllim mbi 14,85m³, me një kapacitet ujëmbajtës rreth 15.000 litra. (fig.26).



Fig. 26- Pamje e sterës së ujit dhe llaçit hidroizolues

të asaj dite u nis me më shumë se 1000 kalorës për në Ohër, duke e hequr ushtrinë me shumë kujdes përmes disa pyjeve dhe vendeve të papërshtatshme, për të mos u mbyllur nga armiku në mes të Sfetigradit dhe të rojeve të tij” (Krhs. BARLETI (1537) 1964, IX, 383).

⁴¹ BARLETI 1537 (1964), VII, 293.

⁴² *Idem*, VII, 293. Studiuesi Gj. Karaiskaj mendon se kështjella e Modricës është ndërtuar menjëherë pas rrethimit të parë të Krujës, rreth viteve 1451-1452. Ai thekson se kështjella e Modricës, ndodhej në kufirin lindor të Shqipërisë, akoma e paidentifikuar. Krhs. KARAIKAI 2016, 157.

⁴³ DysHEMEJA e sterës është e zënë nga shembjet e gurëve dhe dherat.

Gjërësia e murreve të sterës është afër 1.00m. Hapësira e brendshme e saj është e suvatuar me llaç horasan hidroizolues, i bërë me pluhur tjegullash, shumë i fortë dhe i papërshkueshëm nga uji, që ka krijuar një shtresë të forte në trajtë graniti, me ngjyrë të kuqërremtë. Në kontekst me sistemin fortifikues, kjo sterë është përgatitur me të gjithë kujdesin e mundshëm. Një gjë e tillë është e shpjegueshme, po të kujtojmë se kjo fortesë i vlente Skënderbeut kryesisht si pikë vrojtimi, ku nevoja për ujë të pijshëm ishte e përhershme. Në këtë kështjellë, sipas burimeve historike, u instalua nga Skënderbeu për herë të parë sistemi i ndërlidhjes me top, ose siç e quan Barleti “ *përdredhore*”⁴⁴. Edhe për lokalizimin e kësaj kështjelle, është propozuar një toponim i palokalizuar në krahinën e Tetovës⁴⁵, që nuk i përgjigjet as gjeografisë historike dhe as përshkrimeve të Barletit.

3. Kalaja e Skudrinës (Dibër) (x-41°57’, y-20°59’, z-1180m)

Rrënojat e kalasë së Skudrinës gjenden në faqen lindore të malit të Kërçinit, pranë fshatit Skudrine të Rekës së Poshtme në zonën e Dibrës (Maqedonia e Veriut). Kalaja është ndërtuar në një kreshtë të thiktë shkëmbore të vendosur midis dy përrenjëve të thellë që zbresin nga mali i Kërçinit dhe e kufizojnë atë nga ana veriperëndimore dhe juglindore. Është vizituar më parë nga studiuesë maqedonas, që shënojnë lartësinë e saj absolute 1180m dhe relative 500m⁴⁶. Kalaja gëzon një mbrojtje të shkëlqyer natyrore dhe një pozicion mjaft dominant në kontroll të luginës së Radikës në zonën e Rekës së Poshtme, që lidh pellgun e Dibrës me atë të Pollogut dhe luginën e Vardarit. (fig.27)

⁴⁴ BARLETI 1537 (1964), VII, 293.

⁴⁵ Përmendet një toponim i palokalizuar në krahinën e Tetovës “*të përtafërt me trajtën e emrit Modrishë të M. Barlecit*”, “*që mund të lexohet: Mdrushte, Modorishte, Morovishite dhe Medrovishite*”. Krhs. BIÇOKU 2016, 130, shën. 407.

⁴⁶ MIKULČIĆ 1999, 410.




Fig. 27-Pamje e përgjithshme dhe rievimi planimetrik.

Kreshta e kalasë mbyllet me një syprinë të sheshtë me formë afërsisht poligonale, me kalime të buta në këndet. Ajo ka gjatësi 55m dhe gjërësi që lëviz nga 29-40m dhe një sipërfaqe rreth 2200m². Në anën jugore dhe atë lindore ajo bie me faqe të thikta shkëmbore me lartësi rreth 500m mbi përroin e gradishtës. Edhe në anën veriore pjerrësia është mjaft e madhe, ndërsa në atë perëndimore, krijon

shtegun e vetëm komunikues me një tarracë të përshtatshme për banim, si dhe me terrenin përreth. Kalaja ruan gjurmë të fortifikimit të saj, kronologjikisht të lidhur me tri faza të ndryshme, që i referohen përkatësisht periudhës së Bronzit të Vonë, periudhës së vonë antike dhe periudhës mesjetare. Periudha e fundit mendojmë se kronologjikisht lidhet me shek.XIV- XV pas Kr., dhe kryesisht me periudhën e Skënderbeut. Në sistemin fortifikues ajo përfaqësohet nga një kullë rrethore e vendosur në pjesën më të lartë të sipërfaqes së brendshme të kalasë. Kulla me formë rrethore, ka diametër të jashtëm, 7.80m, dhe të brendshëm 3.00m dhe gjërësinë e mureve 2.40m. Muret e kullës janë ndërtuar me gurë mesatarë të lidhur me llaç gëlqerorë, me trashësinë e fugave 2-2.5cm. Llaçi është bërë me gëlqere të pastazhionuar mirë, të përzier me rërë lumi të situar trashë, dhe cilësisht është i dobët dhe thërmohet nga fërkimi.

Në pikpamje të tipologjisë dhe pozicionit topografik, kjo kullë është krejtësisht e ngjashme me atë të kalasë mesjetare të Daules së Kurbinit, si dhe kulla të tilla të fortifikimeve të shek. XIV-XV të Krujës, të Stelushit, të Rodonit, të Durrësit, të Prezës, të Shkodrës⁴⁷, të Petralbës⁴⁸ etj. Kësaj periudhe mendojmë se i përket edhe një sterë uji që gjendet në anën jugperëndimore të kalasë. Ajo ka formë drejtkëndëshe me brinjë 7.00x4.50m dhe thellësi të lexueshme 2.20m. E veçanta e kësaj stere është se në tri anë të saj, përkatësisht në atë lindore, veriore dhe jugore ajo është gdhendur në shkëmb, dhe vetëm faqja perëndimore e saj është zënë nga një mur me gjatësi 4.50m, i ndërtuar me gurë mesatarë të lidhur me llaç gëlqeror. Faqja e brendshme e këtij muri u gjet e shembur dhe nuk u konstastuan gjurmë të llaçit me pluhur tjegullash, të përdorur zakonisht për hidroizolim të sterave, rolin e të cilit e kanë luajtur sa duket faqet shkëmbore të tri anëve të saj. Kalaja ka shërbyer si fortesë në mbrojtje të rrugës tradicionale Dibër-Pollog-Shkup, që kalonte nëpër luginën e lumit të Radikës.

⁴⁷ SARAÇI 1987, 207, shën. 16.

⁴⁸ *Vrojtime individuale në terren.*

4. Kulla e Skënderbeut (x-41°51', y-20° 31', z-978m).

Kreshta shkëmbore e njohur me emrin "Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut" me lartësi absolute 978m, ngrihet përballë qytetës së Valikardhës, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës (fig. 28a).



Fig. 28a- Pamje të shkëmbit të kullës së Skënderbeut

Përmendet për herë të parë nga H. Ceka-J. Adami në vitin 1951, të cilët theksojnë se “Kulla e Skënderbeut” gjendet në një shkëmb të pangjithshëm përballë “qytetit” të Valikardhës⁴⁹. Ajo ka një pozitë dominante dhe të fuqishme kontrolli mbi Fushën e Vajkalit, gjithë luginën e Bulqizës dhe “Rrugën e Arbërit”. Platforma e kësaj kreshte me planimetri poligonale, diametrat lindje-perëndim dhe veri-jug 16x65m, dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme rreth 1000m², ka një pjerrësi të lehtë jugore. Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut ka rrënje të thikta shkëmbore në tre anë, atë jugore, perëndimore dhe lindore, ndërsa në anën veriore, ndahet nga pjesa veriore më e lartësuar e saj, nga një kanion shkëmbor me thellësi 3.50-4.00m dhe

⁴⁹ CEKA-ADAMI 1951, 3.

gjërësi 10-12m. Më në veri të saj lartësohet “Maja e Tëmlave” nën të cilën gjendet “Çardaku” (i Skënderbeut), një shesh i vogël, me hapësirë shikimi mjaft të madhe. Kreshta ku gjendet “Kulla e Skënderbeut” ka një pozitë mjaft dominante. Prej aty kontrollohet lehtësisht e gjithë lugina e Bulqizës, nga Qafa e Buallit në perëndim (844m) deri në luginën e Drinit të Zi dhe qytetin e Dibrës në lindje.

Komunikimi vizual është i dukshëm jo vetëm me qytezën e Valikardhës tek “Ura e Qytetit” dhe “Fushën e Vajkalit” që hapet pranë saj, por edhe me qytezat e Krajkës dhe të Sofraçanit, në krahun e majtë të zallit të Bulqizës dhe Fushën e Gurrës (Strikçan) në krahun e djathtë të luginës së këtij lumi. Ngjitja në “Kullën e Skënderbeut” fillon nga fshati Lepurak i Vajkalit, prej ku duhet të ecësh në një monopat të pjerrët për rreth 1.5-2 orë, deri tek “Rruga e fshehtë e Skënderbeut”, rreth 200m nën platformën e kreshtës shkëmbore ku gjendet kulla. Kjo rrugë e fshehtë me gjatësi 50-60m dhe gjërësi 2.00-2.50m, ka pjerrësi të fortë, rreth 30-35°. Ajo fillon nga “Guri i dybegut” dhe arrin deri tek faqja perëndimore e kreshtës, prej ku rruga ndjek monopatin e thiktë, deri tek shtegu hyrës në këtë kullë. Rruga e fshehtë ka qenë hapur në shkëmb dhe është e shtruar me rasa guri (fig.28b-c).




Fig. 28b-Pamje e faqes perëndimore të kreshtës; fig. 28c-Pamje e rrugës së fshehtë të kullës së Skënderbeut.

Rreth 200m nën faqen perëndimore të kullës, në një sheshpushim buzë Rrugës së fshehtë të Skënderbeut, gjendet një gur i madh dybeku. Është fjala për një shkëmb natyror me faqe të sheshtë, me përmasa 2.20x1.10x0.70m, në pjesën qendrore të së cilës, është gdhendur një gropë cilindrike me diametër 23x23cm, thellësi 5.6cm dhe faqe të lëmuara. Është identik me dy gurët e dybekut të kalasë së Koxhaxhikut dhe mendohet se ka shërbyer për shtypjen e barutit (fig. 28d).



Fig. 28d-Gur dybeku i Kullës së Skënderbeut

Kreshta shkëmbore e njohur me emrin "Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut" ka sipërfaqe afërsisht poligonale (fig. 29a).



Fig. 29a-Pamje e përgjithshme e kreshtës së Kullës së Skënderbeut




Fig. 29b-Skicë planimetrike e kreshtës

Gjatë surveit të gushtit 2018, u konstatuan dy struktura ndërtimore, si pjesë integrale e monumentit mesjetar:

a. Kullë vrojtimi. Në pjesën më të lartë veriore të kreshtës shkëmbore, gjenden rrënojat e një kulle mbrojtëse. Kulla ka formë drejtkëndëshe me ball të harkuar, që i është përshtatur formës së terrenit dhe përfshihet në tipin e kullave në trajtë "U"-je ose në trajtë patkoi. Kulla ka orientim verior, gjatësi 5.50m dhe gjërësi 6.70m. (fig. 30a). Muret e ndërtuara me gur të lidhur me llaç gëlqeror, ruhen në gjendje rrënoje, me gjërësi të lexueshme 0.40m. Në anën lindore të kullës, ruhet një trakt murri me gjatësi 2.00m dhe gjërësi 0.40m, që i vishet nga ana e jashtme faqes së shkëmbit natyror, i cili më parë është prerë vertikalisht (fig. 30b)



Fig. 30a-Kulla veriore-murri verior



Fig. 30b-Kulla veriore-murri lindor

Në gjatësinë 5.50m, faqja jugore e kullës mbyllet me anë të një muri tërthor lindje-perëndim. Gjurmë të murit lindor të këtij fortifikimi, në trajtë rrënojash, vazhdojnë drejt jugut, dhe ndiqen deri në gjatësinë 10m. Në anën perëndimore të kreshtës, gjurmë në trajtë rrënoje të këtij muri mbrojtës, mund të ndiqen deri në gjatësinë 16m, tek shtegu hyrës i kreshtës së Shkëmbit të Kullës së Skënderbeut. Gjurmët e ruajtura në trajtë rrënoje të murreve mbrojtëse, tregojnë se fortifikimi ka qenë i pjesshëm dhe ka shfrytëzuar mjaft mirë vetitë mbrojtëse të terrenit. Kjo situatë arkitektonike, na shtyn të besojmë se thelbi i këtij fortifikimi përfaqësohet nga një kullë në trajtë "U"-je ose patkoi, ku mund të strehoheshin një grup i vogël ushtarësh, me detyra kryesisht të karakterit vrojtues dhe sinjalizues (*fig. 30c*).




Fig. 30c-skicë planimetrike e murrit verior të kullës së Skënderbeut.

Kulla në trajtë U-je, ose gjysëmrrethore janë një tip planimetrik i zakonshëm në fortifikimet mesjetare, përfshirë edhe ato të lidhura ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Tipi i kullës gjysëmrrethore ndeshet në kalanë e Petralbës⁵⁰, të Petrelës⁵¹, të

⁵⁰ Shikuar në terren nga autori.

Krujës⁵², në kështjellën e poshtme të kalasë së Durrësit⁵³, ndërsa kullat në trajtë U-je mbrojnë hyrjen e qytetit të sipërm të kalasë së Shurdhahut (Sarda)⁵⁴etj.

b. Sterë uji. Në gjysmën jugore të kreshtës shkëmbore, ruhen gjurmët e një stere të nëndheshme, të ndërtuar me murre guri të lidhur me llaç gëlqeror. Stera ka qenë e mbuluar me qemer cilindrik gjatësor, sot i shkatërruar thujse tërësisht nga thesarkërkuesë klandestin. Është fjala për një strukturë me planimetri drejtkëndëshe, me orientim verior, me 5° shmangje lindore nga aksi i veriut. Përmasat e brendshme të saj janë 3.97x3.47x2.50m (4.00x3.50x2.50m). Vëllimi i përafërt i sterës është 35m³, me një kapacitet ujëmbajtës 35.000 litra (*fig. 31a-b*)



Fig. 31a-Pamje e sterës së ujit në Kullën e Skënderbeut

⁵¹ KARAISKAJ 2016, 118, fig. 128.

⁵² *Idem*, 141, fig. 157.

⁵³ *Idem*, 161, fig. 185.

⁵⁴ *Idem*, 129, fig. 140.




Fig. 31b-Plan & prerje e sterës së Kullës së Skënderbeut

Hapësira e brendshme e sterës ka qenë e suvatuar me horasan të përgatitur me pluhur tjegullash me veti hidroizoluese, i papërshkueshëm nga uji. Mbetje të këtij llaçi me sipërfaqe mirë të lustruar dhen ngjyrë okër në të kuqërremtë, sot ruhen vetëm në dyshemenë dhe pjesët fundore të sterës, përkatësisht në murin jugor dhe lindor të saj, ndërsa në pjesët e sipërme të mureve, edhe pse ka rënë, ky llaç ka lënë në faqet e gurëve, ngjyrën okër të hapur të tij, lehtësisht e lexueshme. Dyshemeja e sterës ka qenë e shtruar me llaç harasan i përgatitur me pluhur tjegullash me veti hidroizoluese, i njëjtë me atë të faqes së brendshme të mureve anësorë, shtresa e të cilit është mjaft e ngjeshur dhe e fortë. Në pjesët fundore të sterës, ruhet edhe shtresa e llaçit hidroizolues me trashësi 2.5-3cm dhe ngjyrë okër në të kuqërremtë, që ka veshur faqet e brendshme të murreve anësor të saj (fig. 32).



Fig. 32-detaje të llaçit hidroizolues të sterës.

Gjërësia e murreve anësor të sterës është 0.60m, ndërsa gjërësia e murit jugor të saj është 2.00m. Ky murr i jashtëm jugor mund të ketë shërbyer si përforcues i strukturës së sterës ose si aksesori i largimit të ujrave të tepërta. Muret e sterës janë të ndërtuara me gurë gëlqerorë të terrenit, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror, me shumë gëlqere dhe pak rërë lumi. Ndërsa muret jugor dhe verior kanë faqe vertikale, muret lindor dhe perëndimor harkohen lehtë për të formuar qemerin cilindrik ose gjysëmrrëthor. Harkimi fillon në kuotën 0.98m (1.00m) mbi nivelin e dyshemesë. Lartësia e ruajtur e qemerit në anën lindore është 1.00m dhe në atë perëndimore 0.45m,

ndërsa shigjeta e harkut të qemerit rezulton të ketë qenë 1.40m. E gjithë hapësira e brendshme e strukturës, është e mbushur me gurë gëlqerorë të murreve si dhe me gurë çmërsi ranorë të qemerit. Këto të fundit janë të gdhendur, me faqe të sheshta dhe mjaft të lehtë në peshë, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre në kupolën e qemerit. Gurë të të dy llojeve gjenden edhe në anën perëndimore dhe veriore të kësaj strukture. Sterat e ujit kanë qenë pjesë organike e nevojshme dhe e domosdoshme e fortifikimeve mesjetare në përgjithësi, përfshirë edhe fortifikimet e ndërtuara në kohën e Skënderbeut.

Duke e ditur se nevojat e domosdoshme fiziologjike për një njeri janë 2 litra në ditë⁵⁵, mund të llogaritet se stera e Kullës së Skënderbeut, me një kapacitet ujëmbajtës prej 35.000 litrash, mund të plotësonte nevojat e një grupi prej 50-60 ushtarësh për 30 ditë, edhe po të mos binte asnjë pikë shi. Në pikëpamje planimetrike dhe tipologjike, stera e Kullës së Skënderbeut është e ngjashme me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut në Daulë të Kurbinit⁵⁶, me atë të Modriçit⁵⁷, atë të kalasë së Skudrinës⁵⁸ në luginën e poshtme të Radikës (Dibër), me sterën e kalasë së fshehtë të Skënderbeut⁵⁹, në Çidhën të Poshtme, me sterën e vogël me qemer gurësh çmërsi në qytetin e Stelushit (Mat)⁶⁰, me sterën nr. 1 me qemer cilindrik të kalasë së Shkodrës⁶¹ (e ndërtuar para rrethimit të parë të Shkodrës)⁶², me sterën me qemer cilindrik të kështjellës së Matricës⁶³ në Rubik etj. Të dy strukturat e mësipërme të këtij monumenti, kulla në formë patkoi dhe stera e ujit, në pikëpamje kronologjike, lidhen ekskluzivisht me periudhën e Skënderbeut. Përveç tipareve teknike dhe analogjive të tyre të cekura më lart, mund të përmendim edhe dy

⁵⁵ KARAISKAJ 1985, 66.

⁵⁶ SARAÇI 1987, 210.

⁵⁷ BUNGURI 2009, 47, fig. 32.

⁵⁸ BUNGURI 2014, 297, fig. 8.

⁵⁹ BUNGURI 2011, 215, fig. 11.

⁶⁰ ANAMALI 1967, 106.

⁶¹ KARAISKAJ 1985, 60-61, 66-67, tab. I.

⁶² *Idem*, 67.

⁶³ HOXHA 2016, 163, fig. 8b.

objekte mesjetare të lidhura me Kullën e Skënderbeut, përkatësisht një gur dybeku (fig. 28d) dhe një mokër bloje (fig. 34c).

Në mbyllje duhet të vemë dukje një veçori të fortifikimeve të ndërtuara apo rindërtuara në kohën e Skënderbeut. Është fjala për ngjashmërinë e fortë të skemës topografike dhe planimetrike e kalasë së Koxhaxhikut me kala të tjera të pranuar mirëfilli si të rifortifikuara apo të ndërtuara nga Skënderbeu, siç janë kalaja e Stelushit (Qafë-Murrë), kalaja e Petralbës (Mat), kalaja e Krujës, kalaja e Daules (Kurbini), kalaja e Petrelës (Tiranë)⁶⁴ etj.

Është e tepërt të themi se të gjitha kalatë e mësipërme të Skënderbeut gjenden në rajone malore, në mbrojtje të rrugëve të brendshme strategjike nga lëviznin ushtritë. Pjesa kryesore e këtyre kalave, disa prej të cilëve ishin njëherësh edhe qytete mesjetarë, përbëhej nga zona e fortifikuar ose „citadela“, që gjendet në majën e kodrës dhe luan rolin e “akropolit” dhe „varoshi“ ose qyteti jashtë mureve rrethuese, ku gjenden godinat e banimit dhe ato shoqërore dhe zejtare. Çitadela kishte përmasa modeste, me madhësi nga 0.1-0.2ha. Si element integral ajo kishte gjithnjë pusin apo sterën e ujit, zakonisht të furnizuar me tubacion qyngjesh qeramike nga burime të jashtme, dhe në ndonjë rast edhe me ujët e shiut. Përmasat e vogla të çitadelës janë në përputhje me artin ushtarak të Skënderbeut, i cili kurrë nuk i përqëndronte të gjithë forcat brenda saj. Aty ai linte një garnizon të vogël, ndërsa me forcat kryesore i ngrinte pusi armikut, duke e goditur atë në befasi, natën, në fushim ose gjatë marshimit, dhe duke e asgjësuar atë pjesë pjesë. Për ilustrim, po sjellim një tabelë mbi lartësitë mbidetare të disa prej kalave të Skënderbeut në rajonin e Dibrës, Matit dhe Krujës:

Nr.	Kalaja ose fortifikimi	Rajoni	Lartësia absolute (m)
1.	Qytei i Stelushit	Qafë-Murrë/Dibër-Mat	1225
2	Kalaja e Çidhnës së Poshtme	Çidhën/Dibër	1205

⁶⁴ ANAMALI 1967, 108 ; SARAÇI 1987, 205-206.

3.	"	Koxhaxhikut	Zhupë/Dibër	1160
4.	"	Modricës	Drinkoll/Dibër	996
5.	"	Skudrinës	Rekë/Dibër	1180
6.		Kulla e Skënderbeut	Vajkal/Bulqizë	978
7.		Kalaja e Petralbës (Gurit të Bardhë)	Gur i Bardhë/Klos	878
8.		e Krujës	Krujë/Krujë	610
9.	"	Daules	Kurbin/Krujë	527
10.	"	Petrelës	Tiranë/Tiranë	329

5. Objekte arkeologjike:

Sipas të dhënave arkeologjike, gjurmët më të hershme të banimit të luginës së Bulqizës i takojnë shek. XI-IX para Kr. dhe topografikisht lidhen me territorin e fshatit Vajkal (x-41°52', y-20°26', z-750-800m). Përveç tyre, në afërsi të Vajkalit janë gjetur edhe objekte të tjera, që dokumentojnë banimin e kësaj zone, në periudhat e mëposhtme prehistorike dhe historike:

a. Periudha e tranzicionit nga Bronzi i Vonë në Hekurin e Hershëm (shek. XII-IX para Kr.) Kësaj periudhe i përketin dy objekte prehistorike, të gjetura pranë kodrinës “Suka e Lepurit”, të fshatit Vajkal, përkatësisht një majë heshte bronzi dhe një kantar pseudominoen, që përfaqësojnë inventarin e një varri të shkatërruar ilir të periudhës submikene ose protogjeometrike.

a1. Majë heshte bronzi. Gjetur në fshatin Vajkal. Ruhet në Muzeun Historik të Peshkopisë (më tej: MHP), nr.inv.1472, fig. 33a, 1. Është e tipit fletë ngushtë në trajtën e gjethes së shelgut, me bisht tubiform me prerje rrethore. E gjithë fleta përshkohet nga një kurriz konik gypor, gjithashtu me prerje rrethore. Supet i ka të rumbullakuara, ndërsa bishti gypor fare afër fletës, përshkohet

horizontalisht nga dy vrima përçinash. Gajtësia e përgjithshme 20.5cm, gjatësia e fletës 10cm, gjërësia maximale e fletës 2.4cm. Është një variant i majës së heshtës së tipit me fletë në trajtë gjethi. Është e ngjashme me heshta analoge të tumës IV të Pazhokut⁶⁵ etj. Datimi më i mundshëm: periudha submikene (1125-1050 para Kr.) ose protogjeometrike (1050-900 para Kr.)⁶⁶.

a2. Devegjake ilire e restauruar. Gjetur në fshatin Vajkal (Bulqizë). Ruhet në MHP. Nr.inv.1471, fig. 33a, 2. Lartësi 9cm, diametri i grykës 6cm dhe i trupit 11cm. Ka trup dykonik të theksuar, qafë të shkurtër, buzë të drejta dhe fund konkav. Vegjët vertikale me prerje eliptike, që lartësohen mbi grykë, i ngjiten enës në zonën e shpatullave, mbi vijën shumë të theksuar të karrinimit. Është punuar me brum argjilor të pastruar, me pak grimca kuarci, me pjekje dhe lëmim të mirë. Mungesa e zbukurimit dhe dykoniciteti i theksuar, i japin enës së Vajkalit, veçori lokale në raport me enët analoge të kulturës ilire të kësaj periudhe. Datohet në periudhën submikene ose protogjeometrike, nga shoqërimi i saj me majën e heshtës të përshkruar më lart⁶⁷.

⁶⁵ BODINAKU 1982, 79, tab.V,3.

⁶⁶ BUNGURI 1989, 67-69, tab. I, 1; BUNGURI 2010, 253, tab. CIII, 1.

⁶⁷ BUNGURI 2010, 253, tab. CIII, 2.



Fig. 33a-Vajkal-kantar dhe majë shigjete bronzi

b. Periudha e zhvilluar e epokës së Hekurit (shek. VIII-VII para Kr.)

b1. Majë heshte hekuri me fletë në trajtë gjethi. Është gjetur në Qafën e Buallit, në skajin perëndimor të luginës së Bulqizës (x-49°48', y-20°19', z-844m). Ruhet në MHP. Nr.inv.1471, fig. 33b. Gjatësia e përgjithshme është 19cm, gjatësia e fletës 11.5cm dhe

gjatësia e tunit 7.5cm. Përfshihet në tipin e heshtave me fletë në trajtë gjethe plepi, me gjërësi max. 4.2cm, të përshkuar nga kurrizi gjatësor me prerje rombike, tun tubiform me prerje rrethore dhe diametër max. 2cm. Në anën e jashtme, përkatësisht në 1/3 e gjatësisë së tij, tuni është i hapur. Raporti i gjatësisë së tunit me gjatësinë e përgjithshme të heshtës është 1:2.5. Datohet në periudhën e zhvilluar të epokës së Hekurit, shek. VIII-VII para Kr.⁶⁸.




Fig. 33b-Qafë Buall-Majë heshte hekuri

c. Periudha mesjetare paraosmane dhe periudha e Skënderbeut (shek. XIV-XV pas Kr).

c1. Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fushën e fshatit Vajkal. Ruhen në MHP, nr. inv. 44, fig. 34a, 1. Përmasat: gjatësia e përgjithshme 8.5cm, gjatësia e fletës 4cm, gjërësia e fletës 2cm, gjatësia e bishtit konik 4.2cm, diametri i bishtit 0.6-0.8cm. Është e tipit me fletë në trajtë gjethi, me veshëza të zhvilluar, me bisht konik gypor. Fleta me prerje trekëndëshe, përshkohet nga një kurriz gjatësor me prerje ovale në të gjithë gjatësinë e saj.

⁶⁸ BUNGURI 2010, 256, tab. CVI, 12.

c2. Majë shigjete hekuri. Zbuluar nga punimet bujqësore në fushën e fshatit Vajkal. Ruhen në MHP, nr. inv. 45, fig. 34a, 2. Përmasat: gjatësia e përgjithshme 7.2cm, gjatësia e fletës 3.2cm, gjërësia e fletës 1.7cm, gjatësia e bishtit konik 3.6cm, diametri i bishtit-0.8-1cm. Është e tipit me fletë në trajtë gjethi, pa veshëza, me bisht konik gypor. Në dallim nga maja e shtizës nr. 1, ka fletë me prerje trekëndëshe të shtrirë dhe kurriz shumë të lehtë gjatësor. Maja shigjetash me forma të ngjashme njihen në periudhën e hershme mesjetare, të zbuluara në varrezat e kulturës arbërore të Krujës⁶⁹, Lezhës⁷⁰, kalasë së Dalmaces⁷¹, kështjellës së Pogradecit⁷² etj, dhe vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XIV-XV pas Kr.




Fig. 34a-Vajkal-Maja shigjetash hekuri mesjetare

⁶⁹ ANAMALI-SPAHIU 1979-1980, 57, tab. IV, 7.

⁷⁰ PRENDI 1979-1980, 131, tab. XVII; 1-3.

⁷¹ SPAHIU 1964, 82.

⁷² ANAMALI 1979-1980, 231, tab. XI, 5.

c3. Enë e tipit ojnohe. Zbuluar nga punimet bujqësore në afërsi të fshatit Valikardhë të Zerqanit (Bulqizë). Ruhet në Muzeun Arkeologjik, Tiranë, nr. inv. 16478. Përmasat: lartësi 13.5cm, diametri i trupit-9cm, diametri i fundit 7cm, pesha 290gr., fig. 34b. Ena ka grykë trifletëshe me diametër 5.5cm, lëfyt të holluar në majë, trup të fryrë sferik, që veçohet nga gryka me një profilim të lehtë, fund të sheshtë dhe vegjë biforata të thyer. Është punuar me brum të pastër argjilor me ngjyrë rozë dhe ka pjekje shumë të mirë. Ajo është lyer me angobë të hollë të kuqëremtë në rozë dhe është zbukuruar me glazurë polikrome të tipit "*maiolica arcaica*"⁷³. Zona e zbukuruar përfshin të gjithë trupin e enës, nga fundi deri në buzë. Motivet me karakter gjeometrik përfaqësohen nga dy shirita në formë të germës"U", të alternuar me shirita të valëzuar vertikal midis tyre, të gjitha këto të realizuara me pastë të gjelbër. Fusha e shiritave në formë U-je, është e mbushur me pastë të bardhë, e cila nga pjekja në disa vende ka fituar qelqëzim me ngjyrë portokalli. Është enë e kushtueshme importi, e sjellë ose nga brigjet italice, ku enë të tilla gjenden në Pulia, Bari, Venecia etj, dhe datohen në vitet 1350-1450 pas Kr.⁷⁴. Gjetja e saj në afërsi të qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj. Enë të ngjashme, të zbukuruara me "*sgraffito polychrome*" vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XV dhe në fillim të shek. XVI pas Kr., kur shënojnë një përhapje mjaft të gjërë në gjithë Egjeun dhe Mesdheun Lindor⁷⁵. Gjetja e saj pranë qytezës së Valikardhës, dëshmon për një standart relativisht të lartë ekonomik e kulturor të përdoruesëve të saj.

⁷³ CRESCENZO 1992, 38-49.

⁷⁴ *Idem.*

⁷⁵ VROOM 2005, 143, tab. 2.3.




Fig. 34b-Valikardhë-Ojnohe mesjetare

c4. Mokër bloje, e fragmentuar. Gjetur gjatë surveit të vitit 2018, në sipërfaqen e kreshtës së “Kullës së Skënderbeut”. Përmasat: diametër 52cm, trashësi 6cm dhe diametri i vrimës së aksit-5cm (fig. 34c). Mokra të tilla bloje janë të zakonshme në vendbanimet mesjetare kudo në Shqipëri dhe më gjërë.



Fig. 34c-Mokër guri e Kullës së Skënderbeut

6. Edhe njëherë mbi lokalizimin e Vajkalit

Në fushën e Vajkalit (*fig. 35*) brenda vitit 1465 janë zhvilluar dy beteja të përgjakshme midis ushtrisë shqiptare të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe ushtrive osmane të sulltan Mehmetit II, të drejtuara nga renegati B. Pasha (Badera). Lokalizimin e toponimit Vajkal⁷⁶, e ka bërë vetë M. Barleti, kur shkruan mbi

⁷⁶ Terreni fushor ku është vendosur fshati *Vajkal*, në shek. XV-XVI duket se nuk ka qenë i banuar dhe ka qenë njohur thjeshtë si toponim i lidhur me pjesën lindore të luginës së Bulqizës, përderisa një fshat me këtë emër nuk përfshihet në regjistrat kadastral osman të viteve 1467 (Krhs. *Defteri emëror i vilajetit të Dibrës, Dulgobërdës, Rjekës, Çermenikës dhe të tjerave, mars 1467*, Arkivi i Institutit të Historisë, A-III-315 (përkthyer nga V. Buharaja). Ky fakt në të vërtetë e përforcon lokalizimin e vendbetejave të Vajkalit në këtë luginë, pasi betejat kalorsiake të mesjetës, nuk mund të zhvilloheshin në fusha të banuara. Në mesin e shek. XVII, Vajkali rezultoi i banuar dhe përbëhet nga 3 fshatra, sipas një relacioni kishtar të dy misionarëve italianë të vitit 1668-1669: “*Në Valkal (Valcal) ishin tre fshatra;*

betejën e parë të Vajkalit, midis Skënderbeut dhe renegatit B. Pasha (Badera): “*Kampi i skënderbegasvet ishte në një luginë të këndshme dhe të hapët, që zgjatej përpara dhe që e kish emrin Valkal*” ndërsa ushtria osmane i “*kishte ngritur çadrat nga ana tjetër e luginës, pranë një mali, i cili i jepte fund Valkalisë dhe nëpër të cilin kalohej përmes grykash e ngushticash.*”⁷⁷.

Në kohën tonë ky lokalizim është mbështetur nga H. Ceka-J. Adami gjatë vizitës së tyre në Vajkal në vitin 1951⁷⁸ dhe në pikëpamje gjuhësore është argumentuar nga E. Çabej, që ka shënuar se “*forma më e vjetër e tij duhet të ketë qenë Valkal, Valchalia (te Marin Barleti (1537), emri i një luginë në krahinë të Dibrës, që përbën rrugë kalimi*”, emër si “*luginë, udhë, rrugë kalimi*”, që mund të ketë ardhur prej latinishtes “*vall(is) callis* “*luginë, rrugë*”⁷⁹. Lokalizimi i mësipërm nuk është pranuar nga K. Biçoku, që mendon se Vajkali duhet vendosur diku në lindje të Ohrit, hipotezë e pasqyruar edhe në Historinë e Shqipërisë të vitit 2002⁸⁰. Sipas tij, emri *Valkal-Vajkal* rrjedh nga bashkimi i emrave “*val*” dhe “*kal*” dhe do të thotë “*luginë e kuajve*”, toponim që u dashka lokalizuar diku në lindje të Ohrit, ku “*kishte bar të bollshëm për të ushqyer kafshët*”⁸¹ (!), mendim i përsëritur edhe në një botim të kohëve të fundit⁸².

njeri ka pasur 10 shtëpi të krishtera, tjetri 4 dhe i treti rreth 20. Kishin priftin dhe kishën e tyre dhe në to kishte shumë shtëpi myslimane”. (BIÇOKU 2016, 167-168, shën. nr. 537).

⁷⁷ BARLETI (1537), 1964, XI, 450.

⁷⁸ CEKA-ADAMI 1951, 3.

⁷⁹ ÇABEJ 2008, 587.

⁸⁰ BIÇOKU 2002, 449-450. Paraqitja e pikëpamjes individuale dhe subjektive të një studiuesi, si mendim zyrtar dhe i institucionalizuar i historiografisë shqiptare, nuk është sipas pikëpamjes tonë në përputhje me kriteret shkencore të botimeve institucionale. Në një botim zyrtar, kërkohet më së paku, të paraqiten dy hipotezat e ndryshme mbi lokalizimin një vendbeteje apo lokacioni historik, dhe jo të paraqitet si e mirëqenë vetëm njera prej tyre dhe të injorohet mendimi i kundërt, siç ka ndodhur në këtë rast, aq më tepër, kur alternativa e dytë është, sipas bindjes sonë, krejtësisht e vërtetë.

⁸¹ Për më tepër po citojmë autorin e kësaj hipoteze: “*Kur përshkruan Valkalin, M. Barleci tregon se ishte luginë pranë malit Bigë (Furkë), emër mali e vargmali ky në lindje të qytetit të Ohrit....Vetë M. Barleci ka treguar se Valkali ishte luginë, prandaj ai toponim i latinizuar është i përbërë nga dy fjalë (Val dhe Kal), prej të*



Fig. 35-Pamje nga fusha e Vajkalit (Bulqizë)



Fig. 36-Busti i Skënderbeut në Vajkal (Bulqizë)

cilëve, e para me siguri shqipërohet “luginë” dhe e dyta lidhet me “kalë”. Të dyja së bashku zbërthehen në shqip “”Lugina e Kuajve”. Ky emër dëshmon se në këtë luginë kuajt e ushtrive çlodheshin dhe se aty kishte bar të bollshëm për të ushqyer kafshët”. Krhs. BIÇOKU 2006a, 81-82; BIÇOKU 2006b, 82.

⁸² BIÇOKU 2016, 163: *“Kompozita Vajkal (Vau Kal) është sinonim me fjalët “Shtegu i Kalit apo i Kuajve” dhe nuk ka të bëjë me fjalën latine (vallis, vallis)”.*

Argument i pakundërshtueshëm i lokalizimit të betejës së Vajkalit në Vajkal, është pa dyshim vetë fshati Vajkal dhe Fusha e Vajkalit, si dhe përputhja e plotë e tyre me Vajkalin e përshkruar nga M. Barleti. “Kulla e Skënderbeut” e ndërtuar mbi luginën e Vajkalit, në mbrojtje të “Rrugës së Arbërit” që kalonte përbri saj, është padyshim një argument i ri që e përforcon identifikimin e Vajkalit në Vajkal. Në të mirë të këtij identifikimi flasin gjithashtu edhe një varg toponimesh nga gjeografia historike, si “Vajkal”, “Fusha e Vajkalit”, “Valikardhë”, “Fusha e kalasë” (Valikardhës), “Shkëmbi i kullës së Skënderbeut”, “Kulla e Skënderbeut”, “Çardaku i Skënderbeut”, “Liqeni i Skënderbeut”, “Përroi i Skënderbeut”, “Gurra e Kuqe”, “Gurët e Skënderbeut”⁸³ etj.

Fortifikimet mesjetare dhe të dhënat arkeologjike të paraqitura më lart, dëshmojnë se gjatë epopesë Skënderbejane, rritet ndjeshëm numri i vendbanimeve dhe fortifikimeve ushtarake, dukuri që përputhet me burimet historike, sipas të cilave, Dibra, shëndrohet në këtë periudhë në një rajon strategjik të luftimeve çlirimtare të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut. Kërkimet e ardhshme arkeologjike, do të sjellin, pa dyshim, të dhëna më të plota mbi fortifikimet e periudhës së Skënderbeut edhe në rajonin e Dibrës.

⁸³ Në vendin e quajtur "Gurët e Skënderbeut", në skajin jugor të luginës së Vajkalit, me datë 27.05. 2017 është vendosur monumenti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut, në kujtim të dy betejave të Vajkalit të udhëhequra prej Heroit tonë Kombëtar. Monumenti ka lartësi 3.00m dhe gjërësi 2.50m. Punuar nga studenti i skulpturës, E. Balja (Vajkal) (fig. 36).

Summary

New archaeological data on some unknown Skanderbeg's fortifications in Dibra region

Koxhaxhik's castle lies at Zhupa area, between Dibra and Struga, in the eastern edge of Dibra area (FYROM). It was located at the top of a very rocking crest among the villages Koxhaxhik on southeast and Breshtan on northwest. Its altitude is 1160m above the sea level, whereas its relative height is 360m. It has a very strategic favourable position, easy controlling the road Ohër-Dibër through the Drini i Zi valley. This is a very important road, which join the two most important transbalkanian roman vias: the ancient via Egnatia on the south (Ohrid basin) and the Lissus-Naissus on the north (Kukës basin). Being the northern branch of via Egnatia, Drini i Zi road was the very strategic corridor through the prehistoric times to nowadays.

At Koxhaxhik's castle there are some traces of its inhabitation since the late bronze age and early iron age, as well as the late antiquity period and the mediaval ones. There are some parts of its late antiquity period and mediaval ones fortification system, on the upper platform of its even rocking surface, at the so-called "citadel". Its even surface has a polygonal plan with perimeter 145m, 58m long and 34m wide, and a surface nearly 1600m².

The surrounding walls follow the lines of the crest, except the southern side, including inside of the defended surface two narrow terraces with good dwelling conditions. The surrounding wall used the defense abilities of the rocking crest, somewhere including in its structure the natural rocks, or interrupting itself where its slopes are rocky or very steep ones. The nowadays wall's remains consist by 7 tracts of the surrounding walls, respectively 2.00m, 3.50m, 6.00m, 2.10m, 9.00 m, 6.00m and 22m long and its seeing perimeter 50.60m. The wall of the Late antiquity period is actually the earliest fortification of Koxhaxhik's castle. We could see it in the outer line wall of its tower. It had been builded with river and natural stones related with limestones mortar, by *opus incertum* technique. The

castle had nearly been refortified in medieval period, fulfilling the damaged parts and rebuilding the new ones lines of them. To the Medieval period belong all the remains tracts, named A-G, 50.60m long in generally, including the outer second wall of the its tower.

Their height moves from 1.00m to 2.50-3.00m, whereas their width moves from 1.40 to 1.70m. A similar width of surrounding walls have already been seen in some other medieval castles of Albania, such as the castle of Kruja, Shurdhahu(near Scodra), Daula (Kurbin), Stelushi(Dibër-Mat), Guri i Bardhë (Petalba) etc. In the chronological viewpoint, the medieval fortification of Koxhaxhik's castle belong to the XIV-XV centuries A.D. To this period conform the technique of building of the surrounding walls, their narrow width, the techniques features of the mortar determined by the limestones, the using of the iron building scaffold etc.

To the medieval preosman period of the XIV-XV centuries A.D. belong nearly all the the fragments of vessels founded on this castle and its varosh. There are a prevalence of the kitchen vessels with brown and brown to black colour clay, with good baking towards the sparse table ones with cleaner clay in ocrea or light red colour, sometimes decorated in white geometric painting. The similar forms of vessels have been discovered in some other medieval castles, such as at the castle of Stelush, Petrela, Daula, Kruja etc. The new archaeological data confirm that this castle had been inhabited since the LBA and the EIA. It had been fortified with surrounding walls for the first time at the late antiquity period, whereas at the medieval ones, probably at XIV-XV centuries A.D it had been refortified. This period was the most intensed life ones on this castle and its varosh. The above mentioned archaeological and historical arguments make us to believe that the wellknown medieval town of Sfetigrade can be identified in the Koxhaxhik's castle and its varosh. Skanderebeg's tower at Vajkal is without doubt another strong argument to support the identification of Vajkal in Vajkal. The archaeological data presented briefly above, proves that the fortifications in Dibra region was increased especially during the XIV-XV cent. AD. The accuracy of Barlet's descriptions is confirmed by the archaeological surveys as well as by the historical

geography und the identification of Scanderbeg's fortifications and his battles' places locations. We hope that the archaeological information presented here, would be helpful to enrich our knowledge on the archaeological data about the Skanderbeg's fortifications in Dibra region. We need to correct the subjective and voluntarist viewpoints, published in our historical literature, e.g. about the Koxhaxhik and Modrica's castles, as well as Vajkal's location.

Ilustrimet

- Fig.1. Hartë e disa kalave të Skënderbeut në Shqipëri
Fig. 2-4. Pamje e përgjithshme e kalasë së Koxhaxhikut
Fig.5. Pamje e sheshit të kalasë
Fig.6a-b. Trakte të murrit "E"
Fig. 7. Trakt i murrit "F"
Fig. 8. Trakt i murrit "D"
Fig. 9. Murri I i jashtëm I kullës (trakti C)
Fig. 10. Murri II i jashtëm i kullës(trakti C)
Fig. 11. Vrimë skelerie në murin E
Fig. 12. Trakt muri i një godine brenda citadelës (kishë?)
Fig. 13. Skicë planimetrike e kalasë
Fig. 14. Pamje e dybekut nr. 1 të kalasë
Fig. 15. Pamje e varoshit nga kalaja
Fig. 16a-b. Varosh-themele godinash
Fig. 17. Traseja e rrugës së varoshit
Fig. 18a. Pamje e pjesshme e varrezës së poshtme
18b. Pamje e varrezës masive
Fig. 19a-b- tab. I. frag. enësh prehistorike
Fig. 20a-b tab. II. fragmente enësh mesjetare
Fig. 21a-c. tab. III. fragmente enësh mesjetare
Fig. 22. Fragmente enësh mesjetare me dekor të pikturuar, plastik dhe me vija çarku
Fig. 23. Pamje e kreshtës së kështjellës së Modricës
Fig. 24. Trakt i murrit lindor të kështjellës së Modricës

- Fig. 25. Pamje e sterës së ujit të kështjellës së Modricës
 Fig. 26. Skicë planimtriqe e fortesës së Modricës
 Fig.27. Pamje e përgjithshme dhe skica planimtriqe e kalasë së Skudrinës.
 Fig. 28a-Pamje të Shkëmbit të Kullës së Skënderbeut
 Fig. 28b. Pamje perëndimore e kreshtës së kullës së Skënderbeut
 Fig. 28c-Rruga e fshehtë e kullës së Skënderbeut
 Fig. 28d- Gur dybeku pranë kullës së Skënderbeut
 Fig. 29a-Pamje e sipërfaqes së shkëmbit të Kullës së Skënderbeut
 29b. Skicë planimtriqe e shkëmbit të Kullës së Skënderbeut
 Fig. 30a. Pamje e murrin verior të kullës së Skënderbeut
 Fig. 30b. „ „ lindor „ „
 Fig. 30c. Skicë planimtriqe e kullës në formë patkoi
 Fig. 31a-b-Pamje e përgjithshme dhe plan & prereje e sterës së ujit
 Fig.32-Stera-detaje të llaçit hidroizolues
 Fig. 33a-Vajkal: kantar dhe heshtë bronzi të periudhës submikene
 33b-Qafë-Buall-heshtë hekuri e shek. VIII-VII para Kr.
 Fig. 34a. Vajkal-shigjeta mesjetare
 34b. Ojnohe - Valikardhë
 34c. Mokër bluarje-kulla e Skënderbeut
 Fig. 35. Pamje e pjesshme e fushës së Vajkalit
 Fig. 36. Monumenti i Skënderbeut në Vajkal

Shkurtime

- AiA: Arkivi i Institutit Arkeologjik
 AnSt: Anatolian Studies
 Bark: Buletin Arkeologjik
 BSHSH: Buletini i Shkencave Shoqërore
 Candavia: Candavia. Revistë arkeologjike
 Iliria: Iliria. Revistë arkeologjike
 KSA (I): Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike
 KSA (II): Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike
 KSI: Kuvendi i Studimeve Ilire
 Monumentet: Monumentet. Revistë e Institutit të Monumenteve
 PJZ: Praistorija Jugoslavenkih Zemalja

SSSH: Seria e shkencave shoqërore.

StAlb: Studia Albanica

StHist: Studime Historike.

Bibliografia

- ADHAMI 1971: S. ADHAMI, *Gjurmime rreth themelimit dhe rindërtimeve kryesore të kalasë së Krujës*. "Monumentet", 1971/1, 87-101.
- ANAMALI 1967: S. ANAMALI, *Stelushi qytet i Skënderbeut në Mat. (Të dhënat e gërmimeve arkeologjike) (Stelushi, ville de Skënderbeg a Mat)*. "StHist" 1967/4, 105-112.
- ANAMALI 1969: S. ANAMALI, *Kalaja e Varoshit në Mat–Stelushi, një hallkë e sistemit mbrojtës të Skënderbeut*. "KSA" (II). Tiranë 1969, vol. I. 249-253.
- ANAMALI 1979-1980: S. ANAMALI, *Kështjela e Pogradecit, Iliria IX-X, 1979-1980, 211-236*.
- ANAMALI-SPAHIU 1979-1980: S. ANAMALI-H. SPAHIU, *Varreza arbërore e Krujës, , Iliria IX-X, 1979-1980, 47-79*.
- ANDREA 1990: ZH. ANDREA, *Vendbanimi shpellor i Nezirit*. "Iliria" 1990/2, 5-45.
- ANDREA 1996: ZH. ANDREA, *Vendbanimi i Zagorës*. "Iliria" 1996/1-2, 21-55.
- BARLETI 1537 (1964): M. BARLETI, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut (ribotim i vitit 1537: përkthimi nga origjinali S. Prifti)*. Tiranë 1964.

- BIÇOKU 2002: K. BIÇOKU, *Luftrat e mëdha shqiptaro-osmane të viteve 60. Qëndresa e shqiptarëve të Moresë. Fitoret e ushtrisë shqiptare në vitet 1462-1465*. Historia e Popullit Shqiptar", vol. I, Tiranë 2002, 449-450.
- BIÇOKU 2003: K. BIÇOKU, *Dibra dhe Koxhaxhiku në kohën e Skënderbeut*. "StHist" 2003/1-2, 7-29.
- BIÇOKU 2006a: K. BIÇOKU, *Shtrirja lindore e zotërimeve të Kastriotëve*. Konferenca shkencore Ndërkombëtare „Skënderbeu dhe Evropa“ (9-10.12. 2005). Tiranë 2006, 61-82.
- BIÇOKU 2006b: K. BIÇOKU, „*Shtrirja lindore e zotërimeve të Kastriotëve*”. Revista “Albanica”, nr. 62, nëntor 2006, 79-82.
- BIÇOKU 2016: K. BIÇOKU, *Toponimet mesjetare për studimin e Historisë së Skënderbeut*. Tiranë 2016.
- BİSLIMI 2005: M. BİSLIMI, *Kryengritja e Skënderbeut në krahinën e Dibrës*. Simpoziumi „Skënderbeu dhe Dibra“. (Dibër 2 mars 2003), Shkup 2005, 164-172.
- BITRAKOVA-GROŽDANOVA 1966: V. BITRAKOVA-GROŽDANOVA, *Prilog kod antičkata na Debarskijot kraj*. Spisanje na Sojuzot na družvata na istoričarite na Republika Makedonija, Skopje 1966.
- BODINAKU 1982: N. BODINAKU, *Varreza tumulare e Pazhokut. Gërmime të vitit 1973*. Iliria 1982/1 (XII), 48-89.
- BOZHORI-LIÇO 1975: K. BOZHORI-F. LIÇO, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë*. Tiranë 1975.

-
- BUNGURI 1989: A. BUNGURI, *Armë ilire në krahinën e Dibrës*. "Iliria" 1989/1,67-73.
 - BUNGURI 2009: A. BUNGURI, *Kalaja e Koxhaxhikut (Dibër)*. "StHist" 2009 (1-2), 27-56.
 - BUNGURI 2010: A. BUNGURI, *Prehistoria e Dibrës*. Tiranë 2010.
 - BUNGURI 2011: A. BUNGURI, *Të dhëna arkeologjike nga Çidhna e Poshtme (Dibër)*, "Candavia" nr. 3, 2011, 197-219.
 - BUNGURI 2014: A. BUNGURI, *Të dhëna të reja mbi periudhën romake, antike të vonë dhe mesjetare në rajonin e Dibrës*. "Candavia" nr. 4, 2014, 285-308.
 - CEKA 1952: H. CEKA, *Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftave të Skënderbeut sipas Barletit*. "BSSHSH", nr.3,1952.
 - CEKA- ADAMI 1951: H. CEKA-J. ADAMI, *Raport mbi ekspeditën në Peshkopi, Mat e rrethe*. "AiA". Tiranë, 1951.
 - CRESCENZO 1992: A. DE CRESCENZO, *Ceramische invetriate e smaltate*. De Crescenzo invetriate e smaltate del Castello di Salerno del XII et XV secolo. Napoli 1992.
 -
 - ÇABEJ 2008: E. ÇABEJ, *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*. Prishtinë 2008.
 - DEFTERI 1467: *Defteri emëror i vilajetit të Dibrës, Dulgobërdës, Rjekës, Çermenikës dhe të tjerave, mars 1467*. Arkivi i Institutit të Historisë. A-III-315 (përkthyer nga V. Buharaja).

- GARAŠANIN 1983a: M. GARAŠANIN, *Podunavsko-Balkanski Kompleks Ranog Bronzanog Doba*. "PJZ", IV, Sarajevo 1983, 463-470.
- GARAŠANIN 1983b: M. GARAŠANIN, *Razvijeno Bronzano Doba i Prelazni period (Gvoždено Doba I) Makedonije*. „PJZ“, IV, Sarajevo 1983, 786-798.
- HOXHA 2011: G. HOXHA, *Një pagëzimore paleokristiane nën themelet e kishës së Shën Kollit në Lezhë*. "Iliria" XXXV (2011), 285-306.
- HOXHA 2016: G. HOXHA, *Konteksti arkeologjik i truallit dhe pejsazhit rrethues të kishës së Shelbuemit në Rubik (The archaeological context of the site and surrounding landscape of the Salvation church in Rubik)*. "Hylli i Dritës", 2016, nr. 2, 151-171.
- HYSA 2005: M. HYSA, *Sfetigradi si pikë strategjike, si lokacion, si konfiguracion dhe si arenë e luftës*. Simpoziumi „Skënderbeu dhe Dibra“ (Dibër 2 mars 2003), Shkup 2005, 103-117.
- INALÇIK 1969: H. INALÇIK, *Krahina e Krujës dhe e Dibrës rreth vitit 1467, "KSA" (II)*, Tiranë 1969.
- ISLAMI-CEKA 1965: S. ISLAMI-H. CEKA, *Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilëire në territorin e Shqipërisë, "KSA" (I) (15-21 Nëntor 1962)*. Tiranë 1965, 441-456.
- JASTREBOV 1904: I. S. JASTREBOV, *Staraja Srbija i Albania*. Beograd 1904.
- JUBANI 1972: B. JUBANI, *Qeramika ilire e qytezës së Gajtanit, "Iliria" II*, 1972, 377-403.

-
- KARAISKAJ 1979-1980: GJ. KARAISKAJ, *Gradishta e Symyzës në periudhën e vonë antike dhe në mesjetë*. "Iliria" IX-X, 1979-1980, 171-187.
 - KARAISKAJ 1985: GJ. KARAISKAJ, *Furnizimi me ujë i kalasë së Shkodrës në mesjetë*. "Monumentet", 1985/1, 59-68.
 - KARAISKAJ 2016: GJ. KARAISKAJ, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë 2016.
 - KOMATA 1969: D. KOMATA, *Disa tipare të qeramikës mesjetare në Shqipëri*, "Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve", Tiranë 1969, 221-243.
 - KOMATA 1982: D. KOMATA, *Të dhëna të reja arkeologjike nga Kalaja e Krujës*. "Iliria", 1982/1, 221-228.
 - LLESHI 2005: Q. LLESHI, *Përshkrime dhe konstatime mbi Sfetigradin nga burime historike dhe gjurmime në terren*. Simpoziumi shkencor "Skënderbeu dhe Dibra" (Dibër 2 mars 2003). Shkup 2005, 195-202.
 - MURRA 2005: M. MURRA, *Lokalizimi ibetjave të Skënderbeut në Dibër*. Simpoziumi „Skënderbeu dhe Dibra“ (Dibër 2 mars 2003), Shkup 2005, 123-146.
 - МИКУЉЧИЧ 1999: И. МИКУЉЧИЧ, *Антички градови во Македонија*. Книга 8, Скопје 1999.
 - NOLI 1962: F. S. NOLI, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë, 1962.
 - PRENDI 1966: F. PRENDI, *La civilisation préhistorique de Maliq*. "StAlb", 1966/1, 255-280.

- PRENDI 1969: F. PRENDI, Vendvarrimi i Skënderbeut. (La sepulture de Skanderbeg). "KSA" (II), (12-18 janar 1968), vol. I. Tiranë 1969, 241-247.
- PRENDI 1974: F. PRENDI, *Vështrim mbi kulturën e periudhës së parë të epokës së hekurit në Shqipëri*, „Iliria“ III, 1974, 103-121.
- PRENDI 1977-1978: F. PRENDI, *Epoka e bronzit në Shqipëri*, Iliria VII-VIII, 1977-1978, 5-25.
- PRENDI 1979-1980: F. PRENDI, *Një varrezë e kulturës arbërore në Lezhë*, Iliria IX-X, 1979-1980, 123-142.
- PRENDI 1982: F. PRENDI, *Die Bronzezeit und der beginn der Eisenzeit in Albanien*, „Südosteuropa zwischen 1600 und 1000 v. Chr.“, Berlin 1982, 203-233.
- SARAÇI 1987: GJ. SARAÇI, *Kalaja e fshehtë e Skënderbeut pranë fshatit Daulë (rrethi i Krujës)*. "Iliria" 1987/1 (XVII), 203-214.
- SPAHIU 1964: H. SPAHIU, *Gërmime të vitit 1961 në varrezën e hershme mesjetare të kalasë së Dalmaces*, "StHist" 1964/3, 71-96.
- SPAHIU-KOMATA 1974: H. SPAHIU-D. KOMATA, *Shurdhahi-Sarda, qytet i fortifikur mesjetar shqiptar*. "Iliria" III, 1974, 257-313.
- STERN 1997: E. J. STERN, *Excavation of the Courthouse Site At Akko. "The Pottery of the Crusador and Ottoman periods"*, "Atiqot", XXXI, 1997, 48-50.

-
- SHAROFI (1968) 2003: H. SHAROFI, *Historia e Dibrës*, (vol. I, 1968), Tiranë 2003.
 - VROOM 2005: J. VROOM, *Polychrome sgraffito wares from Italy*. In: *Byzantine to modern Pottery in the Aegean (An introduction and field guide)*, Parnassus Press 2005.

Muhamet BELA
(Tiranë)

A ISHTE SKËNDERBEU NGA HASI?!
- Mendime rreth origjinës së Skënderbeut -

Për vetë rëndësinë dhe rolin e spikatur që pati figura e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në historinë e Shqipërisë, jo pak diskutime janë ngritur hera-herës qoftë në rrafshin studimor historiografik, qoftë edhe në rrafshin politiko-mediatik, mbi origjinën dhe përkatësinë etnike apo krahinore të tij.

Ky diskutim historiografik, që shpesh kalon edhe në debate aspak shkencore, merr shkas padyshim nga fakti se për shkaqe dhe rrethana të ndryshme historike në të cilat është gjendur trualli shqiptar përgjatë shekujve, dokumentacioni autentik dhe burimet shkrimore me karakter analitik dhe arkivor janë të pakta, dhe ata që marrin përsipër të trajtojnë çështjet historiografike janë të detyruar t'u drejtohen burimeve të huaja shpesh jo fort bindëse, shpesh të manipuluar për shkaqe politike të prejardhjes përkatëse, ose të mbështeten më fort në deduksione të tërthorta dhe në hipoteza me baza jo fort të qëndrueshme.

Dhe, nëse në rastin e parë, atë të origjinës dhe përkatësisë etnike, debatet dhe pseudo-hipotezat dukshëm janë nisur nga qëllime të mirëfillta politike për të dëmtuar dhe mohuar qenësinë dhe aftësinë historike të vetë shqiptarëve, duke i veshur origjina të huaja, që diskutimi shkencor me të drejtë i ka zhvlerësuar apo nuk i merr në përfillje - në rastin e dytë, atë të origjinës dhe përkatësisë krahinore,

ngjan se diskutimi merr shkas nga një shtysë e brendshme autoriale, që siç thotë me të drejtë prof. K. Frashëri: “*Kjo është e natyrshme, po të kemi parasysh krenarinë që ndjen një qytet ose një fshat, kur e di se nga gjiri i tij ka dalë një personalitet imadh politik, ushtarak, kulturor, letrar ose artistik. Kështu ndodhi dhe me Skënderbeun*”.¹

Për rastin e parë, atë të përkatësisë së huaj të origjinës së Skënderbeut, mund të themi se është anashkaluar logjika e kohës në të cilën jeton dhe vepron Gjergj Kastrioti, duke iu shmangur faktit se një sundimtar me përkatësi të huaj nuk mund të gëzonte atë popullaritet dhe atë mbështetje masive që gjeti ai në zotërimet e tij e më gjerë në territoret arbërore, e më tej kur ai vetë shprehet sipas burimeve shkrimore e dokumentare, se i përket dhe flet në emër të një vetëdijeje etnike, asaj arbërore (apo epirote, apo shqiptare, sipas konotacionit që i jepej asokohe vendeve dhe popullsive).

Ndërkohë që Noli, duke iu referuar dëshmisë së Gjon Muzakës në “Gjenealogjinë” e tij, në studimin e tij “Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë (1405-1468)”, ndër më të rëndësishmit dhe më argumentuesit e studimeve të periudhës bashkëkohore mbi Skënderbeun, vëren: “*Gjon Kastrioti ishte i martuar me Vojsavën, të bijën e kryezotit të Pollogut afër Tetovës. Kjo krahinë dukej që ishte një pjesë e Principatës Balshjane dhe hynte nën influencën e Kastriotëve ... sipas dëshmimit të Gjon Muzakës, e ëma e Vojsavës ishte nga dera e Muzakajve*”.²

Pra, mbetemi në rrafshin e origjinës arbërore (shqiptare) të Skënderbeut dhe në diskutimin mbi përkatësinë krahinore brenda arealit shqiptar të tij. Bihet shpesh në lapsus logjik kur, duke u nisur nga zotërimi faktik i një treve të caktuar i shënuar nga ndonjë dëshmi shkrimore, ky zotërim shihet edhe si përkatësia krahinore e tij, duke i ikur faktit se origjina duhet kërkuar në rrënjët familjare dhe jo tek individit.

Më tej, duhet parë edhe rrjedha e zhvillimeve historike të zotërimeve arbërore (shqiptare) të shekujve XIV-XV. Vërtet që Gjergj Kastrioti-Skënderbeu përbën figurën qendrore të historisë

¹ K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, Tiranë 2002, f.55.

² F.St.Noli, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë 1962, f.14-15.

shqiptare të çerekut të tretë të shekullit XV, por parashtrati politik i zotërimeve shqiptare është disi i ndryshëm dhe duhet marrë patjetër parasysh. Skënderbeu përmbyll epilogun fatal të një etape kohore prej rreth një shekulli e kusur identiteti politik të shqiptarëve, me zotërimet e tyre të rëndësishme, duke nisur nga formacionet shtetërore madhore të Balshajve dhe Shpatajve, për të ardhur në një varg zotërimesh më të pjesëtuara pas rënies së fuqisë së tyre, si Dukagjinët, Aranitët, Muzakajt, Topiajt etj., dhe për të kulmuar me përballjen historike të zotërimit të Kastriotëve me Perandorinë Osmane dekadat e para të shekullit XV e deri në rënien e fuqisë skënderbegiane. Jo pa vlerë vetëpohimi i Gjergj Kastriotit se kërkon të ndjekë gjurmët e Balshës, që e sjell Nikolla Jorga në Kronikën e Manjos tek “Notes”, nëpasazhin: “Brenda tre ditëve pushtoi (Skënderbeu) vende të tjera në Shqipëri dhe u bë i fuqishëm, duke thënë se ishte trashëgimtari i Balshës”.³

Duke parë mendimet mbi origjinën krahinore (shqiptare) të Skënderbeut, shohim të ketë kryesisht hipoteza që shpesh mbështeten në gojëdhëna, legjenda apo duke marrë edhe fakte të shkëputura nga njëri-tjetri: origjina e Skënderbeut është nga Mati, nga Dibra, nga Hasi, nga Mirdita; duke mos i dhënë rëndësi edhe një hipoteze që pretendon të jetë nga jugu epirot, që mbështetet vetëm në një përkim rastësor mbiemëror të njëfarë Branilo Kastrioti, që del diku në një dokument të Kaninës. Për këtë mendoj se duhet t’i referohemi arsyetimit të Francesko Keta-Krispit, i cili thekson: “*Tashmë ne nuk dyshojmë asnjë çast të njohim tek ky Branillo Kastriot, Alesio Vrana Kastriotin tonë. Dallimi mes Brana dhe Vrana është tepër i thjeshtë që të vlejë mundimi të flasim për të: dhe emri i Branillos larg nga të qenit një emër çfarëdo sllav, për ne nuk është tjetër veçse diminutivi, në latinisht, i Brana, gjë për më tepër jo e pazakontë në këtë epokë...*”⁴

³ Jorga, Nicolae, *Notes et Extraits pour servir à l’Histoire des Croisades au XV^e siècle*, seconde serie, Leroux, Paris, 1899.

⁴ Felice Cuniberti, *Shqipëria dhe princi Skanderbeg*, në suplementin: Papas Francesko Keta-Skirò, *Rreth disa dokumenteve gjenealogjike mbi Kastriotët*, Tiranë 2018, Reklama, f. 213-217.

Burimi kryesor ku mbështetet hipoteza e origjinës matjane të Kastriotëve na vjen në fillim të shek. XVI nga humanisti shkodran Marin Barleti, qëmes tjerash shkruan: “*Dhe, meqenëse nuk e quaj me vend që fisi i Skënderbeut të mbetet krejt i panjohur, por edhe s’kam ndërmend të përshkruaj tërë vargun e të parëve të tij, do të jem i kënaqur të prek vetëm një gjë, se krerët e fisit të Kastriotit kanë rrjedhur nga Mati, prej një dere fisnike*”.⁵

Po kështu edhe Dhimitër Frangu, prift katolik nga Drishti, në veprën e tij origjinale latinisht, të përkthyer në italisht pas vdekjes pa emrin e tij, Venedik 1539 (*Komentar për punët e turqve dhe të zotit Gjergj Skanderbeg, Princ i Epirit*), thekson se Kastriotët janë nga Mati. Edhe nipi i tij Andrea Engjëlli⁶ mbështet hipotezën se Kastriotët ishin nga Mati.

Kjo hipotezë nuk ka gjetur mbështetje nga studiues të ndryshëm, përfshi dhe prof. Kristo Frashërin, i cili, duke trajtuar mendimin e Barletit si humanist, ndalet në prirjen e tij klasiciste në lidhje me emërtimin Emat (Aemathia) për origjinën e Kastriotëve, ku në disa raste Barleti i jep kuptimin e Matit, por në raste të tjera ashtu si shkrimtarët klasikë grekë dhe romakë (Straboni, Plini, Justini, Klaudi), të cilët quanin Ematia provincën e Maqedonisë së Dytë, që Roma krijoi në shek. I në trevën midis Durrësit e Ohrit, që më vonë u quajt provinca e Epirit të Ri, dhe në Mesjetë u përfshi në emërtimin Arbëri.⁷

Ndërkohë, një argument logjik që zhvlerëson këtë hipotezë të prejardhjes së Kastriotëve nga Mati, vjen edhe nga dëshmia e bashkëkohësit Gjon Muzaka në “*Historia e Genealogia della casa Musachia, scrittada D. Giovanni Musachio Despote del Epiro*”, botuar në “*Chroniques greco-romanes, inèdites ou peuconnues*” nga Karl Hopf, në Berlin 1873, i cili duke folur për paraardhësit e Skënderbeut thotë: “*I biri i Palit, Gjon Kastrioti, u bë zot i Matit*”, e më tej “*mbasi rifitoi pronat atërore (Skënderbeu), mori qytetin e*

⁵ Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë 2005, f. 2.

⁶ Andrea Engjëlli: *Gjenealogjia e perandorëve romanë dhe konstandinopolitë*, Romë, 1553, f. 490.

⁷ K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, Tiranë 2002, f.56-57.

Krujës që nuk zotërohej prej të jatit” dhe aneksoi “Dibrën, Birinën, domethënë Randisinë, Tomanishën dhe Misien, si dhe krahinën e Gjonmit deri në bregdet”. Pra, Kastriotët nuk mund të kishin origjinën as nga Mati e as nga Kruja për shkak se nuk mund të kesh origjinën nga zotërimet që i fiton në kohë më të vonë se ekzistenca e mëparshme!

Së dyti, dhe që është mbështetur edhe nga historianë me emër, është hipoteza e origjinës nga Dibra. Në veprën e tij mjaft të thelluar “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, Tiranë 2002, në Kreun III: *Nga ish-in Kastriotët*, prof. Kristo Frashëri ndalet gjerësisht mbi origjinën e Skënderbeut. Që në fillim (faqe 54) thekson se “*si familje, Kastriotët, paraardhësit e Skënderbeut, shfaqen më vonë se shumë familje bujare shqiptare të kohës së tij, të cilët përmenden si feudale të vegjël që në vitet ‘70 të shek. XIII, ndonjëri ndoshta më herët ... në përgjithësi kanë përdorur si mbiemër emrin e fshatit të tyre të hershëm. Madje kjo praktikë ka vazhduar deri në ditët tona*”. Po prof. K. Frashëri, në vitin 1974 parashtrori tezën se origjinën e Kastriotëve duhet ta kërkojmë në Dibrën e Poshtme, në bashkësinë krahinore të Qidhnës, në juridiksionin e së cilës ndodhet fshati Kastriot.⁸

Prof. Frashëri mbështet origjinën e Kastriotëve pikërisht nga fshati Sinjë i Dibrës. Duke iu referuar kushëririt të parë të Donika Kastriotit, Gjon Muzakës, si njohës i mirë i familjeve feudale të shek. XV, që thotë se “*gjyshi i zotit Skënderbeg quhej Zoti Pal Kastrioti, dhe ky nuk kishte më tepër se dy fshatra të quajtur Sinjë dhe Gardhi i Poshtëm*”. Nuk është e rastit, thotë Frashëri, që të dy fshatrat ndodhen në krahinën e Qidhnës, ballë për ballë me fshatin Kastriot, nga i cili i ndan Drini i Zi. Po kështu mbështetet tek historiani italian, Rafael Volaterrano, bashkëkohëtar i Skënderbeut, që në vitin 1506 ka botuar një biografi të shkurtër të Skënderbeut, i cili të atin e tij e quan Gjon Dibra ose Dibrani⁹, si dhe tek St. Gaspari¹⁰ në emrin Has të

⁸ Kristo Frashëri, Gazeta “Mësuesi”, 4 shtator 1974.

⁹ Kristo Frashëri: *Skënderbeu...*, vep.cit. f. 64.

¹⁰ St. Gaspari: *Relazione del vescovado di Scutari* etj. (1671), në: “Hylli i Dritës”, vëll. VII (1931).

ndeshur në shek. XVII në fshatin Tren, në Dibrën e Poshtme, në lindje të lumit Drin, në mikrokrasinën e Qidhnës.

Prof. Frashëri më tej kundërshton kronikën raguziane të Lukarit dhe kodeksin boshnjak të Fermentxhinit, për të cilët thotë se *“asnjëri prej tyre nuk ka vlerë dokumentare”*.¹¹

Profesori ndër argumentet kundër origjinës së Skënderbeut nga “Hasi i Krumës” thekson pamundësinë që ka një njeri nga *“Hasi i largët të bëhet zot feudal në një krahinë të huaj për të dhe, ca më tepër që dibranët e bashkësisë krahinore të Qidhnës....., të pranonin të kishin mbi krye një feudal nga një krahinë tjetër e huaj për ta”*! ... dhe *“Në rastin më të mirë, emërimi i një pinjollit kastriotas nga Hasi i Krumës në trevën dibrane, mund të ketë ndodhur gjatë sundimit të Stefan Dushanit. Po Stefan Dushani, përveçse nuk ka shenja të ketë ushtruar pushtet absolut në viset e thella malore, nuk jetoi gjatë. Vdekja e tij duhet të ketë sjellë, si kudo, edhe në Dibër, dëbimin e funksionarëve të tij feudalë nga popullsia vendase”*.¹²

Duke kundërshtuar Nolin për origjinën e Skënderbeut nga Hasi, prof. Kristo Frashëri thekson se: *“Vetëm në Krumë ka një lagje që mban emrin Kastrot”*.¹³

Profesori përmend dhe thëniet e një njohësi të mirë të trevës dibrane, Azis Ndreut, se *“pjesa jugore e Fushës së Kastriotit deri në përroin e Gjelagjoshit, dikur thirrej Hasi i Thatë, kurse tani ajo quhet Fusha e Thatë, ashtu siç përmendet edhe në revistën e përmendur “Albania” të Faik Konicës (1903)”*.¹⁴

Edhe prof. Mark Krasniqi në punimin kushtuar gojëdhënave që kanë qarkulluar mbi gjenezën e Kastriotëve,¹⁵ shton se: *“sipas traditës popullore, Skënderbeu ka qenë prej katundit Kastriot, afër Dibrës”*.

Mendojmë se ngulmimi i prof. Frashërit për mospranimin nga ana e dibranëve të zotëve nga krahina të tjera nuk qëndron, pasi me

¹¹ Po ai, vep. cit., f. 61.

¹² Po aty, f. 62.

¹³ Po aty, f. 59.

¹⁴ Po aty, f. 61-62.

¹⁵ *Gjeneza kastriote e disa fiseve shqiptare dhe malazeze sipas traditës popullore*, në “Simpoziumi për Skënderbeun”, Prishtinë, 1969, f. 265-266.

të njëjtën logjikë nuk do ta pranoinin as matjanët e as krutanët. E më tej, mbas rënies së Stefan Dushanit, zotërimin e gjithë trevave verilindore e mori në dorë dinastia e Balshajve që padyshim nuk janë nga Dibra(!) e as nga Mati. Që edhe Dibra, apo Qidhna e prof. Frashërit, ishin nën zotërimin e Balshajve si pjesë e gjithë principatës balshjane, vijnë një mori dokumentesh e burimesh shkrimore. Kështu, kur flet për forcimin e principatës së Balshajve pas rënies së Dushanit, Giuseppe Gelchih¹⁶ njofton se principata e Balshajve u zgjerua fillimisht në njësinë ekonomike Shirgj-Prizren e më pas zbriti drejt jugut duke zënë tokat Tivar-Prizren-Vlorë. Dëshmi të tilla vijnë edhe tek Nedeljkoviç apo në “Acta Albaniae Veneta”, për kontrollin nga Balshajt të gjithë arealit arbëror të Kosovës duke zbritur në jug drejt Ohrit e Kosturit. Dhe padyshim edhe Dibra e Poshtme nuk mund të ishte jashtë këtij areali. Ndërsa, për zotërimin e Sinjës dhe Gardhit të Poshtëm vijnë edhe dëshmi të tilla që këto dy katunde iu dhuruan gjyshit të Skënderbeut nga Gjergj Balsha, si shpërblim për trimërinë e dëftyer si komandant trupash ushtarake. E edhe në këtë rast, origjina nuk mund të nxirret nga vendet e dhuruara.

Një hipotezë që lëvrohet së voni nga autorë shqiptarë, por që mbështetet në disa autorë të huaj është ajo e origjinës së Skënderbeut nga Mirdita. Mendimin për origjinën e Kastriotëve nga Mirdita fillimisht e ka shprehur J. P. Fallmerayer: “*Kastriotët ishin nga Kastri i Mirditës*”.¹⁷

Po ashtu Athanas Gegaj, mes tjerash vë në dukje se në Mirditë gjendet një lokalitet me emrin Kastri (midis Dibrit, Mënellës, Kashnjetit dhe Vigut), nga i cili Kastriotët e morën mbiemrin e tyre të parë. Ai shton se këtë pohim e mbështet në faktin se Kastriotët kishin të drejta zotërimi mbi krahinat e Mirditës.¹⁸ Duke parashtruar një sërë argumentesh të tij, edhe studiuesit Preng Cub Lleshi etj., kanë trajtuar origjinën e Kastriotëve nga Mirdita. Në paraprijë të hipotezës së fundit, pra të origjinës nga Hasi, të cilën dhe e mbështesim në mënyrë më argumentuese se të tjerat, duhet thënë fillimisht se prej

¹⁶ G. Gelchih, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi*. Spalato 1889.

¹⁷ J. Ph. Fallmerayer: *Elementi shqiptar në Greqi*, Tiranë 2003, f. 167.

¹⁸ A. Gegaj: *L'Albanie et l'invasion turque au XV-e siècle*, Paris 1937, f. 34-35.

disa familjeve që kanë emigruar në Itali, Kastriotët njihen edhe me një mbiemër të dytë Mazreku. Kjo mbështetet edhe në një pohim të Dyfrendu Kanzhit, i cili duke iu referuar FlavKomnenit, jep si stërgjysh të Skënderbeut një “Constantinum Castriotus, cognomento Meserechus, Aemathiae, et Castoriae Principis” (Konstantin Kastrioti, i mbiquajtur Princ i Mazrekut, Matit dhe Kastratit).

Pra, tashmë le të ndalemi në hipotezën e origjinës nga Hasi, të cilën e kanë mbështetur studiues mjaft të njohur, si: Pietro Luccari, Frang Bardhi, E. Fermendzin, F. St. Noli, akademiku i njohur Aleks Buda, Sh. Hoxha, B. Muhadri, N. Çoçaj, M. Dauti etj.

Pietro Lukari në vitin 1605¹⁹ në kronikën e vet shkruan se: “Gjon Kastrioti ishte zot i Krujës” dhe se “familja e tij ka dalë nga Kastrati, fshat në juridiksionin e Hasit në Shqipëri, pak larg lumit Drin”.²⁰

Në vitin 1553, Andrea Engjëlli ka shkruar në Romë se paraardhësit e Gjon Kastriotit, përveç Matit, kanë zotëruar Kastorien dhe Ymenestrien. Sipas këtij autori, Gjon Kastrioti ka qenë i biri i “Gjergj Kastriotit” dhe ky i “Konstandin Kastriotit, të mbiquajtur Mazreku, që kishte vdekur në vitin 1390”.²¹

Me mendimin e Pietro Lukarit bashkohet dhe humanisti, shkrimtari dhe historiani shqiptar Frang Bardhi,²² i cili ka jetuar në Shqipëri. Në veprën e tij për Gjergj Kastriotin, botuar në vitin 1636, kundërshton pikëpamje si ato të J. Mërnjanoviqit, që duan t’i nxjerrin Kastriotët me origjinë sllave. Frang Bardhi, duke polemizuar me ta, argumenton se Kastriotët ishin nga Hasi. Pas një sërë argumentesh të autorëve të ndryshëm për origjinën e Skënderbeut, Frang Bardhi thekson: “Megjithëse ato që kemi thënë gjer tani mund të mjaftojnë për vërtetësinë e çështjes në fjalë, unë do të shtoj edhe disa gjëra nga mendja ime, të cilat ndihmojnë për ta ndriçuar punën e familjes së Kastriotëve. Duhet të dimë, d.m.th., se është një pjesë e vogël e Epirit apo Shqipërisë, që sot në kohën tonë quhet zakonisht nga Epirotët

¹⁹ CopiosoristrettodegliAnnali di Rausa. In Venetia, 1605, f. 86.

²⁰ Giovanni Castriota Signor di Crui, la qual famiglia uscì da Castrati,, villa nella giurisdizione in As in Albania, poco discosto dal fiume Drillon.

²¹ Historia e popullit shqiptar, Vëllimi II, Tiranë 2002, f. 314.

²² Frang Bardhi, Skënderbeu (Apologji), 1957, f. 69.

dhe bashkëkombësit tanë: As. Pranë këtij vendi janë vendosur Pulatasit (a) dhe Dukagjinasi, popullsi shqiptare. Përmes këtyre popullsive dhe përmes maleve shumë të larta rrëshqet lumi i shënuar dhe shumë i shpejtë Drin. Në këtë pjesë të Epirit, ndërmjet vendeve malore të asaj krahine, ngrihet një fshat i njohur, i quajtur prej Askolëvet (b) Kastrat... Të drejtën dhe pushtetin mbi këtë fshat e pretendon për veten e saj një familje e përmendur dhe shumë e vjetër ndërmjet bashkëvendësve tanë, e quajtur Kastrati. ... Unë për shumë arsye guxoj ta pohoj si të vërtetë se nga ky vend e nga kjo familje kanë dalë ata që quhen zakonisht “Kastriotë”. Së pari, se me këtë mendim është në pajtim të plotë mendimi i përgjithshëm i kombit, gjë që unë e kam pasur shumë parasysh në çështjen që shqyrtojmë. Sepse ato që ne trashëgojmë etërit dhe gjyshërit, ua lëmë me lehtësi pasardhësve tanë, sidomos kur është fjala për gjëra të shquara e që vlejnë të mbahen mend, sipas fjalës: “pyet babanë tënd dhe do t’i tregojë të parët e tu” - pastaj është nevoja të merret parasysh se, që nga koha e Skënderbeut e gjer tani, nuk ka kaluar aq kohë sa që të jetë shlyer e harruar çdo kujtim i tij dhe i njerëzve të tij nga bashkëkombësit tanë...”.²³

Duke ndalur mbi këtë pohim të Frang Bardhit, mund të ngulmohet se një autoritet si Bardhi, që ka si objekt të veprës së tij pikërisht origjinën e Skënderbeut, dhe që nuk është i largët nga koha që trajton, siç thotë dhe vetë, ka një peshë më të rëndësishme se autorë të tjerë që i referohen ose koïncidencave emërore, ose fakteve të veçuara pa marrë në konsideratë tërësinë e argumenteve. Kështu që Frang Bardhi superon ndjeshëm mjaft burime të tjera për origjinën të ndryshme të Skënderbeut.

Historiani boshnjak E. Fermentxi, në vitin 1892, gjatë studimit të dokumenteve të Bosnjës mesjetare, të evidentuara në Hungari në një manastir françeskan, u njoh dhe me informacione që flisnin mbi familje fisnike boshnjake dhe shqiptare. Në një prej tyre flitet se “Kastriotët ishin nga fshati Kastriot në krahinën e Hasit”.²⁴

²³ Po aty, f. 70.

²⁴ E. Fermentzin: *Acta Bosnae, Monumenta Spectantis Historam Slavorum Meridionalium*, vol. XXIII, Zagreb 1892, f. 132.

Fan S. Noli, duke folur për këtë, thekson: “Një dokument i zbuluar në një manastir franceskan të Hungarisë prej dijetarit Fermexhin, na tregon që Kastriotët ishin nga një fshat i quajtur Kastriot në Malësinë e Hasit. Këtë na e vërteton edhe kronikani i Raguzës Luccari, duke bërë vetëm lajthim në emrin e katundit, të cilin e shtrembëron si Kastrati, po pastaj e ndreq kur na thotë që ndodhej në krahinën e Hasit afër Drinit”.²⁵

Profesor Aleks Buda thekson se “megjithëse Noli, duke u mbështetur mbi dokumentin, ngul këmbë se fshati quhet Kastriot, unë mendoj se emri duhet të jetë Kastrat. Lukari në “Annali di Rausa”, Venedik 1605, Libri II, f. 80, thotë se katundi nga rridhnin Kastriotët ishte Kastrati në Has. Ky indikacion vërtetohet edhe nga shkrimtari ynë Frang Bardhi. Në kohën e Bardhit gjendej aty ende një familje që ishte fis me Skënderbeun. Megjithatë Gegaj ngul këmbë se Kastriotët rrjedhin nga një katund Mazrek në Has, duke u mbështetur edhe mbi faktin se nuk ekziston në Has fshat Kastrat, sepse ky është emri i një fisi në veri të Shkodrës; emrin e tyre Kastriotët e morën, sipas Gegajt, nga pronat që kishin në fshatin Kastri në Mirditë.

Një njohës i mirë i vendit etnografi Rrok Zojsi, më dëshmon se një lagje e Krumës sot në Has mban ende emrin Kastrat dhe vërteton me këtë indikacionet e Lukarit dhe të Bardhit, rrëzon hipotezën e Gegajt dhe korrigjon, pas mendimit tim, indikacionin e dokumentit të botuar nga Fermexhin. Arsyeja që ky dokument e shkruan Kastriot dhe jo Kastrat emrin e katundit është padyshim se shkruesi ka qenë ndikuar nga analogjia me emrin e familjes. Arsyet, përse emri i familjes që vjen nga Kastrati ka marrë formën Kastrioti, duhen kërkuar në ndikimin bizantin, që ka vepruar mbi emrat e shumë krerëve feudalë shqiptarë në mesjetë”.²⁶

Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar thuhet: “Kastriotët ishin me prejardhje nga Hasi dhe kishin atje fshatrat me emër Mazrek, Kostur, Ujmisht (Vumestje), emra që do t’i mbajnë edhe në emrin e tyre të familjes. Më vonë i shtrinë zotërimet drejt jugut, ku Pal Kastrioti, gjyshi i Skënderbeut, zotëronte fshatrat Sinjë dhe Gardhi i

²⁵ Fan S. Noli, vep. cit., f. 13.

²⁶ Aleks Buda, *Shkrime historike*, Tiranë 1986, f. 164.

Poshtëm, dhe mandej dy Dibrat. Shtrirja e mëtejshme territoriale dhe fuqizimi i sundimit të Kastriotëve lidhet me emrat e Gjon Kastriotit si dhe të Gjergj Kastriotit Skënderbeut".²⁷

Zhan Klod Faverial, duke folur për Skënderbeun thotë: *"Familja e tij e kishte prejardhjen nga fisi shqiptar i Kastratëve, prej nga rrjedh dhe emri i Kastriotit"*.²⁸

Po kështu, në Vëllimin I, të *Historisë së popullit shqiptar*, botim i Akademisë së Shkencave, viti 2002, është interesant argumenti në lidhje me mbiemrin e dytë të Kastriotëve, siç ishte Mazreku, si dhe pronat e tyre Kastorie dhe Ymenestrie, që përmend A. Engjëlli, të cilat gjenden në mikrotoponiminë e hershme dhe të sotme të Hasit (Kostur, Kastrat dhe Mazrek), dhe të Drenicës e të Lumës (Ujmiri dhe Ujmisht, që përmend edhe Dh. Frangu), në përfundim të të cilëve renditet dhe një dëshmi e fillimit të shek. XIX se në qytetin e Gjakovës jetonte rrobaqepësi Mihal Kastrioti, që flet për praninë e ruajtjes ndër shekuj të këtij mbiemri në krahinën e Hasit nga e kishin origjinën Kastriotët.²⁹

Profesorët tanë të mirënjohur që mbështesin origjinën e Skënderbeut nga Hasi, krahas argumenteve të tjerë, citojnë një lagje Kastrat në qytetin e Krumës. Prof. Kristo Frashëri, i cili e kundërshton origjinën e Skënderbeut nga Hasi i Republikës së Shqipërisë, midis të tjerash vë në dukje se *"Po ashtu lagja Kastrat e Krumës nuk ndodhet pranë lumit Drin"*.³⁰

Historishkruesit e deritanishëm duhet të dinë se fare pranë lumit Drin, afro 1 km larg tij, ndodheshin Kastratët e fshatit Brrut (Pikërisht në këtë fshat janë gjetur gjurmë neolitike dhe të periudhave të mëvonshme). Kastratët numerikisht përbënin lagjen më të madhe të këtij fshati. Këta Kastratë, me rastin e ngritjes së Hidrocentralit të Fierzës, u zhvendosën në qytetin e Krumës ku kanë lagjen e tyre. Jo larg ish-fshatit Brrut, në zonën malore ndodhen Kastratët e Pusit të Thatë, në lagjen Demiroll, me të cilët asnjëherë

²⁷ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f. 460.

²⁸ Zhan Klod Faverial, *Historia e Shqipërisë*, Plejada 2004, f.282-283.

²⁹ *Historia e Popullit Shqiptar*, Tiranë 2002, V. I, f. 314.

³⁰ Kristo Frashëri, vep. cit. f. 59.

nuk kanë bërë krushqi, pasi i quajnë të një gjaku. Kastratët gjenden dhe në fshatin e njohur të Golajve në Has.

Kastratët e Brrutit kanë qenë vendosur në një mjedis me kushte gjeomorfologjike mjaft të përshtatshme për banim, ku para së gjithash kishte një fushë tejet pjellore aluvionale, ku kultivoheshin gjithë prodhimet bujqësore, kishte kullota malore për blegtorinë dhe shfrytëzohej edhe peshkimi. Siç duket, fuqizimi i kësaj familjeje mundësoi zgjerimin e saj me prona aq sa ka arritur më vonë të shtrijë zotërimet e saj në Dibër, Mat e Krujë.

Si përmbyllje, Frang Bardhi në veprën e tij të cituar, thekson: *“Por me gjithë këtë, unë nuk mund të kaloj në heshtje, ndërmjet tjerësh, dy nga heronjtë e panumërt të familjes Kastrati, të cilët janë gjallë gjer më sot... I pari u rrëmbye që fëmijë nga duart e prindërve të tij katolikë prej njëfarë turku epirotas që mban emrin Isuf Beg dhe që është nga më të fuqishmit e kohës sonë. Mbasi u edukua ndërmjet oborrtarëve të këtij sipas zakonisht turk, u la i lirë dhe mbas pak vjet shkoi në Stamboll, ku u nderua me gradën e spahiut. Ky është një burrë trim, i urtë dhe i pajisur me dhunti të tjera të shquara. Tani jeton pranë njerëzve të tij, i mbuluar me lavdinë më të madhe dhe quhet Mustafa Kastrati. Tjetri quhet Gjon... Duke dhënë prova të shkëlqyera të burrërisë së tij, po tregohet kështu trashëgimtar i denjë i lavdisë dhe trimërisë stërgjyshore”*.³¹

Nëqoftëse mbështesim traditën e gojëdhënave, edhe sot Kastratët e Brrutit e bashkëkohës të tjerë transmetojnë tregime për Mustafa Kastratin, të përcjella më parë gojë më gojë nga paraardhësit e tyre. E rëndësishme është se Skënderbeu, kjo figurë e jashtëzakonshme, qëbrezat e nderojnë në shekuj, është shqiptar dhe dha kontribut të paçmuar jo vetëm për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga invazioni osman, por dhe në mbrojtjen e vlerave të qytetërimit evropian. Duke hedhur hipotezën se Skënderbeu është me origjinë nga Kastratët në Has, pikërisht fare pranë Drinit ku shtrihej fshati Brrut, shpresoj të kem dhënë një kontribut modest në këtë çështje mjaft të trajtuar nga opinioni shkencor, e edhe ai mediatik.

³¹ F.Bardhi, vep. cit, f. 71-72.

Enver REXHA
(Prishtinë)

HISTORIOGRAFIA SERBE PËR BETEJËN E DYTË TË KOSOVËS, 1448

Beteja e Dytë e Kosovës e vitit 1448, fillimisht shihet që trajtohet nga historiografia serbe, por është interesant të theksojmë se, do të shohim dhe konstatojmë që kjo, kësaj ngjarjeje me përmasa të mëdha historike për Ballkanin e më gjerë, nuk i jep rëndësi trajtimi, hapësirë studimi krahasuar me ngjarje tjera historike të kohës dhe më gjerë.

Historiografia serbe kryesisht e paraqet ngjarjen - Betejën e Dytë të Kosovës (1448), në pak punime, studime ku shihet edhe se, kur kjo çështje trajtohet me të dhëna, ato të dhëna kalohen me dy-tre rreshta. Punime të veçanta ka shumë pak të botuara në revista shkencore, derisa, botim të veçantë për trajtimin e çështjes nuk ka. Çka është me rëndësi, e që duhet të theksohet është se, në shumë punime (studime) historike, përgjithësisht kur studiohet mesjeta, as që përmendet fare kjo Betejë.¹ Këto i theksuam qëllimisht vetëm sa për të ditur se, krahasuar me ngjarjen tjetër po ashtu me rëndësi historike pothuajse të kohës, kur flasim për Betejën e Parë të Kosovës (1389), dihet se janë shkruar qindra punime, studime shkencore dhe botime të veçanta. Sigurisht që interesimi për studime të ngjarjeve historike nga historiografia serbe është e drejtë e tyre,

¹ Istorija srpskog naroda II, Beograd, 1994, f. 263-264; Kosovo, nekad i danas, Beograd, 1978 f. 122; Kosovo i Metohija u Srpskoj Istoriji, Beograd, 1989 f. 45; D. Bogdanović, Knjiga o Kosovu, Beograd, 1985 etj.

por punimet, studimet me u veçuar me trajtime si me thënë, më pak e me më shumë rëndësi, mendoj që kanë dhe arsytet apo qëllimet. Shpresojmë që edhe ky trajtim i shkurtër do të paraqes qëllimin e tij, përmbledhjen e të dhënave historiografike serbe për Betejën në fjalë. Turqit (osmanët, E. R.) në territorin e Kosovës edhe njëherë do të tregojnë epërsinë e tyre, gjë që e kishin treguar tash një kohë në këtë trevë, me fitoren e tyre që do ta mundnin ushtrinë hungareze (Koalicionin e Popujve të Krishterë, E. R.), së cilës i printe Gjon Huniadi,² në tetor të vitit 1448, që në histori hyri si, Beteja e Dytë e Kosovës.

Lidhur për qëndrimet e historiografisë serbe për Betejën e Dytë të Kosovës, pashmangshëm duhet të flasim për sundimtarin e Rasit (Rashkës) - despotin Gjergj Brankoviq, i cili duke sunduar Rasin aso kohe, sundonte dhe pjesë të territorit të sotëm të Kosovës dhe siç e theksova më herët, sundimin e tyre e kishin të lejuar nga sulltanët osmanë si vasalë dhe persona të besuar dhe ndihmës të osmanëve. Gjergj Brankoviqi që nga ardhja në pushtet (1428), gjithnjë ka shikuar që me marrëdhënie të mira me shtetet e fuqishme të kohës, sidomos me osmanët, të ruaj pozitën e tij. Të dhënat historike tregojnë edhe që Gjergj Brankoviqi, kishte arrit me anë të martesës (martesave familjare) të vërtetojë pozitën e tij (të sundimtarit, E. R.) mes Hungarisë dhe Portës (osmanëve). Vajza e madhe e tij, Mara, (këtë e kishte vendosur Gjergj Brankoviqi, E. R.) duhej të bëhej nuse (grua turke-osmane, E. R.) në haremin e Muratit II. Mara, dërgohet me pajë (pasuri) të madhe në vitin 1435 tek sulltani.³

Lidhur me këtë personalitet historik, Gjergj Brankoviq, gjatë kohës dhe raporteve të tij aso kohe, në një anë me sulltanët osmanë, dhe në anën tjetër me Mbretërinë hungareze, veçohet periudha kohore nga viti 1444 deri në vitin 1448, kur kemi dy ngjarje me rëndësi historike ballkanike e më gjerë, Beteja e Varnës dhe Beteja e

² Gjon Huniyadi (John Hunyadi, Hungarisht: *Hunyadi János*, Rumanisht: *Ioan de Hunedoara*, Latinisht: *Ioannes Corvinus*, Serbisht: *Sibinjanin Janko*) ishte figurë e rëndësishme ushtarake dhe politike e Hungarisë në shek. XV.

³ Gllasnik LIII, Beograd, 1903, f.84.

Kosovës. Dëshmohej se ky, Gjergj Brankoviqi, gjatë kësaj kohe, do të bëjë çmos për ruajtjen e interesave dhe pozicionit të tij prej sundimtari gjithnjë me marrëdhënie besnikërie dhe vasaliteti me osmanët, duke mos bashkëvepruar me popujt tjerë ballkanikë si me arbrit (shqiptarët) - luftërat e Skënderbeut kundër osmanëve dhe mbretin hungarezë që aso kohe (shek. XV) prinin në luftëra të organizuara kundër pushtimit të trojeve ballkanike nga Perandoria Osmane.

Në anën tjetër, kuptohet se, J. Huniadi që nga humbja e Betejës së Varnës (1444), përgatitej për rezistencë dhe luftë ndaj pushtimeve të osmanëve në Ballkan e më gjerë. Veçohet se, këtë intensitet për përgatitje për luftë e rritë sidomos nga viti 1446, kur arrit postin e mëkëmbësit të mbretit të Hungarisë (e zëvendësonte mbretin e mitur Ladislav Pasthumi) dhe tani mund të realizonte dëshirën e kahershme për t'iu hakmarrë turqve (osmanëve, E. R.), lidhur me Betejën e humbur kundër tyre - Betejën e Varnës (1444). Nga viti 1447 orvatej që të formonte një aleancë edhe me sundimtarët e Ballkanit. Prandaj, në këtë drejtim kërkoi ndihmë edhe nga Papa, Venediku, mbreti i Aragonës dhe Napolit etj., por tregohet se në këto tentime dështoi. Sipas kronistëve, ai i dërgoi disa emisarë edhe te Skënderbeu, i cili i kishte pranuar dhe pajtohej plotësisht të bashkëpunonte me të.⁴ Si duket, vetëm Skënderbeu dëshiroi t'i ndihmojë dhe personalisht të marrë pjesë në luftë.⁵

Në Hungari, Huniadi kishte filluar përgatitjet për luftë. Në takimin e Budimit - pranverë 1448, vendoset për luftë. Përveç hungarezëve, në aleancë merrnin pjesë dhe luftëtar polakë, çekë, gjermanë dhe një njësi vllahe i udhëhequr nga Princi Dan. Me ta ishte dhe legati i Papës.⁶ Ushtria hungarezë pasi kishte filluar depërtimin, ishte ndalur afër fshatit Suboticë. Nga këtu, Huniadi edhe njëherë e ftoi despotin Gjergj për t'iu bashkangjitur. Bisedimet i udhëhiqte diplomati dubrovnikas, Paskoje Sorkoqeviq - tri herë

⁴ J. Radoniç, *Zapadna Evropa i balkanski narodi prema Turcima*, Beograd, 1905, f. 255-256 - *Zapadna Evropa i balkanski narodi prema Turcima u prvoj polovini XV veka* (in Serbian), Novi Sad: Matica Srpska, 1905.

⁵ Istorija srpskog naroda II..., f. 263.

⁶ J. Radoniç, *Zapadna Evropa...* f. 255-256.

radhazi për disa ditë, por dihet se ai (despoti) nuk pranoi prapë të luftojë. Despoti “premtoi neutralitet të plotë”.⁷

Huniadi që nga koha e Varnës bënte plane për luftë kundër turqve (osmanëve, E. R.). Ai tentoi të bënte aleancë me Venedikun, Mbretin Alfonsi dhe Papën. Despoti Gjergj nuk deshë ta ndihmonte, sepse përgatitjet në Hungari i dukeshin plotësisht të pamjaftueshme. Mbetet vetëm Skënderbeu ai që kishte dëshirën ta ndihmojë. Me mbylljen e Marrëveshjes në Lezhë, ky ka kërkuar nga Venedikasit që të paguajnë përpara një shumë të provizionit, duke porositur se është shumë në qejf për t’iu bashkangjitur Huniadit me një ushtri të madhe (kupto në luftë kundër osmane, E. R.), por dihet se pas dy javëve nga kjo kohë, Beteja e tetorit 1448, mbaron.⁸

Bazuar në të dhëna historike, në muajin shtator 1448, Huniadi me hungarezë, polakë, vllahë, çekë dhe gjermanë, kalon nëpër Serbi dhe vjen në Kosovë. Më 17 tetor, zhvillohet lufta (Huniadi humb betejën, E. R.), që tek serbët kjo ngjarje mbahet mend si “Kaloi si Janko në Kosovë”.⁹ Tregohet që, Beteja kishte filluar të enjten, më 17 tetor 1448. Zgjati 3 ditë duke luftuar pandërprerë, natën dhe ditën. Fitorja e sulltanit ishte e plotë edhe pse të dy palët kishin humbje.¹⁰ Bazuar në të dhënat nga tradita serbe, Huniadi vendos të luftoi kundër forcave turke. Niset për Kosovë për t’u ndeshur me forcat turke. Lufta ka zgjat dy ditë, nga 7 deri 10 tetor 1448.¹¹ Ngjarja më e rëndësishme në historinë ballkanike e asaj kohe ishte lufta e Huniadit kundër turqve {...}. Me fillimin e shtatorit 1448, kaloi Huniadi me ushtri në Serbi dhe e ftoi despotin (Gj. Brankoviq, E. R.) për t’iu bashkëngjiti {...}, por despoti kishte dyshim {...}. Përveç kësaj, nga e gjithë kjo ndërmarrje nuk shpresonte për ndonjë interes për Serbinë.

⁷ M. Kostiq, Opis vojske Jovana Hunijadija pri polasku u boj na Kosovu, Glasnik CND1, 1925, f.79.

⁸ S. Ljubić, Starine, Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, IX, Zagreb, 1880, f. 283; K. Jiriček, Istorija Srba, I, Beograd, 1988, f. 373.

⁹ D.T. Bataković, Nova Istorija Srpskog Naroda, Beograd, 2000.

¹⁰ Istorija Srpskog Naroda II, Beograd, 1994, f. 263; Lj. Stojanović, Rodosllovi i Ljetopisi ..., f. 236.

¹¹ Janosh Hyniadi-Bikipedija, sllobodna enciklopedija, 23/7/2018 në: <https://wikipedia.org/wiki/...>

Nuk dëshironte - nuk pranon të hyj në luftë. Çlirimi nga shtypja turke do ta çonte në vartësi më të madhe tek magjarët (hungarezët, E. R.), të cilët, po ashtu ishin miq të pabesuar. Që nga Beteja e Varnës, marrëdhëniet e despotit me hungarezë ishin ndjeshëm të ftohta. Despoti kësaj here shkoi aq larg, sa përmes Sorkoqeviq (Paskoje Sorkoqeviq, Dubrovnikas, “ministër” i Financave të despotit, E. R.) e njofton sulltanin edhe për kalimin e ushtrisë hungareze dhe fuqinë e saj.¹²

Veçohet nga historiografia se, despoti Gjergj, ishte kundër luftës së mbretit hungarez dhe fuqive perëndimore që përgatiteshin kundër osmanëve, më 1448. Pas humbjes në luftën e Varnës, të vitit 1444, despoti Gjergj udhëhoqi politikën e besnikërisë dhe vasalitetit ndaj sulltanit.¹³ Ishte kundër Aleancës së Krishterë. Mirë e dinte se, me pjesëmarrje në luftë linte në fat gjithçka kishte dhe se, në rast të humbjes, do të humbte “shtetin”. Despoti arriti marrëveshjen me osmanët në Edrene, më 12 qershor 1444.¹⁴ Marrëveshja me Portën, e detyronte për besnikëri. Gjergj Brankoviçi, nuk kishte dëshirë të ngritët në luftë kundër sulltanit, sepse e dinte se, ajo (marrëveshja me osmanët, E. R.) ishte më e rëndësishme se sa miqësia me hungarezët. Kundërshtoi të marrë pjesë në luftë.¹⁵

Autori Halkokondili kur flet për vitin 1444 tregon se, Gjergj Brankoviçi punoi disa muaj për të arritur marrëveshjen me osmanët. Ky ishte iniciator dhe kërkues i bisedimeve me ta, sepse dyshonte që hungarezët do t'i ndihmojnë ta kthej “shtetin”.¹⁶ Ndërmjetëse për të arrit marrëveshjen ishte vajza e tij Mara, gruaja e Muratit II.¹⁷ Thuhet dhe mendohet se, ky veprim i Gjergjit ishte “arritja dhe fitorja më e

¹² Vladimir Çoroviç, Istorija Srpskog Naroda, Banjalluka, Beograd, 1997;

www.rastko.rs/rastko-bl/istorija/corovic/istorija4_7.html

¹³ S. Stefanoviç, Dva dogagajaja ugarske istorije u fashoj narodnoj poeziji, Prilozi proučavanja narodne poezije 6, 1939, f. 35; M. Diniç. Gjorgje Spremac i nasha narodna epika, PPNP 6, 1939, f. 159; Istorija Srpskog Naroda II, Beograd, 1994, f. 258.

¹⁴ M. Spremiç, Despot Gjuragj...f. 290.

¹⁵ Istorija Srpskog Naroda II, Beograd, 1994, f. 263.

¹⁶ B. Krekiç, Uçeshçe...f. 50, P. Gjuk, Carica Mara...f.65 në: M. Spremiç, Despot Gjuragj Brankoviçi i Njegovo Doba, Beograd, 1994,

¹⁷ M. Spremiç, Despot Gjuragj Brankoviçi i Njegovo Doba, Beograd, 1994, f. 287.

madhe e diplomatike e tij me rezultatin e madh që arriti me osmanët”.¹⁸ Edhe kronistët osmanë tregojnë që Gjergj Brankoviçi kërkonte paqe duke premtuar se, në qoftë që e merr “shtetin” e tij, do të jetë gjithë jetën i nënshtruar (kuptohet ndaj osmanëve, E. R.).¹⁹

Tregohet se, edhe pse despoti Gjergj, nuk deshi të marrë pjesë në luftën kundër osmanëve (Beteja e Varnës 1444), ky i lajmëroi sulltanit që ushtria hungareze është nis kundër tij.²⁰ Autori M. Orbini tregon se, Gjergj Brankoviçi kalon në anën turke (osmane, E. R.), sa nga dashuria për vajzën (Mara-gruaja e Murtatit II), po aq edhe nga urrejtja ndaj Janko Huniadit për atë që ky mbante toka në “Serbi”.²¹ Për lëvizjet e Huniadit dhe ofensivës së re dhe këtë, prapë përmes Serbisë së shkatërruar, pa lejen e despotit, të cilit në vitin 1448, nuk i shkonte për një luftë të re me turqit, despoti Gj. Brankoviçi, vasal turk, lajmëron Sulltan Muratin II. Despoti i premtoi sulltanit neutralitet të plotë. Lufta filloi më 17 tetor 1448. Humbja krishtere ishte e tmerrshme.²²

Edhe për këtë luftë (Beteja e Dytë e Kosovës, E. R.), Gjergj Brankoviçi ishte i vendosur për paqe, pra nuk pranon të marrë pjesë. Gjergj Brankoviçi lidhur me këtë rast shprehet se: “më mençur është të frikohemi nga turqit se sa nga hungarezët”.²³ Nga hungarezët gjatë kohë kishte duruar ofendime dhe nuk kishte dëshirë që të bëhej mik e ndihmës i tyre.²⁴ Nuk i shkonte mendja, apo nuk e kishte ndërmend të ngrihej kundër sulltanit.²⁵ Beteja e Dytë e Kosovës ka zgjatur tre ditë. Ka përfunduar tragjikisht për anën krishtere. Huniadi e humbi Betejën, sepse e tradhtoi udhëheqësi i Vllahisë, Dani. Fajtor për humbje është edhe Gjergj Brankoviçi, i cili paratatoi aleatët e Huniadit, të cilët i udhëhiqte Skënderbeu dhe kështu i parandaloi të

¹⁸ M. Spremiq, Despot Gjurgj... f. 294.

¹⁹ G. Elezoviç, Turski Spomenici, Beograd, 1940, f.1135-1136.

²⁰ Konstantin Mihailoviç iz Ostrovice “Janiqareve uspomene ili turska hronika”, Spomenik SANU, 1959, f.27-29.

²¹ M. Orbini, Kraljevstvo Sllovena, Beograd, 1968, f.117.

²² M. Joviç, Istorija Serba, Prishtina, 1997.

²³ M. Spremiq, Despot Gjurgj..., f.337.

²⁴ M. Spremiq, Despot Gjurgj..., f.337.

²⁵ M. Spremiq, Despot Gjurgj..., f.329.

takohen. Nga atëherë ekziston thënia “Vonë vjen Janko në Kosovë”.²⁶

Pas Marrëveshjes së Gjergj Brankoviçit me osmanët (të vitit 1444), ky nga hungarezët bëhet tradhtarë. Duke folur për këtë, duke punuar veç për interesa të tij, ka tradhtuar çështjen krishtere, për më tepër, ka kaluar në taborin turk (osman, E. R.).²⁷

Shkruhet edhe që kishte një mori shkresash në mes të mbretit hungarez Vlladisllavi dhe Skënderbeut (për Betejën e Varnës, E. R.), por që janë të konstruktura me qëllim të vetëm, kinse të tregohet se, despoti Gjergj Brankoviçi e ndaloi (pengoi) Kastriotin të ndihmoi të krishterët.²⁸

Sipas traditës, Hunuadi e humbi luftën falë tradhtisë së Danit II - udhëheqësi i Vllahisë dhe Gjergj Brankoviçit, të cilët i kanë paratakuar aleatët e Huniadit, të cilët i udhëhiqte Kastrioti (Skanderbeg-Gjergj Kastrioti) dhe i ndaluan të takohen, kështu që ushtria e vogël e Huniadit humbi luftën e dytë në Kosovë.²⁹

I vetmi që ishte i gatshëm ta ndihmonte dhe t'i bashkëngjitej Huniadit, ishte Skënderbeu.³⁰ Në aksionin e ri të J. Huniadit /Sibinjanin Janko/ - 1448, ai (Skënderbeu, E. R.) ishte i gatshëm për t'iu bashkangjitur kundër turqve, por Huniadi ishte i mundur në Kosovë - në vend luftimitin e vjetër më 17-19 tetor 1448, para se të arrij Skënderbeu.³¹

²⁶ Rokselanin kofër, Hunjadi kao vishenarodni heroj: Napismeni junak porazhen na Kosovu, a odbranio Beograd, 12/6/2018: <http://www.rokselana.com/hunjadi-kaovisenarodni-heroj...>

²⁷ M. Spremiç, Despot Gjuragj Brankoviç i Njegovo Doba, Beograd, 1994, f. 294.

²⁸ I. Ruvarac, Đurađ Vuković, despot srpski i Đorđe Kastriot-Skenderbeg vođ arbanaški: godine 1444, Beograd, 1902, f.1-13: G. Shkrivaniç, Zashto despot Gjuragj nije uqestvovao u bici na Varni....f.144: S. Qirkoviç, Komentari i izvori Mavra Orbina, u: M. ORBIN, Kraljevstvo Slovena, Beograd, 1968, f.304: M. Spremiç, Despot Gjuragj, f. 304.

²⁹ Janosh Hyniadi- Bikipediija, sllobodna enciklopediija, 23/7/2018 në: <https://wikipedia.org/wiki/...>

³⁰ Vladimir Çoroviç, Istorija Srpskog Naroda, Banjalluka, Beograd, 1997; www.rastko.rs/rastko-bl/istorija/corovic/istorija4_7.html

³¹ D. Bogdanoviç, Knjiga o Kosovu, Beograd, 1985, f. 53.

Në aksionin e ri të Gjon Huniadit “Sibinjanin Janko”, 1448, ai (Skënderbeu, E. R.) ishte i gatshëm t’i bashkohej kundër turqve, por Huniadi ishte i mundur në vendluftimin e vjetër , 17-19 tetor 1448, para se Skënderbeu të arrinë. Turqia më pas lëshohet me tërë fuqinë kundër Shqipërisë së Skënderbeut.³²

Vetëm Skënderbeu i premtoi ndihmë, por e detyruan turqit Huniadin të hyjë në luftë para arritjes së Skënderbeut. Lufta u humb.³³ Për Betejën e Kosovës (1389) dinë të gjithë, megjithatë, shumë pak dikush dinë për Betejën e Dytë të Kosovës. Patriotizmi, dëshira për t’u flijuar për atdhetarizëm si dhe flijimi me vetëdije për ideale, kanë mbetur në kujtesën e popullit tonë (popullit serb, E. R.). Kjo ngjarje, datë mban që nga atëherë simbolikë të fuqishme, e cila me rastin e çdo manifestimi vjetor të ri është gjithëherë më e madhe.³⁴

Megjithatë, opinionit të gjerë i është pak e njohur që më shumë se një gjysmëshekulli më vonë (1448) zhvillohet edhe Beteja e Dytë e Kosovës, ndërmjet forcave të Mbretërisë hungareze të sforcuara me njësi vllahe të udhëhequra nga J. Huniadi nga njëra anë, e forcat osmane-turke të udhëhequra nga Sulltan Murati II në anën tjetër. Huniadi vlerësonte se kishte ardhur momenti ideal që turqve t’u jap grushtin fatal dhe të ndalojë depërtimin e mëtejshëm në Ballkan. Mendimi i tij kyç ishte që ushtria hungareze në Kosovë të lidhet (bashkohet) me forcat e Skënderbeut që në këtë mënyrë bashkërisht të shkaktojnë goditjen vendimtare - grushtin vendimtar të osmanlinjve. Megjithatë, trupat e Huniadit janë rrahur deri në këmbë (mendohet të jenë shkatërruar e vrarë apo, që pësojnë humbje të plotë, E. R.) para se të arrijnë të takohen me ushtrinë e Skënderbeut.³⁵

³² K. Kiriçek, Istroija Srba I, Beograd, 1952.

³³ Zgodovina Jugoslovena, Binter-Strukelj, I Del., Ljubljana, 1938.

³⁴ Ivan Ristiç, Za Kosovsku Bitku Svi Znaju: Megjutim, mallo ko zna za Drugi kosovski Boj, Srbija Danas, 20/08/2016: <https://www.srbijadanas.com/vesti/istorija/za-kosovsku-bitku...>

³⁵ Ivan Ristiç, Za Kosovsku Bitku Svi Znaju: Megjutim, mallo ko zna za Drugi kosovski Boj, Srbija Danas, 20/08/2016: <https://www.srbijadanas.com/vesti/istorija/za-kosovsku-bitku...>

Sa i takon Betejës së Kosovës, shumë harrojnë që ato kanë qenë dy, e para 1389 dhe e dyta në tetor 1448. Në kujtesën popullore, këto dy ngjarje përzihen. Pas Luftës (së Parë), Serbia kërkon mbrojtje nga osmanët kundër Mbretit Zigmund (mbretit hungarez, E. R.), kështu që despoti Stefan mori pjesë si vasal turk në Betejën e Nikopolit. Në Betejën e Dytë të Kosovës, Gj. Brankoviçi për shkak të humbjes së të krishterëve në Betejën e Varnës, në vitin 1444, kundërshtoi pjesëmarrjen në luftë kundër turqve për mos ta humbur tokën, e që për këtë J. Huniadi “Sibinjanin Janko” e konsideron tradhtar. Pas Betejës së Dytë, shumë shpejt Serbia humbë vendin, e dihet që hungarezët e mbajnë Beogradin deri në vitin 1521. Duhet të kuptohet se politika e sundimtarëve nuk është gjithëherë politikë nacionale, sepse ata kryesisht e ruajnë pushtetin dhe udhëheqjen.³⁶

Për fund, të gjitha burimet tregojnë se, Gjergji kishte “marrëveshje me turqit, të cilët sipas tij, duhet ta respektojë”.³⁷ I pakënaqur me qëndrimet e Gjergj Brankoviçit, Huniadi kalon në “Serbi” duke u sjellë sikur kalon nëpër tokë të armikut. Pasi kalon Moravën del në Krushevc, e përmes “Ngushticës së Jankut”, që populli i dha këtë emër këtij vendi sipas këtij kalimi, arrin në Toplicë dhe vazhdon për Kosovë ku ndalet jo larg Prishtinës. Me lajmin se po vijonë hungarezët, sulltani i cili kishte mbledhë trupat ushtarake në Sofje, tani veç i kishte vendosur në Kosovë në vendin e Betejës së vitit 1389. Turqit (osmanët, E. R.) ishin numerikisht më të fortë. Hungarezët e humbin Betejën dhe Huniadi me pak ushtarë e lëshon fushën e luftës. Tek populli “serb”, nga kjo humbje ka mbetur thënia “Kaloi si Janku në Kosovë”.³⁸

Asokohe, Huniadi iu kishte drejtuar edhe despotit të Rashkës, Gjergj (Gjurgj) Brankoviçit, i cili përgjigjen ia kthen “se ishte i lidhur me marrëveshjen për paqe me Portën”. Nuk kishte dëshirë të ngritët kundër sulltanit, besimin e të cilit e bleu, sepse e dinte se ajo është më e rëndësishme se shoqërimi me Oborin hungarez. Refuzoi

³⁶ Vojislav Pavloviç, Garashanin nje zaçetnik nacionalizma, Intervistoi Angjelka Cvijiç për gazetën Politika, dt. 23/7/2018; <http://www.citulje.politika.rs>

³⁷ M. Kostić, Opis vojske Hunijadija...f.86.

³⁸ Lj. Stojanoviç, Rodoslovi i Ljetopisi, Spomenik CKA 3, 1890: Istorija Srpskog Naroda II, Beograd, 1994, f.264.

të marrë pjesë në Betejë.³⁹ Edhe pse nuk iu kishte ofruar ndihma, Huniadi nuk mendonte të tërhiqet nga lufta. Ai, kështu, gjatë kësaj kohe mbledhi ushtarë në përbërje të hungarezëve, polakëve, rumunëve, gjermanëve dhe çekve.⁴⁰

Huniadi që kishte pritur momentin e duhur me ushtrinë e tij të mbledhur, kishte marrë rrugën për Kosovë.⁴¹ Të dhënat flasin se gjatë depërtimit të ushtrisë së Huniadit nëpër Rashkë (Serbi) kjo bëri që despoti Gjergj (Brankoviçi, E. R.) të lajmërojë Muratin II për marshimin e hungarezëve.⁴² Por, ka dëshmi të vërteta që sipas të cilave despoti Gjergji i kishte dërguar informacione sekrete Muratit II mbi përbërjen e ushtrisë së Huniadit. Këto informata ishin dërguar nëpërmjet Pascuale de Sorgos, i cili ishte në shërbim të Gjergj Brankoviçit.

Në raportin e de Sorgos ishte përfshirë edhe informacioni se, Huniadit i kishin arritur emisarët e Skënderbeut, të cilët i kishin premtuar atij 20 000 luftëtarë.⁴³ Për dallimin nga informacionet që u kishte dërguar despoti Gjergji turqve (osmanëve, E. R.), flasin edhe të dhënat e hershme.⁴⁴ Autorë bashkëkohanik të ngjarjes (shek. XV) si Halkokondili tregojnë se, Gjergj Brankoviçi kishte vendosur ta tradhtojë Huniadin. Ky shkruan se, despoti Gjergj para nisjes së ushtrisë hungareze (për luftë me osmanët, E. R.) e lajmëroi (njoftoi) sulltanin me përgatitjet për luftë.⁴⁵ Po në vazhdim autori tjetër Bonfini tregon se (nga despoti Gjergj Brankoviçi, E. R.) janë dërguar informata (për sulltanin, E. R.) edhe për numrin e ushtarëve hungarezë dhe drejtimin e tyre. Despoti Gjergj e këshillon dhëndrin e fuqishëm (Sulltan Muratin II, E. R.) që të mos i kundërvihet

³⁹ Po aty; K. Jiriček, *Istoriya srba I...*, f. 373.

⁴⁰ K. Jiriček, *Istoriya srba I...*, f. 373; *Istoriya srpskog naroda II...*, f. 263.

⁴¹ F. Babinger, *Mehmet pushtuesi dhe koha e tij, Prishtinë, 1989*, f. 61.

⁴² *Istoriya srpskog naroda II...*, f. 263.

⁴³ M. Kostiq, *Opis vojske Jovana Hunijada pri polasku u Boj na Kosovu*, *Glasnik SND*, 1, Skoplje, 1925, f. 79-91.

⁴⁴ L. Chalkondylos, *de Rebus Tur cicis*, Bonae 1843; *Burimet tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, Tiranë, 1975*, f. 331-332; M. Orbini, *Kraljevstvo slovena (Z. Shundriç)*, Beograd, 1968.

⁴⁵ St. Novakoviç, *Veliki çelnik Radiç ili Oblagiç Rade ...*, Beograd, 1908, f.82.

menjëherë (ushtrisë hungareze, E. R.), por ta lenë të hynë në thellësi prej dy apo tri ditë, që atëherë të mbyllë rrugët e kthimit.⁴⁶ Sipas autorit J. Rastiq, deleguesi i despotit Gjergj, i cili më 1448 i dërgoi informata Muratit II në Shqipëri, ishte Paskoje Sorkoqeviq.⁴⁷

Mirë i informuar Sulltan Murati II me trupat e tij evropiane dhe aziatike erdhi përmes Sofjes para hungarezëve në Kosovë. Ushtritë janë takuar në vendin e Betejës së vitit 1389. Në luftë humbën hungarezët. Humbja si sinonim mbeti dhe ndër shekuj u bartë tek serbët, sinonim i thënies “Kaloi si Janko në Kosovë”.⁴⁸ Në këtë mënyrë, ushtria e Huniadit, më 17 tetor 1448, u gjend përballë një fronti të gjatë të forcave osmane, pothuajse në të njëjtin vend ku ishte zhvilluar Beteja e vitit 1389, tek lumi Sitnica para Prishtinës.⁴⁹ Fusha e Kosovës ishte ngjarje e Betejës së madhe në tetor 1448, kur ndeshen Sulltan Murati II dhe “gubernatori” hungarez Janko Huniadi, me ushtri të madhe në territorin e despotit Gjergj, i cili mbeti jashtë ndeshjes dhe i cili nuk mundi të ndalojë shkatërrimin dhe rënien në tokat e tija. Fituan turqit (osmanët, E. R.) a Janko Huniadi mezi shpëtoi, por ra në duar të despotit Gjergj, i cili i kërkoi dëmet për banorët e tij.⁵⁰

Lufta treditore (17-19 tetor 1448) e zhvilluar ditën e natën, ishte katastrofale për ushtrinë e Huniadit. Kështu, pas humbjeve në njerëz, dezertimit të një pjese të ushtrisë, u desh që të tërhiqet nga Beteja edhe vetë Huniadi, kurse ushtarët e mbetur të iknin nga të gjitha anët për të shpëtuar.⁵¹ Në aksionin e ri të Gjon Hunyadit /Sibinjanin Janko/ të vitit 1448, Skënderbeu ishte i gatshëm të bashkohet kundër turqve (osmanëve, E. R.), por Hunyadi ishte

⁴⁶ M. Orbini, *Kraljevstvo Sillovena*, Pesaro, 1601 - Beograd, 1968, f. 21.

⁴⁷ J. Radiniq, *Gjuragj Kastriot Skenderbeg...*, f. 253; M. Kostiq, *Opis vojske Jovana Hunijadija pri polasku u boj na Kosovu*, Glasnik CND 1, Beograd, 1925, f.87; M. Filipoviç, *Nekoliko beljeshke...*, f. 140-141.

⁴⁸ M. Spremiq, *Despot Gjurgj Brankoviç i Njegovo Doba*, Beograd, 1994, f. 342.

⁴⁹ K. Jiriçek, *Istorija srba I...*, f. 373; *Istorija srpskog naroda II...*, f. 264.

⁵⁰ *Istorija Srpskog Naroda II*, Beograd 1994, f. 263; J. Radoniç, *Zapadna Evropa i ballkanski parodi prema Turcima u prvoj pollovini XV veka*, Novi Sad, 1902, f. 252; *Kosovo i Metohija u Srpskoj Istoriji*, Beograd, 1989, f. 45.

⁵¹ *Istorija srpskog naroda II...*, f. 264; L. Stojanoviç, *Rodoslovi i letopisi...*, f. 236; *Kosovo i Metohija u srpskoj...*, f. 45; J. Radiniq, *Zapadna Evropa...*, f. 252-264.

mundur në Kosovë në vendluftimin e vjetër, më 17-18 tetor 1448, para se Skënderbeu të arrinte. Turqia (osmanët, E. R.) pas kësaj drejtohet me tërë fuqinë kundër Shqipërisë (Arbërisë, E. R.) së Skënderbeut.⁵²

Të dhënat flasin se deri tek humbja e luftës nga Huniadi erdhi pasi që atë e sulmoi Murati II para kohe, d.m.th. qysh në fillim e priste atë. Duke e ditur se Huniadi kishte për të pritur forcat e Skënderbeut, Murati II, i cili ishte mirë i informuar nga Gjergj Brankoviçi për të gjitha lëvizjet, e sulmoi Huniadin dhe e detyroi atë të hynte në luftë para kohe.⁵³ Së pari ai shkoi në Kosovë, ku ai u përball me forcat turke (osmane, E. R.). Sipas traditës, Huniadi e humbi Betejën duke u tradhtuar nga Dani II, Trashëgimtar i fronit në Vllahi, dhe Gjergj Brankoviçi, i cili i ka përgjuar/ penguar/ aleatët e Huniadit, pasi ata ishin të udhëhequr nga Kastrioti (Skënderbeu-Gjergj Kastrioti) me ushtri duke i pamundësuar ata me qëllim për t'iu bashkuar (Betejës, E. R.), në mënyrë që ushtria e paktë e Huniadit ta humbë një tjetër betejë në Kosovë.⁵⁴ Është interesant se, Huniadi për humbje i fajëson dubrovnikasit, të cilët ishin në shërbim të despotit Gjergj. Thotë se, Paskoje Sorkoqeviq, ishte ai i dërguari te Murati II. Mos pjesëmarrjen e Gjergjit në dy betejat, e Varnës dhe Kosovës, bënë që shkruesit latinë më vonë ta akuzojnë atë për këto humbje.⁵⁵

Tregohet se, Huniadi armiku më i madh i Gjergj Brankoviqit, mbahej i burgosur në Smederevë nën roje.⁵⁶

Despoti Gjergj për lirimin e Huniadit kërkoi shpërblim dhe nga Hungaria mori 100 000 dukatë për lirimin e tij. Kështu, në fund të dhjetorit 1448, Huniadi udhëtoi për në Segedin (Hungari).⁵⁷ Në këngën popullore serbe, për ngjarjen në fjalë, dalin dhe dilemat ndërmjet hungarezëve dhe serbëve lënë shenjë-gjurmë. Gjergj Brankoviçi, pas dëgjimit të tyre, përfundimisht vendos të tradhtoj

⁵² J. Radoniq, Gjergj Kastriot Skenderbeg i Albanija u XV veku, Spomenica SAN 95, Beograd, 1942; D. Bogdanovič, Kniga o Kosovu, Beograd, 1985, f.53.

⁵³ M. Orbini, Kraljevstvo slovena..., f. 121.

⁵⁴ https://hr.wikipedia.org/wiki/Janko_Hunjadi

⁵⁵ M. Orbini, Kraljevstvo slovena..., f. 343.

⁵⁶ M. Spremiq, Despot Gjuragj..., f.344.

⁵⁷ Istorija srpskog naroda II..., f. 265; M. Spremiq, Despot Gjuragj..., f.345.

Huniadin{...}. Flitet se para fillimit të marshimit të ushtrisë hungareze, ky e njofton (lajmëron) sulltanin për përgatitjet e tyre. Jep informata edhe për numrin e ushtrisë dhe drejtimet - rrugët e tyre. Paraprakisht e këshillon dhëndrin e fuqishëm (Sulltan Muratin II - ishte dhëndër i Gjergj Brankoviqit, E. R.) që mos të sulmon menjëherë, por të lejon të hyjnë thellë në territore dy deri tre ditë ecjeje, e atëherë t'ju mbyll rrugët e kthimit. Personi që u delegua për të dhënë informata që e lajmëroi Sulltan Muratin II në Shqipëri, ishte Paskoje Sorkoqeviq.⁵⁸ Pas marrjes së informatës (lajmit), sulltani menjëherë ndërpreu luftën dhe kthehet në Edrene.⁵⁹

Huniadi mundahej në gjitha mënyrat për të gjetur aleatë, llogariste dhe në Skënderbeun. Ky kishte dëshirë ta ndihmonte {...}. Pasi arriti marrëveshje paqeje me Venedikun, më 4 tetor 1448, filloi përgatitjet të ndihmohet Huniadin.⁶⁰ E gjitha ajo çka është me rëndësi të thuhet për Betejën e Dytë të Kosovës, më 1448 është se, kjo Betejë "Aleancë e Popujve" e udhëhequr nga Huniadi i Hungarisë, ku morën pjesë përveç hungarezëve, polakëve, rumunëve, gjermanëve, çekëve e tjerë, është me rëndësi të theksohet dhe argumenti se, të dhënat e kohës njoftojnë që në këtë aleancë morën pjesë edhe arbërorët (shqiptarët, E. R.). Këtëj, duke iu referuar letrës së P. Sorgos në pasazhin nr. 9 të saj, duke folur për ngritjen e aleancës së krishterë në mesin e pjesëtarëve të Kryqëzatës, i zënë në gojë edhe shqiptarët (arbërorët, E. R.).⁶¹

Këtëj, historiografia shqiptare tregon se, për çështjen e pjesëmarrjes dhe përgatitjes për në luftë antiosmane me Huniadin, anëtarët e Besëlidhjes Arbërore, mbajtën një Kuvend (pak ditë para Betejës së Dytë të Kosovës, E. R.) dhe vendosën që të marrin pjesë me ushtri, numri i së cilës do të arrinte 20 000 ushtarë dhe atë nën komandën e Skënderbeut. Kur ushtria e Huniadit të marshonte drejt viseve verilindore arbërore këta do t'i bashkoheshin. Me gjithë përputhjet për luftë të përbashkët me hungarezët kundër osmanëve,

⁵⁸ M. Spremiq, Despot Gjuragj...,f.339.

⁵⁹ M. Spremiq, Despot Gjuragj...,f.339.

⁶⁰ M. Spremiq, Despot Gjuragj...,f. 339.

⁶¹ J. Drançolli, Kosova më 1448..., f. 265.

forcat arbërore nuk arritën të marrin pjesë në Betejën e Kosovës. Despoti Gjergj Brankoviqi nuk lejoi ushtrinë arbërore të kalonte rrugët në zotërimet e tija.⁶²

Me kohë të shkurtër, Huniadi ka dërguar ambasadorët e tij dy liderëve, Skënderbeut shqiptarit (arbërorit, E.R.) më të shquar dhe babait të gruas së tij, Gjergj Arianitit, për të kërkuar ndihmën e tyre në luftë kundër osmanëve. Aso kohe edhe Papa Eugenius i sugjeronte se, fushata antiosmane duhet të shtyhet. Megjithatë, Huniadi ka deklaruar, në një letër të datës 8 shtator 1448 se, deri tani “ka pasur mjaft nga njerëzit tanë të robëruar, gratë tona të përdhunohen, qerret ngarkuar me koka të prera të popullit tonë”, dhe shprehu vendosmërinë e tij për të dëbuar “armikun nga Evropa”. Në të njëjtën letër, ai shpjegoi strategjinë e tij ushtarake për Papën, duke deklaruar se “fuqia është gjithmonë e më e madhe, kur përdoret në sulm se sa në mbrojtje”.⁶³

Për fund, nga të dhënat historiografike arrijmë në përfundime se, Beteja e Dytë e Kosovës e vitit 1448, ishte një ngjarje e rëndësishme historike e përpjekjeve dhe luftës së popujve të Ballkanit, Hungarisë dhe Arbërisë në rastin tonë, si dhe popujve të Evropës Perëndimore - koalicionit të popujve të krishterë për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokave - shteteve të tyre kundër pushtimeve të osmanëve që kishin filluar luftëra në këtë drejtim që nga shek. XIV. Kuptohet nga të dhënat se, Beteja në fjalë ishte humbëse për koalicionin dhe kuptohet se ishte fitore e osmanëve. Një faktorë i rëndësishëm për humbjen e Betejës nga koalicioni ishte figura e Gjergj Brankoviqit, sundimtarit të Rasit (Rashkës), të cilin edhe historiografia serbe, kuptohet edhe ajo joserbe, e fajësojnë për qëndrimet e tij në luftërat kundërosmane, posaçërisht, për qëndrimin e tij për mospjesëmarrje në Betejën e Dytë të Kosovës. Ky nga historiografia quhet dhe tradhtar i koalicionit të popujve për luftë kundër pushtimeve osmane, tradhtar i çështjes krishtere dhe quhet edhe njeri besnik-vasal i sulltanëve osmanë, duke qenë

⁶² *Historia e popullit shqiptar I*, Tiranë, 2002, f. 412.

⁶³ Muresanu Camil, John Hunyadi Defender of Christendon, The Center for Romanian Studies, 2001, f. 144-148.

bashkëpunëtor i tyre në informacione dhe pjesëmarrje luftarake.

Dëshmohet se, Gjergj Brankoviqi, gjatë kohë së sundimit dhe mbajtjes të këtij sundimi, ishte vasal herë i hungarezëve, herë i osmanëve, por më shumë i osmanëve, kur të dhënat tregojnë edhe se, ky besnikërisht nga vitet 1444-1448 e deri në vdekje, iu kishte betuar për besnikëri osmanëve. Po ashtu, dëshmohet se, despoti Gjergj Brankoviqi, shpeshherë gjatë karrierës (sundimit) të tij, në bashkëpunim dhe bashkëveprim të osmanëve dhe ushtrive të tyre, kishte zhvilluar luftëra për pushtimin e territoreve të popujve fqinjë ballkanikë si, kundër arbërorëve, malazezëve, boshnjakëve, kroatëve, hungarezëve etj.

Nga historiografia serbe duke studiuar çështjen në fjalë, mund të nxjerrim dhe qëndrimet se, në Betejën e Parë të Kosovës (Dardanisë) të vitit 1389, në luftë me Perandorinë Osmane, kishte tradhtuar Vlk (Vuk) Brankoviqin (kemi mjaft shkrime, studime, komentime historike lidhur me çështjen). Po ashtu, janë të dhënat e paraqitura dhe tjera që lidhen me Betejën e Dytë të Kosovës të vitit 1448, po me Perandorinë Osmane, kur tani dihet se tradhton Gjergj (Gjuragj) Brankoviqin, djali i Vlk Brankoviqit. Pra, flasim për më shumë se gjysmë shekulli (59 vite) kur sundimtarët lokalë të Rasit (Rashkës) të fund shek. XIV dhe gjysmës së parë të shek. XV, që janë babë e birë, Vlk dhe Gjergj Brankoviq, të kenë qenë bashkëpunëtorë të sulltanëve të Perandorisë Osmane dhe të tjerëve dhe të cilësohen tradhtarë të luftërave të popujve ballkanikë të krishterë që luftonin për mbrojtjen e tokave dhe popujve të tyre.

Po ashtu, historiografia serbe dëshmon se, po këta dy persona nga familja Brankoviqi, pushtetin e tyre “sundimtarë lokalë” të kohës në treva ballkanike (pjesë të territoreve sot në Serbi dhe Mal të Zi) dhe pjesë të territorit të sotëm të shtetit tonë, Republika e Kosovës, i mbanin vetëm duke ju falënderuar marrëdhënies vasale (shërbëtore) të sulltanëve të Perandorisë Osmane, duke mos përjashtuar dhe të tjerët, si Mbretërinë e Hungarisë. Lidhur me të dhënat që i ofruam për zhvillimin e Betejës së Dytë të Kosovës, duhet të themi se historiografia serbe qëllimisht i ikën studimit të më hollësishëm të ngjarjes duke pasur parasysh marrëdhëniet vasale dhe të mira të Gjergj Brankoviqit, sundimtarit të Rashkës me osmanët. Asokohe

tregohet që Gjergj Brankoviqi, përveç informacioneve sekrete të dhëna për Sulltan Muratit II, veproi dhe vuri pengesat që vështirësonte kalimin e ushtrisë së koalicionit si dhe ushtrisë së Skënderbeut nëpër rrugët që shpinin në trevat që sundonte.

Ky veprim i tij i fundit dhe veprimet e mëhershme disavjeçare të bashkëveprimit me osmanët, bëri që të jetë dhe të veproi kundër koalicionit të popujve të krishterë (Aleancës Perëndimore) të udhëhequr nga Gjon Huniadi i Hungarisë, dhe të përkrahur e ndihmuar nga Skënderbeu-Gjergj Kastrioti, princ i Arbërisë.

Bashkëpunimi i disa sundimtarëve lokalë ballkanikë dhe vasaliteti e besnikëria e tyre me pushtuesin osman aso kohe bënë që, edhe lufta - Beteja e Dytë e Kosovës, të pësoi fatin e Betejës së Parë të Kosovës, pra të humbin. Vlen të theksohet se, historiografia botërore këta 2 (dy) “burrështetas” - “gjeneral” të shek. XV, Gjon Huniadi i Hungarisë dhe Skënderbeu-Gjergj Kastrioti, princ i Arbërisë. Përveçse i vlerëson si trimat dhe strategët më të mëdhenj politikë e ushtarak të kohës, i vlerëson dhe i rreshton ndër burrat, luftëtarët, strategët politiko-ushtarakë ndër më të mëdhenj të historisë botërore.

Petrika THËNGJILLI
(Tiranë)

**VËSHTRIM KRITIK MBI BAZËN DOKUMENTARE DHE
BIBLIOGRAFIKE TË BETEJËS SË DYTË TË KOSOVËS
(1448)**

Plot pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë vjet më parë, u zhvillua Beteja e Dytë e Kosovës, po aty ku u zhvillua Beteja e Parë, më 1389. Të dy betejat kanë të përbashkëta në drejtim të ndeshjeve të ballkanasve me osmanët dhe përfundim i tyre me fitore të osmanëve. Krahas anëve të përbashkëta ka edhe disa dallime. I pari ka të bëjë me përbërjen e forcave ndërluftuese. Në betejën e parë ballkanasit kishin krijuar një koalicion i drejtuar nga princ Lazari, kurse në të dytën u bënë përpjekje për një betejë të përbashkët hungaro-shqiptare, por që për arsye objektive të jashtme mbeti në formën e orvatjes.

Historiografia skënderbegiane e mbështetur mbi një bazë dokumentare të dyzuar ka bërë një evoluim pozitiv, me përfundime që i afrohen më shumë realitetit, por edhe me mendime e qëndrime kontradiktore. Në këtë kumtesë po hedhim një vështrim kritik mbi bazën burimore dhe bibliografike. Po e nisim nga kronistët osmanë. Oruçi me të drejtë e vendos ngjarjen pas luftës së Sfetigradit, kur sulltani grabiti vilajetin e shqiptarëve. I mallkuari Janko ka marshuar dhe ka dalë në Kosovë, duke kaluar nga Beligradi dhe Kovini dhe kërkon të luftojë me sulltanin. Ai u nis nga Sfetigradi dhe qëndroi në Sofje.¹

¹ S. Pulaha, *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV, burime osmane*, Tiranë, 1968, f. 46.

Kronikat osmane anonime e vendosin ngjarjen pas rënies së Sfetigradit, por bëjnë një hap më tej në zgjerimin e të dhënave. Sipas tyre, kur myslimanët forcuan pozitat e tyre në atë vilajet dhe po pushonin, i erdhi lajmi sulltan Muratitse hungarezët dhe Jankua i mallkuar, i cili e kishte vënë veten në vendin e mbretit, kishin sulmuar, duke bashkuar ushtri nga popullsitë e hungarezëve, çekëve, gjermanëve, latinëve dhe vllëve. Ai kishte formuar një ushtri të panumërt dhe po vinte duke kaluar nga Belgradi dhe Kovini. Sulltan Murati posa dëgjoi këtë lajm, u largua nga vendi i shqiptarëve dhe u vendos në Sofje.²

Ashik Pashëzadeja e vendos gabimisht ngjarjen në rrethimin e parë të Krujës. Në fakt ngjarja ka të bëjë me marrjen e Sfetigradit dhe prerja e depozitës së ujit. Ndërkohë, erdhi lajmi se të pafetë hungarezë ishin armatosur mirë dhe po vinin. Atëherë sulltani u nis drejt Sofjes. Ushtarët e Rumelisë i liroi, ndërsa atyre të Anadollit u tha “sillni ushqimet nga shtëpitë tuaja”. Dhe mbas kësaj arriti në Sofje.³

Mehmet Neshriu në përgjithësi përsërit Ashik Pashëzadenë, veçse shton si element të ri mbërritjen e lajmit nga Vidini se të pafetë hungarezë po vinin me ushtritë madhe dhe me pajisje të përsosura.⁴ Aliu ngjarjen e vendos në rrethimin e Krujës, ashtu si Ashik Pashëzadeja. Si elemente të rinj ishin: plaçka e shumtë e kapur ishte aq e madhe sa nuk mund të transportohej. Në këtë kohë u dëgjua lajmi i çuditshëm se mbreti i Hungarisë Jankua, ishte nisur, kishte djegur me topa e dyfegje vendet përreth dhe, duke kaluar nga Beligradi, kishte mbërritur në Kosovë. Më poshtë përshkruhet lufta e dytë e Kosovës, ashtu si ia ka qejfi kronistit osman.⁵ Nga kronikat bizantine numri i autorëve është edhe më i vogël se burimet osmane. Laonik Halkokondili ngjarjen gabimisht e zhvendos gjatë rrethimit të Krujës (1450). Si elemente të rinj janë: lajmi vjen prej Gjergj Brankoviçit se Jani mbasi kishte grumbulluar peonët, kaloi Istrin dhe

² *Po aty*, f. 55-56.

³ *Po aty*. Ashik Pashëzade, vep. cit, f. 69-70.

⁴ *Po aty*. Mehmet Neshri, vep. cit, f.92.

⁵ *Po aty*. Ali, vep. cit, f. 281.

po marshonte kundër tij. Sulltani kur mori vesh këtë, u përgatit me shpejtësi të madhe dhe shkoi atje, ku sipas informatave që kishte do të kalonte Jani (Huniadi). Nga ana tjetër, ai dërgoi lajmëtarë në Turqinë Evropiane, duke urdhëruar që të paraqiten tek ai të gjithë turqit. Ata shkuan tek ai, duke vrapuar me nxitim, ashtu si munda secili, në mënyrën që të ndodhej me të në betejë.

Huniadi marshoi me gjithë ushtrinë drejt Mezisë në vendin e tribalëve; ku kalon Morava, i cili derdhet në Ister. Që këtë vendi i sulltanit nja 800 stade deri në Nish, qytet i sulltanit, i cili ndodhet në anën e djathtë, kur udhëtohet për në qytetin e afër Novopir (Novobërdën), i cili gjendet në një mal të madh në vendin e tribalëve. Kur arriti në Nish, Murati e gjeti atë duke marshuar së bashku me ushtrinë e peonëve. Ishin peonë dhe dakë (rumunë), së bashku me 47 000 kalorës. Sillnin me vete dhe rreth 2 000 qerre të ngarkuara me ushqime dhe armatime. Mbi çdo karro kishte dy burra këmbësorë, një pelast (ushtar me parzmore) dhe një artilier. Sillnin mbi qerret dhe topa të shumta që quheshin zarabotane (topa për goditjen e kalave). Ata mbasi u përgatitën, kaluan Istrin dhe ftonin prijsin e tribalëve që të merrte pjesë me ta në luftë. Ai u përgjigj se nuk e shihte të mjaftueshme përgatitjen luftarake të ushtrisë kundër ushtrisë së Muratit në mënyrë që të triumfonin mbi Muratin, se ai kishte frikë më shumë nga ai sesa nga peonët, të cilët ishin prej një race tjetër dhe i kanë punuar atij të këqija të mëdha. Ai donte të hakmerrej kundër Sulltan Muratit, i cili u kishte nxjerrë sytë të bijve të tij, por duke parë atë përgatitje nuk ishte e mundur që të arrihej fitorja, prandaj me dëshirën e vet nuk do të merrte pjesë në luftë. Mbasi mori këtë përgjigje, Jani u nis dhe marshoi përpara, duke shkelur tokën e sulltanit, arriti në Prishtinë dhe vendosi kampin e vet në fushën e Kosovës, ku Murati i biri i Orhanit, luftoi dikur me Lazarin, të cilin e vrau, por ai u vra njëkohësisht prej një tribali.⁶

Refuzimi për të marrë pjesë në betejë përkrah hungarezëve është një justifikim i rëndomtë. Sipas të dhënave të Halkokondilit që

⁶ *Lufta Shqiptaro-Turke në shekullin XV, burime bizantine*, përgatitur për shtyp nga K. Bozhorit, Titanë, 1967, f. 55-57; Koço Bozhorit & F. Liço, *Burime tregimtare bizantine për Historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, Tiranë, 1975, f. 331-332.

përputhen me kronikat osmane, ishte një ushtri afro të 50 000 vetave me artileri të konsiderueshme, adapte për goditjen e kështjellave. Halkokondili rreth arsyeve të pjesëmarrjes së Huniadit në luftë shkruan se Joani u shty që të shkonte në luftë kundër Muratit meqenëse në betejën e Varnës kishte parë turqit të iknin dhe duke u ndeshur me ta të dorëzoheshin, kujtoi se edhe në këtë rast punët ishin në rregull dhe turqit do t'i dorëzoheshin. Dhe sikur të mos kishte ndodhur çmenduria e Vladislavit nuk do të kishte qenë e vështirë t'ia arrinte qëllimit (d.m.th) të shkatërronte ushtrinë turke, mandej mendonte që pasi të grumbullonte sa më shumë ushtri, të sulmonte dhe kështu të mos kishte dyshim, që duke i goditur me forca më të shumta, do ta mundte Muratin.

Ndonëse shpjegimi i shkaqeve është shumë simplist, nga theksimi i grumbullimit të forcave të shumta dëshmon se ai kërkonte me çdo kusht që në ndeshjen ballore të dilte fitues. Si një element tjetër i ri që përputhet me kronikat perëndimore, ishte dërgimi i delegatëve tek Skënderi dhe tek Arianiti dhe mendonte pasi ata të afroheshin në vendet e afërta të Evropës, të bashkoheshin, kështu i paralajmëroi ata. Murati i biri i Mehmetit, arriti në fushën e Kosovës dhe i gjeti armiqtë duke marshuar, u ndal aty me ushtrinë.⁷ Kjo e dhënë justifikon drejtimin e marshimit drejt perëndimit.

Një kronist tjetër bizantin është Dukasi. Sipas tij, kur Jani (Janosh Huniadi) mori vesh këtë, kaloi në bregun tjetër të Istrit, nga një rrugë tjetër, dhe pasi kaloi të gjitha ngushticat erdhi në drejtim të Nishit ose drejt në Kosovë. Dhe Murati II bashkë me gjithë ushtrinë e tij ishte gati; madje mbasi luftuan qysh nga mbrëmja në mëngjes, kur ishte ende errësirë, Jani ngrihet së bashku me disa ushtarë dhe gjoja për t'u përgatitur para kohe luftën, iku fshehurazi sepse pa ushtrinë e turkut që ishte superiore, kurse hungarezët të frikësuar dhe që mendonin të iknin. Atëherë Murati, kur dielli tashmë kishte ndritur, duke parë çadrat e hungarezëve të shpërndara dhe ata me shikimin për të ikur, u vërsul mbi ta, dhe një pjesë i plaçkiti, kurse të tjerët i

⁷ *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV, burime bizantine*, përgatitur për shtyp nga K. Bozhorit, Titanë, 1967, f. 57-58; Koço Bozhorit & F. Liço, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, Tiranë, 1975, f. 332-333.

theri krejtësisht. Të tjerët ikën. U shënua një fitore e madhe e Muratit dhe një disfatë e Janit.⁸ Në dallim nga paraardhësi bizantin, Dukasi tregon edhe zhvillimin e ngjarjes, që sot për sot mbetet si një nga burimet e para më të besueshme.

Barleti nuk ndalet tek tregimi i luftës hungaro-osmane, por kalimthi na dëshmon për pengimin që i bëri Skënderbeut despoti i Serbisë, vjehri i Sulltan Muaratit II, duke refuzuar kalimin e forcave të Skënderbeut dhe e vetmja gjë që mund të bënte ky i fundit ishte ta dënonte despotin, duke sulmuar tokën e tij.⁹

Pas ngadhënjimit në Fushë-Kosovë sulltani u kthye në Adrianopojë dhe në pranverë 1449, me ndërhyrjen e Brankoviqit u arrit një paqe me Huniadin. Tani i vinte radha Skënderbeut.¹⁰

Në kuadrin e kritikës ndaj Tomkës, F. Bardhi na përsërit disa pasazhe mbi Betejën e Dytë të Kosovës, të nxjerra nga një diplomë boshnjake. Në këtë diplomë thuhet: “Pas luftës në Fushën e Kosovës me sulltanin e turqve Muratin të cilën ushtria e krishterë pësoi kërdrinë, Joan Huniadi u pengua dhe u kap në ikje e sipër nga Gjergj Dhespoti dhe se shpëtoi nga robërimi me ndihmën e Gjergj Margnjaviqit; ky ia rrëmbeu nga duart e Dhespotit dhe e vuri përsëri në krye të vendeve, ku sundonte më parë.¹¹ Për ta bërë më të besueshëm pretendimin e tij shton fjalët e nxjerra nga goja e Huniaditi cili “deklaronte se pas Luftës së Kosovës me Muratin, sulltanin e turqve, kur po ktheheshin më Hungari, u zumë rob nga Gjergj Dhespoti, princi i Serbisë, që i harroi mirësitë tona të panumërta dhe të paharrueshme kundrejt tij. Por, ne na shpëtoi nga duart e tij dhe na vendosi përsëri në mbretëritë që i ishin besuar qeverimit tonë, burrë i fuqishëm Gjergj Margnaviqi, me kujdesin dhe trimërinë e tij të rrallë, duke i kallur tmerrin princit Gjergj të lartpërmendur, na rrëmbeu nga duart e tij dhe na çliroi me trimërinë

⁸ Koço Bozhori & F.Liço, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, Tiranë, 1975, f. 356-357.

⁹ Barleti, M., *Historia e Skënderbeut*, sht.b. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1983, përkthyer nga S. Prifti, fl. 14,121.

¹⁰ Kortcha, Dj. *Tri pyetje nga jeta e Skënderbeut*, Tiranë 1923, sht. “Nikaj”, f. 34.

¹¹ Frang Bardhi, *Skënderbeu, (Apologji)* Biblioteka e Traditës; Antikuar, Tiranë, 1999, f. 54.

dhe famën e tij të madhe e na vuri përsëri në krye të mbretërive, që i besuan qeverimit tonë etj.¹²

F. Bardhi është i bindur se ka të tjerë, që thonë se Huniadi nuk u mbajti aspak nga Gjergj Dhespoti, si armik, por me qëllim që ky të miqësohej me të. Me të bashkohet edhe Leuklavi, i cili në librin e tij shkruan: “Dhe u kujdesua që Janko Semendrintë zënë rob, t’ia shpinin në mënyrë që ta priste me dashuri. Me të vërtetë Jankua qëndroi disa ditë në atë vend pranë Dhespotit. Më poshtë pasi bën fjalë për disa ankesa të Huniadit, kundër Dhespotit, shton: “Për sa i përket vetë kësaj çështjeje, mendimi i Lozoglit nuk ishte ky, se donte d.m.th. që t’ua dorëzonte Jankon turqve, përkundrazi, ai dëshironte që të fitonte gjithë besimin dhe dashamirësinë e tij. Por, Jankua i peshonte të tjerët sipas vetes.¹³

Në favor të këtij mendimi autori sjell faktin se kur Gjergj Dhespoti ishte plak, s’pati frikë të shkonte në Hungari, gjë që me siguri nuk do të kishte guxuar ta bënte po të kishte kurdisur një intrigë kaq çnjerëzore kundër Huniadit. Duke përfunduar se diploma ishte e rreme, autori arrin në përfundimin se mendimi i përgjithshëm i shkrimtarëve veprimin e Gjergj Dhespotit e quan si një pabesi. Mendimin e tij e mbështet mbi të dhënat e M. Barletit, duke e nisur nga letra e mbretit të Hungarisë, vazhdon me ardhjen e ushtrisë me flamuj në kufijtë e Misisë, si rezultat i sjelljes mizore prej të krishterësh të ndyrë, dhe si ndëshkim nga Perëndia, pabesia e një njeriu të vetëm të sillte gjithë ato pengesa e turbullira dhe t’u shkaktonte zi të pafund hungarezëve dhe kërdi të madhe krishterimit. Ky ishte Gjergj Vukoviqi, i quajtur Dhespoti i Serbisë. Ai njeri përbuzte njësoj si mësimet e Krishtit dhe ligjet e Muhamedit.

F. Bardhi shkakun e qëndrimit të Dhespotit ndaj Huniadit e shikon tek fakti se ai nuk mund të duronte që Huniadi të mos ia kthente disa qytete të Serbisë, që i kish mbajtur si shpërblim të trimërisë së vet, prandaj me të marrë vesh përgatitjen e luftës nga hungarezët dhe Skënderbeu, ai ia mbylli këtij të fundit të gjitha shtigjet nga mund të kalonte Skënderbeu, se Skënderbeu u përpoq ta

¹² *Po aty*, f. 54-55.

¹³ *Po aty*, f. 56.

këshillonte nëpërmjet të dërguarve të vet që të merreshin vesh me fjalë të buta se nuk kishte arsye për t'i bërë keq njeriu, të mos kërkonte ta bënte armik nga mik gjiton dhe ta kthente kështu kundër vetvetes gjithë ushtrinë e hungarezëve dhe të Epirit. Në të kundërt do ta kishte armik mbas shpine e ballë për ballë, në rast se nuk do të lejonte kalimin e forcave të tij me qëllim që krishterimi të mos pësonte një humbje të rëndë. Përpjekjet e Skënderbeut nuk patën asnjë dobi, atëherë ai vendosi ta çajë rrugën me forcën e armëve.

Autori ndalet edhe në faktin e vonimit të forcave të Skënderbeut në kufijtë e Misisë. Vladislavi, duke marrë zemër nga letra e Skënderbeut dhe i shtyrë nga fati që po e rrëmbente, kaloi Vllahinë dhe Danubin dhe mbërriti në Varna dhe prej andej do të marshonte drejt Rumanisë. Hungarezët po prisnin Muratin, të pushtuar nga një dëshirë e madhe për të mos iu shmangur përleshjes. Forcat e Muratit sulmuan me plogështi, frika nga besnikëria e grekëve, kalimi i forcave prej 100 000 vetave në një vend të ngushtë që ndante Evropën nga Azia. Lajmi i kalimit të forcave bënë që Vladislavi dhe princat e tjerë të mendojnë për të ikur, por fitoi mendimi i Huniadit se do ta mundnin armikun që mbështetej vetëm në emrin e mirë që kishin fituar, se ata qëndronin më poshtë se hungarezët.

Autori nuk u beson fjalëve se Huniadi që kishte ngulur këmbë për dyluftim, u përpoq t'i mbushte mendjen për të ikur, disa të tjerë shkruajnë se kur lufta kishte arritur kulmin dhe Vladislavi thaujse ia kishte rrëmbyer fitoren, Huniadi iku me dhjetë mijë ushtarët e tij. Autori duke e vlerësuar si çështje të pasigurt, mbështetet tek fjalët e atyre që mbërritën si lajmëtarë dhe mbeturina të asaj kërdie tek Skënderbeu. Sipas tyre Huniadi pas një kërdie të madhe i vuri përpara komandantët e ushtrive dhe i ndoqi shumë larg derisa doli në shesh Vladislavi, i cili ishte këshilluar të rrinte në kamp derisa të ishte kthyer fitimtar. Ai ishte nxitur nga disa këshilla rrënimtare të disa njerëzve, se këshillat e Huniadit ishin për t'i rrëmbyer famën e lavdinë, doli nga kampi dhe u lëshua kundër ushtrisë së Muratit. Gjatë luftimit ai u vra. Koka e tij u shëtit majë një heshte. Kjo uli moralin e hungarezëve dhe ngriti lart atë të turqve. Ndryshimi i fatit të betejës e detyroi Huniadin të tërhiqej. Kur po ikte drejt Serbisë, ai

u kap nga Gjergji, i cili e hodhi me shëmti në burg e nuk e lëshoi para se t'i shtinte në dorë ato qytete të mbretërisë së vet. Ky qe përfundimi i kësaj lufte.¹⁴

Mbi këto të dhëna të nxjerra nga Barleti, autori hedh poshtë pretendimet se Huniadi shpëtoi nga duart e Dhespotit me ndihmën e Gjergj Margnaviqit.¹⁵ Gjithashtu ai bën po atë gabim, duke ngatërruar betejën e Varnës me atë të Kosovës, më 1448.

Ndonëse në mënyrë telegrafike Xh. Korça bën të ditur se Skënderbeu pas paqes së 4 tetorit 1448, u nis drejt Kosovës. Beteja ishte zhvilluar para se të mbërrinte ai. Brankoviçi kishte lajmëruar sulltanin për planin e Huniadit me Skënderbeun. Autori nuk beson se e kish penguar Skënderbeun Brankoviçi, se kjo është bërë për të fituar dashurinë e respektin e sulltanit, sepse Skënderbeu mund të gjente shtigje të tjera. Me ndërhyrjen e Brankoviçit, u arrit më 1449, një paqe me hungarezët dhe tani i vinte radha Skënderbeut.¹⁶

Noli në versionin e vitit 1921 ngutësinë e lidhjes së traktatit të paqes së Skënderbeut me Venedikun, e lidh me lajmin se Huniadi u dërmua krejt prej turqve në Betejën në Kosovë, në një betejë treditëshe, më 17-19 tetor 1448, ku humbi tërë ushtrinë e tij dhe Sulltan Murati, i cili tani i kishte duart e lira, po gatiste një ushtri të madhe kundër tij. Kështu, u negociua dhe u arrit paqja në Lesh, në dimër të motit 1448.¹⁷

Nënshkrimin e paqes e vendos pas Betejës së Kosovës, gjë që dëshmon për pasaktësinë e këtij pohimi të autorit, kurse A. Gegaj i mbështetur tek Marinesco, flet për të kundërtën. Skënderbeu e përfundoi luftën për t'i ardhur në ndihmë Huniadit kundër armikut të përbashkët, duke e ditur se në rast të kundërt avantazhet do t'i kishin turqit që do përfitonin nga konflikti midis shteteve kristiane për të robëruar ballkanasit.¹⁸ Në versionin e vitit 1947, Noli, duke u mbështetur tek Ljubiç, Chronica Ragusina, Bonfinius, Villari, Barleti

¹⁴ *Po aty*, f. 57-63.

¹⁵ *Po aty*, 63.

¹⁶ Dj. Kortcha, *Tri pyetje, vep, cit*, f. 34-35.

¹⁷ F. S. Noli, *Vepra 4*, Tiranë, 1989, f. 128.

¹⁸ A. Gegaj, *Arbëria dhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, 1405-1468*, sht.b. Eurorilindja, Tiranë, 1995, f.70.

dhe Biemi, bën të ditur se Skënderbeu dy herë me radhë u përpoq të bashkohej me forcat e Huniadit: në Varna dhe në Kosovë, por nuk pati sukses, se të dyja betejat u bënë pa pjesëmarrjen e tij. Sipas Bonfinit po të kishte marrë pjesë ai, beteja në Kosovë do të ishte fituar nga të krishterët. Despoti i Serbisë, vjehri i Muratit II, u refuzoi kalimin fuqive të Skënderbeut dhe e vetmja gjë që mund të bënte ky i fundit ishte ta dënonte despotin, duke sulmuar tokën e tij.¹⁹ Që të dyja u humbën pa pjesëmarrjen e tij.²⁰ Në versionin e vitit 1950, Noli përsërit versionin e vitit 1947 me mjaft shkurtime.²¹

Në kumtesën e F. Pal, mbajtur në Konferencën kushtuar 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, me titull: “Skënderbeu dhe Huniadi”, një vend të mirë zë edhe Beteja e Dytë e Kosovës. Autori i përgjigjet pyetjes nëse kishte ndonjë marrëveshje të përbashkët hungaro-shqiptare. Autori mendon se Skënderbeu kishte lidhje me Huniadin që nga viti 1446, duke u mbështetur tek letra e qeverisë së Dubvronikut dhe Laonik Halkokondilin, për të cilin u fol më lart.²²

Duke u mbështetur tek Antonio Bonfini, historiograf i oborrit të Matias Korvinit, autori mendon se ka pasur një marrëveshje midis Huniadit dhe Skënderbeut. Sipas Bonfinit, në përputhje me këtë marrëveshje, Janoshi, duke përparuar nëpër “Serbi dhe Bullgari”, do ta sulmonte armikun përballë, ndërsa Skënderbeu do ta godiste nga prapa, nga ana e Illyricum”, d.m.th. e Shqipërisë. Ai mbështetet edhe mbi një letër të Pasquale de Sorgos, fisnik raguzan në shërbim të Brankoviqit, më dt. 11 shtator 1448, ku midis të tjerave thuhet se pas kalimit të Danubit nga një pjesë e ushtrisë, por para se të vihej në udhë, më 28 të atij muaji përmes Serbisë, Regjenti priti disa ambasadorë nga Shqipëria që i premtuan një ndihmë prej 20 000 vetash.²³

Autori hamendëson duke u bazuar në ndryshimin e drejtimit të marshimit nga jugu i vargmaleve të Ballkanit, duke u mbështetur

¹⁹ F. S. Noli, *Vepra 4vëp. cit.*, f. 279.

²⁰ *Po aty*, f. 278-179.

²¹ *Po aty*, f. 523-524.

²² Francisk Pal, *Skënderbeu dhe Huniadi*, në Konferenca e dytë e studimeve albanologjike, Tiranë 1969, f. 79.

²³ *Po aty*, f. 80.

te Skënderbeu, në Maqedoni e më vonë në Thraki. Nga mesi i tetori 1448 Regjenti mbërriti në Kosovë, për të pushuar dhe për të pritur aleatët shqiptarë. Por, Skënderbeu duhej të përballonte një rrezik të dyfishtë, sulltanin dhe Venedikun. Sukseset e Skënderbeut dhe të aleatëve të tij, e shtynë Sinjorinë të kërkojë ndërhyrjen e sulltanit, kundër një rebeli kokëfortë, sipas një dokumenti venedikas, 27 qershor 1448.²⁴ Sipas tij kjo dëshirë nuk u realizua, por e pranon se sulltani arriti të marrë kështjellën e Sfetigradit. Informatat se Huniadi po bënte përgatitje ushtarake, e shtynë sulltanin të hiqte dorë nga rrethimi i Krujës nga mesi i gushtit të atij viti. Më pas përsërit tërheqjen në Sofje dhe përgatitjet ushtarake. Mbi kronistët osmanë dhe Halkokondilin ai përsërit njoftimin e Brankoviqit të marshimit përmes Serbisë Jugore dhe arritjen në Kosovë.²⁵

Autori justifikon me të drejtë vonesën e Skënderbeut me luftën kundër Venedikut, nënshkrimin e traktatit të 4 tetor 1448, sakrificat e Skënderbeut duke u lënë venedikasve Danjën. Kërkesën e Skënderbeut për paradhënie të pensionit e lidh me përgatitjet ushtarake që të shkonte personalisht e të bashkohej me Huniadin, por ishte tepër vonë.²⁶

Autori na jep datën e zhvillimit të ndeshjes luftarake gjatë 17-19 tetor, por më saktë më 19 tetor. Sipas Bonfinit Huniadi nuk deshi të fillonte veprimet luftarake para ardhjes së ndihmave të premtuara nga shqiptarët. Megjithatë, ndihma e pritur me padurim nuk mbërriti në kohën e duhur. Murati duke u druajtur nga ky rrezik pranoi luftën. Nga 20 tetori deri në nëntor, në Dubrovnik nuk dihej përfundimi tragjik. Të dërguarit të Skënderbeut iu refuzua huaja për luftën kundër turkut, por iu dha si dhuratë një stof prej 200 dukatësh. Nga tregimi i Bonfinit, Skënderbeu ishte nisur për të Kosovë dhe një pjesë e trupave të shkëputura nga mënyra, që kishin marrë drejtimin e Shqipërisë, i takoi udhës në një distancë prej një ditë rruge (nja 30km) nga vendi i katastrofës.

²⁴ *Po aty*, f. 80.

²⁵ *Po aty*, f. 80-81.

²⁶ *Po aty*, f. 81.

Sipas një kronike të Raguzës e Giunio Restit, e shek. XVIII, të analeve të mëparshme dhe akteve arkivore, ardhja e Skënderbeut në ndihmë të Huniadit qe penguar prej Brankoviqit, aleat i dhëndrit dhe sovranit të vet. Është ajo e dhënë që Barleti e jep gabimisht me betejën e Varnës, më 1444. Autori arrin në përfundimin se bashkëpunimi i menduar, më 1448, midis dy protagonistëve të luftës për pavarësi të popujve të Evropës Juglindore për rrethanat e mësipërme nuk mundi të realizohej.

Pasojat e katastrofës ai i shikon tek dobësimi i pozitave të brendshme të Huniadit, dhe marrja fund e fushatave sulmuese të tij, kurse për osmanët u dha hov përpjekjeve për të pushtuar Kostandinopojën.²⁷

K. Frashëri si shkaqe të largimit të ushtrisë osmane jep lodhjen e saj dhe lajmet që erdhën se Huniadi po fillonte fushatën e re kundër turqve. Për këto arsye, sulltani u largua nga Shqipëria dhe i përqendroi ushtritë e veta në Sofje, në pritje të drejtimit që do të merrte marshimi i hungarezëve. Autori tek rezistenca e Sfetigradit shikonte një pasojë tjetër negative. Ajo krijoi rrezikun që Skënderbeu të mos respektonte marrëveshjen me kapitenin hungarez. Për fat të keq në monografi nuk është folur për këtë marrëveshje, për kohën dhe përmbajtjen e saj. Ai mbështetet tek letra e fisnikut raguzian Pasquale de Sorgo, e shkruar nga kampi i Huniadit, në shtator 1448. Atje bëhet e ditur se në kamp kishin mbërritur disa ambasadorë nga Shqipëria, të cilët njoftuan se, sapo të fillonte fushata, shqiptarët do t'i sulmonin turqit me 20 000 veta. Me të drejtë në këtë letër del dëshira e Skënderbeut për të marrë pjesë në luftën e madhe, që po përgatitsnin hungarezët. Për këtë arsye ai vendosi të hiqte dorë nga rrethimi i Danjës dhe të pranonte paqen e propozuar nga Senati i Venedikut.²⁸

K. Biçoku e çon më tej idenë e bashkëpunimit shqiptaro-hungarez. Sipas tij, për të shqyrtuar qëndrimin që duhej të mbanin ndaj përgatitjeve ushtarake antiosmane të J. Huniadit, anëtarët e Besëlidhjes Shqiptare mblodhën kuvendin dhe vendosën që një ushtri

²⁷ *Po aty*, f. 81-82.

²⁸ K. Frashëri, *Skënderbeu jeta dhe veprat*, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 158-159.

e fuqishme e tyre të bashkohej me forcat e Huniadit për të organizuar një fushatë ushtarake të përbashkët kundër pushtuesve osmanë. Për realizimin e këtij projekti të përbashkët, ushtria e Huniadit do të marshonte drejt viseve verilindore shqiptare, ku do të bashkohej me rreth 20 000 luftëtarë shqiptarë që do t'i komandonte vetë Skënderbeu.²⁹ Nga këto rreshta kuptohet se qenka hartuar një projekt i përbashkët, sipas të cilit do të ndryshonte drejtimi i ushtrisë së Huniadit drejt perëndimit. Ashtu si K. Frashëri edhe K. Biçoku pjesëmarrjen e shqiptarëve e çon në 20 000 veta, shifër ndaj së cilës ka mbajtur rezervat e veta K. Frashëri. Po kështu, të dy autorët zhvillimin e fushatës së përbashkët e shikojnë si faktorin kryesor që e detyroi Skënderbeun të hyjë në bisedime me Venedikun dhe t'i japë fund konfliktit.

Lidhur me shkakun e mospjesëmarrjes së Skënderbeut në betejë, autori bashkohet me Barletin e Biemin. Rrjedhimisht trupat e J. Huniadit u gjendën vetëm përballë ushtrisë osmane në betejën, që u zhvillua, më 18 tetor të vitit 1448, në afërsi të Prishtinës, të cilën e humbën.³⁰

Nga një këndvështrimi tjetër luftën në Kosovë e shikon O. J. Schmitt. Ai bën një hap më tej në rikonfirmimin e aleancës midis Huniadit dhe Skënderbeut. Mbështetur në dokumente veneciane, autori mendon se nga fundi i verës së vitit 1448, Huniadi kishte realizuar një aleancë të vërtetë në mbledhjen e dytë të Kuvendit të zotëve arbër, sipas të cilit Huniadi do të marshonte për gjatë Moravës e Skënderbeu do t'i sulmonte osmanët nga perëndimi.³¹ Në radhë të parë ende nuk është vërtetuar nga ndonjë burim tjetër kjo aleancë dhe për më tepër një e dhënë e marrë nga dokumentacioni armik, duhet parë me shumë rezervë mbasi aty ka frikë dhe tepri. Sipas tij, duheshin bërë për vete edhe Serbia dhe Venediku, por të dyja për arsytet e veta nuk pranuan të bashkëpunonin.³²

²⁹ K. Biçoku, *Skënderbeu*, Sht.b. "Botimpex" vep. cit, f. 121.

³⁰ *Po aty*, f. 122.

³¹ O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, Sht.b. K&B, Tiranë, 2002, f. 84-85.

³² *Po aty*, f. 85.

“Zbulimi më i madh” i autorit është akuza ndaj Skënderbeut dhe fisnikëve shqiptarë, se Huniadi nuk kishte llogaritur miopinë e fisnikëve arbër, mbasi ajo që ndodhi në Arbëri në vitet 1447-1448 mezi mund të besohet kur kemi parasysh yllësin e politikës së madhe - çështja e Huniadit ishte dëbimi i osmanëve nga Evropa.

Ai pretendon se në vitet e 1447-1448, fisnikëria shqiptare u mor me disa luftëra të vogla për kullota malore apo një stacion doganor në vend që të përgatitej për luftën e madhe që synonte dëbimin e osmanëve nga Evropa. Doli në plan të parë lufta për një qytet të vogël.³³ Sipas tij shumica e fisnikëve mendonin për sot e nesër dhe pak ishin të informuar lidhur me politikën e madhe. Fajin ia hedh se ishin zotërues të ultësirash dhe luginash të vogla dhe nuk mund të mendonin në mënyrë afatgjatë. Kështu, mund të shpjegohet se si Skënderbeu u ngatërrua në ca luftime të vogla për kullota malore apo për një stacion doganor, a një rrugë karvanësh, në vend që të gatitej për sulmin e madh kundër Muratit II, në plan të parë dilte lufta zemërake për një qytet të vogël.³⁴

Kritika është e njëanshme dhe tendencioze. Si mund të merresh me luftën e madhe në rast se nuk ke krijuar një familje të bashkuar, ku të përfshihen si zona rurale dhe ajo qytetare, si mund ta mbash familjen e bashkuar, kur armiku është ulur këmbëkryq në qytetet bregdetare shqiptare dhe punon nën rogoz jo vetëm për të mos e lënë atë familje të ketë harmoni, duke futur shkopinj nën rrota dhe më keq, kur të godiste mbas shpine. Në këto rrethana kur mungon uniteti dhe mobilizimi i forcave njerëzore, si mund të akuzosh për miopi Skënderbeun, i cili i paradoli gjendjes përpara me Kuvendin dhe krijimin e Lidhjes, mu në qytetin, ku sundonte arkitekti i intrigave midis fisnikëve shqiptarë. Fisnikët e tjerë që dolën kundër Skënderbeut jo vetëm ishin miopë, por dhe vegla të bindura të Venetisë, sigurisht duke u nisur nga interesat e ngushta vetjake. Sikur Skënderbeu të mos i kushtonte rëndësi Danjës, uniteti i princërve shqiptarë do të prishej, grindjet do të rriteshin në saje të

³³ *Po aty*, f. 86.

³⁴ *Po aty*, f. 85.

hostenit të Sinjorisë. Në këto rrethana nuk mund të mobilizojnë forcat ndaj armikut kryesor, sulltanit.

Me këtë kritikë autori kërkon që Skënderbeu luftën ta drejtonte kundër Venedikut qysh në fillim. Vetë lufta e Danjës apo lufta në dy fronte, tregoi për pasojat negative të kësaj lufte për shqiptarët. Vetë autori ka harruar kritikën për miopi ndaj Skënderbeut dhe fisnikëve shqiptarë dhe ngre lart vlerën e qytetit të Danjës, që shikon fushën e Shkodrës dhe kontrollon rrugën e Prizrenit, Arbërinë venedikase.³⁵ Me fjalë të tjera, nuk ishte një luftë për një doganë, por për një nyje në rrugën me rëndësi strategjike, ushtarake dhe ekonomike.

Unë mendoj se përpara se të akuzosh Skënderbeun dhe fisnikërinë shqiptare, duhet të akuzosh pa mëdyshjen më të vogël, shumicën e fisnikërisë evropiane që bënte sehir se si luftonte Huniadi dhe Skënderbeu, kurse disa të tjerë, si Venediku ruajtën raportet e mira dhe shpesh e ndihmuan sulltanin. Sinjoria shtriu kthetrat mbi Danjën dhe futi grindje midis fisnikëve shqiptarë.

Autori e ngarkon edhe me një përgjegjësi tjetër Skënderbeun dhe aleatët e tij mbasi humbën kohë të çmuar në luftërat anës detit.³⁶ Mendimin antiskënderbegas autori e çon më tej. Sipas tij, zotërisë arbër nuk i mbetej kohë që të korrigjonte gabimin e tij të rëndë. Kishte dërguar kasnecë në Romë me dy fajkonj, një përfaqësues i Skënderbeut u shfaq në Raguzë, të cilit i dhanë 200 dukatë, jo më shumë se ia kishin frikën sulltanit. Sidoqoftë, çdo ndihmë do të kishte mbërritur vonë. Autori i mëshon më shumë terrenit gjatë kalimit të ushtrisë drejt Kosovës, duke e paraqitur një vend malor e i thepisur ku nuk mund të kalonin grupe të vogla dhe jo një ushtri e tërë, pa na thënë se cila ishte kjo rrugë dhish ku nuk kalonte ushtria për një.

I mbështetur tek Radoniqi, autori tregon mënyrën se si Huniadi u jepte zemër pasuesve të vet të dëshpëruar se nga çasti në çast do të mbërrijë Skënderbeu, mirëpo Kastrioti nuk erdhi. Huniadit po i buzëqeshte fitorja, kur pa prituri princi trashëgimtar, Mehmeti, u

³⁵ *Po aty*, f. 86.

³⁶ *Po aty*, f. 92.

hodh në fushë të betejës me rezervat e tij, që ishin fshehur mbrapa një sopi. Të krishterët u thyen, si më 1389. Vetëm se kësaj here disfata ishte përfundimtare. Këto pohime janë shpikje të mendjes së autorit, mbasi pse Skënderbeu e kishte fajin se Huniadi nuk e kishte parashikuar këtë veprim në planin e luftës. Edhe në shumë raste të tjera, si në historinë e Bizantit dhe atë osmane, fitorja ka kaluar nga një palë tek tjetra sa hap e mbyll sytë. Kështu, ndodhi po në Betejën e Kosovës më 1389, kur në fillim fitorja i buzëqeshte koalicionit kundërosman, por ndërhyrja e Bajazitit ndryshoi fundin e luftës.³⁷ Përveç kësaj, autori i jep një rëndësi më të madhe Betejës së Kosovës, kur pohon se kjo betejë vendosi për 4-5 shekuj fatet e Ballkanit.³⁸ Sulltanit iu deshën vite të tëra dhe luftëra të shumta dhe të kushteshme derisa nënshtroi gjithë Ballkanin.

Po kështu, kritika ndaj biografëve të parë të cilët shkakun e vonësës e panë tek Gjergj Brankoviçi, nuk është e argumentuar. Pohimet e tij se despoti e pati dëmtuar ushtrinë hungareze dhe nuk ishte në interesin e tij mbërritja e Skënderbeut natyrshëm na bëjnë të shtrojmë pyetjen pse do ta ndryshonte qëndrimin ndaj Skënderbeut, aleatit të Huniadit? Refuzimi i Skënderbeut kërkesës së Brankoviçit për të bërë aleancë shkon në vazhdë të vërtetimit të njoftimeve të biografëve. Po kështu, falënderimet e Venedikut për refuzimin që i kishte bërë Skënderbeu kërkesës së Gjergj Brankoviçit janë në të kundërtën e Schmittit. Në kuadrin e argumentimit të pikëpamjes se Skënderbeu dhe fisnikët shqiptarë nuk ishin gjë tjetër veçse instrumente të politikës italiane përfshin edhe luftën e Brankoviçit në Zetë nën nxitjen e Alfonsit V, i cili kishte premtuar edhe strehim, por ndenji si spektator si luftonin vasalët e tij ballkanikë.³⁹ Natyrshëm pyesim nga dolën këta vasalë ballkanikë, përfshi edhe ata shqiptarë, kur do të duhen edhe disa vjet të nënshkruhen marrëveshjet me Skënderbeun dhe me Gjergj Arianitin.

³⁷ Shih më hollësisht P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes e Perëndimit, fusha politike*, vep. cit, f. 557-558.

³⁸ O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, vep. cit, f. 94-96.

³⁹ *Po aty*, f. 88.

Vetëm për të fajësuar Skënderbeun dhe fisnikët shqiptarë, autori mbi dokumentin venedikas shkruan se në dimrin e vitit 1447 Venediku u përpoq të shpëtonte paqen, duke ofruar zotërinjve të Kuvendit 1 000 dukate ari dhe lëniën e lirë të rrugës dhe mbrojtjen e zotërimeve venedikase nga serbët.⁴⁰ Ndonëse kanë kaluar kaq vite, Beteja e Dytë e Kosovës nuk është sqaruar plotësisht. Shumë aspekte kërkojnë hulumtime dhe studime të mëtejshme dhe të thelluara. Ne po ndalemi vetëm në njërin prej tyre, ku ia vlen të hulumtohet. Konkretisht marshimi i Huniadit drejt Perëndimit ishte fryt i bashkëpunimit të Skënderbeut me Huniadin apo një ndryshim taktike në luftën kundër osmanëve?

Barleti marrëdhëniet e Skënderbeut me hungarezët, ndonëse i nis qysh kur Skënderbeu ishte në oborrin e sulltanit nuk është i sigurtë për këtë, pasi do ta besonte,⁴¹ kurse A. Gegaj hamendëson se ka mundësi që në çastet e fundit mbreti t'i jetë lutur Skënderbeut, por e vonoi dhespoti i Serbisë.⁴² A. Buda, qysh në vitin 1957 mundohet të vërtetojë nënkuptimin e Barletit, se kishte një marrëveshje paraprake ndërmjet Huniadit dhe Skënderbeut, më përpara se ky i fundit të ndërmernte hapin vendimtar.⁴³ Sipas tij fitoret e hungarezëve që u dhanë goditjen e parë të ndjeshme pushtuesve osmanë, ishin faktori themelor i jashtëm, i cili favorizoi aq shumë etapën e re të luftës së popullit shqiptar kundër sundimit osman.⁴⁴ Si shkak të vonesës së Skënderbeut në Betejën e Kosovës (1448), autori e shikon zgjatjen e bisedimeve prej Venedikut. Huniadi pësoi disfatë.⁴⁵ Më vonë prof. A. Buda mendon se Huniadi u përpoq të bashkërendisë veprimet e veta me të hungarezëve në vitet 1443-1444, 1448 e 1456 dhe me ato të shteteve italiane, veçanërisht në vitet 1463-1468.⁴⁶ Sipas tij përderisa Skënderbeu dhe Janosh Huniadi ishin dy figura kryesore në luftën e popujve të Evropës Juglindore, secili në sektorin

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ M. Barleti, *Historia*, vep. cit., f. 84.

⁴² A. Gegaj, *Arbëria* dhe, vep. cit, f. 63-64.

⁴³ A. Buda, *Shkrime historike*, 1, sht.b. "Nëntori" f. 211.

⁴⁴ *Po aty*, f. 212.

⁴⁵ *Po aty*, f. 215-216.

⁴⁶ *Po aty*, f. 266, 281.

e vet të luftës ia lehtësoi barrën tjetrit. Të dy u përpoqën që bashkëpunimin ushtarak ta shtrin deri në organizimin e fushatave të përbashkëta, ndonëse largësia territoriale midis vendeve të tyre ishte e madhe. Me fjalë të tjera ai nuk bën fjalë për marrëveshje konkrete.

A. Ermenji në punimin e tij justifikon distancën e largët që pengoi Gjergjin dhe Huniadin në organizimin e fushatave të përbashkëta.⁴⁷

K. Frashëri duke u mbështetur mbi “Kronikën Raguzane” na bën fjalë për një aleancë shqiptaro-hungareze. Sipas kronikës meqenëse Skënderbeu ishte bërë shkëmb ku thërrmoheshin të gjitha orvatjet osmane, në vitin 1448, Huniadi dhe Skënderbeu lidhën marrëveshje për t’u bashkuar në Sllavoni dhe për të ndërmarrë që andej një fushatë të përbashkët kundër armatave osmane.⁴⁸ Ai mendon se në ndonjë rast, bashkëpunimi luftarak u farkëtua në mënyrë të natyrshme, pa u stipuluar në akte protokolare. Kështu ndodhi midis Hungarisë së Huniadit dhe Shqipërisë së Skënderbeut, mbasi të dyja palët zhvillonin, në të njëjtën kohë, një luftë çlirimtare kundër të njëjtit armik, pa pasur asnjëra synime territoriale ose politike ndaj njëra-tjetrës. Aleanca shqiptaro-hungareze apo e kundërta, në qoftë se marrim në konsideratë se nismëtari i saj ishte Janosh Huniadi, hyri në veprim që në ditët e kryengritjes të përgjithshme të nëntorit 1443. Ajo erdhi duke u forcuar dhe u konsakrua në fushën e betejës, pa pësuar asnjëherë lëkundje. Baza e kësaj aleance e paformalizuar me shkrim, e cila vazhdoi derisa kapiteni i lavdishëm hungarez vdiq (1456), mbështetej mbi parimin: secili në sektorin e vet godiste armikun e përbashkët, duke lehtësuar njëkohësisht barrën e tjetrit. Për të dyja palët mund të thuhet se aleati më i ngushtë i Huniadit ishte Skënderbeu, ashtu si aleat i ngushtë për Skënderbeun ishte Huniadi.⁴⁹

K. Biçoku si aleat të natyrshëm të Skënderbeut nxjerr në krye Hungarinë. Sipas tij, deri në vitin 1456, kur vdiq Janosh Huniadi,

⁴⁷ A. Ermenji, *Vendi që zë Skënderbeu në historinë e Shqipërisë*, sht. b. “ÇABEJ”, Tiranë, 1996, botuar për herë të parë në vitin 1968, f. 57.

⁴⁸ K. Frashëri, *Skënderbeu*, vep.cit., f. 1151-152.

⁴⁹ *Po aty*, f. 302.

Hungaria luftoi me vendosmëri kundër pushtuesve osmanë dhe ishte aleati më i rëndësishëm i shqiptarëve.⁵⁰ Bashkëpunimin u përpoqën ta shtrinin deri në organizimin e fushatave ushtarake të përbashkëta, me gjithë vështirësitë që rridhnin nga largësia midis dy vendeve. Kështu, ndodhi më 1448 në Fushë-Dardani, me atë të Beogradit (1456). Burimet historike tregojnë se Skënderbeu ndërmoi masa energjike për të marrë pjesë në ato dy beteja përkrah Huniadit me 20 000 deri në 30 000 luftëtarë. Vështirësitë nga largësia midis dy vendeve dhe qëndrimi i sundimtarëve fqinjë, vasalë të sulltanit, nuk e lejuan ushtrinë e Skënderbeut të kalonte nëpër rrugët e zotërimeve të tyre dhe penguan realizimin me sukses të fushatave ushtarake. Pas vdekjes së Huniadit, Hungaria u tërhoq përkohësisht nga veprimtaria aktive ushtarake dhe kështu u dobësuan lidhjet. Ato u gjallëruan në mesin e viteve '60 kur trupat hungareze arritën të çlironin Bosnjën Veriore.⁵¹

Një vëmendje të posaçme marrëdhënieve me Hungarinë u ka kushtuar edhe O. J. Schmitt. Sipas tij Skënderbeu nuk e priste ndihmën nga Italia, por nga Hungaria. Ai hamendëson se Skënderbeu dhe Huniadi duhen të jenë njohur në Transilvani, në fillim të viteve '40. Të dy ishin të vendosur t'i asgjësonin osmanët, të dy ishin karizmatikë dhe kishin respekt të ndërsjellë.⁵² Huniadi do të marshonte gjatë Moravës, kurse Skënderbeu do t'i sulmonte nga Perëndimi, por duheshin bërë për vete Gjergj Brankoviqin dhe Venedikun, por ata nuk pranuan. Ai hamendëson se nuk përjashtohet mundësia e ndonjë propozimi për paqe nga ana e sulltanit, që përmendet nga biografët, siç veproi edhe me Gjergj Brankoviqin. Skënderbeu tani planifikonte një sulm në formë dare ndaj perandorisë së bashku me Huniadin. Lidhja me të e fuste në politikën e madhe se ai ishte i lidhur me Alfonsin V. Më 16 prill 1446, Raguza kishte përgatitur një letër me lutje ndaj Skënderbeut dhe Komino Aranitit. Si element i ri është se Huniadi dërgoi bajlozë te Skënderbeu dhe Komino Araniti. Para luftës së vitit 1448 ishte

⁵⁰ K. Biçoku, *Skënderbeu*, vep.cit., f. 171.

⁵¹ *Po aty*, f. 171-172.

⁵² O. J. Schmitt, *Skënderbeu*, vep. cit, f. 476.

realizuar edhe aleanca e vërtetë, në mbledhjen e dytë të Kuvendit, ku thuhet se zotërinjtë e lartpërmendur të Arbërisë, u këshilluan së bashku.⁵³

Siç shihet trajtimi i marrëdhënieve të Skënderbeut me hungarezët është në fillimet e veta, me mendime të ndryshme dhe kontradiktore.

⁵³ Po aty, f. 77-86.

Jakup KRASNIQI
(Prishtinë)

**POROSIA E FUNDIT E GJERGJ KASTRIOTIT-
SKËNDERBEUT¹ DHE VLERAT E SAJ PËR KOHËN TONË**
(Komentimi i fjalës së fundit të Skënderbeut)

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi nuk është shkrimi i historisë në parametrat strikte shkencore për Skënderbeun, kryetrimin e shqiptarëve të shekullit XV, por shfrytëzimi për sot, për kohën tonë, shekullin XXI, urtinë, dijet që burojnë nga fjalimi i fundit i Skënderbeut sipas S. Zanovigit. Pra, kemi një koment timin për atë fjalim vizionar të Gjergjit tonë. Natyrisht që këtu ka edhe histori, se vetë fjalimi është historik. Kam bërë përpjekje që atë histori ta shfrytëzoj për sot e nesër. Pra, qëllimi është sesi vizioni historik i Skënderbeut t’ju shërbejë gjeneratave të shekullit tonë dhe shekujve në vazhdim!

Shkurt, qëllimi im është që atë epokë të lavdishme të historisë sonë të pakontestueshme nga shqiptarët dhe europerëndimorët, ta

¹Fjalimi është marrë nga libri i autorit, StephanZannowich, me titull: “Le Grand Castriottod’Albanie, Histoire”. Teksti prej 131 faqesh është botuar në vitin 1779 nga shtëpia botuese J. J. Kesler, Frankfurt. Citimet që janë marrë nga ky fjalim nuk kanë fusnota.

përdorim si mësuese jete e vlerë për ta vërë në shërbim të së sotmes dhe të së ardhmes së kombit!

I

Pas lavdisë 25-vjeçare të shqiptarëve të prirë nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, erdhi momenti më i dhimbshëm për shqiptarët, kryeprijësi i tyre ishte në shtratin e vdekjes. Skënderbeu para se të vdiste, i kishte ftuar fisnikët shqiptarë dhe djalin e tij dhjetëvjeçar, për t'iu dhënë porosinë e fundit. Mbreti i shqiptarëve, udhëheqësi më i shquar historik i shqiptarëve i të gjitha kohërave, e dinte se ç'vështirësi e prisnin kombin, prandaj dëshironte që t'u jepte këshillën e fundit se si duhej të qeverisej e mbrohej Shqipëria nga pushtuesit grabitqarë, qofshin ata nga Lindja apo Perëndimi. Kastrioti u tha: *“Jam në prag të varrit. Po ju lë një mbretëri me forca të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të virtytshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj”*. Skënderbeu ishte i bindur, se trashëgimtari që po e linte ishte fëmijë, nuk kishte kaluar në shkollat ushtarake që kishte kaluar ai, nuk e kishte moshën e as përvojën për ta drejtuar vendin, i cili deri atëherë ishte drejtuar sa nga strategu ushtarak, sa nga mençuria e dija për drejtim e qeverisje të vendit e po aq edhe nga fuqia e përdorimit të shpatës nga Skënderbeu dhe ushtarët e tij trima.

Nuk ka asnjë dyshim, që për qeveritarët e sotëm, një porosi që do të duhej ta dinte çdo njeri që dëshiron të merret me politikë, është kjo: *“Nuk është sipërfaqja e vendit ajo që bën një fron të respektueshëm, por aftësia e atij që ulet mbi të ...”*. Jo vetëm shekulli i Skënderbeut e ka konfirmuar këtë. Diçka më emblematike, sidomos për qeveritarët tanë, Skënderbeu nuk do të mund të linte, por e terë çështja është sa jemi duke mësuar nga këto porosi?

Mënyra se si Skënderbeu e kupton virtytin, të lë që të kuptosh se ai e njuh mirë domethënien e kësaj fjale. Për këtë ai thotë: *“Duhet të jetë virtyti themelor i fronit. Virtyti nuk është fantazi (...)”*. Dihet se për virtytin, shpjegimin e kësaj fjale në antikitet, të gjitha meritat ia lënë Sokratit. Për Sokratin, virtyti është dije, është shkencë, është dituria e së mirës. Madje për Sokratin, denjësia e individit nuk është

gjë tjetër, veçse dija e tij. *“Dija, - thotë Sokrati, - është themeli i virtyteve”*.² E them me bindje se, në të gjitha institucionet e pavarura të shtetit tonë, në karriget drejtuese, janë vendosur njerëz të paditur, që do të thotë njerëz *“jo të denjë e të virtytshëm”*. E sidomos te ne në Kosovë, në mënyrë të veçantë pas pavarësisë, askush nuk ka pyetur për virtytin e dinjitetin e njerëzve që po viheshin në drejtimin e institucioneve të shtetit dhe kjo është bërë me një dinakëri të përsosur. Prandaj, bash gjatë këtyre viteve, nga Kosova ka pasur një ikje të heshtur e të hapur, ikje e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite. Skënderbeu para 550 vjetësh na porosiste: *“Duke pasur virtytin si udhërrëfyes, lajkatarët dhe të pabesët do të largohen prej jush... Të virtytshëm, ju mund ta mbani lehtë perandorinë që po ju lë të tronditur nga lufta e vazhdueshme; ta përforconi, ta rimëkëmbni nëpërmjet pushimit dhe qetësisë...”*.

Para 550 vjetësh, Skënderbeu ynë kërkonte që qytetarëve që u bëheshin padrejtësi, t’u krijohej mundësia t’i njoftonin ato te prijësi i tyre. Skënderbeu u thotë: *“Krijoni vendshkrime të pacensuruara në të gjithë sipërfaqen e mbretërisë, ku mund të publikohen të gjitha padrejtësitë dhe dhuna që mund të ushtrohen nga drejtuesit e krahinave tuaja”*. Nëse kemi parasysh kohën kur është thënë kjo kërkesë e Kastriotit, del të jetë më shumë se demokrat. Kjo, gjithashtu, është një dëshmi tjetër, se e Drejta Zakonore shqiptare ka pasur një nivel të lartë të drejtësisë. Drejtësia e instaluar sot, në të dy shtetet tona, nuk mund të thirret në traditën tonë kombëtare. Skënderbeu vazhdon fjalën e tij: *“Ju do të mbroni artizanët, si njerëzit më të dobishëm të zonave të pushtetit tuaj, dhe do të parandaloni shtypjen e tyre nga pasanikët. Krenaria dhe luksi i bën pasanikët të pandjeshëm ndaj fatkeqësive të varfërve, të cilët nuk kanë as tituj (grada) e as mbështetje”*. Këtu Skënderbeun e shohim të ketë solidaritet me shtresat e mesme e të varfra të popullit.

Nga ai që do të ulet në fronin mbretëror, Skënderbeu kërkon që të jetë shpesh në mesin e popullit. Dhe i porosinë: *“Duhet të jeni të butë dhe të dashur me njerëzit tuaj! Dukuni shpesh mes tyre, bisedoni me ta, pyetini ata nëse dëshirat tuaja për drejtësi janë*

² <https://sq.wikipedia.org/wiki/Sokrati>

ekzekutuar nga ministrat tuaj”. Kastrioti e ka të qartë, se udhëheqësi gjithnjë ka mundësi të rrethohet me njerëz servilë e mashtrues, se vartësit e tij mund të jenë njerëz që u mungojnë virtytet, prandaj duhet krijuar mekanizmat kontrollues, madje edhe duke krijuar lidhje të drejtpërdrejta me popullin. Skënderbeu duke pasur përvojën e viteve sa ishte në oborrin e sulltanit, e di se *“Princi që qëndron i mbyllur me oborrtarët e tij shikohet nga populli i tij si armik dhe tiran... Dëgjoni ankesat dhe kërkesat e popullit tuaj me qetësi, saqë t’i frymëzoni besim atij për t’ju ndihmuar të korrigjoni abuzimet dhe fatkeqësitë e shtetit*”. Për Skënderbeun, mbreti, princi a cilido udhëheqës i shtetit, si dje ashtu edhe sot, duhet të jenë të urtë, të drejtë dhe të virtytshëm, se vetëm udhëheqës të tillë e kanë vullnetin për t’i ndihmuar, për t’i korrigjuar abuzimet e fatkeqësitë që pushtetarët pa dinjitet u shkaktojnë shtetasve, sovranit të vetëm të shtetit. Udhëheqësit e padijshëm, të padinjitetshëm e arrogantë, mendojnë se ata janë sovrani e jo qytetarët, pa të cilët nuk ka as shtet e as sovranitet. Vërtetë, largpamësia e Kastriotit më së miri shihet në vazhdim, kur thotë se *“kushdo që këshillon për të luftuar për hir të Perëndisë, është një mashtrues, i cili dëshiron të sakrifikojë të vërtetën për interesat e tij. Zoti është i fuqishëm, ai mund të bëjë gjithçka vetë, pa ndihmën e askujt...”*. Thënie më të mirë, më të fuqishme e më aktuale se kjo nuk ka! Dhe ky xhevahir është thënë para 550 vjetësh dhe është goxha vështirë të haset diku tjetër kjo *mrekulli skënderbegiane*. Ky mendim avangardë po i mungon shumë kohës sonë. Këtu çdo fjalë është diamant më vete dhe secila është në vendin e vet. Jo më kot është thënë se te Skënderbeu ka diçka hyjnore.

Iljaz REXHA
(Holandë)

**SKËNDERBEU NGA KËNDVËSHTRIMI I KRONIKAVE
KLASIKE OSMANE DHE I HISTORIOGRAFISË MODERNE
TURKE**

Hyrje

Për Skënderbeun është shkruar nga shumë studiues të botës së huaj dhe asaj shqiptare, nga këndvështrime të ndryshme, të vërteta, gjysmë të vërteta, deri te ato panegjirike dhe mitologjike. Për të zbardhur të vërtetat shkencore dhe dokumentet sekrete deri më tani të pazbuluara për heroin kombëtarë shqiptar dhe legjendar, Skënderbeun, duhet vazhduar me kërkime gjithëpërfshirëse shkencore dhe historike në arkivat e huaja e sidomos në arkivat dhe bibliotekat e Turqisë.

Ne, kësaj radhe në kumtesën tonë do të mundohemi që, në pika të shkurtra nëpërmjet kronikave klasike osmane dhe të historiografisë moderne turke, t'i gjejmë dhe t'i analizojmë opinionet pohore dhe mohore të studiuesve të disa autorëve turq, për jetën dhe veprimtarinë e tij politike, strategjike-ushtarake dhe diplomatike, duke analizuar përmbajtjen e lëndës narrative të kronikave të shekullit XV-XVI, dhe shkrimeve të historiografisë moderne turke se, deri ku përputhën pikat qenësore dhe ku dallohen në mes të këtyre dy burimeve. Natyrisht se, panegjerimi, glorifikimi, ekzagjerimi i përmbajtjeve të këtyre kronikave, është për ushtrinë e pamposhtur osmane dhe fitoret e tyre, ndërsa, minimizimi i forcave guerile mbrojtëse shqiptare, dallojnë në disa nuanca dhe ngjyrimë,

për nga trajtimi dhe paraqitja e objektivitetit të historiografisë moderne turke, por edhe me doza subjektivizmi, që lë vend për t'u diskutuar, ndaj konfliktit të armatosur shqiptaro-osman 25-vjeçar dhe figurës së heroit kombëtar të popullit shqiptar, për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun.

Për shkak se shumica e autorëve modernë turq, janë të ndikuar, nga përmbajtja e këtyre kronikave mesjetare, meqë rezistencën dhe betejat e fituara të popullit shqiptar kundër ushtrisë pushtuese osmane të udhëhequra nga Skënderbeu, i kanë minimizuar dhe paraqitur në kontekstin stereotip negativ. Me një fjalë, autorët modernë turq, nuk kanë shprehur qëndrim kritik ndaj autorëve të këtyre kronikave mesjetare që ishin identifikuar me klasën sunduese të sistemit feudal-ushtarak osman duke përkrahur pushtimin e tokave të huaja. Njësoj kanë vepruar edhe shtetet tjera mesjetare të krishtera të Lindjes dhe të Perëndimit, kur i kanë pushtuar tokat e shteteve islame gjatë kryqëzatave mesjetare, andaj, edhe në kronikat e kronistëve perëndimorë në paraqitjen dhe përshkrimin e shumë betejave dhe ngjarjeve në mes të shteteve evropiane, ka glorifikime dhe shumë herë nuk është thënë realiteti dhe e vërteta. Për këtë arsye, kronikat mesjetare dhe memoaret e të gjitha proveniencave duhet krahasuar me dokumentet arkivore dhe diplomatike për të qenë sa më afër të vërtetës historike.

Historiografia shqiptare që merret me studimin e të kaluarës së popullit shqiptar që nga antika, mesjeta e deri në kohën e sotme, rëndësi të veçantë dhe në qendër të vëmendjes i ka vënë kërkimet shkencore për zbardhjen e jetës dhe veprimtarisë politike, ushtarake, strategjike dhe diplomatike të Skënderbeut që ka përdorë gjatë kohës së luftërave për rezistencën e tij kundër sulmeve të furishme 25-vjeçare të ushtrisë osmane. Kronikat narrative osmane dhe ato perëndimore, pjesërisht deri diku janë të njohura për studiuesit e shkencave ndihmëse historike, atyre juridike, etnologjike dhe etnografike. Ndërsa, në anën tjetër, dokumentet diplomatike të administratës osmane për së paku për tri marrëveshje të lidhura në mes Skënderbeut dhe sulltanit, origjinalet dhe përmbajtja e tyre të hartuara në gjuhën osmane, ende nuk janë bërë të njohura për opinionin shkencor, përveç një dokumenti-raporti i zyrtar i vitit 1438,

i cili ruhet në Arkivin e Muzeut Topkapi Saray, në Stamboll, i regjistruar nën shifrën E-6665, që flet për shkresën e sanxhakbeut të Krujës, Mustafait, dërguar sulltanit, që siç thuhet në këtë dokument: “Kërkesa e Skënderbeut të refuzohet nga Sulltani”, i cili kishte kërkuar që të qeveriste në nahijen e Mysjes, ku më herët kishte sunduar babai i tij, Gjon Kastrioti.

Ky dokument për herë të parë është botuar nga historiani i njohur turk I. H. Uzunçarshili, në Turqi, në vitin 1961, i cili Skënderbeun e quan me epitetin se ai ishte një princ shqiptar që organizoi kryengritje kundër sundimit osman. Ai përveç paraqitjes së këtij dokumenti, ku Skënderbeu kishte kërkuar të qeverisë në ish-krahinën e babait të tij, nuk zgjerohet më tepër. Këtë të dhënë e kishte bërë të njohur S. Pulaha, se ky dokument është përkthye dhe botuar, së pari nga orientalisti Myqerrem Janina, në gazetën “*Bashkimi*”, më 3 mars të vitit 1967, ndërsa ai të njëjtin dokument e ribotoi, në *Burime osmane - Lufta shqiptaro-turke në shek. XV*, në vitin 1968. Edhe studiuesi, Ermal Nurja, kohë më parë, në punimin e tij: “*Qasje ndaj indiceve në dokumente osmane*”, në revistën e Institutit për Trashëgimi Kulturorë të Shqiptarëve në Shkup, 2018, sjellë disa informacione të reja lidhur me këtë dokument që ka të bëjë me kërkesën e Skënderbeut për t’u emëruar në krahinën, ku më parë kishte sunduar babai i tij Gjon Kastrioti.

Kronikat osmane i ekzagjerojnë fitoret osmane, ndërsa i minimizojnë fitoret e Skënderbeut

Kur kemi të bëjmë me të dhënat e kronikave narrative osmane që janë zbuluar qysh herët dhe shfrytëzuar në mënyrë fragmentare nga ana e studiuesve turq e të huaj, e më pak nga ata shqiptarë. Ato nuk janë shumë të besueshme dhe burime të dorës së parë, për të zbardhur jetën, veprimtarinë politike, diplomatike dhe luftarake të Skënderbeut, meqë ato në njëfarë mënyre rezistencën që e kishte bërë populli shqiptar dhe fitoret që i kishte korrë në mbrojtje të vendit me një ushtri të vogël guerile të udhëhequra nga ai në ballafaqime taktike dhe herë frontale disavjeçare kundër armatës disa herë më të madhe se sa osmane, minimizohen dhe përshkruhen

sikurse janë bërë falë ndihmës dhe përkrahjes nga ana e Venedikut, Napolit, Hungarisë, Dubrovnikut etj. Sipas kronikave narrative osmane, Skënderbeu kishte arritur t'i bënte rezistencë për një çerekshekulli ushtrisë osmane, e cila edhe pas shumë betejave nuk arriti të pushtojë një pjesë të Arbërisë qendrore mesjetare, në krye me selinë e Krujës, vetëm pas vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut u bë pushtimi i saj.

Kronistët klasikë osmanë gati të gjithë pohojnë se Gjon Kastrioti, në atë kohë ishte fisniku më i fuqishëm në Arbërinë mesjetare, si princ i Principatës së Kastriotëve dhe pas një rezistence relative të gjatë që kishte bërë në fillim kundër ushtrisë osmane, tregoi një diplomaci të mençur dhe më në fund e pranoi vasalitetin osman, ku sipas kronistëve ai tregoi diplomaci të mençur dhe vazhdoi pa pengesa qeverisjen në Arbërinë qendrore, por me kusht që të paguajë çdo vit atributin vjetor, një shumë të caktuar fiskale. Kronistët osmanë e bëjnë fajtor Skënderbeun, meqë ai nuk e vazhdoi politikën paqësore dhe vasalitetin e babait të tij ndaj Sulltanit, por mori guximin dhe ngriti krye ndaj një Perandorie, e cila kishte nënshtrua të gjitha shtetet tjera feudale të Evropës Juglindore. Skënderbeu i bindur se rezistencën e popullit shqiptar kundër pushtuesve osmanë do të përkrahin materialisht dhe ushtarakisht shtetet e krishtera perëndimore të cilat e nxitën në luftë kundër osmanëve, më në fund e mashtruan duke e lënë të vetmuar, ndërsa vendi i tij përjetoi shkatërrime të mëdha, viktima të shumta në njerëz dhe dëme të mëdha materiale dhe ekonomike.

Sulltan Murati II, qysh në fillim të pushtimit të Arbërisë, për të siguruar besnikërinë, lojalitetin dhe vasalitetin e Gjon Kastriotit ndaj tij, ishte i detyruar që Gjergjin, qysh kur ishte 9-vjeçar ta jepte si peng në Pallatin e Sulltanit, ku si i ri, ai së bashku me të birin e tij Mehmet Fatihun, u edukua në shkollën speciale ushtarake në Pallatin e Enderunit në Edirne. Meqë, Skënderbeu, gjatë shkollimit të rregullt 5-vjeçar, tregoi njohuri dhe shkathtësi të jashtëzakonshme në fushën e doktrinës dhe strategjisë ushtarake, por edhe gjatë betejave kur dilte në dyluftim kundër shumë pehlivanëve të ndryshëm, në praninë e sulltanit, ai gjithnjë fitonte. Këto aftësi mendore, fizike dhe shkathtësi ushtarake që Skënderbeu e tregonte gjatë betejave kundër

ushtrive armiqësore i përngjante Aleksandërit të Madh, e këto aftësi të tija e inspiruan Sulltanin Muratin II, që të pagëzonte me emrin e ri të formës turke *Iskender*, me kuptim, *Aleksandër - Leka i Madh*, figurë historike dhe strateg ushtarak i përmasave botërore. Skënderbeu u gradua edhe me titullin e lartë *beg*, post i rangut të sanxhakbeut, apo epror qeveritar administrativ-ushtarak që mund të drejtojë një krahinë, sanxhak në Perandorinë Osmane. Edhe pse iu dha kjo gradë, ai nuk u emërua sanxhakbej, në krahinën ku më parë i ati Gjoni kishte qeverisur, por iu dha vetëm një timar i vogël me disa fshatra edhe ndërkohë një pjesë e tij iu kishte marrë.

Kronistët si Hoxha Sadudin, Solakzade dhe Koxha Hysejn, kishin gabuar kur në kronikat e tyre kishin shkruar se pas vdekjes së Gjunit, babait të Skënderbeut, sulltani e kishte emëruar si vali në vilajetin-krahinën me kuptim në Principatën e babait të tij të Gjunit, ku më herët si vasal kishte qeverisur ai. Mirëpo, ky pohim i këtyre kronistëve nuk ishte i vërtetë, meqë veprimi i sulltanit për mos emërimin e tij në postin e babait të tij, shkaktoi zemërim dhe pakënaqësi të madhe të Skënderbeut që e nxiti të organizojë kryengritje gjithë populllore për çlirim social dhe popullor nga pushtimi osman. Derisa ishte në shërbim të ushtrisë osmane, e cila korrite fitore të udhëhequra përveç sulltanit edhe nga Skënderbeu, ai lavdërohej me epitete të larta dhe fjalë tepër lavdëruese dhe dashamirësie si një strateg ushtarak i pazëvendësueshëm në armatën osmane. Mirëpo, prej kohës kur u ngritë në luftë kundër sulltanit dhe pushtimit osman të Arbërisë mesjetare, filluan mallkimet dhe shprehjet më nënçmuese, me përbuzje cinike dhe fyese si një njeri bukëshkalës, tradhtar, renegat, i pabesë, armik i përbetuar deri te një njeriu i pa fe.

Ky veprim nuk është veçori vetëm i pushtuesve osmanë, por edhe i të tjerëve, sidomos i pushtuesve sllavë, kur shqiptarët që luftonin për autonomi dhe pavarësi gjatë kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Monarkia e Principatës Serbisë (Knjezhvina Srbije), në propagandën e saj raciste e shoviniste, shqiptarët i quante njerëz të egër të maleve me bishta. Kronistët osmanë në përshkrimin e ngjarjeve të luftërave shqiptaro-osmane i stërmadhonin ndihmat modeste, që ishin shumë të vogla që kishte marrë shteti i

Skënderbeut nga shtetet perëndimore, për t'i bërë rezistencë ushtrisë osmane.

Sipas burimeve perëndimore, thuhet se, mbreti i Hungarisë për çdo vit kishte marrë ndihma financiare nga shtetet perëndimore nga 40 000 dukatë, ndërsa sipas burimeve të Arkivit Shtetëror të Raguzës, që i hulumtoi dhe i përgatiti studiuesi i mesjetës *Gjon Berisha, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2018*, shihe se Skënderbeu 4 herë kishte marrë ndihma modeste, shumë të vogla financiare, njëherë 5 000 dukatë nga Republika e Dubrovnikut, njëherë tjetër nga Selia Apostolike 4 983 perperë, dhe dy herë tjera nga 500 e 200 dukatë. Nga këto të dhëna del se forca ushtarake dhe materiale është mbështetur, kryesisht nga financimi i popullsisë vendore shqiptare.

Kronistët mesjetarë nuk kishin aspak fjalë të mira për kryengritësit shqiptarë, e më së paku për Skënderbeun, meqë ushtria e madhe osmane nuk arrinte t'i nënshtrohte, andaj kronistët duke i mallkuar ata, shpeshherë i quanin; *rebelë, banditë, kusarë, prebesë, tradhtarë, njerëz paganë, të pafe etj.*, andaj edhe kronistët me jo sinqeritetin e tyre përkrahnin pushtimet dhe luftimet kundër kryengritësve shqiptarë po si klasa sunduese osmane. Natyrisht se kronistët e asaj kohe kanë qenë në shërbim të klasës sunduese dhe nën ndikimin e fanatizmit ideologjik-fetar të sistemit feudo-ushtarak osman dhe ndryshe as që kanë mundur të shkruajnë. Në kohën e obskurantizmit mesjetar edhe më ashpër ka vepruar klasa sunduese e shteteve të krishtera gjatë kryqëzatave kundër armiqve, duke i masakruar, madje duke i djegur në turrën e drunjve. Të gjithë studiuesit që merren me studimin dhe shfrytëzimin e kronikave narrative klasike osmane, duhet pasur qëndrim kritik ndaj ngjarjeve historike dhe lajmeve që sjellin këto kronika për periudha të caktuara. Natyrisht se ato duhet krahasuar edhe me burimet tjera perëndimore dhe dokumentet arkivore, që është kriter shkencor dhe parësor për përdorimin e çdolloj burimi apo dokumenti historik, për të arritur të vërtetën shkencore. Shumica e këtyre titullohen me togfjalëshin: *Tevarih-i Ali Osman (Historia e Dinastisë Osmane)*, apo *Tacu Tevarih-i Osman (Kurora e Historisë Osmane)*. Disa nga

ato që janë shkruar nga kronistët bashkëkohanikë okularë në vendin e ngjarjeve, kanë edhe të dhëna origjinale, por edhe subjektivizëm, ndërsa shumica e tyre janë të kompiluara, kryesisht të shkruara në bazë të kronikave më të hershme, andaj nuk mund të jenë shumë të besueshme.

Në këto kronika ka edhe ngjarje dhe lajme të vërteta, por më tepër kanë përmbajtje panegjirike dhe ekzagjerime ku, lavdërohet dinastia e sulltanëve osmanë dhe glorifikohen fitoret e ushtrisë osmane, e në shumë raste nuk paraqiten, padrejtësitë, humbjet dhe disfatat e tyre gjatë pushtimeve të tyre kundër territoreve të huaja. Kronistët osmanë, zakonisht ishin njerëz të shkolluar dhe kanë shërbyer në pallatin e sulltanit ose në zyrat e kryeministrave dhe funksionarëve të lartë të administratës osmane duke e identifikuar vetën nga pozita e politikës pushtuese, që e kanë arsyetuar dhe përkrahur një politikë të tillë, të pushtimeve dhe rrëmbimin e tokave të huaja, e kjo shihet nga përmbajtja e kronikave osmane se si janë pushtuar dhe shkatërruar në mënyrë të tmerrshme dhe brutale tokat edhe të Arbërisë mesjetare, duke bërë vrasje, plaçkitje, shpronësime të pasurive, shpërngulje masive të popullsisë autoktone, si asnjë vend tjetër të Ballkanit, e cila ka bërë rezistencë të madhe, po ashtu si asnjë vend tjetër, në mbrojtje të vendit të vetë kundër agresionit të ushtrisë pushtuese osmane.

Ndërsa, popullsia e krishterë shqiptare e Maqedonisë Veriperëndimore dhe e Kosovës mesjetare, që ishin konvertuar me dhunë në fenë ortodokse të ritit pravosllav, ku shumica ishte e pagëzuar, më se 85% me emra tipikë sllavë dhe kishin mbetur nën sundimin e despotëve sllavë-serbë dhe të administratës së Kishës Pravosllave që nga shekulli XIII, deri në vitin 1455, kur përfundimisht osmanlinjtë e larguan klasën sunduese feudale serbe nga Kosova dhe e vendosën administratën e tyre, popullsia shqiptare nuk kishte bërë pothuajse as një rezistencë, sikur që kishte bërë popullsia e krishterë, sidomos ajo katolike e Arbërisë mesjetare ndaj pushtimit osman, meqë kishin qenë të shtypur dhe krejtësisht të shpronësuar nga pronat e tyre nga mbretërit dhe despotët sllavë gjatë sundimit mesjetar të shtetit mesjetar të Rashkës.

Për t'u distancuar nga Kisha dhe gjuha sllave e imponuar, shumica e popullsisë shqiptare që gjatë sundimit dyshekullor serb, që me forcë ishte kthyer në fenë pravosllave, i shfrytëzoi rrethanat e ndryshimeve historike që pasuan nën ndikimin e shumë faktorëve politikë, ekonomikë, socialë dhe psikologjikë që vepronin gjatë sundimit osman, gradualisht kaloi në fenë islame dhe arriti të ruajë identitetin etnik-gjuhësor dhe të shpëtojë nga asimilimi i tërësishëm sllavë që kishte filluar me një intensitet të madh me pasoja të paparashikueshme.

Po ashtu, edhe pjesa më e vogël e popullsisë shqiptare e rritit latin-katolik që gjatë sundimit mesjetar sllav, nga i cili ishte e përndjekur dhe e persekutuar si *herezë* nga mbretërit dhe Kisha Pravosllave, qysh nga koha e sundimit mesjetar serb, kjo popullsi, kishte filluar të ushtrojë një doktrinë filozofike, të kultivojë ritin e *fshehët-laraman-kripto-katolikë* dhe arriti të mbijetojë dhe të ruajë identitetin etnik-gjuhësor dhe së pari të shpëtojë nga asimilimi mesjetar sllav dhe pastaj edhe nga ai osman-turk. Andaj, dallimi mes pushtimit të Arbërisë mesjetare dhe të shtetit të Skënderbeut që është pushtuar pas një rezistence të madhe heroike 25-vjeçare të popullit shqiptar dhe pushtimit të Kosovës, kur ajo gjendej nën pushtimin dhe sundimin e despotëve serbë të Rashkës, përfundimisht është pushtuar nga osmanët në vitin 1455, pa kurrfarë rezistence, meqë fisnikët serbë e kishin pranuar vasalitetin osman, qysh në viti 1389, dhe që nga ajo kohë në Kosovë ka ekzistuar dypushteti paralel serb dhe ai osman-turk.

Qysh gjatë shekullit XIII-XIV, klasa feudale e shqiptarëve para depërtimit osman në Kosovë ishte shpartalluar dhe shpronësuar, përveç disa fisnikëve që kishin arritur të mbijetojnë gjatë sundimit mesjetar serb në Kosovë, siç ishin fisnikët: Rajk dhe Bogdan të Krizmajve nga Prizreni, Nikolla Peci nga Deçani, Jakov Arbanasi nga Peja, Gjergj Mazreku, Nikolla Gjergjashi, Mark Zogoi, Pjeter dhe Lesh Spani, nga Novobërda, Zhivko Kastrati, Gjuka dhe Nikolla Kastrati nga vendbanimi Kastrati i Kurshulisë, familja fisnike Musiqi-Muzaqët e Prokupjes, e disa fisnikë tjerë, që të gjithë ishin konvertuar në fenë pravosllave dhe ishin asimiluar edhe në aspektin etnik në serbë dhe të gjithë kishin qenë në shërbim të administratës të

despotëve serbë. Andaj, në Kosovë nuk ka ekzistuar një klasë feudale e mirëfilltë shqiptare në pushtet, sikurse ekzistonte në Arbërinë mesjetare, andaj në mungesë të kësaj klase që ishte shpronësuar dhe tërësisht e sllavizuar, siç e kemi theksua edhe më lartë, nuk pati rezistencë as nga fisnikët e asimiluar shqiptarë as nga popullsia krishtere shqiptare e Kosovës që ishte e përndjekur, e shpronësuar dhe me dhunë ishte kthyer në fenë pravosllave.

Disa të dhëna nga historiografia moderne turke për luftën e Skënderbeut kundër osmanëve

Nga studiuesit e historiografisë moderne osmane-turke, në radhë të parë na paraqitet Süeyman Külçe, autori i librit *Osmanli Tarihinde Arnavutluk - Shqipëria në historinë osmane*, botuar në Izmir, 1944, me një vështrim të shkurtër informativ dhe mjaft pozitiv. Ai familjen e Kastriotëve e nxjerrë me origjinë nga Principata katolike e Arbërit. Ai emrin e Gjonit e jep me formën greke Jan-is Kastrioti, kështu e gjejmë edhe te Sami Frashëri dhe në disa burime tjera. Emri i *Gjonit* ishte shkruar në disa forma, si: *Giovani-Gjovani, Johannis-Johannes, Jovan-Ivan, Janis-Juano, Castrioto-Castriothis*, e i *Gjergjiut*, si: *Georgio-Georgii, Castrioti-Scandarbechi-Scanderbeg* etj., me forma latine, sllave dhe greke, varësisht nga kronistët e kohës në çfarë shkrimi dhe gjuhe i kanë shkruar emrat e tyre. Mjerisht, shkrimi i shqipes nuk është përdorur gjatë mesjetës as në zyrat e Gjonit dhe as të Gjergj-Skënderbeut dhe pasojat janë evidente që sllavët, Gjonin dhe birin e tij Gjergjin, i kanë regjistruar në burimet sllave me formën sllave si *Jovan* herë si *Ivan Kastriotoviq*, ndërsa *Gjergjin* si *Gjorgje dhe Gjuraç Kastriotoviq*, dhe jo me formën e mirëfilltë të shqipes, si *Gjon dhe Gjergj Kastrioti*.

Për këtë arsye, sllavët janë munduar t'i nxjerrin me origjinë sllave, këto dy figura historike që i kanë bënë rezistencë të madhe pushtimit osman kundër Arbërisë mesjetare, duke i konsideruar si sllavë, mu për shkak që ata ishin shënuar në burimet sllave me forma tipike sllave. Studiuesi Külçe, përveç informacioneve tjera, jep edhe një të dhënë interesante se ku thuhet se *Mojisi Dibra Golemi* dhe

Hamza Kastroti me dijen e Skënderbeut kanë kaluar përkohësisht në anën e ushtrisë osmane, kjo ishte një taktikë për ta mashtruar dhe për të vënë në kurth ushtrinë osmane. Kjo çështje duhet të hulumtohet, sepse në burimet tjera, thuhet se ata e kishin tradhtuar Skënderbeun dhe kishin kaluar në anë të ushtrisë osmane që kishin premtuar se do ta kapin Skënderbeut për t'ia dorëzuar sulltanit.

Historiani turk, Isamil Haki Uzunçarşılı, në vitin 1961, botoi një dokument osman, me të cilin pohon se Skënderbeu i drejtohet sanxhakbeut të Krujës, Mustafa beut, që kërkonte një referencë që atij t'i jepet për qeverisje *zeameti* (pronat) e krahinës së Mysjes në Arbërinë e Vjetër mesjetare, ku më herët kishte sunduar babai tij, Gjoni. Nga ky dokument, kuptohet se Skënderbeu kishte fituar statusin e së drejtës për t'u bërë posedues i timareve. Mirëpo, meqë sulltani sipas porosisë së sanxhakbeut të Krujës, nuk lejoi që *zeameti* i kësaj krahine t'i jepet atij, por iu dha tjetërkujt. Kjo si duket ishte njëra ndër arsyet që Skënderbeu filloi të organizojë kryengritjen kundër sundimit osman. Historiani tjetër i mirënjohur turk, Halil Inalcik, qysh në vitin 1974, e kishte botuar veprën me titull: *Perandoria Osmane - periudha klasike 1300-1660*, në këtë vepër shqiptarët dhe Skënderbeu përmenden shumë shkurtë, pikërisht, pas ekspeditës ushtarake kundër Selanikut të vitit 1400, kur i venë në dukje kërkesat e venedikasve për t'u vendosur në krahinën e Moresë dhe në Arbërinë mesjetare.

Pra, pas 14 vjetësh, përsëri përmendet Skënderbeu si një nga fisnikët me rëndësi që kishte rrokur armët kundër ushtrisë osmane për çlirimin e vendit të tij. Skënderbeu dëshironte ta kthejë trashëgiminë dhe tokat e babait të tij, Gjon Kastriotit në Arbërinë Verilindore. Autori në fjalë në mes tjerash thekson se, Sulltan Murati II, luftoi kundër Gjonit, pa treguar humbjet apo fitoret e këtyre betejave. Mirëpo, ai e pranon se në vitet 1431-1432, turqit që e kishin vendosur pushtetin dhe administratën e tyre në tokat e Arbërisë, u desh që të zhvillonin luftëra të ashpra dhe të gjata për të nënshtuar popullin e saj. Në vitin 1432, *Andre Thopia*, një princ arbëror, u kishte shkaktuar humbje të madha ushtrisë osmane, prandaj prej kësaj kohe kryengritjet u zgjeruan edhe më shumë, ku u përfshinë edhe masat fshatare. Në vitin 1433, për shtypjen e tyre, nga ana e

Portës së Lartë u dërguan Ali Bej Evrenosi dhe një vit më vonë, u dërguan forca të mëdha ushtarake nga sanxhaku i Shkupit me Isa beun në krye dhe përsëri ata pësuan humbje dhe disfatë.

Në një punim tjetër të H. Inalcikut, flitet për depërtimin dhe vendosjen e sundimit osman në Arbërinë mesjetare, ku në mes tjerash shkruan: Njëri prej faktorëve të rëndësishëm që penguan vendosjen e sigurt të shtetit osman në Ballkan dhe në kuptimin e plotë zgjerimin e perandorisë gjatë sundimit të Sulltan Muratit II dhe Sulltan Mehmet Fatihut e përbënin kryengritjet e gjata dhe të ashpra në Shqipëri, kundër sundimit osman. *Duke filluar nga kryengritja e parë e Mbretërisë së Fortë të shtetit të Hungarisë, e cila kishte mbështetjen e Papës dhe përkrahjen materiale dhe morale të botës krishtere, prapë se prapë, Perandoria Osmane sundimin e vet mudohej ta zgjeronte duke pushtuar vendet deri te lumi Danub, edhe pse tentimet për pushtimin e tokave nën sundimin osman në Ballkan (nga bota e krishterë) kishin të njëjtin rrezik me ato të viteve 1443 dhe 1444, nga kryengritjet në Arbërinë mesjetare në mënyrë të frikshme dhe tragjike ishte duke e dobësuar rezistencën e krahut të majtë të Perandorisë Osmane. Edhe pse ato, në njërën anë Beogradi (që mbrohej nga hungarezët) si zonë e kufirit të Evropës së Mesme, kurse në anën tjetër Arbëria, si zonë e kufirit me Italinë, ato njëkohësisht, ishin edhe dy porta kryesore të Ballkanit. Për shkak të këtyre dy pikave kyçe strategjike, përplasjet e Perandorisë Osmane me botën perëndimore kanë marr formën më të ashpër gjatë betejave të ashpra dhe, si rezultat i këtyre kanë qenë edhe ekspeditat e mëdha ushtarake dërguar në Arbëri të udhëhequra nga vet Sulltan Murati II dhe Sulltan Mehmet Fatihu II.*

Pushtimi osman princat arbërorë i gjeti të papërgatitur, të përcarë, në luftëra dhe konflikte në mes vete. Historikisht, dihet se për herë të parë osmanët i thirrën disa pinca arbërorë si Karl Topia, për t'i shuar konfliktet në luftën civile që kishte shpërthyer ndërmjet principatave arbërore. Kjo ftesë shërbeu edhe si pretekst që ndërkohë osmanët e shfrytëzuan rastin për ta pushtuar më lehtë Arbërinë mesjetare. Inalcik në artikullin e tij të botuar në *Enciklopedinë Islame* jep një përshkrim të gjatë për organizimin e sistemit e timarit spahi në Shqipëri, dhe për filltet e kryengritjes së Skënderbeut kundër

sundimit osman, ai në vijim shkruan: “Skënderbeu lindi në vitin 1405. Emri i tij i vërtetë ishte Gjergj (Kastrioti), në burimet perëndimore është shënuar edhe me formën Scandarbeg. Skënderbeu i njohur si hero kombëtar i shqiptarëve, rrjedh prej familjes së njohur fisnike, Kastrioti. Pas humbjes së betejës në Vjosë, në vitin 1385, edhe fisnikët e tjerë shqiptarë e njohën Sulltan Muratin I, për sundues. Babai i Skënderbeut Gjon (Ivan-Yovan-formë sllave) Kastrioti në burimet osmane dhe bizantine tregohet se ishte njëri prej fisnikëve më të rëndësishëm në Arbëri”. Osmanët vendet që ishin në veri të sanxhakut të Gjirokastrës, i quanin krahina e Ivanit (Gjonit).

Në vitin 1432, sipas Defterit të timarit të *sanxhakut Arvanit*, a po i *Arbërit*, përkatësisht tokat e Gjonit shtriheshin edhe përtej Krahinës së Matit në Veri, përkatësisht deri në fshatin Reçan në verilindje të Prizrenit. Kurse, sipas Defterit të Rumelisë të vitit 1451/52, No. 12, thuhet se në Kështjellën e Prizrenit gjendej garnizoni ushtarak osman, andaj Prizreni ishte pushtuar shumë më herët e jo në vitin 1455, dhe kinse, ky qytet gjendej nën sundimin e Gjuraç Brankoviçit, siç supozojnë në mënyrë narrative autorët serbë. Shih edhe fragmentin e këtij Defteri me titull, *Vilajeti Arnavud*, botuar nga Iljaz Rexha, botuar në librin: *Vendbanimet dhe popullsia albane - sipas defterëve osmanë të shek. XV*, Prishtinë, 2016.

Prej vitit 1402 deri në vitin 1413, kur shteti osman gjendej në trazira të mëdha të brendshme dhe kaloi një periudhë pa pushtet, Gjoni Kastrioti kishte hyrë nën pushtetin e Republikës së Venedikut duke u munduar të shkëputet nga vasaliteti i shtetit osman. Mirëpo, pas marrjes së pushtetit Murati II, pasi që e forcoi pozitën e tij, ai përsëri dërgoi forca të mëdha ushtarake në krahinat e Gjonit. Kështu që në vitin 1423, ai në këtë pjesë të Arbërisë i përqendroi forcat në krye me Ali Bej Evrenosin.

Gjon Kastrioti në fillim bëri rezistencë dhe zhvilloi disa beteja kundër ushtrisë osmane. Mirëpo më vonë, ai tregoi një politikë dhe diplomaci të mençur, meqë pranoi përkohësisht vasalitetin osman, për të mos iu eksponuar rreziqeve të mëdha, se po të vazhdonte edhe më tej konfrontimin frontal me ushtrinë osmane, mund t'i shkaktonin pasoja dhe dëme më të mëdha materiale në pasuri dhe viktima në njerëz. Qëllimi tjetër ishte që, ai ende të mbetet

të sundojë në Arbërinë Qendrore. Gjon Kastrioti, babai i Skënderbeut, kur e pa se nuk do të mund t'i përballojë sulmet e furishme të ushtrisë osmane, tregoi diplomaci të mençur, e pranoi vasalitetin osman dhe kjo ishte një prej arsyeve kryesore që formalisht, përkrah emrit të vet të krishterë, *Gjoni* e mori emrin formal *Hamza*, me kuptim (Luan), natyrisht, si lajthitje diplomatike ndaj sulltanit, që si kusht i vasalitetit ishte që ai të vazhdojë edhe më tej të sundojë dhe qeverisë në territorin e *Principatës së Kastriotëve*, me pikësynim që sado kudo, në mënyrë direkte të mos i lejojë të huajt dhe që drejtpërsëdrejti të sundonin në territorin e Arbërisë Qendrore mesjetare dhe natyrisht se Gjoni vazhdoi si vasal i sulltanit të sundojë në *Arbërinë Qendrore* deri në vdekje.

Edhe sipas një autori tjetër turk, Ismail Ertaylan, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, nuk vazhdoi politikën e babait të tij për të treguar një lojalitet ndaj Perandorisë Osmane, siç kishin vepruar edhe të gjithë princat e shteteve ballkanike, por nën ndikimin e politikës së huaj të shteteve perëndimore dhe Papës, ai morri guximin për të ngritur krye kundër sulltanëve dhe vendosi t'i kundërvihej ushtrisë së madhe të Perandorisë Osmane duke e organizuar shumë kryengritje, gjithë populllore dhe njëkohësisht duke i bashkuar të gjithë princat shqiptarë për t'i çliruar nga sundimi osman, e duke i shkaktuar humbje ushtrisë osmane, por shumë më shumë viktime ka pasur nga njësitë e forcave ushtarake guerile të Skënderbeut. Kjo rezistencë e tij 25-vjeçare, me një ushtri prej 5 000-10 000 vetash, si edhe me ndihmën e popullsisë vendore dhe konfiguracioni gjeografik, Skënderbeu arriti t'i bënte ballë ushtrisë osmane. Mirëpo, sipas autorit në fjalë, gjatë zhvillimit të betejave pati pasoja dhe humbje të mëdha, viktime në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, për popullin shqiptar. Autori në fjalë i kësaj vepre, nga ana tij nuk jep të dhëna për humbjen që ka pasur në njerëz ushtria osmane gjatë kësaj periudhe 25-vjeçare. Studiuesi turk, Erteylan, duke u mbështetur gjithnjë në kronikat osmane, të cilat tregojnë se Sulltani Murati II, gjatë viteve 1448 dhe 1450 si edhe Sulltan Mehmeti II, në vitet 1466- 1467 dhe në vitin 1478, me ushtritë e tyre të mëdha të Perandorisë Osmane, ndërmorën fushata luftarake të rëndësishme me qëllim që të thyenin qëndresën dhe rezistencën e popullit shqiptar

të udhëhequr nga Skënderbeu.

Kronikat klasike si burime narrative osmane sjellin deri diku edhe të dhëna objektive, por shumica e tyre që kanë përshkruar ngjarjet dhe betejat e zhvilluara në mes të ushtrisë osmane të udhëhequra nga Sulltan Murati II dhe Sulltan Mehmet Fattihu II dhe asaj shqiptare të udhëhequra nga Skënderbeu, kanë përmbajtje panegjirike, ku glorifikohen fitore të vogla të sulltanëve, humbjet e tyre heshtën, ndërsa fitoret e Skënderbeut minimizohen. Nga konteksti i këtyre burimeve narrative osmane, mund të pohojmë faktin se të dy këta sulltanë të fuqishëm edhe pse e patën edhe ndihmën e dy komandantëve renegatë shqiptarë, *Ballaban Pashën* dhe *Jakupbej Muzakën*, që u vranë në beteja me Skënderbeun, ata pësuan humbje të mëdha, përpara fortesave të Krujës dhe të Shkodrës. Në veprat e studiuesve turq, gjejmë të dhëna edhe mbi tradhtinë e *Hamza Kastriotit* e të *Mojsi Golemit*, të cilët kishin kaluar në anën e sulltanëve dhe e kishin tradhtuar Skënderbeun, por më vonë, Skënderbeu shpirtmirë që të dy i zuri dhe më në fund i fali. Mbetet të dëshmohet se ai ishte me të vërtetë kalimi i tyre në ushtrinë osmane, tradhti ndaj Skënderbeut, apo taktikë kamuflazhi nga Skënderbeu, për të futur në kurth ushtrinë osmane.

Sipas të dhënave që Inalcik sjellë nga *Defteri Arvanit*, të vitit 1431, shihet se Ali beu ishte sanxhakbej i Korçës. Sipas të të njëjtit defterë në faqen 1, shihet se Gjoni në atë kohë e kishte dërguar të birin e tij Gjergjin si peng, sipas gjitha gjasave 9-vjeçar, në Pallatin e Sulltanit. Gjergji si i zgjedhur i Pallatit të Sulltan Muratit II, në Edrene, ku u edukua dhe u arsimua në kushte të mira duke e pranuar fenë islame, ku e mori edhe emrin e ri Iskender (Skender). Derisa babai i tij Gjoni, nga frika se i biri tij mund të vijë si fisnik osman dhe t'i merr tokat e tij e kishte paralajmëruar Venedikun. Sipas defterit të timarit Arvanit, të vitit 1437-1438, shihet se me të vërtetë Skënderbeu kishte një timar në tokat e *Krahinës së Gjonit*, por shumica e tokave të babait të tij iu kishin dhënë spahinjve të tjerë *lojalë* ndaj sulltanit. Në maj të vitit 1438, një pjesë e këtyre tokave të Skënderbeut që gjendeshin në nahijen fisnikut *Dhimitri Gjonima*, prej tyre nëntë katunde ju kishin dhënë Andre Karlos. Historiani i njohur turk, Inalciku ishte në dilemë dhe e shtron pyetjen nëse,

Skënderbeu në atë kohë së bashku me kadiun e Krujës, lëshonte dokumente për timare (toka bujqësore), atëherë ai do të duhej të ishte *komandant-subash* i Krujës.

Një dokument që gjendet në Arkivin e Muzeut të Topkapi Saray, në Stamboll, nuk e vërteton një gjë të tillë, i cili nuk ka datë, por i regjistruar me shifrën E-6665. Në këtë dokument thuhet se, Skënderbeu e kishte kërkuar që t'i jepej krahina e Mysjes, e cila ishte qendër e babait të tij, Gjonit, mirëpo kjo kërkesë e tij nuk ishte pranuar nga sanxhakbeu i atëhershëm. Kjo ngjarje duhet të ishte një shkas për lëkundje në lojalitetin e tij ndaj sulltanit. Sipas burimeve perëndimore, pas humbjes së betejës së Izladit afër Nishit, ku mendohet se Skënderbeu mori pjesë si spahi (kalorës ushtarak), pas pasimit të humbje së betejës, ai dezertoi nga ushtria osmane dhe më vonë me këmbëngulje, filloi të organizojë kryengritje kundër osmanëve.

Në këto luftërat e fundit ku, në përgjithësi, komandantët e njësisive elite sulmuese osmane (akinxhit) dhe bejlerët e Rumelisë me veprimet e tyre luftarake joefektive dhe të pasuksesshme ndaj Skënderbeut, e hidhëruan shumë sulltanin dhe si duket, ata janë larguar nga postet e tyre. Në atë kohë shteti osman gjendej në një krizë të madhe qeveritare. Në anën tjetër ushtria hungareze përgatitej për një kryqëzatë të re dhe besonin se me këtë do t'i largonin osmanët nga Ballkani. Nga ky këndvështrim, siç e thotë edhe kronisti bizantin Halkokondil, çdo kush ishte i shqetësuar se, si ta rikthente pronën e vet. Në jug të Arbërisë, fisniku Gjin Zenebishi për t'i rikthyer tokat e të parëve, ishte nisur ta sulmonte Gjirokastrën që ishte qendra e sanxhakut. Në këto rrethana, dhe trazira të përgjithshme edhe Skënderbeu shpejtoi të vinte në vendlindje të Arbërisë për t'i marrë zotërimet në Principatën e babait të tij, Gjonit. Në të vërtetë, në Arbërinë mesjetare, kryengritje kundër sundimit osman ka pasur shumë më herët se ato të Skënderbeut. Sidomos pronarët vendorë të cilët ishin emëruar si spahinj nga Porta e Lartë, nga që i humbën të drejtat në pronë dhe trashëgimi, ishin të gatshëm për kryengritje kundër sundimit osman. Me të vërtetë kryengritja e parë me rëndësi është ajo që e organizoi *Gjergj Arjaniti*, i cili më vonë do të bëhet vjehërr i Skënderbeut, shkak i së cilës ishte

pakënaqësia në shpërndarjen e tokave, apo shpronësimi i fisnikëve shqiptarë nga territoret që i kishin pushtuar osmanët.

Sipas historianëve turq, për ta rimarrë kështjellën e Koxhaxhikut, sulltani e emëroi të birin e Evrenosit, Isa beun. Suksesin e parë Skënderbeu e fitoi me këtë betejë. Osmanët pësuan humbje të mëdha. Ndërkohë një ushtri e madhe krishtere përparonte në drejtim të Varnës në Bullgari. Kryengritja në Shqipëri përkrahej nga Papa; Skënderbeu i cili më vonë shpallet si një hero i krishterë nga Papa, ai, sipas historianëve turq, gjatë shekullin XIX, nga nacionalistët shqiptarë do të përmendet si hero kombëtar, i cili ka luftuar për çlirimin e tokave të Arbërisë. Është e vërtetë që Skënderbeu mblodhi rreth vetit prijësit feudalë shqiptarë që kishin afërsi fisnore dhe prijësit e tjerë të fiseve. Mirëpo, nuk është për t'u çuditur që disa prijës të tjerë dhe spahinj shqiptarë u bashkuan kundër tij me Venedikun, e disa të tjerë u bashkuan dhe u radhitën në anën e ushtrisë osmane. Kështu që në betejat e zhvilluara kundër Skënderbeut shumë prijës shqiptarë morën pjesë në radhët e ushtrisë osmane si spahinj, pronarë të timareve që u kishte dhënë sulltani, i cili me privilegje dhe leverdi ekonomike kishte arritur të futë përçarje në mes disa fisnikëve shqiptarë.

Administrata osmane bëri përpjekje që të vendoste përfundimisht pushtetin dhe administratën e saj në këto zona, duke bërë regjistrimin e tokave, të cilat administrativisht ju kishin bashkëngjitur sanxhakut të Ohrit. Të dhëna tjera të burimeve narrative osmane, vënë në dukje se pushteti osman në këto zona ishte i pastabilizuar, prandaj, sulltani vendosi për një kohë t'i ndalë ekspeditat ushtarake kundër Skënderbeut, dhe ishte kthyer në Filebe të Bullgarisë, ku e kaloi dimrin.

Sipas një versioni tjetër narrativ, pas ikjes nga shtabi ushtarak i Kasim beut, që ishte afër Nishit, Skënderbeu u nis për në tokat e babait të tij dhe gjatë rrugës që çonte në veri të Arbërisë, ai pushtoi kalanë e Koxhaxhikut dhe atë të Krujës. Më 1 mars 1444, në Kuvendin e Lezhës, që në këtë kohë ishte nën protektoratin e Venedikut ishte mbajtur *Kuvendi Besëlidhja e Krerëve Shqiptarë*. Skënderbeu u takua me prijësit dhe fisnikët tjerë shqiptarë me të cilët bëri marrëveshje, për një bashkim gjithëpopullor dhe me këtë rast

thuhet që u largua edhe nga feja islame. Natyrisht, në mënyrë të saktë askush nuk e di të vërtetën sekrete shpirtërore të tij, meqë ai ishte edukuar në dy kultura dhe në dy besime (religjioze monoteiste), i cili gjatë jetës së tij, përkrahu një tolerancë shpirtërore-fetare. *Ne mendojmë se Skënderbeu nuk luftoi apriori, as në emër të fesë të Jesu Krishtit, as kundër fesë islame, ai luftoi kundër forcës fizike të agresorëve dhe pushtuesve osmanë e jo kundër Forcës Hyjnore, e cila e frymëzonte në luftën e tij të drejtë për mbrojtjen dhe çlirimin e Tokës së Shenjët të Arbërisë ilire.*

Skënderbeu luftoi po ashtu, kur e kërkoi nevoja, edhe kundër venedikasve katolikë, meqë lufta e tij për mbrojtjen e atdheut edhe sipas Lamartinit, më tepër kishte karakter etnik-popullor se sa fetar. Në njësitë e tij ushtarake, përveç shqiptarëve të krishterë, kishte fisnikë dhe pjesëtarë të besimit islam, që luftonin së bashku kundër osmanëve, pikë së pari për mbrojtjen dhe çlirimin e atdheut, sikur që ekziston edhe *maksima pa atdhe nuk ka fe*. Këto luftëra që i zhvillonte Perandoria Osmane, në pamje dhe në formë dukeshin si fetare, por në esencë, në konfliktin e luftërave shqiptare-osmane, nuk kishin fare karakter fetar. Feja e popujve të krishterë ishte e mbrojtur me Ligjin e Sheriatit dhe dekretet e sulltanit. Shteti osman nuk kishte as ligje as projekte të sanksionuara për asimilimin etnik të popujve të ndryshëm që jetonin nën sundimin e tij. *Motoja e tyre kryesore e pushtimeve osmane* ishte zgjerimi i territoreve dhe shfrytëzimi i pasurive natyrore të shteteve të huaja të krishtera, por edhe të atyre islame. Ishte shtet i shumë grupeve etnike, religjioneve, i shumë kulturash dhe i shumë gjuhësh. Ka zhvilluar luftëra edhe kundër shteteve islame për të zgjeruar Perandorinë e vetë në tre kontinente, po si ajo e Romës dhe e Bizantit. Në kuadër të ushtrisë së saj kishte edhe ushtarë të krishterë të shteteve vasale që luftonin kundër shteteve arabe: Sirisë, Egjiptit, Jemenit, Tunizisë, Algjerisë e sidomos kundër Iranit etj. Andaj, luftërat e Skënderbeut, sipas mendimit të disa autorëve të huaj, madje edhe të disa atyre vendorë se gjoja kishin karakter fetar, nuk mund të qëndrojnë dhe nuk kanë mbështetje shkencore. Është fakt i pamohueshëm se luftërat e Skënderbeut kundër osmanëve ishin bërë digë dhe pendë kryesore, për një çerek shekulli, që e penguan depërtimin dhe pushtimit osman

të shteteve italiane dhe të Evropës së krishterë perëndimore, e cilat mjerisht, nuk e ndihmoi ushtarakisht shtetin e Arbërisë mesjetare të Gjergj Kastriot-Skënderbeut të mbijetojë, përveç disa ndihmave të vogla simbolike financiare që nuk mjaftonin as për furnizimin me armatim të nevojshëm.

Rezistenca 25-vjeçare dhe sakrificat e popullit shqiptar kundër pushtimit osman, më tepër shkoi në favor të shteteve italiane dhe Selisë së Shenjët, meqë shtetet përtej detit Adriatik mbeten të papushtuara nga agresioni i Perandorisë Osmane. Nuk ka kurrfarë dileme në mes studiuesve realë dhe objektivë që figura historike e Skënderbeut, jo vetëm në historiografinë kombëtare shqiptare, por edhe në atë evropiane, do të mbetet si një ndër strategët më të mëdhenj të doktrinës ushtarake të asaj kohe me përmasa ballkanike dhe evropiane, e para së gjithash si luftëtar legjendar dhe hero i përjetshëm kombëtar shqiptar, simbol dhe frymëzues i lirisë, i unitetit dhe i bashkimit gjithëkombëtarë, pa dallime fetare. Të gjithë ata studiues që janë të ngarkuar me premisa ideologjike fetare apo klasore-sektare dhe tentojnë që luftën e Skënderbeut, pa argumente shkencore, ta paraqesin vetëm si luftë fetare e jo si luftë për çlirimin social dhe etnik të popullit shqiptar dhe të tokës së Arbërisë mesjetare nën pushtimin osman dhe të atij venedikas, e zhvlerësojnë luftën e tij të drejtë çlirimtare e popullore dhe rëndë e cenojnë dhe e dëmtojnë unitetin mbarëkombëtarë dhe gjithëshqiptar.

Bibliografi

- *Başbakanlık Osmanlı Arşivi*, Tapu tahrir müdevver defteri, No 12, nga viti 1451/52.
- *Aşık Paşazade Tevarih-i Ali Osman*, Istanbul, 1900.
- Sadudin Hoca, *Tacu Tevarih*, Istanbul, 1895.
- *Sokolzade Tarihi*, Istanbul, 1895.
- Şukrullah, *Behcet ül Tevarih*, Hanover, 1925.
- Tursun Bey, *Tarih-i Ebul Feth*, Istanbul. 1914.
- Franz Babynger, *Die Fruosmanischen, Jahr bucher des Uredsc*, Hannover, 1925.
- Fetihname-i Sultan Mehmed, *published by Franc Babinger, Mearif Vekaleti yayinlardan*, Istanbul, 1965.
- Ermal Nurja, “Qasje ndaj indicieve në dokumentet osmane në lidhje me Skënderbeun”, *Revista, e Institutit për trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve*, Shkup, 2018.
- Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2018.
- Halil Inalcik, “Arnavutluk’ta Osmanli Hakimiyetinin Yerleşmsi ve Iskender Bey Isyaninin Menşei”, *Fatih ve Istanbul, Fethi Dernegi Tarafından yayinlanan iki aylık dergi*, I Cild, 29 Mayıs Isambul, 1953
- Halil Inalcik, “Iskender Bey, Osmanlilar’a karşı mücadele eden Arnavut Beyi”, *Islam Ansiklopedisi*, Istanbul, 1953.

- Halili Inalcik, *Suret-i, Defter-i, Arvanid, Ankara*, 1954.
- Ibn-i Kemal, *Tevarih-i Ali Osman*, VII Defter, Hazirlayan Dr. Şerafetin Turan TTK, Yazinlardan, III seri, No. 5, Ankara, 197.
- Iljaz Rexha, “Skënderbeu sipas veprës historike “Fatih ve Futuhati” të Ismail Ertaylan, botuar në librin”, *Skënderbeu dhe Evropa.*, Tiranë, 2005.
- Iljaz Rexha, *Vendbanimet dhe popullsia albane- sipas defterëve osmanë të shekullit XV*, Instituti I Historisë- Ali-Hadri, Prishtinë, 2016.
- Ismail Hikmet Ertaylan, *Fatih ve Futuhati II, Mars Matba’asi*, Ankara, 1966.
- Ismail. H. Danişmend, *Izahli Osmanli Kronolojisi*, I, Ankara, 1971.
- Ismail. H. Uzunçarşılı, “Arnavut Prensi meşhur Iskender bey’e ait orijial vesika”, *VI Türk Tarih Kongresi*, 20-26, Ekim, 196.
- Petrika Thëngjili, *Skënderbeu, Arritje-Mangësi*, Prishtinë, 2012.
- Sami Frashëri, *Skënderbeu, Kamus al Alam, Mihran matba’asi*, Istanbul, 1894.
- Selami Pulaha, *Lufta Shqipare -Turke në shekullin XV, Burime Osmane*, Tiranë, 1968.
- Süleyman Külçe, *Arnavudluk Osmanli Tarinde*, Izmir, 1944.

Myrvete DRESHAJ-BALIU & Begzad BALIU
(Prishtinë)

PORTRETI I SKËNDERBEUT NË LETËRSINË BOTËRORE

Abstrakt: Ky hulumtim ka për objekt studimi figurën historike të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut (1405-1468) dhe reflektimin e saj në letërsinë botërore. Skënderbeu është heroi ynë kombëtar që më së shumti i ka frymëzuar krijuesit e studiuesit e fushave të ndryshme të artit kombëtar dhe ndërkombëtar. Për të janë shkruar shumë vepra historike, publicistike, dokumentare dhe letrare, madje në të gjitha llojet dhe gjinitë letrare. Kjo figurë e madhe historike është përjetësuar nga krijuesit e botës artistike deri në mitizimin e saj, jo vetëm nga krijuesit shqiptarë, por edhe nga krijuesit e letërsisë së përbotshme: për atdhedashurinë dhe aspektin më njerëzor të tij, për strategjinë ushtarake të pashembullt në luftë me Perandorinë Osmane, si dhe përgjithësisht për dinjitetin moral e qytetërues të tij,

Në këtë rrjedhë, janë shkruar edhe studime mbi vendin dhe rëndësinë e tij në letërsinë botërore, por një sintezë gjithëpërfshirëse të këtyre veprave ende nuk e kemi as në letërsinë shqipe as në letërsinë e përbotshme. Prej kërkimeve dhe vlerësimeve të gjertanishme nuk është vështirë të shihet se për Skënderbeun vepra të karakterit historik, publicistik e madje filozofik e letrar kanë shkruar studiues, teologë, strategë e ushtarakë, politikëbërës e shkrimtarë, filozofë e historianë. Në veprat e tyre ata kanë identifikuar gjithë përbërësit historikë e etnografikë të kohës, brenda së cilës realizohet portreti dhe imazhi largvajtës i Skënderbeut, prirjet teoriko-letrare e

stilistike të veprave përfaqësuese për këtë hero, që nga imazhihistoriki tij deri te imazhi letrar e artistik, nga përpjekjet për të sjellë pamjen e vërtetë dokumentare, deri te sforcimi dhe mitizimi historik.

Në studimin tonë do të përpiqemi të bëjmë tipologjinë e pamjes fizike dhe karakterin luftarak të Skënderbeut, të përbërësve etno-psikologjikë e etikë të imazhit të tij, të ndërtuara në shkrimet e përbotshme letrare e artistike, qofshin ato prozaikë, poetike apo dramatike, si të poetëve: Pal Jovi, Jacques de Lavardin, Pierre de Ronsard, Edmund Spenser, Henry Wadsworth Longfellow, Margarita Sarroti etj.; të romansierëve: Antonio Posenti, Xheims M. Ludllou, Benjamin Disrael etj.; si dhe të dramaturgëve: Lope De Vega, Tomas Uinkop, Mauricio Gerardin etj.

Fjalë dhe shprehje kyçe: *Skënderbeu, imazhi reflektues, letërsia botërore, poezia, proza, drama*

Hyrje

Dy përvjetorë të rëndësishëm të kujtimit të Skënderbeut (1968, 2018), të shënuar në Kosovë dhe në Shqipëri, si dhe në disa qytete evropiane, i kanë nxitur hulumtuesit për të hapur shumë arkiva dhe zbuluar shumë vepra pothuajse të panjohura ndër biblioteka evropiane e botërore, si dhe përkthimin e ribotimit të shumë prej tyre, të cilat dëshmojnë për rolin e Skënderbeut në historinë kombëtare shqiptare, ballkanike, evropiane dhe botërore.

Vepra “Histori e Skënderbeut” e Marin Barletit, e botuar në Romë, më 1508, në latinisht, shënon shembullin e parë jo vetëm në kontekstin e së vërtetës historike po edhe të mendimit kritik, për diskutimin mbi përmasën filozofike e diturore të bëmave dhe misionit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në vendin e tij (Shqipërinë) dhe në hapësirën ballkanike e evropiane. Në këtë vepër, ngjarjet historike të së kaluarës përdoren edhe për të ilustruar idetë filozofike të autorit, siç është pikëpamja se në këtë botë asgjë nuk është e pandryshueshme, se ligjit të hekurt të ndryshimit i janë nënshtruar shtete dhe perandori me pasuri të pallogaritshme dhe me ushtri që

mbaheshin si të pathyeshme. Ky element do të jetë më reflektuesi dhe më mbamendësi për lexuesit e Evropës, se sa forca e mendjes dhe strategjia e njeriut janë triumfuese në çdo situatë.

Krijuesit shqiptarë të të gjitha periudhave edhe pas Barletit, si: Frang Bardhi, Jeronim de Rada, Naim Frashëri, deri te Sabri Godo, Fatos Arapi e Ismail Kadare, dhe studiuesit si: Fan Noli, Aleks Buda, Jup Kastrati, Selman Riza, Androkli Kostallari, Kristo Frashëri e të tjerë, kanë vazhduar ta përplotësojnë figurën e personalitetit të Skënderbeut në aspektin njerëzor, moral, strategjik e kombëtar në krijimtarinë artistike, si dhe ta hulumtojnë e studiojnë reflektimin e këtij personaliteti të madh në historiografinë botërore. Përgjithësisht, vlerësohet se ka dy grupe kryesore botimesh për Skënderbeun. Në njërën anë, qëndrojnë veprat me karakter të mirëfilltë historik, ku bëhen përpjekje për të ndërtuar e saktësuar më tej biografinë e heroit në kuadrin e ngjarjeve të epokës së tij, për të përcaktuar rolin e luftës së pamposhtur njëzetepesëvjeçare të shqiptarëve (...) të Evropës së shek. XV. Nga ana tjetër qëndrojnë veprat që kanë si qëllim thelbësor jo zbulimin e fakteve historike e rindërtimin sa më të dokumentuar të ngjarjeve, por trajtimin e figurës së Skënderbeut për qëllime të caktuara politiko-publicistike, filozofike e edukuese-didaktike, si edhe për krijime letrare-artistike të gjinive më të ndryshme. (Riza, 2016; Kostallari, 2018).

Në letërsinë botërore për Skënderbeun janë shkruar krijime letrare në të gjitha gjuhët e mëdha a më të vogla të kulturës së kohës, në të gjitha periudhat e mëdha historike dhe në të gjitha gjinitë dhe llojet letrare e artistike. Studiuesit e gjertanishëm kanë vënë re praninë e krijimeve letrare artistike në disa gjuhë të mëdha të kohës, sikur janë: tekstet historike, publicistike dhe letrare e artistike në gjuhën latine, frënge, angleze, gjermane, italiane, polake, spanjolle, greke, sllave dhe madje gjuhët e shteteve skandinave. Ata kanë vënë re praninë e teksteve historike, publicistike, filozofike, politike, letrare e artistike nga periudha e mesjetës së vonë deri në shekullin XX, por deri më tash një sintezë e plotë apo tipologji sintetike dhe historiko-letrare, më shteruese, ende nuk është bërë. Studime me karakter tipologjik e sintetik nuk janë bërë as për kronologjinë historiko-letrare të ndikimit të disa veprave themelore, sikur është ajo

e Barletit, e një kërkim shterues e dokumentues do të ishte me interes të bëhet së paku për natyrën historiko-letrare të përkthimit dhe ndikimit të veprës së Marin Barletit, *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut*, nga botimi i saj i parë më 1508 e deri më sot. Kjo vepër ka ushtruar ndikimin e saj në botimin, përmbajtjen, individualizimin e portretit të Skënderbeut dhe bashkëkohësve të tij në disa gjuhë dhe te disa autorë, të cilët kanë shkruar, traktate filozofike, poezi, poema, novela, drama, tragjedi, komedi, librete e romane, në gjuhë dhe në kohë të ndryshme.

Disa studiues kanë theksuar faktin se për Skënderbeun kanë shkruar përgjithësisht bardët kishtarë, filozofikë, politikë, strategjikë, ushtarakë e ekonomikë evropianë, në kohën kur ishin të bindur se rreziku nga Turqia nuk ekzistonte, por po të shihet më gjerësisht krijimtaria letrare edhe e mëvonshme, nuk është vështirë të kuptohet se vepra letrare e artistike për Skënderbeun janë shkruar, kur më shumë e kur më pak, në të gjitha periudhat historike, madje duke i zgjeruar përmasat stilistike të gjinive dhe llojeve letrare, nga tekstet historiko-letrare dhe poezia, të cilat mbizotëronin në fillim, me tekstet dramatike, teatrore e poemat, të cilat mbizotërojnë në periudhën e dytë, e madje deri te novelat dhe romanet, të cilat e mbizotërojnë periudhën e tretë.

Në studimet e gjertanishme skënderbegiane kanë munguar dhe vazhdojnë të mungojnë sintezat historiko-letrare për figurën e Skënderbeut. Vetëm në 500-vjetorin e vdekjes së tij janë bërë vlerësimet parasinjetizuese mbështetur në gjuhët e kulturat më të mëdha evropiane, autorët përfaqësues dhe veprat më me ndikim. Trajtimin e dyfishtë mbi tekstet historike dhe letrare të botuara gjithandej Evropës mund ta hapim me konceptet e historianëve, kritikëve dhe studiuesve të mendimit shkencor dhe letrar mbi historiografinë e Skënderbeut dhe Epokës së tij, Aleks Budës, Jup Kastratit, Selman Rizës, Androkli Kostallarit etj. Pas shumë teksteve përgjithësuese mbi mendimin shkencor shqiptar, evropian e botëror për vendin që zë Skënderbeu në historiografinë botërore, sintezat e para kritike të kësaj dijeje në gjysmën e dytë të shekullit XX, ia kanë sjellë Aleks Buda (1968) dhe Jup Kastrati (1969). I pari me konceptet përgjithësuese të disa prej veprave përfaqësuese, ndërsa i

dyti me paraqitjen shtruese të këtyre veprave, me interes edhe për studimet e mëtejshme skënderbegiane. Buda do të shquhet për pikëpamjet institucionale që shprehin dijet albanologjike, ndërsa Kastrati për tërësinë përmbajtjesore që kanë ato, pavarësisht periudhës së shkrimit dhe mesazhit që dërgonin (Kastrati, 1967, 1978).

Kjo është edhe arsyeja pse në këtë studim krijimtarisë letrare kushtuar Skënderbeut nga të huajt do t'i qasemi duke i identifikuar temat historike, bëmat ushtarake, karakterin kombëtar dhe gjithë përmasën e jetës së tij brenda llojeve e gjinive letrare, duke e konsideruar këtë një nismë modeste për sinteza të tjera të kësaj natyre edhe në të ardhmen.

Tash së fundi kërkimet për Skënderbeun jo vetëm janë thelluar, por edhe hapur në shumë drejtime. Tani bëhen kërkime jo vetëm për vepra të botuara kryesisht në hapësirën e gjuhëve më të mëdha evropiane (Agron Fico, 1967; Bulka, 1967; Jaka, 1979; Luarasi, 1967; Lacaj, 1967), po edhe në Amerikë (Qirzidhi, 2009; Sina, 2018; Daci, 2018 etj.) e madje edhe në shtetet Skandinave (Lloshi & John Quandrud, 2018) deri në Rusi e shtetet aziatike.

Portreti i Skënderbeut në poezinë botërore

Poezia është një prej gjinive letrare me të cilën shkrimtarët e të gjitha periudhave i kanë shprehur ndjenjat e tyre, përkushtimin ndaj Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe epokën e tij. Studiuesi dhe përkthyesi Fotaq Andrea, i ka ndarë në tri epoka interesimet e shkrimtarëve, përkatësisht poetëve për të shkruar poezi dhe poema për Skënderbeun. Sipas tij, epoka e parë përfshinë “periudhën e Rilindjes Evropiane me Gabriele Faernon e Luigi Groton, etj.; periudhën e luftës për pavarësinë greke në fillim të shekullit XIX, kur shkëlqyen Boçari me arvanitasit e tij dhe kur Bajroni përjetësoi shqiptarin historik të Skënderbeut me fustanellën e gjatë karakteristike; dhe më në fund periudhën e fillimit të luftës për pavarësinë shqiptare me Lidhjen e Prizrenit dhe kur De Rada i shkruante Lamartinit të madh e Dora d’Istrias në Amerikë dhe i kërkonte Longfellow, poetit kombëtar amerikan, të shkruante për

lavdinë skënderbegiane. Fakti është se nga Rilindja evropiane e gjer në ditët e sotme, figura e Skënderbeut ka qenë dhe mbetet simbol i përhershëm frymëzimi i vargut të ëmbël lirik e poetik” (Andrea, 2018).

Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe Shqipërinë i ka përjetësuar si një tërësi dhe në mënyrë të veçantë shkrimtari, udhëpërshkruesi dhe personaliteti i shquar i romantizimit evropian Gordon George Byron (1788-1824) me vargjet:

O Shqipëri ku lindi Skënderbeu!

Këng' e së ardhmes dhe fanar i të urtëve

dhe tjetri Skënderbe që shkoi e u drodh dheu

me shpatë preu çdo armik të udhëve.

Shqipëri, lejomë të kthej sytë mbi ty

o nën' e ashpër burrash të rreptë,

ja, kryqi po zbret e zbardhin minaret

dhe hën' e zbehtë ndrit nëpër lugina,

mbi drurët me selvi në çdo shesh pazari. (Qirzidhi, 2009: 72)

Për Skënderbeun ka shkruar Pal Jovi (1485-1552) sonetin brilant “Madhështi”, në të cilin ka përjetësuar gjithë biografinë e tij sa krenare po kaq edhe tragjike: nga fitoret e njëpasnjëshme të zhvarrimi i tij, i cili më parë se sa për anën tragjike të tij dëshmon për kthimin e tij në legjendë të një perandorie të pushtuar. Do të shkruaj më pas poeti dhe personaliteti i shquar i epokës së tij Jacques de Lavardin (shek. XVI); si edhe poeti i shquar i po kësaj epoke Petrus Regulus Vincentius, (1519-1581), duke e vendosur poezinë e tij në ballinën e botimit të parë të kryeveprës së Marin Barletit “Historia e Skënderbeut”, Romë, 1508-1510; poeti Dominicus Alezegnano Patavinus (shek. XVI), poeti Jamin Amadis (1540-1593), shkrimtari më me ndikim i rilindjes franceze Pierre de Ronsard (1524-1585); shkrimtari i periudhës skënderbegiane Gabriele Faerno (1510-1561); poeti Luigi Groto (1541-1585); poeti dhe personaliteti i shquar Edmund Spenser (1553-1599); shkrimtari i lavdishëm Théodore Agrippa D’Aubigné (1552-1630); shkrimtari amerikan Henry Wadsworth Longfellow (1807-1882), poezia e të cilit për Skënderbeun mund të konsiderohet ndër më të bukurat tekste poetike

skënderbegiane të shekullit XX; poetja dhe enciklopedistja e përmasave universale Margaret Sarroti (XVI-XVII), poeti kroat Andrija Kaçiq Mioshiq (1704-1760), shkrimtari maqedonas Grigor Perliçev (1829-1893) etj.

Siç mund të shihet prej teksteve të shkruara dhe të botuara kryesisht ndër botime historiko-publicistike për Skënderbeun, tekstet e poetëve, në të shumtën e rasteve janë poemtha të botuara ndër kopertina librash për Skënderbeun dhe trajtojnë kryesisht madhështinë e biografisë së tij, prejardhjen etnike arbërore/epirotase, luftërat dhe fitoret kundër Perandorisë Osmane, të qenit mbret i nderuar dhe i vlerësuar në sytë e Evropës, fundin tragjik të zhvarrimit të tij, situatë kjo, që më parë se anën tragjike do t'ia sigurojë shenjtërinë e tij.

Në këtë rrjedhë të sjelljes sa më të plotë të biografisë dhe bëmave të tij, shkrimtarët në radhë të parë kanë theksuar etninë, përkatësisht prejardhjen e tij: “prejardhjen epirotase”, (Patavinusi); madhështinë e vendit ku ka lindur: “Të madhit të Epirit, që aq ndritshëm ngadhënjën” (Patavinus); përkatësinë etnike dhe gjeografike “Gjak i kulluar mbretërisht të Epirit” (Amadis); përkatësinë shqiptare “O shqiptar prej fatit sjellë”! (Ronsardi); origjinën e lashtë etnike të tij “Të tillë Hero mes të lashtëve të tu, lum ai”! (Grotto); përkatësinë shqiptare dhe të virtyteve trimërore e luftarake të tij: “...Prisi trim shqiptar! (Sarrok) etj.

Poetët e të gjitha kohëve Skënderbeun do ta identifikojnë edhe me disa cilësi, disa veçori etike të karakterit të tij dhe estetike të pamjes së tij, si dhe do ta pasurojnë poezinë e tyre me shumë epitete, metafora e hiperbola. Le të sjellim disa nga ato: “rrufe”, “shpirtmadh”, “luan”, i krahasuar me Aleksandrin e Madh (Vincentius); “gjëni i lartë”, “shpirtmadh”, “Cezar i pamposhtur” (Patavinusi); “në radhën e perëndive”, “i përzgjedhur i perëndive”, “I denjtë për përjetësi”, “(Amadis); “guximtar prej trimit Akil” (Ronsard) etj.

Një prej veçorive sa tragjike aq edhe të lavdishme në biografinë e Skënderbeut është edhe zhvarrimi i tij, prej të cilës do të frymëzohen shumë krijues të poezive përkushtuese për jetën, veprën dhe pasurinë materiale e shpirtërore të tij. Këtë pamje tragjike do ta

theksojë madje njëri prej poetëve që ka shkruar mbase poezinë e parë kushtuar Skënderbeut, Pal Jovi, me titull “Madhështi”. Poezia e tij, përkatësisht soneti hapet me vargjet brilante:

*Në varrin tënd, o Gjergj, përmbyllur janë
rrënoja turke, mbrojtja epirote;
Por kockat e tua të shenjta pa marrëveshje kurrfarë
Në shumë vende u shpërndanë e depërtuan kudo,
(...) dhe mbyllet me vargjet:
Virtyti varr i jep çdo krijese,
Ty ta rrëmbeu varrin dhe të dhanë
Përjetësisht veç nder e madhështi (Jovi, 2018: 45).*

Në këtë rrjedhë shekujsh të përkushtimit të poetëve për figurën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ka vazhduar edhe me autorë, trajta dhe tema më bashkëkohore të shkrimit. Do të mund të shquanim këtu autoren e poemës homerike për Skënderbeun Margaret Sarroti (shek. XVI), shkrimtarin kroat, Andrija Kaçiq Mioshiq (shek. XVII), dhe shkrimtarin shumë të popullarizuar amerikan, Henry Wadsworth Longfellow (shek. XIX). Që të tre janë shquar me pikëpamjet e tyre mbi bëmat e Skënderbeut, luftërat e tij kundër Perandorisë Osmane, rolin e tij në organizimin e shtetit shqiptar, si dhe misionin e tij prej mbrojtësi të vlerave të qytetërimit perëndimor.

Autorja e parë Sarroti në poemën e saj tek biografia e Skënderbeut ka përjetësuar vlerat epike të tij, duke e parë atë në rrjedha të zhvillimeve të kohës. Karakteristikë e kësaj poeme është hapja e saj sipas natyrës së eposit ballkanik, duke përfshirë këtu edhe eposin shqiptar: “Trimërin’ e pashoqe këndo, o Zanë”, për të theksuar më tej prejardhjen trimërore shqiptare, besën e popullit arbëror, marrëdhëniet e tij me mbretërit e Napolit, lavdinë e fitoreve të tij etj. Edhe poema e Mioshiqit ndërtohet pothuajse krejtësisht mbi parimet e këngëve legjendare, duke përshkruar pothuajse me besnikëri disa aspekte të bëmave legjendare të tij. Ndonëse pa u larguar nga fatura historike, por duke sjellë edhe elemente lirike të jetës dhe shfaqjes historike të karakterit të brendshëm të Skënderbeut, sjell shkrimtari amerikan Longfellow, poemthi i të cilit

falë edhe përkthimit mjesh tëror të Nolit pati një perceptim të gjerë në letërsinë shqipe.

Skënderbeu në letërsinë romanore botërore

Nëse në periudhën e parë treshekullore, për Skënderbeun janë shkruar kryesisht poezi, poemtha dhe fjalë hyrëse kur historike, kur panagjerike e madje edhe kur filozofike, të cilat para se gjithash vendoseshin në hyrje të vëllimeve biografike dhe historike të veprave kushtuar heroit tonë kombëtar, në periudhën e dytë dhe të tretë botohen edhe vepra të llojeve e gjinive të tjera. Me gjithë atë për Skënderbeun janë shkruar vepra të tjera edhe në shekujt e parë të lavdisë së tij. Shembulli më i mirë është romani i shkrimtarit italian Antonio Posenti “Tmerri i turqve” (1548) dhe i shkrimtarit francez Yrben Shevro “Skënderbeu” (1644).

Pas poezive e poemthave, të vendosura kryesisht si hyrje për vepra të caktuara historike, publicistike e filozofike të botuara deri në shekullin XVI e më tej, në shekullin XVII fillon botimi i veprave me përmasa më të gjera letrare e krijuese, me tema më të gjera dhe me ndjenja më të thella krijuese, jo vetëm për luftërat e tij e betejat e veçanta antiosmane, po edhe për situata të tjera personale, shoqërore, aventura djaloshare, ndjenja familjare etj. Sikur ka vënë re studiuesi Androkli Kostallari “nga fundi i shek. XVII e në gjysmën e parë të shek. XVIII, në periudhën kur pakësohet rreziku otoman, trajtimi i figurës së Skënderbeut merr një karakter tjetër: vëmendja përqendrohet jo te luftërat e tij çlirimtare, po te peripecitë dhe aventurat e jetës së tij, te kthesat e papritura dhe çastet e mprehta, si shkëputja e tij nga oborri i turqve, lufta kundër atyre me të cilët kishte jetuar në moshën e re, vuajtjet dashurore e të tjera. Subjekte të tilla u dhanë fill sidomos romaneve të vëllimshme. (...) Më 1548 italiani Antonio Posenti botoi romanin “Tmerri i turqve”, i cili u ribotua edhe dy herë më vonë, dhe shkrimtari francez Yrben Shevro botoi në Paris, më 1644 romanin “Skënderbeu”, ndërsa po gjatë këtij shekulli një autor rus shkroi po një vepër të tillë, me titull “Tregime për Skënderbeun, princin shqiptar”. Por këto ishin, në thelb, romane historike, që lidheshin organikisht me gjithë letërsinë historike të

kohës së vet dhe që ndofta do të ishte më e drejtë të quheshin histori të romantizuara (Kostallari, 2018).

Në letërsinë angleze vepra e parë romanore kushtuar Skënderbeut nuk erdhi nga autorët anglezë. Romani i parë për Skënderbeun në gjuhën angleze erdhi i përkthyer nga letërsia franceze, respektivisht nga shkrimtarja Anne de la Roche Guilhem (1644-1707/1710). Guilhem kishte shkruar disa vepra gjatë qëndrimit në Angli dhe Holandë, por do të shquhet romani “Le Grand Scanderberg”(1688) (Kadija, 2018).

Sikur e ka theksuar studiuesi Androkli Kostallari, këto romane ishin, në thelb, romane historike, që lidheshin organikisht me gjithë letërsinë historike të kohës së vet dhe që ndoshta do të ishte më e drejtë të quheshin histori të romantizuara. Ato që në fillim shprehin qartë synimin e tyre politik, qëllim që aq bukur e pati formuluar më parë Kaspar Hedi. Antonio Posenti, (...) paralajmëron lexuesit që vepra e tij është një tregim “për prijësin më të guximshëm që ka parë ndonjëherë bota” dhe “nga ajo që bëri ai, të mësohet ajo që duhet bërë”. (Kostallari, 1988.) Në këtë periudhë edhe romansierja franceze dhe njëra prej grave të shquara të kohës Anne de la Roche Guilhem, botoi romanin e saj për Skënderbeun.

Njëra prej veprave padyshim më mbresëlënëse në letërsinë skënderbegiane është romani i shkrimtarit Xheims M. Ludllou, “Konstantini dhe Mersina” (*Një histori nga koha e Skënderbeut*), që në origjinal mban titullin: “The Capitan”. Fjala është për një histori ndërlidhësh ballkanike të personazheve, dhe përpjekjes së tyre për t’u çliruar nga Perandoria Osmane. Romani ka një masazh të dyfishtë: artistik dhe historik, për të mos thënë etik dhe estetik. Ai ndërtohet mbi dy linja komplementare: historike (si rrafsh i ambientit ku zhvillohen ngjarjet) dhe frymëzues e ndjenjor (si përmbajtje e brendshme e zhvillimit të ngjarjeve).

Në vepër vendosen përballë njëri-tjetrit dy personalitete historike të kohës, përkatësisht dy personazhe karakteresh të ndryshme, Ballabani dhe Skënderbeu. Në plan të parë del Ballabani dhe ëndrrat e tij fëmijërore për të qenë i pasur, i fuqishëm dhe urdhërdhënës i kohës së tij, ndërsa në plan të dytë Skënderbeu, një personalitet i ndjenjave krejt të tjera, i vlerave më pozitive edhe në

luftë edhe në paqe. Karakteri i Ballabanit në të gjitha rastet del në kontekstin më të errët edhe në marrëdhëniet e tij me Sulltanin edhe në ambientin e Perandorisë në Stamboll.

Raportet e egos së tij personale madje nuk dalin vetëm prej marrëdhënieve që ndërton me të tjerët, por në fund dalin edhe me vetveten. Edhe atëherë kur bie në dashuri me Mersinën, ai papritmas i thërret ndërgjegjes së tij: si është e mundur të bie në dashuri me tjetrën në vend se ta dua veten time! Urrejtjen e tij ndaj të tjerëve, duke mos parë me sy njerëzor as fëmijët dhe botën tjetër gjinore, do ta dëshmojë me rastin e hedhjes së një qeni të ngordhur në pusin e Kështjellës së Sfetigradit.

Ndryshe ndodh me çiftin Konstantini dhe Mersina, të cilët cilësohen për virtyte shembullore në raport me njëri-tjetrin dhe në raport me qëllimet për të cilat luftojnë ata. Megjithëse në rastin e parë, Ballabanin, kemi të bëjmë me një personazh sa artistik aq edhe historik, në rastin e dytë vetëm në kontekst të prejardhjes Konstantini dhe Mersina janë personazhe historike dhe komplementarisht artistike. Raportet e tyre shpirtërore dalin po kaq të shenjta sa edhe lufta e tyre e shenjtë në raport me atdheun e tyre.

Si i tillë romani “Konstantini dhe Mersina”, pasuron dyherësh dhe në mënyrë paralele jetën dhe veprën e Skënderbeut dhe personazheve historike të kohës; ndërton sisteme të reja paralele mes historisë dhe letërsisë, mes fiksonit dhe realitetit; si rrallë në ndonjë roman tjetër të shkruar deri në gjysmën e dytë të shekullit XX, korrespondojnë letërsia dhe historia duke i dhënë njëra-tjetrës. Nuk mund të mos thuhet madje edhe rëndësia që ka romani edhe në raport me romanin e shkruar në kohën tonë dhe ndikimin e tij. Përbërës historikë e letrarë të tij, si ai i helmimit të ujit, i gjejmë edhe te romani i Ismail Kadaresë “Kështjella” (1970).

Ndër romanet posaçërisht të njohura dhe të vlerësuara nga mendimi kritik i kohës e nga mendimi historiko-letrar është edhe romani i shkrimtarit anglez Benjamin Disrael, “Naltësimi i Skënderit” (1833). Shkrimtari, politikani, eseisti dhe autori i disa veprave me përmbajtje të rëndësishme shoqërore të kohës, kryeministri anglez me prejardhje hebreje Benjamin Disrael, ka shkruar edhe njërin prej romaneve më të mira për Skënderbeun dhe

kohën e tij. I frymëzuar nga Bajroni dhe vargjet e tij epike, ai edhe romanin e tij e shkroi në stilin romantik të kohës, duke vendosur në qendër të kohës tre nga personalitetet më të mëdha të kohës: Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, Gjon Huniadin dhe Sulltan Mehmetin II, i njohur edhe si pushtuesi i Kostandinopojës. Disraeli, ashtu si edhe Bajroni, më parë kishte bërë udhëtime në Mesdhe, duke vizituar disa nga shtetet më të rëndësishme të kohës, prandaj nuk është e rastit pse ndikimi helen, si edhe te Bajroni, në veprën e tij shfaqet gjerësisht.

Këtë e kanë vënë re edhe kritikët e veprës së tij. Madje edhe hapësirën ku vepron Skënderbeu ai e ndanë në tri pjesë: Shqipëri, Epir dhe Greqi. Dhe për më tej nuk është e rastit pse Nikeasi, princi fiktiv i Athinës, krahas Idunës, vajzës së Huniadit, del pothuajse kudo në gjithë romanin e tij. Në anën tjetër del gjeografia shqiptare, përkatësisht emrat e vendeve, si: Kruja, Petrela, Kalishta etj., të cilat përcaktojnë hapësirën shqiptare ku zhvillohen ngjarjet e romanit. Një linjë tjetër etnike dhe historike kombëtare përfaqëson historia tipike e marrjes peng të djemve të Gjon Kastriotit.

Studiuesi dhe përkthyesi shqiptar i veprës së Benjamin Disraelit, Malë Berisha, pasi ka identifikuar gjerësisht dhe thellësisht veçoritë historike dhe artistike të saj, ka theksuar edhe përmasën evropiane: “Parë në këndvështrimin pozitiv - shkruan Berisha - duhet theksuar se kjo vepër ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin e shumë fakteve historike të kohës, kur Shqipëria u vu nën rrezikun e zhdukjes nga harta e Evropës për shkak të pushtimeve osmane. Po ashtu, në këtë vepër evidentohet qartë mbrojtja që asaj i bëri Skënderbeu, i cili nuk e harroi atdheun e vet. Libri ka një natyrë shumë edukative-patriotike pasi në vazhdimësi përmend ndjenjat atdhetare, thirrjen e brendshme që Skënderbeu kishte për atdheun, detyra më fisnike që ai ja kishte vënë vetes në jetë, përplasja me fatin e vet për të mbrojtur dheun e të parëve” etj. (Berisha, 2018: 25).

Si i tillë, ky roman sjell një pamje interesante jo vetëm të figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe personazheve historike të bashkëkohësve të tij, po edhe perceptime të reja letrare e estetike në prozën skënderbegiane.

Skënderbeu në dramaturgjinë botërore

Vepra madhore për Skënderbeun dhe kohën e tij do të shkruhen edhe në gjininë dramatike, si drama, sidomos njëaktëshe, tragjedi, komedi, opera, balete etj. Me dramën dhe llojet e saj letërsia për Skënderbeun do të zgjerohet shumë për nga temat dhe motivet që do të trajtojë. Ndryshe nga poezia dhe poema, të cilat kishin karakter përgjithësisht historik dhe epik, ndryshe nga novela dhe romani në të cilët tema historike merr dimensione më të gjera historike dhe etnografike, drama dhe llojet e saj e zgjeruan shumë temën, motivin dhe karakterin jo vetëm historik, po edhe personal të Skënderbeut.

Drama e ka zgjeruar shumë dhe pakrahasueshëm konceptin evropian për Skënderbeun, hapësirën gjeografike të veprimit të tij, natyrën luftarake të tij, duke i dhënë asaj jo vetëm karakterin historik po edhe aventuristik, jo vetëm karakterin epik po edhe sentimental, si dhe duke e vendosur atë jo vetëm në hapësirën gjeografike të Shqipërisë por edhe të Greqisë, qendrës së Perandorisë Osmane, Italisë e më gjerë. Drama zgjeroi dukshëm pamjet nga ambientet historike, sallonet, kafenetë, ambientet urbane, më shumë se ato rurale në jetën dhe bëmat e Skënderbeut.

Drama, ai asnjë gjini tjetër, kushtuar Skënderbeut, u botuan dhe madje u shkruan vetëm për teatrot e kohës, po edhe për teatrot e hapura, për publikun e mbyllur, d.m.th. vetëm për mbretërit etj. Ato ishin drama klasike, tragjedi, drama shumë të popullarizuara “comedia famosa” dhe të ashtuquajturat “akte sakramentale”, pra pjesë njëaktëshe që shfaqeshin në zona të caktuara qytetare. Shumë nga ato u botuan dhe tani janë të njohura edhe për lexuesit dhe publikun e sotëm, por mjaft prej tyre janë të njohura vetëm fal tablove dhe reklamave të ruajtura në arkivin e institucioneve përkatëse.

Dramat për Skënderbeun, si askund tjetër dhe për askë tjetër, janë botuar dhe janë shfaqur në qendrat më të mëdha të Evropës dhe në gjuhët më të mëdha të saj: angleze, franceze, spanjolle, italiane dhe gjermane. Të dhënat bibliotekare, bibliografitë për dramën evropiane dhe studimet e gjertanishme për letërsinë skënderbegiane, dëshmojnë se për Skënderbeun janë shkruar drama nga shkrimtarë të

shquar të skenës evropiane, sikur është Lope de Vega dhe bashkëkohësit e tij, nga dramaturgë të shquar anglezë, francezë, bashkëkohës të Gëtes në letërsinë gjermane etj. Përveç komedisë së famshme të De Vegas, “Princi Skënderbej” (1562) vepra dramatike për Skënderbeun kanë shkruar edhe Perez de Montalban, “Princi i robëruar Skënderbej” (1629), Luis Valez de Guevara (1634), “I madhi Gjergj Kastrioti e princi Skënderbe”(1634), bashkautorët Belmonte Bermudez, Augustin Moreto dhe Antonio Martinez de Meneses “Princi i persekutuar”, shkrimtari Antonio de Meneses, “Shembull i virtyteve morale në jetën e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skënderbej” (1688) etj. Karakteristikë e teksteve dramatike të shkrimtarëve polakë, ndërkaq është gjuha latine e shkrimit të tyre. Shkrimtari Chelmsciane Lunae, ka shkruar dramën “Castriotto Georgius”, (1685) ndërsa shkrimtari Olszowski, ka shkruar dramën “Publica Sarmatiae felicitas in Scanderbego” (1714). Prapa, me tekstet e tyre dramatike të temës skënderbegiane nuk qëndrojnë as shkrimtarët anglezë. Kështu, shkrimtari Kristofor Marlout, botoi dramën “Historia e vërtetë e Gjergj Kastriotit”, shkrimtari Tomas Uinkop botoi dramën “Skënderbeu ose Liri e Dashuri”, shkrimtari Uiliam Havard botoi dramën “Skënderbeu”, ndërsa Xhorxh Lilo, botoi dramën e tij “Heroi i krishterë”, me të cilën sikur thuhet nuk pasuroi vetëm dramën dhe teatrin me temën për Skënderbeun po edhe dramën evropiane përgjithësisht.

Vend me rëndësi në dramën skënderbegiane zënë edhe shkrimtarët italianë dhe ata gjermanë. Rëndësia e këtyre teksteve nuk qëndron vetëm tek vlerat historike dhe artistike të teksteve të tyre, po edhe tek reflektimi i gjerë që patën ato gjatë shfaqjeve nga njëri teatër tek tjetri, për t’i kaluar një ditë edhe kufijtë e Evropës.

Në këtë rrjedhë do theksuar dramën e shkrimtarit italian Arkangelos, “Shqipëria e sulmuar” (1650), dramën e shkrimtarit Anton Zanibonit, “Trimëritë e princit Skënderbe, mundësitë e Sulltan Muratit” (1730), si dhe dramën në vargje të Mauricio Gerardinit, “Skënderbeu, princi i Shqipërisë” (1732). Karakteristikë e dramës gjermane është bartja e temës së Skënderbeut në hapësirën dhe ambientet e kohës për liri të popullit grek.

Me këtë temë shkrimtari gjerman Karl Sondershauzen, botoi dramën poetike “Çlirimi i Greqisë” (1821), ndërsa F. G. Rudbek botoi dramën historike “Skënderbeu” (1835).

Vepra letrare dramatike, në vargje dhe në prozë, më në fund kanë shkruar edhe shkrimtarët e Gadishullit Ballkanik. Shkrimtarët ballkanikë, për Skënderbeun kanë shkruar jo vetëm poezinë dhe prozën po edhe dramën dhe format e saj. Më 1889, shkrimtari grek Anton Antoniadhi botoi dramën “Skënderbeu”, ndërsa shkrimtari serb Jovan Steria Popoviqi, botoi komedinë po ashtu me emrin “Skënderbeu”(1848) (Schmaus, 1969: 161). Si edhe në dramat e shkruara në gjuhët e mëdha të Evropës edhe në dramat e letërsisë së popujve të Ballkanit, Skënderbeu del shembull virtyti i luftëtarit, model i karakterit human e synim çlirimtar i luftëtarit, pra shembulli më emblematik jo vetëm për popullin e tij, po edhe për popujt fqinj.

Përfundime

Për Skënderbeun është shkruar më shumë se pesë shekuj me radhë. Ato janë vepra të botuar në disa nga shtetet evropiane dhe në disa gjuhë të mëdha të popujve të Evropës. Pjesa më e madhe e tyre, fillimisht janë botuar nën ndikimin e përkthimit të veprës së Marin Barletit, “Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut”, por më tej ato sado kanë përdorur historinë si referencë, janë mbështetur edhe në botime të tjera dhe njëkohësisht kanë zgjeruar fushat e kërkimit, duke e parë atë edhe në kontekst të simbolit të mbrojtjes së krishterimit dhe rrezikut që mund të vinte nga Perandoria Osmane.

Për jetën dhe betejat e tij kundër Perandorisë Osmane është shkruar kryesisht gjatë shekujve XV-XVII, ndërsa tre shekujt e fundit luftërat e tij janë parë edhe në kontekst të filozofisë së lirisë universale, prandaj për Skënderbeun nuk janë shkruar vetëm poezi e pamflete historike dhe politike, po edhe drama, romane, tragjedi, komedi, poema epike e lirike, pra gjini e lloje të tjera letrare e artistike, nga Ballkani në Evropën Perëndimore e deri te Shtetet Skandinave e në Amerikë, dhe nga Mesdheu drejt Lindjes deri në Rusi. Veprat e gjinive dhe llojeve historiko-letrare, filozofike e

teologjike dhe kulturore e artistike, janë shkruar pothuajse në të gjitha gjuhët e mëdha dhe në gjuhët klasike.

Tekstet letrare e historiko-letrare të shkruara në gjuhë të ndryshme të botës dëshmojnë përpjekjen e shkrimtarëve për njohjen e thellë të personalitetit të tij, të biografisë jetësore të tij dhe të karakterit shpirtëror të tij, prandaj ato sjellin jo vetëm imazhe të jetës dhe betejave të tij, po edhe pamje historike e etnografike të shoqërisë shqiptare të kohës, si dhe ndjenja artistike e përjetime estetike të veprave të shkruara. Nuk është e rastit që poezitë e shkruara disa shekuj më parë, pra vetëm pas vdekjes së heroit tonë, në shekujt XV-XVII, nuk janë më pak të realizuara artistikisht se poezitë e shkruara në shekullin XX-XXI. Nuk është e rastit madje pse dramet, tragjeditë e komeditë e shkruara në shekujt e largët, sot i mungojnë teatrit shqiptar dhe teatrit evropian, si dhe nuk është e rastit që prej romaneve të shkruara shekuj më parë, janë frymëzuar edhe shkrimtarët e kohës sonë. Kërkimet e gjertanishme në fushë të botimeve skënderbegiane kanë dëshmuar se deri më tash janë botuar mbi 1 000 vepra, ndërsa disa dhjetëra botime e ribotime pritet të dalin gjatë vitit jubilar (2018), por prej aktiviteteve të gjertanishme shkencore një sintezë e madhe e tyre ende nuk është bërë. Prej kërkimeve arkivore dëshmohet se jo vetëm dokumentet pritet të zbulohen e botohen po edhe dorëshkrime veprash dramatike, të cilat ishin shkruar për teatrot e kohës, por nuk ishin botuar. Janë provuar të bëhen vepra dhe sinteza për portretin e Skënderbeut në gjuhë të ndryshme: angleze, italiane, spanjolle, gjermane, serbe etj., por ende nuk janë bërë sinteza të mëdha e gjithëpërfshirëse për imazhin e Skënderbeut në krijimtarinë letrare: poezi, dramë, romane etj., e të mos flasim për tekstet historike, biografike, publicistike, dokumentare, ushtarake, politike etj. Ende nuk kemi monografi të veçanta për imazhin e Skënderbeut në teatro, muzikë, pikturë, filma dokumentarë e artistikë etj. Sprova jonë që këtë ta bëjmë për gjininë poetike, prozaike dhe dramatike është vetëm një fillim iniciues dhe orientues.

Bibliografi

- Andrea, Fotaq (2018). *Njëmbëdhjetë poema për Skënderbeun nga autorë të shquar botërorë*, in <http://www.javanews.al/njembedhjetepoema-per-skenderbeun-nga-autore-te-shquar-boterore/> (14/01/2018 - 10:45).
- Barletius, Marinus (1508). *Mbi sjelljet e jetës dhe punët, veçanërisht kundrejt turqve, bëmat e Gjergj Kastriotit, princi i shkëlqyer i epirotëve, i mbiquajtur Skanderbeg për veprat e tij, ndryshe Aleksandri i Madh. Shkruar prej Marin Barlet Shkodranit* (Titulli i origjinalit lat. *De Vita Moribus Ac Rebus Praecipue Aduersus Turcas, Gestis, Georgii Castrioti, Clarissimi Epirotarum Principis, qui propter celeberrima facinora, Scanderbegus, hoc est, Alexander Magnus, cognominatus fuit, libri Tredecim, per Marinum Barletium Scodrensem conscripti*). Roma. Cituar sipas botimit shqip: Prishtinë, 2010.
- Berisha, Malë (2018): in Benjamin Israel, *Naltësimi i Iskënderit*. Prishtinë.
- Biçaku, Kasem & Kastrati, Jup (1997). *Gjergj Kastrioti Skënderbeu*. Bibliografi 1454 - 1835. I. Biblioteka Kombëtare. Tiranë,.
- Buda, Aleks (1968). *Figura e Skënderbeut në letërsinë botërore*. Rev. "Ylli", nr. 1. Tiranë.
- Bulka, Nonda (1967). *Skënderbeu dhe letërsia frënge* [Les lettres françaises et Skanderbeg], "Studime filologjike", 1967/4: 113, Tiranë.

- Daci, Halit (2018). *Scanderbeg in Anglo-American Literature* ("Skënderbeu në literaturën anglo-amerikane").
- Disraeli, Benjamin (1833). *The wondrous tale of Alroy*, 'The rise of Iskander', by the author of 'Vivian Grey', 'Contarini Fleming' etc. (Saunders and Otley, London 1833) 3 vol. Collected edition of the novels and tales by the Right Honorable B. Disraeli. New edition. 11 vol. Në studimin tonë e kishim parasysh botimin shqip të editorit "Koha", Prishtinë, 2018, me përkthim të Malë Berishës.
- Fico, Agron (1967). *Probleme të epikës popullore historike dhe figura e Skënderbeut* [Problèmes de l'épique populaire historique et la figure de Skanderbeg], "Studime filologjike", 1967/4: 33, Tiranë.
- Frashëri, Kristo. (2005). *Skënderbeu dhe Evropa*, në: Gjergj Kastrioti – Skënderbeu: 600 vjet pas. Edit., Dom Ndue Ballabani. Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci & Këshilli i Pakicës Kombëtare Shqiptare të Qytetit të Zagrebit.
- Frashëri, Naim. (1998). *Istori e Skënderbeut*. Prishtinë.
- Jaka, Ymer (1979). *Skënderbeu në teatrin frëng*, in "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", V, Prishtinë.
- Jovi, Pal (2018). *Madhështi*, është cituar nga përkthimi i poetit Xhevahir Spahiu, botuar në revistën "Illz", Tiranë, nr. 10/2018, f. 45.
- Kadare, Ismail. (2006). *Identiteti Evropian i Shqiptarëve*. Tiranë.

-
- Kadija, Refik (2018). *Figura e Skënderbeut në letërsinë angleze*. <https://telegرافي.com/figura-e-skenderbeut-ne-lettersine-angleze> (14.04.2018 • 16:40)
 - Kastrati, Jup (1967). *Botime për Skënderbeun në shek. XV, XVI*, “Buletin shkencor”, Shkodër, 1967, IV, 6, 71 - 88.
 - Kastrati, Jup (1969). *Problèmes de la Bibliographie rétrospective de Skenderbeg*. “Deuxième Conférence des Etudes Albanologiques”, 12 - 18 janvier 1968, pp. 709 – 717. Tirana.
 - Kastrati, Jup (1978). *Skanderbeg in European Literatura during the first half of the 17th century*, “New Albania”, 1:22. Tirana.
 - Kostallari, Androkli. (2014). *Figura e Skënderbeut në letërsinë botërore*. (<http://www.gazetadita.al/figura-e-skenderbeut-ne-lettersine-boterore/>). January 31, 2018 11:41.
 - Lacaj, Henrik (1967). *Skënderbeu në letërsinë italiane* [Skanderbeg dans la littérature italienne], “Studime filologjike”, 1967/4:131, Tiranë.
 - Luarasi, Skënder (1967). *Skënderbeu në letërsinë angleze* [Skanderbeg dans les lettres anglaises], “Studime filologjike”, 1967/4: 121, Tiranë.
 - Lloshi, Xhevat&Quandrud,John (2018). *Skënderbeu në vendet nordike*, Instituti i Studimeve Shqiptare dhe Protestante. Tiranë.

- Puto, Artan. (1912). *Nga Skënderbeu mitik në atë historik*, in: *Skënderbeu i kërkimit shkencor*, “Përpjekja”, yiti XIX, no. 28-29. Tiranë.
- Qirzidhi, Dionis (2009). *Lord Byron - Shtegtari i lirisë*. Tiranë.
- Riza, Selman. (2016). *Gjergj Kastrioti–Heroi në këndvështrimin e shkrimtarëve të huaj* (<https://www.voal.ch/gjergj-kastrioti-heroi-ne-kendveshtrimin-e-shkrimtareve-te-huaj-studim-nga-selman-riza/>). By voal.ch | January 17, 2016.
- Schmaus, Alois (1969). *Skanderbeg in der serbischen Literatur*: in *Studia Albanica Monacensia*, 146–175.
- Schmitt, Oliver Jens. (2012) *Kosova: Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. trans., Enver Robelli. Prishtinë.
- Sina, Beqir (2010). *Skënderbeu në literaturën anglo-amerikane*, http://fryma.blogspot.com/2010/08/skenderabeu-ne-literaturen-anglo_11.html.

Mirie RUSHANI
(Shkup)

**GJEOGRAFIA POLITIKE E EVROPËS NË SHEK. XV DHE
IDEJA PËR MBROJTJE TË PËRBASHKËT NË LUFTËN
KUNDËR INVAZIONIT TURK**

Hyrje

Ideja për mbrojtje të përbashkët nuk është e re e as e panjohur në historinë e Evropës. Atë mund ta gjejmë të artikuluar në forma të ndryshme, qysh prej mesjetës e deri më sot. Por, ne do të përqendrohemi në shek. XV kur ajo fiton kontura dhe dimensione të reja e nxitur edhe nga invazioni turk. Kjo ide mandej do të ngritet edhe në projekt panevropian.

Prej idesë deri te projekti

Në të vërtetë konturat e para të kësaj ideje fillojnë të duken qysh kur perandori Aleks I Komneni, kërkoi ndihmë nga Papa për luftën kundër turqve selxhukë, si edhe ribashkimin e kishës duke pranuar që Kisha Lindore t'i nënshtrohet primatit të Papës. Gjithashtu edhe perandori Mikel Paleologu VIII, në vitin 1261 pasi e rimori Kostandinopojën, kërkoi sërish bashkimin e kishave si instrument i fuqishëm për arritjen e paqes me perëndimin katolik me qëllim të mbrojtjes së përbashkët. Do të ketë edhe një varg përpjekjesh tjera të pasuksesshme kryesisht për shkak të rrjedhave brenda vet Kishës Perëndimore (lëvizjet heretike, skizma e

brendshme dhe lëvizja për reforma). Krejt këto ngjarje shkonin në dobi të ambicieve turke.

Për këtë qëllim, me iniciativën e perandorit Sigismund, u thirr Kuvendi i Përgjithshëm (Ekumenik) i Kishës në Kostancë të Gjermanisë, për t'i dhënë sa më shpejt fund skizmës së Perëndimit dhe konflikteve. Por, nën ndikimin e perandorit fuqizohet Kuvendi dhe vendoset mbi autoritetin e Papës. Më 1431, u mbajt Kuvendi i Përgjithshëm i Kishës në Bazel të Zvicrës, me një rend dite edhe më të rëndësishëm: bashkimi me Kishën Lindore dhe reforma e Kishës etj. Megjithatë, ky Kuvend i ratifikoi edhe vendimet me të cilat paralizohej pothuajse plotësisht autoriteti i Papës për shkak të qëndrimeve nënshtruese të papëve ndaj sundimtarëve dhe korrupsionit të vet institucionit, prandaj pushteti vendimmarrës kalon te Kuvendi i Përgjithshëm. Papa Eugjeni IV nuk e pranon këtë dispozitë dhe krijohet sërish konflikt jo i vogël. Andaj, Papa e tërhoqi Kuvendin në Ferara dhe me sukses e largoi fraksionin francez, i cili i vazhdoi punimet dhe sërish zgjodhi një antipapë nga familja Savoja *profranceze*, nga ato forca politike që nuk janë të interesuar të marrin pjesë në luftërat antiturke.

Derisa ndodhnin gjithë këto gjëra negative, në të njëjtën kohë në Kuvendin e Ferarës-Firences arriti një delegacion i madh i një elite të zgjedhur kishtare, intelektuale e politike në krye me vet perandorin Gjon Paleologun VIII dhe patriarkun e Kostandinopojës Jozefi II. Kjo tregonte se ishin të gatshëm të bëjnë çmos për të filluar një epokë të re. Roma gjithashtu tregoi gatishmëri të plotë. Më në fund u nënshkrua akti i madh historik që dëshmoi se megjithatë ekziston një diçka e fuqishme evropiane të cilës i nënshtrohen edhe të dy kishat. Të gjitha këto ndikuan që të forcohet rezistenca antiturke në Ballkan, por kur në vitin 1454 ra Kostandinopoja dhe u zhduk Bizanti tragjikisht, u krijua një dëshpërim dhe frikë e paparë në krejt Evropën. Ndihmat nga Evropa kishin qenë pak dhe nuk kishin mbërri me kohë!!! Evropa politike nuk u tregua as e aftë e as serioze në trajtimin e këtij rreziku. Por ka ende forca dhe lëvizje që edhe mëtej do të kërkojnë zgjidhje. Papa e shpalli “Vit Jubilar” vitin 1450, me ç'rast u mblodhën fonde të konsiderueshme për luftën antiturke. Le ta përmendim edhe Projektin e Alfonsit V, gjithashtu

me shumë rëndësi, por ai nuk kishte besim te sundimtarët evropianë, prandaj nëse nuk do mund të bashkoheshin të gjithë në një front atëherë ai do ta vazhdonte idenë e tij për një perandori mediteranike.

Por, vdekja e Alfonsit, 1458, e shuajti këtë ide, e me këtë shqiptarët dhe hungarezët humbën një mbështetës të madh politik e ushtarak. Edhe një tjetër projekt i rëndësishëm i këtij lloji lidhet me figurën e Jirzhi Poxhibradi (1420-1471) udhëheqës i Husitëve që u bë mbret i Bohemisë, më 1458, i cili predikon një perandori laike. Me këtë Projekt-Marrëveshje (1462), ai propozon njëaleancë midis të gjithë mbretërve të Evropës. Ndërsa, është përjashtuar perandori dhe Papa. Sipas Jirzhit, kjo do të ishte një Evropë e re e shteteve të pavarura, me një fjalë një federatë që do të mbështetet mbi gjendjen reale të gjërave dhe do ta pengojë anarkinë e sovranitetit. Vetëm kështu do të mund të dëbohen turqit nga Evropa.

Ky dokument ka rëndësi, sepse, për herë të parë e kemi një plan-projekt të skicuar në detaje për një konfederatë gjithëpërfshirëse të krejt kontinentit të Evropës me çka do të hiqet sovraniteti i shteteve. Kështu do të ndalen konfliktet. Ndërsa, luftën apo mbrojtjen nga turqit e sheh si me më prioritet. Projekti kishte një të metë: përjashtojë Papa i vetmi institucion mbinacional. Kjo ide do të dështojë dhe për shkak se Poxhibrad ishte futur nënjë spirale konfliktesh fetare e civile që do të merr flakënë krejt Evropën Qendrore e Perëndimore. Më në fund kemi edhe një traktat i cili do ta avancojë edhe më shumë këtë ide dhe do ta ngrejë në projekt panevropian.

Vepra e humanistit të madh Enea Silvio Pikolomini, Papa i ardhshëm Piu II. Vepra e tij e shkruar në latinisht në formë Traktati “De Europa” (1458), bëri bujë të madhe. Autori prezanton një Evropë që deri më tani askush nuk e kishte njohur kaq gjerë e kaq thellë. Këtu midis tjerash vizatohet shumë qartë ideja për mbrojtje nga invazioni turk. Tani në rolin e Papës ai do të merr ta realizojë këtë projekt madhor të jetës së tij. Ai cakton njëKongres me të gjithë sovranët e Evropës në Mantova të Italisë (1462), me një qëllim të vetëm: organizimi i një kryqëzate gjithëevropiane, e cila do ta dëbonte turkun përgjithmonë nga tokat e Evropës. Në këtë kongres morën pjesë kryesisht ata që ishin aleatë midis veti me shqiptarët dhe

hungarezët: ambasadori i mbretit të Aragonës, i mbretit të Napolit, Venedikut, Firences, Ferarës, Lukës, Bolonjës, të Shqipërisë (Epiri dhe Iliria), të Peloponezit, Lesbosit dhe Qipros. Të gjithë u deklaruan të gatshëm ta realizojnë këtë vendim edhe me sakrificat më të mëdha, derisa ta dëbojnë (largojnë) turkun një herë e përgjithmonë në Azi. Më 1463, Papa e nxori edhe *Bullën* me të cilën u shpall lufta. Caktohet vendi i tubimit në Ankona prej ku do të niseshin ushtria drejt Raguzës ku i prishte Skënderbeu dhe Matia Korvini, të cilët do të komandojnë me ushtrinë. Papa i sëmure por i vendosur, arriti në Ankona me qëllim që t'i bashkohet kryqëzatës, por çfarë gjeti? Kurrë nga ajo që kishte shpresuar: nuk kishte kurrfarë ushtrie profesionale, ishin vetëm disa mijëra ushtarë pa armë dhe pa para. Ndërsa, anijet veneciane do vijën me vonësë pas dy muajve dhe nuk mjaftonin për bartjen e ushtarëve. Ky ishte një opstrucion dhe skandal historik. Vetëm tre ditë më vonë, më 14 gusht 1464, Papa ndërroi jetë, ndërsa anijet veneciane u kthyen në shtëpi. Kështu mori fund edhe shpresa e fundit e Skënderbeut. Evropa tani doli të ishte një vend i mjerë...për të cilën më vonë Luteri nga pezmi do të kërkojë kërbaçin e zotit (turqit) që të vijë e t'ua kthejë mendtë në kokë krishterëve apo evropianëve.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes

(Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “*Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes*”, mbajtur në Prishtinë, më 16 tetor 2018)

Botues:

Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë

Formati:

14.8 x 21.8 cm.

Madhësia:

19.75 ta.

Tirazhi:

500 ekzemplarë

U shtyp në shtypshkronjën:

Blendi - Prishtinë

Prishtinë

2019